



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LEGJISLATURA X - SEANCA E DITËS SË ENJTE, 15 QERSHOR 2023, TIRANË

PROCESVERBAL

SEANCËN E DREJTON
KRYETARJA E KUVENDIT
LINDITA NIKOLLA
(Seanca filloi në orën 10:00)

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 08.06.2023 (neni 44, pika 2 e Rregullores)

2. Njoftime (neni 44, pika 3 e Rregullores)

3. Raporti vjetor i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për vitin 2022 (neni 39 i ligjit nr. 9049/2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar”) dhe neni 103 i Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratimin e projektrezolutës)

Paraqitja e raportit nga Inspektorja e Përgjithshme, zonja Evgjëni Bashari, jo më shumë se 20 minuta.

Shprehet për projektrezolutën Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Pyetje

Zhvillimi i debatit (nëse kërkohet me shkrim nga një komision i përhershëm, një kryetar grupi parlamentar ose të paktën 10 deputetë).

Koha e votimit të projektrezolutës

4. Raporti vjetor i Departamentit të Administratës Publike për vitin 2022 (ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar”), si dhe neni 103 i Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratimin e projektrezolutës)

Paraqitja e raportit nga drejtoresha e DAP-it, zonja Albana Koçiu, jo më shumë se 20 minuta.

Shprehet për projektrezolutën Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Pyetje

Zhvillimi i debatit (nëse kërkohet me shkrim nga një komision i përhershëm, një kryetar grupi parlamentar ose të paktën 10 deputetë).

Koha e votimit të projektrezolutës

5. Raporti vjetor i veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2022 (*neni 24 i ligjit nr. 9121/2003 "Për Autoritetin e Konkurrencës" dhe neni 103 i Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratimin e projektrezolutës*)

Paraqitja e raportit nga titullari, zoti Denar Biba, jo më shumë se 20 minuta.

Shprehet për projektrezolutën Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Pyetje

Zhvillimi i debatit (*nëse kërkohet me shkrim nga një komision i përhershëm, një kryetar grupi parlamentar ose të paktën 10 deputetë*).

Koha e votimit të projektrezolutës

6. Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë (huamarrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW Frankfurt am Main (KfW) për programin "Për menaxhim të qëndrueshëm dhe miqësor me klimën në sektorin e mbetjeve të ngurta" (*në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, shkronja "ç", të Kushtetutës, dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë absolute votash për miratim*)

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Politikën e Jashtme.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Ekonominë dhe Financat.

Diskutime

(*Shprehen grupet parlamentare.*)

Koha e votimit

7. Projektligji "Për pranimin e protokollit për ndryshimin e marrëveshjes së Marrakeshit për themelimin e Organizatës Botërore të Tregtisë, marrëveshja për subvencionet e peshkimit" (*në mbështetje të neneve 78 dhe 83, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë absolute votash për miratim*)

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme.

Diskutime

(*Shprehen grupet parlamentare*)

Koha e votimit

8. Projektligji "Për qeverisjen elektronike" (*në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim*)

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Ekonominë dhe Financat.

Diskutime

(*Shprehen grupet parlamentare.*)

Koha e votimit

9. Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar (*në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim*)

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Europiane.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Ekonominë dhe Financat.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Diskutime

(*Shprehen grupet parlamentare.*)

Koha e votimit

10. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (në mbështetje të nenit 45 të Rregullores së Kuvendit, çdo deputet mund të flasë jo më shumë se 5 minuta dhe, nëse diskuton në emër të grupit parlamentar, jo më shumë se 8 minuta. Koha e diskutimeve për çështje jashtë rendit të ditës nuk mund të jetë më shumë se 60 minuta),

Lindita Nikolla – Mirëdita!

Hapim seancën plenare.

Në bazë të nenit 30 të Rregullores, ju bëj të njohur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

(Pasi lexon rendin e ditës.)

Të nderuara kolege e kolegë deputetë, para se të fillojmë shqyrtimin e çështjeve të rendit të ditës, ju njoftoj se Kuvendi i Shqipërisë do të nderojë kujtimin e ish-Kryeministrit të Italisë, Silvio Berlusconi, i cili u nda nga jeta më 12 qershor, dhe në orën 12:00 do të mbajmë minutën e heshtjes në nderim të tij.

Ju lutem, njoftoni kolegët!

Fillojmë me çështjet sipas rendit të ditës: miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 08.06.2023. Procesverbalin e keni marrë në rrugë elektronike.

Ka ndonjë vërejtje? Nuk ka.

Miratohet.

Ju njoftoj se në Kuvend janë depozituar dy akte nga Këshilli i Ministrave dhe një projektligj i depozituar nga deputetë. Titujt e çështjeve të depozituara i gjeni në sistemin këtu në sallë, ndërsa materialet në sistemin “e-Parlament” dhe në faqen e Kuvendit në internet.

Ju njoftoj se kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike dhe një grup deputetësh, në bazë të nenit 103, pika 8 e Rregullores, kanë paraqitur kërkesën për diskutime për raportin vjetor të Departamentit të Administratës Publike për vitin 2022 dhe për raportin vjetor të veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2022.

Konferenca e Kryetarëve, në zbatim të nenit 103, pika 8 e Rregullores, ka vendosur që koha e debatit për raportet e mësipërme të jetë 1 orë e 30 minuta për çdo raport. Në bazë të nenit 48, pika 3 e Rregullores, koha prej 90 minutash do të ndahet

në mënyrë përpjesëtimore ndërmjet grupeve parlamentare.

Gjithashtu, nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste dhe ai i Partisë Demokratike janë depozituar propozimet për anëtarët në komisionet e përhershme parlamentare, vendime të cilat do të votohen në fund të diskutimeve.

Vijojmë me rendin e ditës: raporti i veprimtarisë vjetore të Departamentit të Administratës Publike për vitin 2022.

Në bazë të nenit 103, pika 2 e Rregullores së Kuvendit dhe ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar”, sot do ta paraqesë raportin vjetor për vitin 2022 një anëtar i Këshillit të Ministrave, zonja Milva Ekonomi, ministre e Shtetit për Standardet dhe Shërbimin.

Zonja Ekonomi, fjala për ju.

Koha në dispozicion është deri në 20 minuta.

Milva Ekonomi – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Faleminderit, zonja Kryetare e Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Siç ju e dini, reforma në administratën publike ka qenë dhe vijon të mbetet në vëmendjen e qeverisë shqiptare si një ndër reformat më të rëndësishme për zhvillimin e vendit dhe për integrimin e vendit tonë në Bashkimin Europian.

Ndaj sot unë po prezantoj para jush progresin dhe masat e marra nga qeveria shqiptare në drejtim të reformës në administratën publike gjatë vitit 2022.

Administrata publike përbën themelet mbi të cilat zbatohet çdo nismë apo reformë në drejtim të zhvillimit ekonomik dhe social të vendit. Cilësia, profesionalizmi, paaënësia dhe integriteti i administratës publike janë kriteret e domosdoshme për një administratë të suksesshme në shërbim të plotë të qytetarëve, në një mënyrë sa më transparente.

Reforma e administratës publike në Shqipëri ka tashmë prej 8 vjetësh një kornizë të mirëpërcaktuar, e cila formalizohet në Strategjinë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike dhe përbën dokumentin bazë ku kjo reformë bazohet. Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike është një dokument strategjik i periudhës 2015-2022 dhe përcakton objektivat kryesorë të institucioneve, mbi bazën e të cilëve ne vlerësohemi në mënyrë periodike nga Komisioni Europian dhe struktura të tjera që monitorojnë progresin e vendit.

Falë bashkëpunimit me të gjitha institucionet përgjegjëse për këtë reformë ndërinstitucionale, sot ne mund të themi me kënaqësi që periudha 2015-2022 e ka të realizuar reformën në masën 97%; janë realizuar 126 aktivitete ose nënaktivitete, nga 130 që ka caktuar kjo Strategji. Kjo arritje është tejet pozitive dhe i atribuohet, në radhë të parë, ndjekjes së objektivave të përcaktuar në Strategji, buxheteve të planifikuara nga institucionet, por edhe koordinimit që ka bërë Departamenti i Administratës Publike me çdo institucion të përfshirë në zbatimin e Strategjisë.

Viti 2022 përkoi me përfundimin e Strategjisë Ndërsëktoriale të Reformës në Administratën Publike dhe Departamenti i Administratës Publike ka nisur punën për hartimin e strategjisë së re të reformës ndërinstitucionale në administratën publike për periudhën 2023-2030. Për këtë janë bërë shumë konsultime me grupe pune, organizata partnere dhe ky dokument po shkon në linjë me të gjitha parimet strategjike që ka administrata publike në vendet e Bashkimit Europian dhe po ndjek një nga një të gjitha parimet e Bashkimit Europian të konfirmuara për një administratë publike të hapur, transparente dhe profesionale. Në fakt, Bashkimi Europian ka gjashtë parime kryesore, ku e mbështet reformën në administratën publike dhe Shqipëria është duke i ndjekur këto në mënyrë tejet rigorozë.

Me fillimin e negociatave me Bashkimin Europian më 19.07.2022, reforma në administratën publike përbënte një nga piketat hapëse të *cluster*-it të parë, që ishte ai politik. Prandaj për të bërë reformën e re të administratës publike gjatë vitit të kaluar deri sot janë kryer një sërë takimesh jo vetëm me institucionet publike shqiptare, me institucionet e administratës publike të Bashkimit Europian, por edhe me vetë komisionerët e Bashkimit Europian.

Në radhë të parë, kërkohet që ne t'i përmbushim me shumë sukses detyrat për një anëtarësim të mirë, ndaj edhe në takimin bilateral, që u mbajt në dhjetor të vitit të kaluar, Shqipëria raportoi të gjithë progresin që kishte bërë në implementimin e reformës ndërinstitucionale të administratës publike.

Sot, përveçse ne duhet të ndjekim parimet, na kërkohet të hartojmë edhe një *roadmap* ose një udhëzues që ka të bëjë me parimet e administratës

publike, ndërkohë Departamenti i Administratës Publike me të gjitha institucionet e përfshira po punon pikërisht për hartimin e tij.

Unë besoj shumë fort se ky kuadër i ri politik që ne po hartojmë, në bashkëpunim me partnerët tanë, do të jetë një shtyllë edhe më e madhe angazhimi për të gjitha institucionet e përfshira. Të mos harrojmë se masat kanë të bëjnë me hartimin e strategjive sektoriale, me koordinimin më të mirë të financave publike, me luftën kundër korrupsionit, me mënyrën se si ne rekrutojmë në administratën publike, siç ka të bëjë edhe me dhënien e shërbimeve publike ndaj qytetarëve dhe bizneseve. Të gjithë këta kanë indikatorë që maten dhe mbi bazën e të cilëve, gjithashtu, përllogaritet edhe ndihma që Bashkimi Europian jep për vendet si Shqipëria, të cilat e kanë hapur tashmë procesin e anëtarësimit.

Për të kaluar nga fusha e reformës në administratën publike në fushën tjetër, që ka të bëjë me shërbimin civil dhe menaxhimin e burimeve njerëzore, unë dua t'ju vë në dijeni se ne sot kemi një kuadër të plotë ligjor, të qartë dhe të konsoliduar që e ka përmirësuar ndjeshëm menaxhimin e burimeve njerëzore. Procesi është i digjitalizuar tërësisht. Ai fillon që nga aplikimi për pozicion pune, vlerësimi i dosjes së aplikantit, gjenerimi automatik i pyetjeve për testin me shkrim, si dhe korrigjimi elektronik që u bëhet këtyre testeve për të garantuar një rekrutim të bazuar mbi meritën.

Në këtë kontekst, vitin që lamë pas, për të cilin po raportojmë, mund të themi se puna e Departamentit të Administratës Publike ka qenë e fokusuar, së pari, në plotësimin e vendeve vakante në Shërbimin Civil. Këtu duhet të kemi parasysh një moment të vështirë të muajit korrik të vitit të kaluar, kur Shqipëria u cenua nga krimi kibernetik dhe disa pjesë të infrastrukturës së sistemeve shtetërore, sikurse ishte ai i DAP-it, u ndikuan nga ky sulm.

Megjithatë, pavarësisht kësaj, nga Departamenti i Administratës Publike mund të themi se janë realizuar: plani vjetor i pranimit në masën 89% dhe në masën 78% plotësimi i vendeve vakante në raport me pozicionet e shpallura; janë shpallur 1070 pozicione të lira, janë zhvilluar 576 procedura konkurrimi, si dhe janë plotësuar 830 vende vakante.

E rëndësishme është që ne kemi një mobilitet të lartë në Shërbimin Civil, një tregues

ky i rëndësishëm kur vjen fjala për të folur për efikasitetin në administratën tonë publike dhe për të promovuar karrierën e punonjësve civilë.

38% e këtyre pozicioneve, pra 316 nga 830 pozicione vakante të plotësuara, janë bërë nëpërmjet lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë me nëpunës që vijnë brenda Shërbimit Civil.

Së dyti, është punuar për rritjen e pagave.

Qeveria shqiptare, siç e dini, e ka pasur në fokus reformimin e sistemit të pagave prej 3 vjetësh dhe për këtë arsye Departamenti i Administratës Publike, së bashku me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe me mbështetjen e projekteve të IPA-s dhe SIGMA-s kanë realizuar një analizë shumë sistemike të sistemeve aktuale që ne përdorim.

Në bazë të analizës së kryer u arrit në konkluzionin që sistemi i pagave për nëpunësit civilë dhe nëpunësit e tjerë, që i referohet së njëjtës skemë page, ka nevojë jo thjesht për rritje, por ka nevojë edhe për përmirësimin e disa elementeve që lidhen kryesisht me shpërblimin e drejtë, të bazuar në përgjegjësi dhe në funksione, por edhe bazuar në eksperiencën, që është një vlerë e shtuar të cilën secili prej njerëzve që ka një eksperiencë në vendin e punës, i shton vlerë produktit që nxjerr.

Në vijim të rekomandimit për politikat e pagave për nëpunësit civilë, me partnerin tonë ndërkombëtar SIGMA, që na ka asistuar që në krye të herës, janë zhvilluar konsultime dhe është punuar disa herë për skemën e pagave më të përshtatshme që duhet të aplikohet në Shqipëri. Në të gjitha këto skema është marrë në konsideratë edhe eksperiencia e vendeve të tjera për të pasur një përafrim më të mirë të sistemit të pagës. Këto diskutime sollën propozimin e dy ligjeve të rëndësishme të cilat ne i kemi miratuar në Kuvend: ligjit “Për hierarkinë e pagave të titullarëve të institucioneve të pavarura” dhe ligjit “Për kompetencat e caktimit të pagave” që i hapën rrugë reformës së rritjes së pagave, e cila do të shtrihet në dy vjet.

Sot ne kemi një rritje të pagës minimale. Në qoftë se flasim për vitin 2022, na kujtohet të gjithëve se paga minimale nga 30 mijë lekë në muaj, kaloi në 34 mijë lekë në muaj, ndërsa sot që flasim, që nga 1 prilli i këtij viti, paga minimale ka shkuar 40 mijë lekë në muaj.

Gjithashtu, ne e dimë shumë mirë se, duke filluar që nga prilli i këtij viti, paga mesatare e

punonjësve në sektorin publik do të shkojë nga 530 euro, në 900 euro, në fund të korrikut të vitit të ardhshëm.

Së treti, është punuar shumë edhe për rienergizimin e administratës publike.

Duke pasur parasysh dhe në qendër të vëmendjes performancën, ne i kemi kushtuar një vëmendje të veçantë promovimit të ekselencës dhe promovimit të një kulture të re pune. Është rasti të përmendim krijimin e qendrave të ekselencës nëpërmjet programit “Gati për Shqipërinë”, një program i cili synon të sjellë individë të diplomuar jashtë apo brenda vendit, të cilët kontribuojnë me ide, projekte dhe iniciativa të ndryshme zhvillimore dhe që nga fillimi, nga viti 2019, sot kemi të punësuar gjithsej në administratën publike 793 studentë ekselentë.

Një projekt tjetër i rëndësishëm që Departamenti i Administratës Publike po zbaton për të rienergizuar administratën, është projekti që quhet “*Young Cells*”, një projekt i ndihmuar nga Bashkimi Europian nëpërmjet fondeve të IPA-s, ku punonjës civilë, dhe këtë vit bëhet fjalë për 25 të tillë, marrin pjesë në një program trajnimi, praktikash pune, vizitash studimore në institucionet shtetërore të vendeve anëtare të Bashkimit Europian. Programi ka qëllim të aftësojë jo vetëm punonjësit civilë të administratës sonë publike qendrore, po edhe punonjësit civilë të administratës sonë vendore, për të cilat, gjithashtu, është me rëndësi të rritet aftësia e të bërit të punës.

Së katërti, është shumë e rëndësishme që trupa e nëpunësve civilë të ketë një performancë të lartë në të gjitha nivelet. Për këtë arsye ne e kemi ndihmuar rritjen e performancës nëpërmjet trajnimeve që ofron Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, e cila në vitin 2022 ka pasur në fokus kryesor hartimin e kurrikulave të reja që ndihmojnë për përafrimin e Shqipërisë me rregulloret dhe të gjitha procedurat administrative që ndiqen në Bashkimin Europian.

ASPА ka trajnuar 5397 individë gjatë vitit të kaluar dhe kanë marrë pjesë në trajnime 20 500 individë; janë zhvilluar gjithsej 665 ditë trajnimi dhe nga këto të fundit projektet kanë asistuar në më shumë se 140 ditë.

Rëndësi i është dhënë edhe ofrimit të trajnimeve në Bashkimin Europian. Nga administrata publike shqiptare në trajnimet që realizon Bashkimi Europian kanë marrë pjesë

3755 individë. Pra, i jepet një rol kyç për të kuptuar të gjitha procedurat që duhet të ndiqen në vendin tonë *vis a vis* rregullave që përdor Bashkimi Europian. Përveç kësaj, ASPA ka vënë në dispozicion trajnime të tjera, të cilat kanë pasur tematika të ndryshme. Tematikat e zhvilluara gjatë vitit 2022 nga ASPA kanë qenë rreth 108.

Për vitin 2023, pa dyshim që janë vendosur disa prioritete, të cilat do të ndiqen me shumë kujdes në Departamentin e Administratës Publike, siç është, për shembull, mbajtja e talenteve në administratën publike nëpërmjet skemave të motivit apo nëpërmjet sistemit stimules të pagave; vijimi i aftësisimit të punonjësve të administratës publike nëpërmjet diversifikimit të programeve dhe rritjes së kapaciteteve; thjeshtësimi i të gjitha metodologjive të vlerësimit të nevojave për trajnim dhe vlerësimi i cilësisë së procesit që i ofrohet APSA-ës; përmirësimi i infrastrukturës së burimeve njerëzore nëpërmjet sistemit *management information system* për të vijuar përlogaritjen e pagave edhe për institucionet e qeverisjes vendore; intensifikimi i punës me qëllim bërjen funksional të këtij sistemi në të gjithë administratën publike dhe rritjen e cilësisë së të dhënave për politikën e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Qeveria shqiptare do të vazhdojë me angazhim maksimal në drejtim të reformimit të administratës publike për një administratë publike në përputhje me standardet e BE-së, e cila është e aftë të japë shërbime me cilësi për qytetarët dhe bizneset në mënyrë transparente, efikase dhe të efektshme.

Nga ana tjetër, dua t'ju them se në programin e vlerësimit 2017- 2021 të hartuar nga SIGMA, administrata publike në Shqipëri ka qenë një nga administratat më mirë të vlerësuara në rajon për mënyrën e rekrutimit dhe për aftësinë që ajo u jep punonjësve të saj për të qenë të përshtatur me të gjitha ndryshimet që kërkon kjo kohë, ku lëvizjet teknologjike, lëvizjet e iniciative dhe të ideve janë shumë të shpejta.

Ky ishte raporti i përgatitur nga administrata publike për aktivitetin që ka kryer gjatë vitit 2022.

Lindita Nikolla – Faleminderit, zonja Ekonomi!

Siç e dini, ju janë vënë në dispozicion edhe pyetjet që janë adresuar drejt jush nga zoti Flamur Noka, kështu që mund të dëgjojmë përgjigjet.

Milva Ekonomi – Në rregull.

Unë nuk e di nëse i dinë të gjithë pyetjet, por po i lexoj: “Pothuajse të gjithë drejtuesit e administratës publike kanë qenë të angazhuar në fushatën e kandidatëve të PS-së në zgjedhjet vendore. A keni ju informacion në lidhje me këtë? A keni nisur ndonjë hetim administrativ? A keni marrë ndonjë masë?”

Atëherë, unë dua t'ju them se Departamenti i Administratës Publike, me qëllim zbatimin e legjislacionit në drejtim të respektimit të drejtave politike të nëpunësve civilë, ka njoftuar sistemet ministore dhe sistemin e Kryeministrit për të pasur në vëmendje të drejtat dhe detyrimet gjatë periudhës së fushatës zgjedhore.

Konkretisht, janë marrë këto masa. Janë informuar punonjësit civilë të institucioneve të administratës publike për të drejtën e tyre për t'u përcaktuar si komisionerë në strukturat e administratës zgjedhore, si në KZAZ apo në KQV. Janë kryer monitorime dhe është konstatuar garantimi i pjesëmarrësve të punonjësve civilë në institucionet e administratës zgjedhore. 151 nëpunës kanë paraqitur dhe u është miratuar kërkesa për të marrë pjesë në komisionet e zonave të administrimit, zonat e administratës zgjedhore, grupet e numërimit të votave, si dhe komisionet e qendrës së votimit. Duke administruar rastet e pezullimit të punonjësve të institucionet e administratës shtetërore për shkak të pjesëmarrjes si kandidatë për kryetar bashkie apo anëtarë të këshillit bashkiak në zgjedhjet vendore të viti 2023, në total janë bërë 7 pezullime. Janë ngritur dhe kanë funksionuar grupet e punës mbi monitorimin e sjelljes së nëpunësve civilë në institucionet e administratës shtetërore gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet vendore të vitit 2023 dhe grupi i punës ka funksionuar nëpërmjet një task force, e cila ka qenë në terren që nga fillimi i fushatës.

Janë hartuar dhe janë miratuar rregulloret e brendshme të institucioneve për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të nëpunësve civilë gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet lokale. Është monitoruar sjellja e veprimtarisë së nëpunësve civilë në institucionet e administratës shtetërore dhe nga grupet e punës janë kryer kontrole, sondazhe gjatë orarit zyrtar. Kontrollat janë ushtuar një herë në ditë në orare të ndryshme dhe aktkonstatimet janë administruar dhe janë ndjekur

nga DAP-i dhe Komisioneri i Mbrojtës së Shërbimit Civil.

Gjatë fushatës zgjedhore DAP-i vendosi pezullimin e procedurave të rekrutimit në shërbimin civil në institucionet e administratës shtetërore për periudhën 14.04.2023 - 14.05.2023. Për më tepër, gjatë fushatës zgjedhore nuk janë bërë transferime të përhershme ose të përkohshëm për shkaqe ligjore të parashikuara edhe në ligjin 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar”. Nëpunësit civilë të liruar nga shërbimi civil për periudhën e fushatës zgjedhore për shkaqet e parashikuara në këtë ligj, gjithsej janë 25: 11 pensione pleqërie, 13 dorëheqje, 11 largim me masë disiplinore, si dhe nuk është administruar asnjë procedurë administrative për nisjen e ecuresë disiplinore për nëpunës civilë për shkak të kryerjes së veprimeve ose mosveprimeve në kundërshtim me legjislacionin e shërbimit civil gjatë fushatës zgjedhore.

Sa është shtuar numri i punonjësve të administratës publike në periudhën 4 muaj para zgjedhjeve?

Përgjigjja që kam për këtë pyetje, është se rekrutimet në DAP janë ndërprerë që nga 1 marsi dhe nuk është marrë në punë asnjëri duke ndjekur, pikë së pari, të gjitha vendimet që ishin marrë në rezolutën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, e cila daton më 24 dhjetor 2020.

A jeni në dijeni të një aplikacioni të quajtur “Aktivisti”, i cili ka detyruar mbi 70 mijë punonjës të administratës publike të bëjnë *like*, *share* dhe komente?

Aplikacioni “Aktivisti” është një aplikacion partie, nuk është aplikacion i administratës publike. Në aplikacionin “Aktivisti” mund të hyjë çdo anëtar i Partisë Socialiste. Është një aplikacion që e ngrenë edhe vendet simotra, parti simotra në vende të tjera të rajonit ose të Europës për të ftuar aty të gjithë ndjekësit e tyre në një fushatë.

A jeni në dijeni të një sistemi paralel me pikë për çdo punonjës të administratës të aplikacionit “Aktivisti”? A keni marrë ndonjë masë si institucion për mbylljen e këtij aplikacioni që shkel rëndë të drejtat e çdo nëpunësi civil?

Aplikacioni që ka DAP-i për rekrutimin dhe aplikacioni “Aktivisti” nuk kanë lidhje me njëri-tjetrit, ata ekzistojnë në mënyrë independente. Njërin aplikacion e menaxhon partia, aplikacionin tjetër e menaxhon administrata publike në kuadrin

e sistemeve shtetërore. Këto aplikacione nuk përputhen në asnjë moment. Sistemi i DAP-it është krejtësisht i pavarur nga sistemi i aplikacionit “Aktivisti”.

Në qoftë se ka pyetje të tjera, unë jam këtu për përgjigje.

Lindita Nikolla – Faleminderit, zonja Ekonomist!

Po, zoti Noka.

Flamur Noka – Se duhej t’ia kisha sqaruar pyetjet që më parë zonjës.

Lindita Nikolla – I keni depozituar me shkrim.

Flamur Noka – Po, më fal.

Në lidhje me aplikacionin “Aktivisti”, zonja, duhet të japë një sqarim nëse është aplikacion partie, pasi 75 mijë punonjës të administratës të shtetit shqiptar e kanë shkarkuar apo e kanë plotësuar këtë aplikacion dhe janë të involvuar brenda këtij aplikacioni. Çfarë janë këta punonjës, meqenëse qenkan të ndara, aplikacioni i shtetit nga aplikacioni i partisë?! A ka dijeni zonja se drejtorët, ministrat, ministret e kabinetit, i kanë terrorizuar punonjësit e shtetit për ta plotësuar me detyrim aplikacionin ose për t’u larguar nga vendi i punës në administratën shtetërore?

Unë nuk e pyeta, nuk i kërkova të më sqaronte për kurse dhe për trajnime. Po, more, po, koncepti “Aktivisti” është kriminal, sepse involvon dhe e bën një punonjës të shtetit me punonjës apo militantin e partisë. A është ky një standard i DAP-it dhe standard i administratës publike, se na tregoi zonja edhe për partitë simotra? Në rastin e Internacionales Socialiste aplikohen aktivistë, patronazhistë apo edhe dreqistë, por unë po flas për administratën e shtetit shqiptar, ku “nëpunësi civil” si term është i likuiduar dhe ngelet vetëm në letra, kur lexohen hartime dhe përralla këtu, pasi nëpunësi civil i shteti shqiptar me “Rilindjen” në pushtet është shndërruar në një militant, qoftë me dëshirë, qoftë militant përdhuni i partisë në shërbim të fushatës, të blerjes së votës, të kërcënimit, të shantazhimit, të terrorizimit të tij dhe të qytetarëve. Prandaj, është gjë e thjeshtë të vish këtu dhe të flasësh dokrra, por po ju them, termat “DAP”, “administratë civile” në Shqipëri janë inekzistentë.

Lindita Nikolla – Zonja ministre i dha përgjigjet e saj, por ndoshta ka diçka për të shtuar.

Një sekondë, zoti Noka, se nuk po bëjmë dialog së bashku.

Milva Ekonomi – Së pari, unë raportova për aktivitetin e vitit 2022 të Departamentit të Administratës Publike dhe, siç e theksova, “Aktivisti” nuk ka lidhje absolutisht me sistemet shtetërore që menaxhon DAP-i. Meqenëse ne kemi 70 mijë përdorues të “Aktivistit”, kjo tregon se qenka një aplikacion i suksesshëm! Unë ju ftoj ta shikoni edhe vetë, që “Aktivisti” nuk të kërkon pozicionin e punës, nuk ka pozicion pune tek “Aktivist”. “Aktivisti” është një platformë ku anëtarët e Partisë Socialiste informohen për aktivitetet e partisë. Mund të jesh edhe anëtar i Partisë Demokratike dhe askush nuk të ndalon të hysh në aplikacionin “Aktivisti” dhe të shikosh se çfarë gjërash bën Partia Socialiste në territor. Kështu që këto janë dy gjëra të ndara. Po të hysh në aplikacionin “Aktivisti”, e shikon shumë mirë që nuk ka asnjë lidhje me administratën publike.

Lindita Nikolla – Faleminderit!

Hapim diskutimet.

Fjala për zotin Eduard Ndreca, 10 minuta në dispozicion.

Të përgatiten zonja Ina Zhupa dhe më pas zoti Flamur Noka.

Eduard Ndreca – E nderuar Kryetare,

Të nderuar kolegë,

E dëgjova me vëmendje kolegen ministre për raportin e administratës publike dhe jam i bindur se puna e këtij institucioni përgjatë vitit 2022 ka qenë një punë e jashtëzakonshme, por sado që flasim mbi punën e këtij institucioni, patjetër që do të ketë një palë, e cila do të përpiket ta gjejë pikërisht këtu justifikimin për humbjet e zgjedhjeve të 14 majit.

Por para se të kalojmë në këtë çështje, të nderuar kolegë, unë mendoj se sot është koha, kur ne të gjithë së bashku, të majtë dhe të djathtë, duhej të kishim ardhur këtu përtej politikës së ditës me dy qëndrime në lidhje me situatën aktuale në Kosovë.

Së pari, duhej të kishim ardhur me një qëndrim të përbashkët drejtuar shtetit serb për të ndaluar provokacionet, sepse ato nuk janë thjesht provokacione drejtuar Kosovës, por janë provokacione drejtuar gjithë shqiptarëve kudo janë, siç ishte rasti i pengmarrjes së 3 policëve kosovarë. Është e pafalshme që të ndodhin provokacione të tilla dhe të vihet në pikëpyetje paqja në rajon.

Nga ana tjetër, ne duhej të ishim, po ashtu, të bashkuar të gjithë sot për t'i bërë një thirrje, edhe qeverisë së Kosovës, edhe kryeministrit Albin Kurti, që të mos e tërheqë edhe më shumë litarin, por të gjejë gjuhën e bashkëpunimit dhe të mirëkuptimit, me qëllim që të nxitë paqen në rajon me sa forcë ka.

Unë e kam vërejtur me një lloj doze hidhërimi të gjithë baltën e hedhur këto ditë ndaj Kryeministrit shqiptar thjesht për propagandën e ditës, sikur Kryeministri i Shqipërisë mbajta një qëndrim kundër qeverisë së Kosovës dhe Kryeministrit Kurti. Është e pafalshme se si një segment i opozitës për çorbën e ditës bën propagandë edhe me interesin kombëtar, kur, në fakt, ne të gjithë këtu jemi betuar për t'i shërbyer interesit kombëtar. Është jashtëzakonisht e pafalshme që politika e ditës del mbi interesin e shqiptarëve kudo janë.

Të nderuar kolegë,

Ju mund ta akuzoni gjithë ditën Partinë Socialiste dhe Kryeministrin shqiptar, se, në fund të fundit, do të përpiqeni të gjeni një rrugë për të bërë propagandë, për të justifikuar humbjen e 14 majit apo ku di unë, por ju kursesi nuk mund të vini dot një shenjë barazimi mbi gjithçka ka bërë Partia Socialiste në shërbim të interesit kombëtar me atë çfarë keni bërë ju, të nderuar ish-drejtuës të Shqipërisë, nga viti 2005 deri në vitin 2013. Më lejoni të vë përballë këtu dy deklaratat, të cilat flasin vetë, atë të ish-kryeministrit shqiptar me të ndierin Silvio Berlusconi, ku në sytë e kryeministrit të vendit tonë Berlusconi cenonte rëndë moralin kombëtar të një vendi dhe Kryeministri ynë, krejt i pafuqishëm, zgërdhihej dhe nuk kishte dot forcën t'i jepte një përgjigje, kurse në anën tjetër kemi deklaratën e Kryeministrit shqiptar në Beograd, ku në vatrën më të egër të antishqiptarizmit Kryeministri shqiptar mbron shqiptarët, shqiptarizmin dhe Kosovën. Nuk ka nevojë për fjalë të tjera, mjafton të krahasojmë këto dy deklaratat.

Patjetër që të gjithë ne mund të kemi rezerva, sidomos për diplomacinë europiane të shekujve të kaluar, sepse, në fakt, ajo që ndodh sot, është gjithçka ata mbrojtën në shekujt e kaluar që nga Shën Stefani famëkeq e me radhë me konferenca të hapura dhe të fshehura, por ne kursesi nuk mund t'i kthejmë shpinën një miku strategjik të shqiptarëve, siç janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilat që në ditën e parë të prezencës

së tyre në diplomacinë botërore i kanë shërbyer çështjes shqiptare, për të arritur më pas në kulmin e këtij shërbimi: angazhimi i drejtpërdrejtë i tyre në çlirimin dhe ndërtimin e shtetit të Kosovës.

Kështu që përpjekja e qeverisë së Kosovës për ta bërë këtë rol është fatkeqe, ndaj ne këtu duhet t'i bëjmë thirrje urgjente qeverisë së Kosovës që të ulet me partnerët ndërkombëtarë për të gjetur një zgjidhje sa më të favorshme për krizën e krijuar në Veri të Kosovës.

Për të kaluar të çështja e ditës, ne si komision e kemi dëgjuar me vëmendje raportin e Departamentit të Administratës Publike për aktivitetin e saj gjatë vitit 2022. Natyrshëm, është një punë që e vlerësojmë shumë dhe ky institucion, në zbatim të ligjeve të këtij vendi, e ka zhvilluar të gjithë aktivitetin e tij përgjatë vitit 2022. Ky institucion është delikat dhe patjetër që do të ketë mbi vete akuza. Në fakt, sa më mirë ta bësh një punë, aq më shumë punë u prish atyre që e kanë zët punën, ndaj edhe balta fillon të derdhet lum.

Unë e inkurajoj këtë institucion të bëjë gjithçka mundet që punën e tij ta organizojë jashtë çdo ndikimi dhe përpjekjeje për ndikim, sepse nga puna e tij varet shumë edhe rrugëtimi ynë drejt Bashkimit Europian. Besoj se për secilin prej nesh, me pushtet apo jo, më shumë sesa një punësim rëndësi ka bashkimi me familjen europiane. Administrata e pastër dhe e pandikuar është një kërkesë e vazhdueshme, por përveç kësaj, një administratë e pavarur do të thotë shërbim edhe më cilësor ndaj qytetarëve.

Nisur edhe nga nevoja për funksionim më të mirë të administratës publike, unë i kërkoj këtij institucioni që vendet vakante të plotësohen konform të gjitha procedurave që parashikon ligji. Sot kemi akoma (këtë e them edhe si deputet i qarkut të Lezhës) institucione gjysmake për nga numri i punonjësve thjesht se procedurat për rekrutim zgjasin për vite të tëra ose janë shumë të ngadalta.

Institucioneve në rrethe u kërkohet puna, kurse kapacitetet njerëzore nuk janë aty ku duhet për ta justifikuar këtë punë, ndaj edhe disa prej institucioneve nuk funksionojnë siç duhet. Në fund të fundit, ata që e paguajnë këtë janë qytetarët, të cilëve do t'u mbetet mangët shërbimi.

Po ashtu, nuk duhet reshtur në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm të administratës nëpërmjet trajnimeve. Siç e thashë edhe më sipër,

pavarësisht se sa mirë e bën punën, akuza të panumërta do të ketë mbi këtë institucion, sidomos në këtë vit elektoral.

Kam dëgjuar me vëmendje kolegët e mi këtu nga qarku i Lezhës, të cilët na akuzojnë ne se kemi shfrytëzuar administratën. Pra, kolegët kanë shkuar derë më derë ndaj dhe kanë qenë në prag të fitores, por dhuna jonë mbi administratën i ka bërë ata të dështojnë.

Të nderuar kolegë,

Ka një diferencë të madhe vajtja derë më derë gjatë kohës së fushatës me vajtjen derë më derë përgjatë 4 vjetëve, të cilën e kanë bërë, në fakt, bashkitë tona me administratën e tyre në qark, sidomos në dy ngjarje të rënda, siç ishte tërmeti dhe pandemia. Bashkitë Lezhë, Kurbin dhe Mirditë kanë qenë pranë qytetarëve në çdo moment, çdo ditë, çdo muaj dhe jo vetëm gjatë kohës së fushatës. Ju mund të keni shkuar gjatë muajit të fushatës, por është shumë e rëndësishme të kuptoni se nuk ka rëndësi ku shkon, por sa duar ta shtrëngojnë dorën dhe sa zemra të hapen. Kjo është vota.

E dyta, kam dëgjuar një koleg të nderuar të opozitës të thotë se më 14 maj Partia Socialiste u shkri me pushtetin dhe me administratën.

Të nderuar kolegë,

Ajo që unë, fatkeqësisht, kam konstatuar më 14 maj është se vota qytetare, së bashku me ndihmën që vetë opozita po u jep atyre, po çojnë në shkrirjen e një force politike, të cilën unë personalisht, ndryshe nga shumë kolegë, nuk e pëlqej.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjala për zonjën Tabaku.

Jorida Tabaku – Zonja Kryetare, dje është zhvilluar ceremoni shtetërore për varrimin e ish-Presidentit Berlusconi dhe unë nuk e kuptoj pse ishte e nevojshme të përmendej sot këtu një koment i thënë në një kontekst të caktuar. Unë besoj se nuk i bën nder këtij Kuvendi ...

Lindita Nikolla – Ky është koment. Edhe ju vetë e dini që nuk është procedurë.

Jorida Tabaku – Më lejoni ta përfundoj, sepse lidhet...

Lindita Nikolla – Pse ta përfundoni kur kuptohet që nuk është procedurë?

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Fjalën e ka zoti Dogjani.

Aslan Dogjani – Faleminderit, zonja Kryetare!

Në seancën e kaluar kam kërkuar që Kuvendi i Shqipërisë të dalë me një qëndrim për situatën në Kosovë, për dhunën e ushtruar nga grupet paramilitare dhe grupet e organizuara kriminale ndaj KFOR-it, Policisë së Kosovës dhe qytetarëve të saj. Sot situata ka agravuar më tej. Forcat Speciale të Serbisë janë futur në territorin...

Lindita Nikolla – Edhe kjo nuk është procedurë. Ju e bëtë kërkesën tuaj, kurse këto janë komente të tepërta.

Fjala për zotin Noka, 5 minuta në dispozicion.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Mos e ngrini zërin!

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Çfarë ke? Qetësohu, se je në Kuvendin e Shqipërisë!

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Dakord, por e dhatë mendimin tuaj.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Shkoni në vendin tuaj, se do t'ju jap fjalën atje.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Kemi filluar diskutimet për ...

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Dakord, keni 1 minutë kohë për ta përfunduar.

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Jo, jo, keni 1 minutë kohë për ta përfunduar, sepse morët nga koha juaj.

Asllan Dogjani – Në seancën e kaluar unë kam kërkuar që Kuvendi të mbajë një qëndrim për situatën në Kosovë. Situata ka agravuar. Forcat Speciale serbe janë futur në Kosovë dhe kanë marrë peng 3 policë. Kryeministri i Shqipërisë sillet si kryetari i OKB-së, por nuk vjen këtu për të dhënë informacion se çfarë platforme u ka dërguar francezëve dhe gjermanëve për vëllezërit tanë në Kosovë.

Prandaj, kërkoj të mblidhet Komisioni për Politikën e Jashtme, për të cilën edhe ju dhatë dakordësinë, dhe në fund të kësaj seance të dalim me një qëndrim për të dënuar sulmet e Serbisë ndaj policëve të Kosovës. Kjo është ajo që kam kërkuar. Mos më thuaj “dakord”, por mblidhe Komisionin për Politikën e Jashtme. Flasim kudo nën zë, por Kuvendi i Shqipërisë nuk ka dalë akoma me një qëndrim. Mendoj se në fund të kësaj seance duhet të dalim patjetër.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Zoti Noka, fjala për ju, 5 minuta në dispozicion.

Flamur Noka – Zonja Kryetare, mos e bëni të udhës t'i ndërprisni fjalën opozitës sa herë ajo thotë gjëra që ju shqetësojnë apo i djegin mazhorancës! Pra, bëhuni Kryetare dhe moderojeni këtë seancë.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Qesh ti, Taulant!

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Kur të rinoresh ti, do të flasim edhe për të rinjtë, por ti je i dalë jashtë mode, kështu që nuk flet dot për të rinjtë.

Dëgjova zonzjën të fliste për DAP-in, trajnimet e DAP-it, për administratën publike në përgjithësi, për kurse, për shpenzime. Zonzjë, koncepti “administratë publike” në Shqipëri është pushkatuar që kur ka ardhur në pushtet kjo farë e keqe e Rilindjes. Zonzjë, ti nuk ke lidhje me administratën publike, por je një militante e përdorur dhe e keqpërdorur. Edhe kur ke qenë zëvendësministre e Shëndetësisë, edhe tani, vetëm je keqpërdorur për të bërë afera, kurse për çështje politike as ti dhe as Kryeministri yt nuk u keni shërbyer asnjë sekondë shtetit, qytetarëve dhe ligjeve të këtij vendi. Ndaj, mos ua thoni këto doktra shqiptarëve! Po, në forumet e partisë suaj mund të bëni hartime, citime, recitime dhe tregoni përralla. Ju vidhni, se vetëm atë dini të bëni, nuk dini gjë tjetër, kurse për administratën publike mos flisni.

Aplikacioni “Aktivisti”, që ju ...

Më falni, që po jua them, por duhet të kesh guxim të tejskajshëm të thuash para shqiptarëve dhe para gjithë deputetëve që aplikacionin e kanë plotësuar vetëm socialistët dhe jo administrata, ndërkohë që ne kemi mijëra raste kur administrata është terrorizuar dhe kërcënuar për të plotësuar aplikacionin kriminal të “Rilindjes”, i quajtur “Aktivisti”, edhe pse si patronazhistët, ashtu edhe aplikacionin “Aktivisti” e kanë denoncuar institucionet ndërkombëtare, zonzjë! Ju nuk keni fytyrë! Çfarë t'ju them unë!? Ju dilni fare pa turp këtu dhe mundoheni të na mbushni mendjen jo vetëm neve, por edhe të gjithë shqiptarëve, që e zeza është e bardhë. Pastaj, brenda pak minutash dilni përsëri këtu dhe thoni që e bardha është e zezë!

Ndjesë, këtë eskalim të këtyre limiteve ne nuk e njohim dhe mbase prandaj nuk ju kuptojmë, por raporti i ODIHR-it, zonzjë, thotë se janë

shpërdoruar burimet njerëzore të administratës, është bërë presion mbi administratën dhe mbi votuesit e rrethit familjar të punonjësve të administratës.

Çfarë është kjo? Vetëm opozita e thotë këtë? E thotë ODIHR-i. Zonjë, ju nuk keni ndjeshmëri ndaj kësaj! Këtë e thotë edhe Parlamenti European në rezolutën për patronazhistët, por ju nuk keni ndjeshmëri. Ju keni ndjeshmëri vetëm për çfarë ju thotë “babloku”. Sulltan Surreli ju thotë dhe ju hyxhym përpara: s’ka ligj, s’ka Maliq, s’ka asgjë, rroftë Sulltani; çmendurira thoni, as skuqeni, as zverdheni.

Zonjë, shikojeni pak këtë! Kjo këtu është ministria në fushatë. Qendra shëndetësore “Bregu i lumit” i ka bërë *share* dhe *like* ministres në fushatë. Drejtuesi i kësaj qendre çfarë është?

Spitali bashkiak i Delvinës i bën *share* dhe *like* ministres tënde në fushatë. Çfarë është kjo?

Zëvendësudrejtori gjeneral i Operatorit të Shpërndarjes, Makens Shllaku, se është edhe me emër këtu, i bën *share* dhe *like*. A është administratë kjo, apo jo?

Po Besart Mataj është pjesë e administratës publike? Edhe ai i bën *share* dhe *like*.

Këtu kam edhe disa të tjera, si: qendra shëndetësore në Bërxullë, njësia vendore e kujdesit shëndetësor në Durrës, spitali bashkiak i Delvinës.

Vazhdojmë me të tjera.

Mirela Cami, operatore e Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor, i bën *share* dhe *like*, zonjë.

Ti, zonja Ministre, të lutem mos ndërhy kur flas unë! I ke të gjitha këtu.

Njësia administrative në Sult, po ashtu.

Lindita Nikolla – Zoti Noka, përfundojeni!

Flamur Noka - Nuk kam mbaruar, se kam 10 minuta kohë.

Ja ku i keni përsëri. Të gjithë janë pjesë e administratës publike. Ndaj mos flisni më për administratë publike, mos flisni më për përralla, për shpenzime parash dhe për vjedhje parash, sepse e keni shndërruar administratën në një strukturë militantësh partie, e keni vrarë administratën publike dhe keni bërë gjithçka për ta shndërruar në një organizatë kriminale, në funksion të “Rilindjes”, sikundër jeni edhe ju. Ndaj, të paktën kursejani këto shqiptarëve, njëritjetrit thojani, sepse jeni të ngjashëm dhe jeni njëlloj, por pafytyrësinë, mashtrimin, hajdutërinë,

babëzinë dhe kriminalitetin nuk ua pranojnë shqiptarët.

Lindita Nikolla - Fjala për zonjën Resulaj. Të përgatitet zonja Bushka dhe më pas zoti Petrit Vasili.

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Është me kohë të përcaktuar, zonja ministre.

Pranvera Resulaj - Faleminderit, e nderuara Kryetare!

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Së pari, pa dyshim që e përhëndes dhe e vlerësoj punën e deritanishme të Departamentit të Administratës Publike dhe raportin vjetor si tregues të ecurisë së zhvillimit aktual dhe progresit të pritshëm në të ardhmen të kësaj administrate.

Në fakt, dy elemente percepton vlerësimi i publikut në lidhje me administratën publike, qendrore apo lokale: shërbimet publike, infrastrukturën e ofrimit të tyre dhe performancën e punonjësve apo nëpunësve të shërbimit civil.

Të ndalemi, së pari, te këto dy elemente dhe të shohim nëse progresi i tyre ka ecur në mënyrë paralele. Një çështje kyçe, që vlen të evidentohet për vitin 2022, ashtu siç theksohet edhe në raport, është çelja e negociatave për anëtarësimin në Bashkimin European ku, pa dyshim, pati ndikimin e vet pozitiv edhe reforma në administratën publike.

Ndër praktikatat më pozitive të reformës në administratën publike spikat digjitalizimi i ofrimit të shërbimeve publike, llogaridhënies dhe transparencës. Shërbimet publike kanë shënuar një progres të rëndësishëm gjatë këtij viti me kalimin e të gjitha shërbimeve *online*, duke bërë që sot të ofrohen 1227 shërbime *online*, ose rreth 95% e të gjitha shërbimeve publike, krahasuar me vitin 2013, kur ofroheshin vetëm 14 shërbime elektronike. Në portalin e-Albania ofrohen 55 dokumente me vulë elektronike, duke eliminuar tërësisht printimin e tyre në letër dhe duke shënuar kështu një ndryshim radikal, ku në 5 vjet janë gjeneruar 23 milionë dokumente me vulë elektronike. Spektri i ofrimit të shërbimeve publike *online* ka bërë që në vitin 2022 institucionet ndërkombëtare ta rendisin Shqipërinë në vendin e 19-të në botë dhe në vendin e 8-të në Europë.

Në rendin e ditës së sotme do të diskutojmë, gjithashtu, projektligjin “Për qeverisjen

elektronike”, i cili ka për qëllim menaxhimin e sistemeve të infrastrukturës të informacionit; respektimin e standardeve të sigurisë elektronike; përcaktimin e rregullave për krijimin dhe ofrimin e shërbimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë; si edhe aksesin, përpunimin dhe protokollimin e dokumentit elektronik. Pa dyshim që këto përparësi të zhvillimit digjital e kanë bërë më të lehtë jetën e qytetarit.

Elementi i dytë, që percepton publiku në lidhje me administratën publike, siç e theksova, është performanca e nëpunësve civilë. Nëse fola për digjitalizimin e shërbimeve publike, të cilat e kanë lehtësuar jetën e qytetarit, nuk di të them se sa kjo performancë e punonjësve dhe nëpunësve civilë e ka përmirësuar dhe lehtësuar jetën e tyre.

Në raport analizohet programi “Administrata që duam” ku theksohet se si promovimi i kulturës organizative në shërbimin civil ka qenë në fokus të programit të qeverisë për reformimin e mëtejshëm të shërbimit civil. Aktivitete të ndryshme të këtij programi janë zbatuar për përmirësimin e performancës së nëpunësve civilë dhe institucioneve të administratës shtetërore, me qëllim zhvillimin e një kulture të fortë administrative. Sigurisht, të gjitha këto aktivitete e kanë bërë më cilësore administratën dhe vlen të përmenden si tregues pozitivë edhe në raportin vjetor, por do të doja të ngrija një pyetje, të dashur qytetarë dhe kolegë të nderuar: a është kjo administratë, që kemi, ajo që duam? Pa dyshim që jo.

Administrata publike është tabela e qitjes e pakënaqësive qytetare, ca për faj të tyre e ca për faj të drejtimit, sepse njerëzit perceptojnë në bazë të motivimit që marrin. Administrata, përtej infrastrukturës së shërbimeve, menaxhimit, organizimit dhe trajnimeve, ka nevojë për një reformë të thellë në konceptin që ka për misionin e vet. Në fakt, ka shumë kohë që themi se ka ardhur koha që në administratë të ketë vend vetëm për më të mirët. E, në fakt, kjo kohë duket se nuk pret më. Si mund të bëhet që ta kemi më efektive dhe më eficiente?

Reforma e pagave, ligji të cilin e miratuan në këtë parlament jo më larg se dy seanca më parë, sigurisht, do ta bëjë më të pëlqyer dhe shumë më konkurrues pozicionin e punës në administratën publike.

Gjithashtu, duhet të theksojmë, se një instrument i shkëlqyer ka qenë deri tani

promovimi i të rinjve ekselentë, si një mënyrë që jo vetëm e ka energjizuar administratën, por edhe ka synuar të krijojë një kulturë të re organizative. Gjithmonë kjo për rastet kur të rinjtë ekselentë nuk i ka mbytur fryma që kanë gjetur në administratë, sepse ka ndodhur në jo pak raste që janë larguar nga administrata publike për t’u drejtuar serish sektorit privat. Ndaj kjo është një kampion për të na treguar se si duhet t’i mbajmë këta të rinj në administratën publike dhe si ata duhet të përthithen dhe të rekrutohen nga kjo administratë.

Një program i shkëlqyer është programi “Gati për Shqipërinë”, një program që synon që individë të ndryshëm, të diplomuar jashtë dhe brenda vendit, të punësohen duke kontribuar me ide, projekte dhe iniciativa të ndryshme zhvillimore, ashtu siç ministrja e shpjegoi në raportin e saj. Sipas statistikave, në vitin 2022, nga 190 aplikantë të përzgjedhur nga kjo platformë, 62 u kualifikuan si rezultat i plotësimit të kriterëve dhe 42 prej tyre u emëruan. Në fakt, do të doja të ngrija sërish një pyetje: a mjafton kjo? Më shumë të rinj, në fakt, duhet të përthithen dhe të rekrutohen nga administrata publike. Në raport përmenden disa indikatorë, por unë do të ndalem në njërin prej tyre që lidhet me këtë argument dhe që ka të bëjë me indikatorin e aplikimeve sipas moshës. Krahasimi i moshës mesatare të aplikantëve, për ta thënë shkurtimisht dhe për të mos marrë shumë minuta, është një tregues që tregon se moshja mesatare e aplikantëve është shumë më e re dhe më e vogël sesa moshja mesatare e atyre që rekrutohen ose dalin fitues nga këto aplikime. Kjo do të thotë se kandidatët fitues janë me përvojë dhe me eksperiencë të lartë. Sigurisht, mund të thuhet që eksperiencia ndihmon për të qenë fitues në konkurrimin për administratën publike, por dua të ngre këtu një shqetësim që vjen nga shumë të rinj, të cilët dëshirojnë të jenë pjesë e administratës publike, se përveç të rinjve ekselentë, për të cilët ka një program të veçantë, ka edhe të rinj të tjerë që nuk e kanë eksperiencën e punës, që është e vlefshme dhe që ndihmon për t’u rekrutuar, por ata të rinj që nuk e kanë këtë eksperiencë pune ku do ta gjejnë atë? Pra, duhet të kemi një tërheqje sa më të madhe sa i përket rekrutimit të të rinjve.

Gjithashtu, përtej çështjes së rekrutimeve të reja, do të doja të ndalesha edhe te një element shumë i rëndësishëm, që ka të bëjë me

përmirësimin e performancës së nëpunësve civilë, që është vlerësimi i performancës për punonjësit aktualë. Punonjësit aktualë do të duhet ta rrisin këtë performancë dhe të përmirësojnë eficiencën dhe efektivitetin e punës së tyre, dhe sigurisht, të mbeten në administratë ata njerëz që e meritojnë më së shumti. Reforma e pagave do të jetë një nga treguesit e konkurrueshmërisë, duke bërë që edhe vetë administrata, nëpunësit civilë të jenë më të angazhuar në përmirësimin e punës dhe në përgatitjen e tyre profesionale

Vlerësimi real i performancës së nëpunësit ka një problem, sepse do të duhet të bazohet në indikatorë realë dhe të matshëm, që do të thotë se nëse një punonjës përballet me ndonjë objektivi të përcaktuar, të matshëm objektivisht nëpërmjet indikatorëve të matjes së performancës, sigurisht që duhet ta drejtojë gishtin e gabimit nga vetja dhe jo nga eprori, sepse, nëse nuk kemi një tregues të matshëm dhe objektiv të performancës së nëpunësit civil, ndonjëherë, jo rrallë, mund të ndodhë që eprori direkt apo nëpunësi autorizues, të bëjnë një vlerësim, të themi, subjektiv nisur nga simpatitë apo antipatitë personale dhe as vetë të mos jetë i qartë ndonjëherë se përse mund ta vlerësojë një punonjës me vlerësimin 1 apo 4.

Në raport, në mos gaboj, lexova që për vitin 2022 kishte ndërprerje të marrëdhënieve të punës, për shkak të vlerësimit negativ të performancës, vetëm për 4 raste. Sigurisht, mund të mos ketë, pra mund të ketë edhe zero raste të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës për shkak të vlerësimit negativ të performancës, kur filtrat e rekrutimit janë shumë të fortë, por, për sa kohë që kemi inefficiencë në administratën publike, dhe këtë e kemi pranuar, do të duhet që nëpërmjet këtij vlerësimi të performancës të qëndrojnë në administratë ata që realisht e meritojnë.

Në mbyllje të fjalës sime, të nderuar kolegë, dhe të dashur qytetarë, dua të adresoj një ideal të lartë të shërbimeve publike që është: të punosh për të mirën e komunitetit. Për të trajtuar problemet aktuale dhe ato në zhvillim, qeveria ka nevojë për burra dhe gra që janë në gjendje të mendojnë në mënyrë strategjike, krijuese dhe vendimtare. Shërbimi publik është një privilegj, është një shans për ta bërë jetën e njerëzve më të mirë dhe të ardhmen e tyre më të ndritshme, shërbimi publik është një thirrje ku individët dhe organizatat mund të ndihmojnë në ndërtimin e një të ardhmeje më të mirë për kombin tonë.

Lindita Nikolla - Fjala për zonjën Bushka, të përgatitet zoti Vasili.

Po, zoti Alizoti, për çfarë e keni kërkuar fjalën?

Tomor Alizoti – Për procedurë.

Mendoj, zonjë e nderuar, që sot Kuvendi, para se të diskutojë për tema, të cilat kanë rëndësinë e tyre, duhet të diskutojë rreth çështjes së Kosovës, sepse kriza në Kosovë po merr dimensione shumë tragjike, dhe më e rëndësishme sot edhe në mediat botërore, edhe te shqiptarët në Kosovë, edhe te shqiptarët në Shqipëri është kriza në Kosovë, e cila mund të agravojë. Shqipëria, me përvojën e saj historike, politike dhe diplomatike, duhet ta ketë rend dite diskutimin rreth Kosovës. Kosova përbëhet nga shqiptarë, ata janë vëllezërit tanë dhe ne nuk mund ta anashkalojmë në këtë mënyrë. Ky është propozimi im.

Merreni seriozisht këtë gjë, sepse na shikojnë shumë shqiptarë në Kosovë dhe në Shqipëri, dhe kriza atje mund të agravojë, sepse kriza prodhon krizë. Ky është sugjerimi im dhe, u lutem, të gjithë kolegëve, ta marrin parasys!

Faleminderit!

Lindita Nikolla - Po, zonja Bushka, fjala për ju.

Klotilda Bushka – Faleminderit!

Kolegë, në lidhje me çështjen që po diskutojmë, së pari, duke dëgjuar kolegët e opozitës, do të më duhet t'i them gjithsecilit nga ju, nga ne, që punonjësit në administratën publike janë pasuria dhe vlera më e madhe që kemi drejt konsolidimit të shërbimeve më të mira për qytetarët.

Ne nuk mund t'i ndajmë punonjësit e administratës në të njëjës parti apo të partisë tjetër, ata janë punonjës të shtetit shqiptar, që i shërbejnë interesit publik. Ndaj kur flasim këtu për administratën do të duhet ta mbajnë këtë në konsideratë dhe të kemi kujdes kur bëjmë etiketime. Nuk më pëlqen që kolegët e opozitës përdorin gjithmonë situata, episode, të cilat, në fakt, nuk janë të vërteta, por i krijojnë vetë, për të justifikuar humbjet e njëpasnjëshme në proceset zgjedhore, duke etiketuar përdorimin e administratës.

Ju kujtoj, kolegë, që kemi miratuar Kodin Zgjedhor dhe ligje të tjera, të cilat rastet e keqpërdorimit të administratës i ngarkojnë me përgjegjësi penale. Nuk është nevoja të krijojmë raste hipotetike, që nuk kanë ndodhur, për t'i

përdorur këtu për të justifikuar humbjet, por t'u drejtoheni organeve përkatëse, administrative apo të drejtësisë për të nxjerrë në pah përgjegjësitë nëse ka pasur raste të keqpërdorimit, dhe të vihen para ligjit të gjithë ata që kanë kryer veprimtari të tilla. Të diskutosh këtu që administrata qenka e detyruar të marrë pjesë në proceset zgjedhore, që u bëhet terror nëpunësve të administratës, se nëse nuk marrin pjesë në aktivitet *online* janë të rrezikuar në punën e tyre, është guxim i madh, kur nuk ke bërë qoftë dhe një ankim të vetëm, qoftë edhe një kallëzim të vetëm, kur nuk ke bërë qoftë edhe një detyrë shtetërore në zbatim të ligjeve për t'i çuar atje ku adresohen këto çështje dhe ku gjejnë zgjidhjen ligjore.

Ne nuk mund ta përdorim administratën publike për interes politik, sepse është e të gjithëve. Ata janë qytetarët tanë, që u shërbejnë po qytetarëve tanë, prandaj do të duhet t'u japim dinjitetin që u takon, do të duhet t'u japim respektin që u takon dhe respektin, së pari, ua japim duke i respektuar në punën e tyre.

E keqpërdorni të gjithë sistemin e shërbimeve elektronike që po organizon sot qeveria në kuadër të transformimit digjital, në interes të shërbimit qytetar me aplikacionet *online* të partive politike. I keqpërdorni! Të përdorësh një aplikacion *online* është e drejtë e çdo qytetari sot në Shqipëri dhe kudo, në çdo vend të botës. Ju me qëllim i ngatërroni sikur këto sisteme na qenkan të ndërlidhura me sistemet publike, por nuk është fare kështu. Aplikacioni "Aktivisti", i Partisë Socialiste, është një aplikacion për të gjithë qytetarët që kanë dëshirë dhe që me vullnet të lirë mund të përdorin informacionin atje, por ndërkohë aplikacionet e tjera, që përdor administrata shtetërore, janë komplet një gjë tjetër dhe nuk kanë lidhje me aplikacionin "Aktivisti". Nuk mund ta minimizojmë gjithë diskutimin për një çështje, të cilën ne po e diskutojmë sot dhe që është kaq e rëndësishme, siç është veprimtaria vjetore e Departamentit të Administratës Publike, me justifikimin tuaj të radhës, për të treguar se, në fakt, mund të fitonit, por ja u përdor administrata dhe prandaj Partia Socialiste i fitoi përsëri këto zgjedhje dhe ju humbët, siç humbni gjithmonë. Pra, nuk është kështu, sepse gabimi që bëni gjithmonë është se nuk shihni te vetja, por gjeni arsye për të treguar se jua kanë fajin të tjerët.

Në gjetjen e këtyre arsyeve, ku rëndoni ju? Rëndoni tek ata njerëz që punojnë nga mëngjesi

në darkë për t'u dhënë shërbime më të mira qytetarëve, për t'u ulur autoritetin atyre, për të mos vlerësuar një punë që po bën administrata publike prej më se 8 vjetësh tashmë, në kuadër të një reforme për administratën publike, e cila jo vetëm synon të arrijë objektivat e shtetit shqiptar për një administratë të përgjegjshme, për një administratë me shërbime cilësore, të konsoliduara për qytetarët, por edhe të përmbushë detyrimet që kemi në kuadër të anëtarësimit në Bashkimin Europian.

Në fakt, ne monitorohemi nga Bashkimi Europian dhe kemi dy programe të rëndësishme që e asistojnë shtetin shqiptar dhe qeverinë shqiptare për konsolidimin e administratës publike. Në të dyja këto programe asistence ne kemi rezultate; mjafton të lexoni raportet e progresit të Bashkimit Europian për Shqipërinë dhe do të shihni se nga viti në vit ka përmirësim në konsolidimin e administratës shtetërore në disa drejtime.

Drejtimi i parë është rekrutimi në bazë të meritës.

I dyti ka të bëjë me faktin e rritjes së cilësisë së shërbimeve nga administrata jonë publike.

A ka probleme? Sigurisht që ka. Ne nuk mund të themi se kemi arritur maksimumin e asaj që synojmë, por ama është bërë shumë punë falë asaj drejtorie dhe atij Departamenti të Administratës Publike në zbatim të të gjitha strategjive dhe politikave të qeverisë shqiptare për një administratë të përgjegjshme dhe që u shërben sa më mirë qytetarëve, që ne të kemi rezultate, të cilat na vlerësohen edhe në raportet ndërkombëtare, por edhe ndihen në shërbimet publike që u ofrohen sot qytetarëve.

Është fakt që shërbimet publike në epokën digjitale po përkthehen në shërbime elektronike. Një administratë, përveçse duhet të rrisë nivelin e saj në ofrimin e shërbimeve, do të duhet edhe të përshtatet me këtë mënyrë të re të dhënies së shërbimeve, po ne nuk mund të themi që nuk është bërë asgjë në këtë drejtim. Është bërë shumë, sepse një sërë stafesh në administratën tonë publike janë trajnuar dhe i kanë rritur kapacitetet e tyre se si t'u shërbejnë qytetarëve nëpërmjet mekanizmave të teknologjisë së informacionit. Kjo do të thotë metoda të reja pune, organizim ndryshe i punës, rritje e eficiencës, më shumë rregulla për transparencë dhe më shumë kontroll dhe këta janë indikatorë që na tregojnë se

administrata ka ecur në një drejtim pozitiv dhe ku janë sfidat për t'u përmirësuar.

Këto kanë qenë pak a shumë edhe diskutimet që janë bërë në kuadër të raportimit vjetor në Komisionin e Ligjeve, duke e vënë theksin te plotësimi i vakancave brenda afateve. Rezulton që Departamenti i Administratës Publike ka arritur 98% të realizimit të planit për thirrje, për plotësimin e vendeve vakante, por ka plotësuar 78% për efekt të sulmit kibernetik që i ndodhi Shqipërisë, i cili bllokoi edhe proceset e aplikimeve *online*. I gjithë procesi i aplikimeve për rekrutim në administratën publike është *online*, pra jo më me dokumente fizike. Kjo tregon, gjithashtu, që ka një synim, ashtu siç ka edhe rezultate në drejtim të rritjes së transparencës dhe të nxitjes për të pasur sa më shumë konkurrueshmëri, sepse çdo gjë është e hapur për kandidatët, për publikun, për ata që e monitorojnë departamentin së brendshmi, pra institucionet e tjera shtetërore, por edhe për administratën e Brukselit të Bashkimit Europian, që e monitoron Shqipërinë në këtë proces.

Nga ana tjetër, një indikator është: sa vendime gjyqësore ka sot kundër vendimeve të organeve shtetërore sa u takon proceseve të punës në administratë? Po të krahasojmë shifrat, kemi një ulje të proceseve gjyqësore. Në qoftë se ne kemi një ulje të proceseve gjyqësore, kjo nënkupton që performanca administrative e Departamentit të Administratës Publike është rritur, por ama, nga ana tjetër, Departamenti i Administratës Publike do të duhet ende të progresojë me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore që kanë mbetur në një mori vitesh.

Kolegët që më pyesin nga vendi mirë është ta analizojnë se pse janë gjithë ato vendime, sepse është hera e gjashtë, të paktën, që unë flas këtu çdo vit për Departamentin e Administratës Publike. Vendimet gjyqësore të paekzekutuara janë të mbartura që nga koha para se mazhoranca socialiste të vinte në pushtet dhe reduktimi i numrit të vendimeve gjyqësore të pazbatuara ka ardhur vetëm në këta 8 vjet, sepse ishte bërë një mori e madhe vendimesh kur hiqeshin njerëzit nga puna dhe ata e fitonin gjyqin, dhe për një vend të administratës kishte një punonjës të rekrutuar me synime politike nga qeveria e atyre që sot janë në opozitë dhe një person tjetër, i cili do të duhej të sistemohej diku ose t'i adresoheshin të drejtat, sepse kishte një vendim gjyqësor të formës së

prerë. Askush nuk shqetësohej për këtë, por shqetësoheshin pse përdorej administrata për zgjedhje, me fakte të pavërteta. Departamenti i Administratës Publike dhe shteti shqiptar gjatë këtyre 8 vjetëve e kanë reduktuar numrin e vendimeve gjyqësore të pazbatuara, që ishin të mbartura që nga periudha e mëparshme e qeverisjes së Partisë Demokratike.

Këto janë fakte dhe ne këto shohim, sa ka ecur Departamenti i Administratës Publike nën mbikëqyrjen e realizimit të këtyre indikatorëve, që për ne janë të rëndësishëm.

E rëndësishme është, gjithashtu, të themi se me transformimin digjital administrata ka ende nevojë jo vetëm që të rekrutojë më të mirët, por edhe t'i trajtojë ata, që t'u përgjigjen sfidave të kohës, ndaj do të duhet, që përveçse të ecet me planin e rekrutimeve, me rritjen e kapaciteteve, me rritjen e llogaridhënies, të ecim edhe me zbatimin e detyrimeve për t'iu përshtatur kohës digjitale.

Së fundmi, unë uroj që rritja e pagave dhe gjithë reforma në administratën publike, e cila synon që pagën mesatare në administratë ta kthejë nga 530 euro në 900 euro në fund të realizimit të reformës, të jetë një faktor nxitës që më të mirët të shkojnë në administratë, që ata që punojnë në administratë t'u përgjigjen realisht të ardhurave të pagës që ata meritojnë, por në shërbim të interesit publik. Ky do të ishte, në fakt, një nga sukseset më të mëdha të reformës së pagave jo vetëm për t'i pasur dinjitozë ata që ofrojnë shërbime në administratën publike, por edhe për të justifikuar vlerësimin që atyre u bëhet me këtë reformë.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjala për zotin Petrit Vasili. Keni 5 minuta.

Zonja Vokshi e ka kërkuar fjalën për procedurë.

Ju lutem, përmbajuni procedurës!

Albana Vokshi – Patjetër.

Po i bëni diskutimet për raportet sa për të kaluar radhën dhe duket sikur Konferenca e Kryetarëve po tallet me ne, deputetët, tallet me të gjithë qytetarët apo edhe me nëpunësit e administratës publike, të cilët mund të jenë duke na ndjekur në këto momente.

150 minuta ka përcaktuar Konferenca e Kryetarëve për 140 deputetë. Me një llogaritje të thjeshtë i bie 1 minutë për çdo deputet për të diskutuar për një çështje që sot është ndër të

rëndësishmet. Unë dua, si deputete, të flas për administratën publike, por Konferenca e Kryetarëve ma heq këtë të drejtë, sepse mua më jep 1 minutë, çdo deputeti që ju e konsideroni si jashtë grupeve parlamentare, në mënyrë antikushtetuese i jepni nga 1 minutë dhe ne nuk dimë se kush do të flasë më parë.

Zonja Kryetare, a është e mundur t'i parashtroni Konferencës së Kryetarëve një kërkesë që të mos lini më 150 minuta? Kjo është qesharake dhe absurde. Ju duhet të lini vetëm një raport dhe secili të ketë 10 minuta për të folur për çdo çështje, sepse më shumë flitet për procedurë dhe për replikë sesa diskutohet për administratën publike, e cila sot është kthyer në makthin e çdo votuesi.

Lindita Nikolla – Dakord.

Albana Vokshi – Të lutem, nuk e kam mbaruar procedurën!

Më lini të flas, se kam 3 minuta për procedurë!

Lindita Nikolla – Po bëni komente për administratën publike.

Albana Vokshi - Ju lutem, mos ndërhyni! Pse keni frikë nga fjala?

Kam 3 minuta për procedurë, kështu që m'i lini 3 minuta për procedurë!

Si i duket zonjës Bushka kjo tabelë, që është e AKSHI-it dhe ka të gjitha të dhënat personale? Ky është modernizimi i administratës?! Ky është sistemi i patronazhimit. Ju duken normale këto *share*, të të gjitha spitaleve të Shqipërisë, që bëjnë postime të aktiviteteve politike të ministres?! Kjo është administrata që po punon për qytetarët?! Jo, nuk është. "Patronazhisti" dhe "Aktivisti" janë sistemet më të dhunshme të administratës publike...

Lindita Nikolla – Kjo nuk është për procedurë, këto janë komente. Unë do t'ju ndërpres fjalën.

Zoti Petrit Vasili, fjala për ju. Keni 5 minuta në dispozicion.

Më pas fjalën e ka zoti Oerd Bylykbashi. Po 5 minuta ka në dispozicion.

Petrit Vasili – E nderuar Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Absolutisht, bashkohem me atë që sapo tha zonja Vokshi, sepse, sigurisht, tendenca për të folur për raportimet vjetore është një prirje e qartë e mazhorancës për ta kthyer në një moment

formal, pa përmbajtje dhe për të krijuar një fasadë të rreme. A është sot administrata publike ajo që do t'i duhej vitit 2023? Absolutisht jo. Kushdo mund të kënaqet dhe mund të tallet me veten e tij dhe është një e drejtë legjitime e gjithsecujt, po ky Kuvendi i Shqipërisë e ka parë se me çfarë cilësie të administratës përballet në ballafaqimet, në propozimin e projektligjeve, të raportimeve dhe të akteve të caktuara. Kemi parë qartazi një nivel mizerabël, jemi përballur me njerëz, CV-ja e të cilëve ka qenë për faqe të zezë. Kanë qenë estetikiist perfekt në pikëpamje të shfaqjes së tyre estetike dhe të *fashion*-it të radhës, por brenda kanë qenë një shtuf i vërtetë, dhe kemi dëgjuar përgjigje nga më idiotet që mund të jenë parë ndonjëherë në Kuvendin e Shqipërisë. Besoj se t'i bësh avokatinë kësaj administrate dhe të mos jesh kritik ndaj saj, do të thotë të jesh një bashkërrënues i përditshmërisë së funksionimit të shtetit.

Është shumë e qartë, e dinë të gjithë, që nuk është fatura e 300 vjetëve më parë, por e këtyre 10 vjetëve, që paguhen me 100 e ca milionë euro dhe kush e di se në sa vende në administratë paguhen 2 vetë për të njëjtin vend pune. E keni shumë të qartë dhe e keni parë, nuk është konstatimi ynë, sepse dielli me shoshë nuk mbulohet, keqpërdorimi i administratës në mënyrë flagrante është në raportet e OSBE-ODIHR-it për zgjedhjet. Bëni çfarë të doni dhe thoni çfarë të doni, nuk është ky aplikacioni, por është ky, flisni sa të doni, broçkullisni sa të doni, por atje në raport thuhet: "administratë publike e keqpërdorur". Një administratë që me idiotësi shembullore mund ta bëjë militantizmin, por së paku jo trupërisht hapur, ku në ditën e saj të punës ka vetëm e vetëm se si të promovojë edhe gomarllëkun më të fundit që bën një drejtues i Partisë Socialiste në fushatë.

Postimi, ripostimi, kjo është detyra, ky është kriteri, kjo është matja e punës së tyre. Kjo nuk është më e fshehur, është publike. Në rast se e mohoni këtë dhe nuk e pranoni, është pastaj të mos kesh respekt për veten. Kjo administratë e mat punën e saj me sa ia fërkon kurrizin, sa ia ngop kapriçon drejtuesit politik të radhës dhe sa i plotëson dhe i bën alibira çdo lloj aventure që ai propozon, sepse ju e keni parë që në të gjitha verifikimet që bëhen për qindra tenderë, për qindra procedura korruptive, njëra më e shtrembër se tjetra, atje brenda gjenden firmat e këtyre

punonjësve të shkëlqyer të administratës, të cilët në vend që të ishin barrierë në emër të ligjit, në emër të detyrimit që kanë si punonjës të shërbimit civil e të shërbimit publik të Republikës, të cilët janë aty për të qenë rezistentë të kësaj gjëje, ndaj janë edhe pjesa më e ruajtur dhe më stabël, ndërkohë që drejtuesit politikë vijnë dhe shkojnë, ata nuk e bëjnë; janë thjesht e vetëm fërkuesit, palma, freskorja e radhës e ministrit, e drejtorit të Përgjithshëm, e sekretarit të Përgjithshëm të radhës apo çfarë janë me radhë të tërë. Është më i vlefshëm ai që bën arrogantin, që di të trysnojë më mirë e që di t'u marrë firmat me dhunë e për të cilat pastaj, siç thotë populli: "Shqelmat e atllarëve i hanë gomarët". Pastaj radhë-radhë shkojnë këta përpara drejtësisë, sepse ata që kanë realizuar kapriçon e radhës, thjesht, jo vetëm kanë futur paratë në xhep, por kanë përdorur këta punonjës pa kualitet, pa cilësi dhe pa identitet që pranojnë të vetëpërdoren.

Kështu që është fare e qartë, plus edhe me mungesat e mëdha të paplotësuara me vite në administratë, për turpin e administratës, kur ju e dini që punonjësit dinjitozë janë bërë vetëm një ëndërr e bukur e së shkuarës, por punonjës dinjitozë, me eksperiencë, rojtarë e shërbëtorë të vërtetë të ligjit, ju nuk gjeni më. Kjo është fytyra e vërtetë e administratës. Sado të sforcuar të bëjnë të gjitha llojet e alibive, nuk e fshehin dot këtë fytyrë kaq të shëmtuar të punonjësve të shërbimit publik në Shqipëri.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Faleminderit!

Fjala për zotin Oerd Bylykbashi.

(Ndërrhyrje pa mikrofon nga salla)

Oerd Bylykbashi – A ka mundësi të vendoset koha për procedurë fillimisht?

Lindita Nikolla – Koha në dispozicion është 7 minuta.

Oerd Bylykbashi – Zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Sensibilitet më të lartë se ajo që po ndodh në Kosovë, nuk ka. Ne këtu nuk jemi administrata publike e Këshillit të Ministrave, por jemi parlamenti, jemi 140 deputetët e zgjedhur. Në qoftë se ky parlament nuk reagon për atë që po ndodh, në qoftë se nuk kërkon llogari nga Kryeministri për atë që po ndodh dhe se çfarë po bën qeveria shqiptare, do të thotë se nuk po kryejmë rolin për të cilin jemi zgjedhur, nuk po bëjmë detyrën tonë, përfaqësimin e sovranit.

Nëse ka një interes që shkruhet që në preambul, është interesi kombëtar, dhe nëse ka diçka që e thotë Kushtetuta që në fillim, madje na udhëzon, është të futemi edhe në aleanca për mbrojtjen e interesit kombëtar, jo të interesit shtetëror. Ne duhet të kishim sot këtu Kryeministrin e një vendi anëtar të NATO-s, për të kuptuar se si po e shfrytëzojmë këtë aleancë për interesin kombëtar. Po ku është Kryeministri? Kryeministri nuk vjen këtu, nuk duket kurrë, sepse interesi dhe konsiderata e tij për parlamentin janë zero, se kështu e ka katandisur grupin e tij parlamentar; nuk e shikon fare të nevojshme. Ai duhet të ishte këtu dhe të jepte llogari për atë që u ka propozuar më parë të tjerëve, por jo Kosovës, për ato veprime, që janë ato sanksione, veprime të cilat qartazi dëmtojnë interesin kombëtar. Interesi ynë kombëtar nuk është në Lindje të Ukrainës, por në Veri të Kosovës. Ky parlament duhet të kërkojë llogari nga Kryeministri.

Ndaj, zonja Kryetare, Kryeministri duhet të ishte këtu sot, jo të kemi këto situata, ku vendet e anëtarëve të qeverisë, pas shpinës sonë, janë bosh. Nëse ne nuk diskutojmë për këtë çështje, çdo gjë tjetër duket një rutinë e shëmtuar dhe askush nuk na kupton.

E them sërish, ne nuk jemi administrata publike e Kryeministrit, por jemi të zgjedhurit e shqiptarëve, që, sa të kemi mundësi, t'i mbështesim ata dhe jo të mbivendosemi ndaj atyre që ka zgjedhur Kosova. Çdo gjë tjetër është thikë pas shpine për ta. Ky Kryeministër, jo ne, por edhe ky parlament me heshtjen e vet janë duke e vënë në pozitë të vështirë negociuese Kosovën. Në vend që Kosova të ketë aset strategjik një vend anëtar të NATO-s, që të ndikojë në interesin e saj, ne bëjmë të kundërtën, e dëmtojmë Kosovën në negociata. Ata e dinë më mirë se ne se si duhet bërë e gjithë kjo, por ne duhet t'i mbështesim, sigurisht, edhe t'i këshillojmë, por jo duke i vënë ata në pozitë të vështirë me deklarata, si: "Jemi ne më të rëndë sesa partnerët ndërkombëtarë".

Zonja Kryetare,

Po kthehem te çështja që kemi sot në diskutim.

10 vjet më parë, më 30 maj të vitit 2013 në këtë parlament u ndërpre fushata zgjedhore dhe u thirr një seancë e jashtëzakonshme. Ndoshta edhe ju i mbani mend 3 ligjet me shumicë të cilësuar, që, në fakt, ishin vetëm 2: ligji për nëpunësin civil

dhe ligji për Gjykatën e Lartë; e treta ishte Rregullorja e Kuvendit, e cila miratohet me 71 vota, por Sali Berisha kishte vendosur ta miratonte me konsensus, edhe pse i kishte votat, madje komisioneri Fyle në atë kohë ia kërkonte: “Sido të jetë, edhe referendum të bëni, ne e duam me konsensus”. U mblodh parlamenti në seancë të jashtëzakonshme, në mes të fushatës, për të gjetur konsensus për ligjin për nëpunësin civil.

Çfarë ndodhi më pas? Më 30 shtator, 2 orë para se ai ligj të hynte në fuqi, më 1 tetor, ju e ndryshuat me akt normativ, e pezulluat. Pas 6 muajsh Gjykata Kushtetuese u shpreh se akti normativ ishte antikushtetues, por ndërkohë mijëra nëpunës civilë e punonjës të administratës publike ishin qeruar nga administrata! Pra, në vend që t’i japim stabilitet administratës, dëgjojmë nga ministrja që mobiliteti i administratës është sukses! Një nga parametrat është se sa stabël është administrata, jo sa e lëvizshme.

Një avokat me emër, para pak kohësh, thoshte: “Po më vijnë pas zgjedhjeve nëpunës të administratës, sepse janë të frikësuar për ato që detyrohen të nënshkruajnë në këtë administratë”. Një ish-kolegu juaj, që sot nuk është më këtu, ish-deputet socialist, pak kohë para zgjedhjeve më thoshte: “Çuditërisht se çfarë firmosin sot punonjësit e administratës! Si nuk kanë frikë nga firma e tyre?!” sepse firma shkon dhe më pas vijnë problemet, dhe ju i shihni te këto proceset. Dalëngadalë do të shihni se, ata që na duken peshq të vegjël, në momentin kur do të kenë frikë, pra shumica e eprorëve, do ta kenë të vështirë të çojnë para agjendat korruptive.

Administrata politizohet nga koka te këmbët, pra ka jo vetëm njerëz ndaj të cilëve ushtrohet presion, por edhe njerëz që zëvendësohen me militantë, që më pas marrin edhe emrin “patronazhistë” dhe Kryeministri i përhëndet dhe i duartroket. Të gjithë këta janë indikatorë që tregojnë se administrata është e politizuar. Po e them unë këtë? Jo. Po e thonë kolegët e mi?! Jo! Në vitin 2019, 4 vjet më parë, OSBE-ODIHR-i në rekomandim kanë kërkuar të depolitizohet administrata publike. Çfarë ka ndodhur? Asgjë! Ndërkohë, ju thoni se keni arritur sukses, “eficiencë”, “efikasitet”, i thoni të dyja bashkë, se nuk e ndani se çfarë është njëra dhe çfarë është tjetra.

Në datën 4 qershor të vitit 2020 (ajo marrëveshja e 5 qershorit) nuk u ra dakord për depolitizimin e administratës zgjedhore, sepse vetë BE-ja e tha që nuk e bëni dot, pasi administrata është e politizuar. Kjo gjë është e shkruar.

Ku jemi sot? Kemi sistemin e patronazhimit, sistemin e aktivistit, dhe në deklaratën paraprake të ODIHR-it thuhet shumë qartë se administrata qendrore dhe lokale është përdorur në fushatë zgjedhore. Raporti nuk ka dalë ende. Prisni dhe do ta shihni se çfarë do të dalë! Çfarë do të thotë kjo? Ju e profilizuar zgjedhësin, e eskortuar deri në qendrën e votimit dhe ai e shihte edhe patronazhistin e tij në komision apo si vëzhgues.

Zonja Kryetare, ju kërkoj edhe pak sekonda kohë.

Kemi një sistem, i cili është shtrirë në mënyrë brutale tashmë në të gjithë territorin, që kontrollon zgjedhësin, ushtron trysni tek ai, dhe zgjedhësi mendon se nuk ka shpresë. Kjo është administrata publike socialiste që keni ngritur, administratë patronazhistësh! Këtë e thotë vetë Kryeministri. Nëse ka sot korrupsion galopant, ky është tregues shumë i qartë i administratës që kemi, jo vetëm në raport me cilësinë, por edhe në raport me ligjin. Ata nuk pyesin se çfarë firmosin, “se na mbron ai sipër”. Pandëshkueshmëria është ajo që më pas i bën këto “jaka të bardha” të vogla të mos ndiejnë siklet kur shkojnë dhe e kërkojnë votën me para, sepse ky sistem i shitblerjes së votës, ose i blerjes së të drejtës së votës për të mos shkuar për të votuar, mund të jetë ekstensiv në 100% të territorit vetëm nëse përdoren dhjetëra e mijëra nëpunës të administratës. Ju këtë keni bërë. Është vepër penale, por sa kohë prokuroria fle gjumë apo e kthen kokën në krahn tjetër, sigurisht, sistemi i pandëshkueshmërisë do ta rrënojë.

Por një gjë dua t’ju them: harrojeni që ky vend do të ketë progres, në qoftë se administrata publike është kaq e paaftë, kaq e politizuar dhe kaq e inkriminuar!

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjala për zotin Taulant Balla.

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Zoti Spaho, po abuzoni me kërkesat e vazhdueshme për procedurë!

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Atëherë, po ju dëgjojmë se si i përmbaheni nenit përkatës.

Edmond Spaho – Zonja Kryetare, edhe një herë dua të ngre çështjen e kohës që u vihet në dispozicion deputetëve për të diskutuar për probleme kaq të rëndësishme. Rregullorja e Kuvendit qëndron mbi Konferencën e Kryetarëve. Nuk mundet që Konferenca e Kryetarëve të përcaktojë kohën për të folur çdo deputet, sa kohë që Rregullorja na ka vënë në dispozicion maksimumi 10 minuta për të diskutuar për çdo çështje.

(Ndërrhyrje pa mikrofon nga salla)

Urdhëro, zoti Balla?

(Ndërrhyrje pa mikrofon nga salla)

Rregulloren po lexoj. Unë si deputet kam të drejtë që të diskutoj për çdo çështje deri në 10 minuta. Ju më thoni: “Diskuto për 3 minuta”.

Lindita Nikolla – Zoti Spaho, ju lutem, deputetit i jepen 10 minuta kur diskutohet projektligji. Nëse bëhet debat për raportime, është në të drejtën e Konferencës së Kryetarëve përcaktimi i kohës, dhe ne këtë kemi bërë.

Edmond Spaho – Zonja Kryetare, grupet parlamentare mund të bien dakord për kohën e tyre. Deputetët, të cilët nuk janë në grupe parlamentare, kanë të drejtë të flasin 10 minuta, sipas Rregullores. Kështu që ju, kur llogarisni kohën, kohës që kanë dëshirë grupet parlamentare për të folur, duhet t’i shtoni edhe kohën që kanë të drejtë të flasin deputetët të cilët nuk bëjnë pjesë në një grup parlamentar.

Pse një koleg nga mazhoranca ka të drejtë të flasë 10 minuta, sepse ka më shumë kohë në dispozicion, dhe unë duhet të flas vetëm 1 minutë?!

Lindita Nikolla – Sepse është brenda kohës së grupit. Mund të flisni edhe ju 10 minuta dhe të merrni të gjithë kohën e grupit.

Edmond Spaho – Të gjithë deputetëve të pavarur u keni dhënë 5 minuta kohë. Çfarë të flasim ne?! Ky është diskriminim dhe është qëndrim me dy standarde! Përse i referoheni Rregullores kur është “Java e gjelbër” dhe thoni se në Rregullore është e përcaktuar saktësisht që janë vetëm 4 orë për të folur, dhe nuk i referoheni edhe në këtë rast?

Lindita Nikolla – Po, edhe në këtë rast i referohemi Rregullores, pra është Konferenca e Kryetarëve ajo që e vendos kohën e debatit në

total. Koha e debatit ndahet në mënyrë përpjesëtimore.

Edmond Spaho – Çfarë do t’ju gjejë juve nëse do të flasim edhe ne 10 minuta?!

Lindita Nikolla – Faleminderit, zoti Spaho! Zoti Balla, fjala për ju.

Taulant Balla – Zoti Spaho, nuk është faji ynë që kohën tënde ta merr Muli e, më keq akoma, Saliu! Ja, të erdhi dhe do të të marrë kohën tjetër tani! Të erdhi, iku, edhe tek tjetra nuk do të flasësh, se do ta marrë fjalën ai.

(Ndërrhyrje pa mikrofon nga salla)

Dëgjova një seri ndërhyrjesh gjoja për procedurë, njëri si i inatosur, tjetri si vrerosur, një tjetër që vjen në parlament si për shkollë nate, ku propozimi ishte të kërkohej një debat në Kuvendin e Shqipërisë për situatën në Veri të Kosovës. Keqardhje e madhe që kemi ende në këtë sallë politikanë që frymëzohen nga të tjerë syresh që sapo hynë, e që të gjithë e dimë një gjë brenda nesh: as nuk duan t’ia dinë për Kosovën, as nuk duan t’ia dinë për Shqipërinë, por vetëm e duan Kosovën dhe Shqipërinë për t’u stërhumbur përsëri këtu, mes nesh, për debatin politik të ditës, për ta përdorur Kosovën tonë të dashur “mish për top”, për të gjuajtur Kryeministrin, qeverinë dhe për të keqpërdorur Shqipërinë. Nuk ka asnjë dyshim që Shqipëria, (të paktën sa kohë kemi qenë ne në qeverisje dhe do të vazhdojmë të jemi), është dhe do të jetë gjithmonë pranë popullit të Kosovës, e theksoj këtë, pranë interesave të Kosovës si shtet i pavarur e sovran. Por mos harroni që jemi një vend anëtar i organizatës euroatlantike, falë së cilës u bombardua për afro dy muaj Beogradi, Serbia, dhe falë së cilës e kemi sot Kosovën shtet të lirë, sovran, të pavarur, dhe Shqipëria, doni apo nuk doni ju, antiamerikanët e asaj fundsalle, duhet të jetë në të njëjtën linjë me organizatën euroatlantike.

Këtu besoj se shteron gjithë ky zelli i madh i ndonjë propozimi: “Të lutem, e kam për procedurë!”; del ky tjetri, që sa ka ardhur: “Është situata...”, a thua ti se ky do të marrë armët e do të shkojë të përballet atje!

Ndaj, ju lutem, populli i Kosovës ka nevojë për Shqipërinë, natyrshëm, dhe Shqipërinë këtu e ka! Të mos harrojmë kurrë që lirinë e arritëm në aleancë me SHBA-të, me BE-në, me Britaninë e Madhe dhe duhet të vazhdojmë ta konsolidojmë këtë aleancë historike.

Për sa u përket këtyre diskutimeve të tjera, është fat i madh për ne që diskutimet më inflamuese të opozitës kanë ngelur në dorë të Muilt (është fat i madh), i cili fillon e mbaron dhe hallin e ka, duke qenë se i ka ngelur mendja kur ka qenë sekretar Organizativ i PD-së, sepse tani e kanë ngritur në detyrë, është sekretar i Përgjithshëm i foltores, e thotë “aktivisti, patronazhisti; patronazhisti, aktivisti”. Këta i kemi, jemi shumë krenarë që i kemi, do t'i shtojmë e do t'ju mundim sa herë të na dilni përballë. Por, meqë kishit probleme me “Aktivistin” (nuk e mora dot telefonin), mund t'ju them që unë jam një shtetas shqiptar, kam hyrë dhe jam në aplikacionin e një partie politike të djathtë, t'ju them të drejtën, më e forta dhe më e mirorganizuar në Europë, CDU-ja, e cila ka një aplikacion që quhet “Meine CDU”...

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Të lutem, ta mbaroj unë, se ka një respekt!

Ka një aplikacion që quhet “Meine CDU” dhe aty mund të hyjë kushdo; mund të hyjë edhe një shtetas i huaj si unë; mund të hyjë një punonjës i administratës së secilës prej bashkive të Gjermanisë, madje edhe këta të Bavarisë që janë CSU, mund të hyjnë tek aplikacioni i CDU-së, pra mund të hyjë çdokush. Edhe aplikacioni “Aktivisti” është një aplikacion i hapur..

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Dëgjo, Saliu ka mbaruar punë, por është fat i madh që pas Saliut je ti dhe Muli, ju të dy jeni personifikimi më kuptimplotë i budallait. Dakord?

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Ta mbaroj.

Ajo që po ju them, është: lërin dokrrat me histori administrate. Administrata shqiptare është me rregulla, natyrshëm, duhet ta përmirësojmë dhe, jam shumë dakord, hajdeni me propozime, por e vërteta është që si përqindje ne kemi administratën civile më të lartë si numër, në kuptimin e të gjithë punonjësve të shtetit. T'ju them të drejtën, unë nuk jam dakord që plot institucione, të cilat janë përfshirë në administratën publike, të vazhdojnë të jenë pjesë e ligjit të nëpunësit civil, dhe e kam thënë që kur është miratuar se është e papranueshme që administrata tatimore, ose ajo doganore të jenë me status të nëpunësit civil, por kjo është një politikë e qeverisë, ka vendosur të jetë e tillë, me status të nëpunësit civil dhe vazhdojmë punën.

E vërteta është që ne kemi shumë, po shumë punë për të bërë dhe për të konsoliduar, por një gjë mos e harroni: lexojini të gjitha progresraportet, të paktën të 5 vjetëve të fundit, dhe shikoni që vlerësimi për performancën e Departamentit të Administratës Publike, për Komisionerin e Shërbimit Civil dhe për të gjithë procesin e rekrutimeve në administratë është maksimal. Kjo është një arritje shumë e madhe, sepse koha kur për të marrë provimin e administratës publike bëhej me ndërhyrje me telefona ka mbaruar njëherë e përgjithmonë. Nuk ka ndërhyrje në rekrutimin për në administratën publike.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Nuk ka, bëni kot.

Prandaj, duke qenë se erdhi koha dhe po e ndërpres fjalën time, sepse kemi përcaktuar të kemi një minutë heshtje në respekt të një personaliteti, i cili gjatë gjithë karrierës së tij politike, që nga vitit 1994, kur hyri në politikën italiane, ka pasur një afeksion për Shqipërisë; ka qenë një mbështetës i palëkundur në politikën italiane dhe në atë europiane për aspiratën për anëtarësimin europian të Shqipërisë. Mendoj se përcaktimi që u bë në fillim të kësaj seance për të mbajtur 1 minutë heshtje për kavalierin, për Presidentin e Këshillit, *il Presidente del Consiglio*, Kryeministrin Italian, Silvio Berlusconi, i bën nder Kuvendit të Shqipërisë.

U prehtë në paqe!

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Silvio Berlusconi ishte një personalitet, politikan, parlamentar dhe qeveritar i shquar i Italisë mike. Gjatë shërbimit të tij si politikan, deputet, senator dhe Kryeministër i Republikës së Italisë dhe si deputet i Parlamentit Europian ka dhënë një kontribut të spikatur për forcimin e bashkëpunimit mes Shqipërisë dhe Italisë, si dhe të miqësisë mes popullit shqiptar dhe popullit italian.

Në nderim të kujtimit dhe kontributit të ish-Kryeministrit, Silvio Berlusconi, ju ftoj të mbajmë një minutë heshtje.

(Mbahet një minutë heshtje.)

U prehtë në paqe!

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Zoti Dogjani, a ka mundësi, sepse sa erdhët në parlament, ju lutem!

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Dakord. Ka një radhë këtu dhe unë do të respektoj radhën. Uluni në vend! Keni kërkuar replikë dhe do t'ju jepet fjala për replikë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, ka një radhë këtu!

Zoti Edmond Spaho e ka kërkuar fjalën për replikë para jush.

Fjalën e kanë zoti Dogjani, zoti Gështenja dhe zoti Bardhi.

Zoti Bardhi, si kryetar i Grupit Parlamentar, keni përparësi.

Gazment Bardhi – Zonja Kryetare, në fakt, unë mendova se ju do të reagonit ndaj fjalës së zotit Balla në parlament. Askush në këtë sallë nuk ka të drejtë të fyejë deputetë, t'i quajë ata budallenj. Ne e kemi Kryeministrin me kartelë dhe kryebudalla, por nuk ia kemi thënë ndonjëherë në parlament. Prandaj, zonja Kryetare, unë kërkoj marrjen e menjëhershme të masës disiplinore ndaj kryetarit të Grupit Parlamentar të PS-së, i cili fyeu dy kolegë duke i quajtur ata nga foltorja e parlamentit “budallenj”, njëri prej tyre ishte zonjë. Në fakt, ju, si zonjë, zonja Kryetare, do të duhej të kishit reaguar menjëherë. Nuk mund të shkelet etika në parlament duke fyer pa asnjë shkak kolegët deputetë...

Lindita Nikolla – Gjë që e bëtë edhe ju tani në fjalën tuaj, zoti Bardhi, në shkelje të rëndë të nenit të Rregullores.

Gazment Bardhi – Jo, unë nuk e bëra fare, por thashë: kemi kryebudalla...

Kemi kryebudalla Kryeministrin, por nuk ia kemi thënë ndonjëherë.

Lindita Nikolla – Ju lutem, mos e përsërisni më, sepse jeni për masë disiplinore.

Gazment Bardhi – E kemi me kartelë dhe nuk ia kemi thënë ndonjëherë, por nuk mundet askush t'i fyejë kolegët pa asnjë shkak dhe ju si zonjë keni më së shumti detyrimin për të mos lejuar që të fyhen zonjat në këtë seancë. Është e papranueshme, zonja Kryetare, prandaj ju kërkoj të merrni menjëherë masë disiplinore ndaj kryetarit të grupit për shkelje të etikës në fjalimin e tij.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Zoti Spaho, fjala për ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Spaho, Dogjani, Gështenja.

Edmond Spaho – Zoti Balla, unë mendoj se është turp i madh që Kuvendi i Shqipërisë nuk organizon sot debat për Kosovën, e cila gjendet në

momentin më të vështirë e më kritik në të gjithë historinë e ekzistencës së shtetit kosovar. Thikat për ta copëtuar janë mprehur dhe ky është një skenar shumë ogurzi. Po nuk folëm sot ne, kur do të flasim?! Ju thoni që nuk ka nevojë të mblidhemi e të diskutojmë, por po të them ty sot, për shembull, presidenti i Serbisë sot ka qenë në ambasadën ruse në Beograd dhe është takuar me ambasadorin rus dhe me ambasadorin kineze, ndërsa ne dëgjojmë fjalët e tua, që kërcen nga një degë në një degë.

Së dyti, është turp i madh që Kryeministri i Shqipërisë del dhe bën publike qëndrimet për Kosovën, në një kohë kur nuk ka diskutuar për asgjë me udhëheqjen kosovare, madje nuk ka diskutuar as brenda spektrit politik në Shqipëri, sepse ky është një interes përtej politikës.

Turp i madh që anulohet takimi i dy qeverive në Kosovë. Këtë mund ta bëjë vetëm një bashibuzuk si Haxhi Qamili, ose një tradhtar si Esat Pasha dhe e bën për të ruajtur karrigen e tij dhe për t'u thënë aleatëve: unë jam me ju. Me aleatët do të jemi ne, sigurisht, por, së pari, duhet ta zgjidhim midis nesh. Turp i madh që tre kryeministra shqiptarë në rajon dhe një zëvendëskryeministër në Maqedoni nuk mblidhen një herë të rakordojnë qëndrimin për Kosovën. Më fal, përgjegjësia, në radhë të parë, është e Kryeministrit të Shqipërisë, sepse është vendi amë dhe duhet...

(Zoti Spaho flet pa mikrofon.)

Lindita Nikolla – Ju lutem, edhe një herë ju tërheq vëmendjen për ruajtjen e etikës, për kontrollin e gjuhës dhe të fjalorit brenda caqeve të etikës. Kjo është për të gjithë, nuk po veçoj askënd.

Zoti Dogjani, fjala për ju.

Asllan Dogjani – Faleminderit, zonja Kryetare!

Nëse do të jetë nevoja për të marrë armët për të shkuar për të luftuar për Shqipërinë dhe për Kosovën, po, unë jam i pari që i marr armët dhe ne kuksianët i kemi marrë armët gjatë luftës për çlirimin e Kosovës, ku janë vranë disa të rinj kuksianë për çlirimin e Kosovës; kemi pritur mbi 500 mijë qytetarë shqiptarë të Kosovës, të cilët u përzunë nga Milosheviçi dhe ministri i tij Vuçiçi, i cili sot po i sulmon përsëri shqiptarët në Kosovë. Pra, zotëri, që fole para meje, po, unë e marr armën për të luftuar për Kosovën.

Për sa i përket asaj që unë jam i ri në këtë parlament, absolutisht nuk kam ardhur me votat tuaja, por kam ardhur me votat e demokratëve të Kamzës dhe të qytetarëve të Tiranës dhe do të bëj gjithçka për të mbrojtur interesat e tyre.

Unë qëparë kur mora fjalën në këtë seancë, por edhe në seancën e kaluar kam kërkuar të dalim me një rezolutë që ta dënojmë absolutisht dhunën e ushtruar nga paramilitarët, grupet e organizuara kriminale ndaj qytetarëve të Kosovës, ndaj policisë së KFOR-it dhe policisë së Kosovës. Këtë kam kërkuar.

Zotërinj, sot nuk është koha për luftë, por është koha që ne si parlament sot të mos ishim duke diskutuar këto projektligje, por duhej të bënim një seancë jashtë radhës për të mbajtur një qëndrim ndaj shqiptarëve të Kosovës. Natyrisht, unë e kam thënë edhe herë të tjera që ne jemi me aleatët tanë shumë të rëndësishëm, me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Europian. Ne nuk po analizojmë veprimet e Albin Kurtit, por ne kërkojmë që Kryeministri ynë të mos bëjë paçavure në platforma, por, edhe nëse i bën, le të vijë e të japë llogari, ose të jetë transparent me ne dhe të na thotë se çfarë platforme ka bërë dhe a e ka diskutuar me qeverinë e Kosovës, sepse është Kryeministri i Shqipërisë dhe duhet të jetë transparent, jo të sillet poshtë e përpjetë, por të vijë këtu e të japë llogari. Prandaj, edhe një herë po ju them: të dalim me një rezolutë, ku të dënojmë dhunën e ushtruar në Kosovë nga grupet e organizuara kriminale, të dalim me një rezolutë që ta dënojmë këtë dhunë dhe t'i mbështesim shqiptarët e Kosovës.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Ju lutem, edhe një herë, duke kërkuar qetësi, ne jemi pranë Kosovës dhe duam zgjidhjen e situatës, njësoj siç e duan edhe partnerët e Kosovës, Bashkimi Europian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pa dyshim me qetësi dhe dialog. Ju lutem, të mos e përdorim Kosovën për situatat tona të brendshme politike! E kemi shumë të shtrenjtë Kosovën për ta përdorur për këtë.

Fjala për zotin Gështenja.

Lifter Gështenja – Faleminderit, zonja Kryetare!

Në fakt, doja të ngrija si shqetësim një propozim që kam bërë para 6 muajsh lidhur me projektligjin e administratës publike, ku përfshihej edhe aplikacioni i Partisë Socialiste

“Aktivisti”. Askush nuk është kundër aplikacionit që mund të ketë një parti politike, por për ne si deputetë të opozitës përdorimi i administratës publike në fushata elektorale është i dukshëm dhe ne kërkojmë që administrata publike të mos përdoret për fushatë politike. Kjo është lehtësisht e verifikueshme, mjafton hapja e një faqeje Facebook-u, në rrjetet sociale, qoftë e Kryeministrit, e ministrave apo e drejtuesve të qarqeve që në kohë rekord, sapo hidhet postimi, bëhet *share* dhe *like* nga administrata publike në orar zyrtar, gjë që e ndalon ligji. Këtë kemi kërkuar ta ndalojmë, edhe me ndryshimet që kemi propozuar. Nuk e kam kuptuar akoma pse duhen 6 muaj për t'i përfshirë në kalendarin e punimeve! Gjithsesi, unë dua që të përfshihet sa më parë, edhe pse efektet do t'i kishte para fushatës zgjedhore.

Në lidhje me aplikimin e “Aktivistit”, do të thosha edhe diçka tjetër: Partia Socialiste mund të ketë aplikacion, por nuk duhet t'i përdorë institucionet shtetërore, administratën publike; nuk mund ta përdorë AKSHI-n dhe programacionet që ka shteti.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Mbarojmë me këtë pikë të rendit të ditës.

Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës: raporti i veprimtarisë vjetore të Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2022. Në bazë të nenit 103, pika 2 e Rregullores së Kuvendit dhe nenit 24 të ligjit nr. 9121/2003 “Për Autoritetin e Konkurrencës”, sot do ta paraqesë raportin vjetor për vitin 2022 kryetari i Autoritetit, zoti Denar Biba.

Zoti Biba, keni fjalën. Koha në dispozicion deri në 20 minuta.

Denar Biba – E nderuar zonja Kryetare e Kuvendit,

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,

Autoriteti i Konkurrencës gjatë vitit 2022 i ka përmbushur detyrimet ligjore, që rrjedhin nga ligji “Për mbrojtjen e konkurrencës” për të garantuar respektimin e rregullave të konkurrencës nga të gjithë operatorët në treg, nga ku duhet veçuar monitorimi në vazhdimësi i aktiviteteve të ndërmarrjeve, që u janë dhënë nga shteti të drejta ekskluzive dhe të veçanta.

Autoriteti i Konkurrencës ka ndjekur me prioritet plotësimin e rekomandimeve të lëna nga Kuvendi i Shqipërisë në rezolutën “Për vlerësimin

e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2021”.

Gjatë vitit 2022 u morën 99 vendime nga Komisioni i Konkurrencës. Ky është numri më i lartë i vendimeve që janë marrë ndonjëherë gjatë një viti nga Autoriteti i Konkurrencës.

Autoriteti gjatë vitit 2022 ka realizuar në tregjet sensitive dhe me ndikim të drejtpërdrejtë për mirëqenien e konsumatorit 15 monitorime: në tregun me pakicë të shërbimeve celulare; në sektorin e arsimit të lartë; në tregun e importit të grurit; importit, prodhimit dhe tregimit të miellit; në tregun e prodhimit dhe tregimit të naftës bruto; në tregun e ofrimit të shërbimit të fjetjes në hotele dhe akomodime të ngjashme në qytetin e Tiranës; në tregun e veprimtarive ekonomike që zhvillohen nga Federata Shqiptare e Futbollit; në tregun e ofrimit të shërbimit të marrjes së qelizave staminale; në tregun e tregimit me shumicë të karburantit, naftë dhe benzinë; në tregun e shërbimeve celulare; në tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare; në tregun e sigurimeve për produktin e kartonit jeshil; në tregun e sigurimeve për produktin TPL; në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore; në tregun e shërbimeve të infrastrukturës aeroportuale; në tregun e shërbimeve bankare dhe në tregun e grumbullimit dhe përpunimit të qumështit të lidhura në nivel tensioni 35 kilovolt.

Gjatë vitit 2022 janë realizuar edhe 11 procedura hetimore prej të cilave 6 hetime për marrëveshje të ndaluara në tregun e importit, prodhimit dhe tregimit me shumicë të vajit vegjetal; në tregun e barnave dhe pajisjeve mjekësore; në tregun e tregimit me shumicë të karburantit, naftë dhe benzinë; në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike; në tregun e prodhimit/importit dhe shitjes me shumicë të çimentos dhe në tregun e prodhimit të betonit në qarqet e Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit.

Gjithashtu, kemi zhvilluar edhe 5 hetime për abuzim me pozitën dominuese dhe kanë qenë: tregu i menaxhimit të faciliteteve të parkimit të *Tirana International Airport*; tregu i shërbimeve celulare; tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare; tregu ku operojnë subjektet financiare jobankare; tregu i ofrimit të shërbimit të instrumenteve matëse nëpërmjet instrumenteve shpërndarëse të karburanteve dhe

gazit të lëngshëm, si dhe tregu i prodhimit, transmetimit dhe shitjes në mënyrë digjitale të produkteve audio dhe video tek operatorët kabllorë.

Në lidhje me këto hetime, mund të them edhe në një analizë krahasuese se Autoriteti i Konkurrencës është në një mesatare mbi mesataren e hetimeve që zhvillojnë vendet e rajonit, për shembull, Kroacia, një vend të cilit ne duam t'i ngajmë, sepse relativisht për territor dhe për popullatë jemi diku të përafërt, për vitin 2022 ka zhvilluar vetëm 4 hetime, ndërsa ne raportuam 15 hetime.

Përgjatë vitit 2022 Autoriteti i Konkurrencës ka vendosur 4 gjoba, pra edhe ky është një tjetër rekord, ku në 5 vjetët e fundit është numri më i lartë i gjobave për shkelje të rënda të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, përkatësisht në tregun e importit dhe tregimit me shumicë të plehrave kimike, në tregun e prodhimit dhe tregimit të naftës bruto, në tregun e menaxhimit të faciliteteve të parkimit të *Tirana International Airport*, si dhe në tregun e importit të grurit, importit, prodhimit dhe tregimit të miellit, që në total kapin vlerën 224 milionë dhe disa bishta nga pas, që është absolutisht një shifër rekord i 10 vjetëve të fundit në lidhje me vlerën e gjobave të vëna.

Të ardhurat e arkëtuara në buxhetin e shtetit nga vjelja e gjobave të prapambetura, duke filluar nga viti 2018 deri më 31 dhjetor 2022, janë në shumën 26 milionë lekë të reja.

Në zbatim të neneve 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, kontrolli i përqendrimeve është realizuar nëpërmjet vlerësimit të 46 rasteve të autorizuara nga Komisioni i Konkurrencës, dhe 15 raste të tjera, që janë të njoftuara, por që nuk kanë përmbushur kriteret ligjore për t'u autorizuar nga Komisioni i Konkurrencës. Nga autorizimi i përqendrimeve, Autoriteti i Konkurrencës ka derdhur në buxhetin e shtetit shumën rekord prej 26 milionë lekësh. Ne matemi me veten dhe viti 2022 realisht ka qenë një vit rekordesh.

Në vitin 2022 tregu i energjisë së rinovueshme dhe tregu i prodhimit të *software-ve* në industrinë e automjeteve janë tregjet më të prekura nga transaksionet e ndryshimit të kontrollit.

Gjatë vitit 2022, në zbatim të nenit 70 të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Autoriteti i

Konkurrencës është shprehur me 17 vendime, me rekomandime drejtuar enteve rregullatore dhe institucioneve të administratës qendrore.

Procesi i integritimit european përbën një nga prioritetet e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës. Si një institucion lider dhe koordinator për kapitullin 8 “Politika e konkurrencës”, Autoriteti i Konkurrencës jep kontributin e tij në kuadër të Planit Kombëtar për Integrimin European, duke raportuar në mënyrë periodike pranë Kryenegociatorit, Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, për tregun e brendshëm dhe konkurrencën, si dhe jep kontributin e tij për progresraportin.

Në datat 6, 7 dhe 8 mars të vitit 2023 u zhvillua në Bruksel takimi “*Bilateral screening*”, në të cilin Autoriteti i Konkurrencës raportoi si lider i kapitullit 8 “Politika e konkurrencës”. Kam kënaqësinë personale dhe institucionale të ndaj me ju vlerësimin e shkëlqyer që patën zotërinjtë e Brukselit në lidhje me punën dhe veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës, duke thënë tekstualisht: “Sikur të ishte për Autoritetin e Konkurrencës, Shqipëria mund të hynte në BE që nesër”.

Gjatë vitit 2022 Autoriteti i Konkurrencës ka hartuar Planin Kombëtar për Integrimin European 2023-2025, i cili është dokumenti bazë për përcaktimin e prioritetëve, planifikimin, koordinimin dhe monitorimin e përbushjes së detyrimeve në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Autoriteti i Konkurrencës ka përgatitur dhe ka integruar në këtë plan kombëtar kapitullin 8 “Politika e konkurrencës”, duke parashikuar nismat ligjore afatshkurtra dhe afatmesme në kuadër të procesit të përafrimit të legjislacionit me atë të BE-së.

Në përputhje me Planin Kombëtar për Integrimin European 2021-2023, Autoriteti i Konkurrencës e ka përbushur 100% këtë plan, duke miratuar brenda afateve kohore të përcaktuara nismat ligjore të parashikuara, në përputhje të plotë me legjislacionin european në fushën e konkurrencës.

Gjatë vitit 2022, Komisioni i Konkurrencës ka miratuar me vendim edhe udhëzimin “Mbi kufizimet e konkurrencës “sipas objektit” për qëllime të përcaktimit të marrëveshjeve me rëndësi të vogël”, duke qenë një ndër institucionet e Autoritetit të Konkurrencës, i cili ka një nga legjislacionet më të përafruara me *aquis-të* e BE-

së. Si vend kandidat në procesin e integritimit, është i nevojshëm një rishikim i mëtejshëm i kuadrit tonë ligjor në fushën e konkurrencës, duke e përditësuar atë me risitë e legjislacionit përkatës të konkurrencës në vendet e BE-së.

Për sa më sipër, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë përmes rezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2021” ka parashikuar që Autoriteti i Konkurrencës të përfshijë sa më parë ndryshimet në rishikimin e ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” në progresin e konsultimit publik, me qëllim paraqitjen e tyre në Kuvend brenda vitit 2022. Në kuadër të përbushjes së këtij rekomandimi të rezolutës, Autoriteti i Konkurrencës zhvilloi në datën 12 dhjetor 2022 aktivitetin me temë “Dita e konkurrencës dhe prezantimi i ndryshimeve të propozuara në ligjin “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të cilat po i paraqes në mënyrë të përmblodhur: përmirësohet qëllimi i ligjit, duke zhvendosur fokusin nga konkurrenca tek eficientia; zgjerohet dispozita mbi marrëveshjet e ndaluara, duke përfshirë marrëveshjet në oferta në procedurat e prokurimit publik, që është një risi në mënyrën sesi po funksionojnë sot homologët tanë në vendet e BE-së; shtohet një dispozitë e re “Ftesa për marrëveshje të ndaluara”, e cila përcakton ndalimin për një ndërmarrje të propozojë, të detyrojë, të motivojë ose në çfarëdolloj mënyre të ftojë një ndërmarrje tjetër për të marrë pjesë në një marrëveshje midis ndërmarrjeve ose në vendimet e grupimeve të ndërmarrjeve, ose në praktikat e bashkërenduara që synojnë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës; përmirësohet përjashtimi i marrëveshjeve; kontrolli i përqendrimeve bëhet më gjithëpërfshirës; përmirësohen procedurat hetimore; shtohen dy dispozita të reja në lidhje me afatet e parashkrimit për vendosjen e gjobave, të hartuara në përputhje me nenin 25 të rregullores së Këshillit European të vitit 2003, si dhe për afatin e parashkrimit për ekzekutimin e gjobave, edhe kjo e hartuar në respekt të plotë me nenin 26 të rregullores së Këshillit European “EC 2003”.

Lidhur me ankimin në gjykatë, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative kundër vendimeve të Komisionit të Konkurrencës janë bërë ndryshime në ligj, në mënyrë që të përshtaten me zhvillimet e fundit në botën e gjyqësorit.

Për sa më sipër, Autoriteti i Konkurrencës ka përgatitur draftin e amendimeve të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, draft i cili është dërguar prej kohësh pranë Ministres së Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, pranë Komisionit për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Autoriteti i Konkurrencës i kushton rëndësi të veçantë ndjekjes së procedurave gjyqësore, duke qenë aktiv në të gjitha këto procese në shkallët e gjykimit nëpërmjet paraqitjes së argumenteve dhe provave në mbështetje të vendimeve të marra nga Komisioni i Konkurrencës.

Ndjekja e çështjeve gjyqësore lidhet me ndikimin që kanë vendimet e Komisionit në tregun përkatës dhe në publikun e gjerë, si dhe me faktin që pothuajse të gjitha vendimet e Komisionit i janë nënshtruar procesit të ankimit gjykatë.

Për vitin 2022 Autoriteti i Konkurrencës ka qenë palë në 9 procese gjyqësore, nga të cilat 5 raste i kemi fituar, ndërkohë që 4 të tjera janë në apel.

Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë përgjatë vitit 2022 janë shqyrtuar 7 çështje, në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë është shqyrtuar 1 çështje dhe 1 çështje tjetër në Gjykatën e Lartë.

Gjatë vitit 2022, në zbatim të nenit 69 të ligjit, kemi vlerësuar 30 akte normative, nga të cilat 21 akte nënligjore në tregun e energjisë dhe gazit; 6 akte nënligjore në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit të përpunimit të ujërave; 1 vlerësim i projekt marrëveshjes së investimeve me Arabinë Saudite; 1 vlerësim i ligjit për “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe 1 vlerësim i projektit të investimit strategjik “*Marina & Jahtet e Durrësit*”, dërguar nga AIDA.

Në kuadër të procesit të përafrimit të legjislationit dhe respektimit të afateve të parashikuara në Planin Kombëtar të Integritit Europian, gjatë vitit 2022 Autoriteti i Konkurrencës ka miratuar 1 akt nënligjor “Udhëzim mbi kufizimet e konkurrencës “sipas objektit” për qëllime të përcaktimit të marrëveshjeve me rëndësi të vogël”. Autoriteti është angazhuar në drejtim të promovimit të advokacisë së konkurrencës përkundrejt shumë

palëve në treg, konsumatorëve, komunitet të biznesit dhe institucioneve shtetërore dhe botën akademike, ku, konkretisht, gjatë vitit 2022 kemi zhvilluar 2 takime me botën akademike në Tiranë, 1 *workshop* me komunitetin e biznesit, 1 aktivitet për “Ditën e konkurrencës” dhe 1 tryezë të rrumbullaket në fushën e prokurimit publik, ku u nënshkrua edhe udhërrëfyesi i përbashkët ndërmjet APP-së dhe AK-së.

Gjithashtu, është nënshkruar një memorandum bashkëpunimi ndërmjet Autoritetit të Konkurrencës me Agjencinë gjeorgjiane Kombëtare të Konkurrencës dhe marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë dhe Autoritetit të Konkurrencës.

Gjatë veprimtarisë së vitit 2022 Autoriteti i Konkurrencës ka synuar forcimin e marrëdhënieve ndërkombëtare me institucionet homologe, forumet dhe qendrat e trajnimeve të konkurrencës në rajon e më gjerë.

Gjatë vitit 2022 përdorimi i buxhetit të miratuar për Autoritetin e Konkurrencës ka qenë konform kërkesave të ligjit dhe është përdorur me efikasitet për plotësimin e kushteve dhe kërkesave të punonjësve për realizimin e detyrave të ngarkuara për të siguruar një konkurrencë të lirë dhe të ndershme.

Ju falënderoj për mbështetjen dhe për vëmendjen!

Lindita Nikolla – Faleminderit!

Pyetje nuk janë depozituar.

Çelim debatin.

(Ndërrhyrje nga salla pa mikrofon)

Jo, duhej të ishin depozituar.

Fjalën e ka zonja Jorida Tabaku.

Të përgatitet Sali Berisha.

(Ndërrhyrje nga salla pa mikrofon)

Kemi një sponst, sepse është në një angazhim.

Jorida Tabaku – Të nderuar kolegë,

Besoje se diskutimi për raportin e Autoritetit të Konkurrencës ka rëndësi, por dua të ndalem dy minuta edhe të çështja që shumë kolegë me të drejtë e kanë ngritur në seancën e sotme. Jemi njohur nga media që Kryeministri i Shqipërisë ka prezantuar një draft për asociacionin, i cili kishte kohë që diskutohej ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Unë nuk flas dot për diçka që nuk e kam lexuar, nuk është dokument publik dhe nuk besoj se mund të flasim dhe të supozojmë për diçka që ne nuk e dimë. Por, derisa ne ta kemi diskutim dhe

të kemi informacion për të, unë besoj se nuk i shërben askujt marrja në patronazh e kësaj çështjeje.

Shqipëria gjithmonë ka pasur, sigurisht, një marrëdhënie të veçantë me Kosovën, për atë që ne përfaqësojmë, për atë çfarë Kosova përfaqëson; kemi tentuar shumë herë të mos e përdorim për politikën tonë të ditës; të mos e shfrytëzojmë dhe të mos debatojmë për politikën tonë të ditës, por koordinimi me partnerët nga njëra anë, dhe, nga ana tjetër, mbajtja e interesit kombëtar para syve duhet ta drejtojnë këtë proces. Interesi kombëtar bën fjalë për Shqipërinë dhe shqiptarët kudo ndodhen, në çdo truall, si në Shqipëri, po ashtu edhe përtej kufijve.

Nuk e kam zakon që diskutimet që zhvilloj me kolegët, por njëkohësisht edhe me të gjithë drejtuesit në Kosovë, t'i bëj publike. Unë kam qenë në kontakt me të gjitha nivelet në Kosovë. Ata, sigurisht, nuk kanë dijeni dhe nuk kanë pasur dijeni për këtë draft, por do të ishte e udhës që ata të ishin pjesë e këtij procesi. Trajtimi i tyre si palë, nuk i shërben askujt.

Besoj se është e nevojshme t'i rikthehem dialogut, t'i rikthehem asaj që është marrë me shumë mundim, asaj që është fituar me shumë mundim, t'i rikthehem Marrëveshjes së Ohrit, por ajo që është më e rëndësishme sot është të mos i dënojmë si palë, por të dënojmë atë që po ndodh në territorin e Kosovës, duke filluar që nga marrja peng e 3 policëve në territorin e Kosovës deri te përshkallëzimi i asaj çfarë po ndodh në Mitrovicë, Leposaviç dhe në të gjitha bashkitë e tjera në Veri, ku sot nuk mund të quhet një situatë normale.

Për këtë arsye është në nderin e këtij parlamenti dhe të Komisionit të Jashtëm që ta ketë temë diskutimi, ta ketë çështje, jo për ta përdorur Kosovën, por për të kuptuar se çfarë po ndodh në Kosovë, cilat janë kërkesat e krerëve të qeverisë në Kosovë dhe si mund ta ndihmojmë ne Kosovën, jo ta pengojmë atë.

Thënë këtë, është pak e vështirë të diskutosh sot për Autoritetin e Konkurrencës, por nuk ka çështje më të rëndësishme për ekonominë shqiptare se diskutimi i disa prej tregjeve dhe çfarë po ndodh sot me tregjet, të cilat kanë lidhje dhe impakt të drejtpërdrejtë të çmimit.

Që në shtator të vitit të kaluar, në emër të Partisë Demokratike, ne kemi kërkuar informacion dhe hetim për disa tregje specifike: tregu i parë është ai që lidhet me ushqimet e

shportës; tregu i dytë ai që lidhet me karburantet; tregu i tretë është ai që lidhet me sigurimet; së fundi, se si qeveria shqiptare po zbaton Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit dhe si Autoriteti i Konkurrencës po përpiqet të hetojë çdo cenim të kësaj marrëveshjeje, por edhe ruajtjen e konkurrencës në vendimet e fundit të qeverisë, duke filluar me aeroportin e Vlorës dhe duke vazhduar me projektin e "Marinës" së Durrësit.

Cenimi i konkurrencës në të gjitha ligjet që qeveria ka kaluar, si ligje speciale, duhet të kishte qenë objekt i veçantë i punës së Autoritetit të Konkurrencës; duhet të kishin marrë masa specifike për të parë se si qeveria ka shkelur dhe ka cenuar konkurrencën dhe, nga ana tjetër, ka kufizuar garën në të dyja rastet, edhe në rastin e aeroportit të Vlorës, edhe në rastin e portit të Durrësit. Unë dua të përgëzoj të gjithë kolegët, të majtë dhe të djathtë, të cilët në rezolutën e miratuar e kanë vendosur si një nga pikat që duhet të hetohet patjetër. Se sa vlerë ka që të hetohet pasi kjo ka ndodhur, nuk e di, AK-ja duhej pyetur dhe përfshirë në këtë proces përpara se kjo të ndodhte, përpara se këto marrëveshje të ndodhnin.

Së dyti, sot ekonomia shqiptare, por edhe Shqipëria në përgjithësi, është në krizë të thellë ekonomike dhe sociale, sepse një pjesë e madhe e tregjeve, duke filluar me tregun e karburanteve, duke vazhduar me atë të ushqimeve, ndodhen qartësisht në pozita ku nuk ka konkurrencë. Tregu i karburanteve, me vendosjen e bordit, që unë e kam quajtur "bord oligark", që përcakton çmimet, praktikisht *de facto* e ka shumëzuar me zero konkurrencën. Çfarë bëri AK-ja për këtë? Asnjë hetim! Edhe kjo është vendosur në rezolutë dhe unë shpresoj të kemi një hetim për tregun e karburanteve, për vendosjen dhe parapërcaktimin e çmimeve, ku në mënyrë ekzemplare pronarët e kompanive të karburanteve, ulur në një tryezë me qeverinë shqiptare, por edhe me përfaqësues të tjerë të bizneseve, kanë vendosur çmimet.

E njëjta situatë ka ndodhur në tregun e ushqimeve. Vendosja e çmimeve për ushqimet bashkë me bordin qartësisht ka favorizuar kompanitë, ka prekur dhe ka cenuar konkurrencën.

E njëjta situatë ka ndodhur te prokurimet publike. Praktikisht sot te prokurimet publike nuk ka garë; një në tre tendera jepet pa garë; 99% e rasteve jepen me vlerën limit; në të gjitha rastet në

prokurimet publike, kryetari i AK-së e njeh shumë mirë si fushë, është cenuar konkurrenca dhe gara publike është përqendruar në pak duar. Kjo ka bërë që në një pjesë të madhe të prokurimeve publike të jenë 10-11 kompani, që marrin çdo garë publike. Ku është AK-ja në hetimin e kësaj situatë?

Së fundi, tregu i kompanive të sigurimit. Kompanitë e sigurimit sot ndodhen në një situatë ku nuk ka më garë, nuk ka as konkurrencë. Kur e pyeta drejtuesin e mbikëqyrjes financiare, që mbulon këtë sektor, për të gjitha shqetësimet që kam për tregun e sigurimeve, pra sa kompani kanë hyrë në treg vitin e fundit, çfarë ka ndodhur me barrierat, a është e lehtë që të hysh apo të dalësh nga ky treg, çfarë ka ndodhur me pronësinë e kompanive, çfarë ka ndodhur me ndarjen e tregut, ai nuk pati përgjigje.

Tregu i sigurimeve sot ka nevojë për një monitorim dhe një hetim, sepse sot përsëri po ndodhin marrëveshje kartel për përcaktimin e çmimeve jo vetëm për sigurimin e detyrueshëm për makinat, por edhe për të gjitha sigurimet e tjera. Janë të paktën 6 tregje prioritare, të cilët sot përcaktojnë çmimet, në të cilët sot nuk ka konkurrencë, ku sot sistemi është i ndrydhur në një grusht kompanish, që nuk e pengon dhe nuk e lejon konkurrencën.

Kur flasim për konkurrencën, flasim për hir të qytetarëve, sepse kjo do të ndikojë në përmirësimin e situatës së çmimeve; do të ndikojë në rigjallërimin dhe rivitalizimin e tregut dhe do të bëjë që sot të mos kemi këta sektorë me këtë kapje të ekonomisë, që ka ndodhur pikërisht si rezultat i mungesës së hetimit dhe monitorimit të këtyre tregjeve.

Të gjitha këto elemente, që unë kam vite që i diskutoj, dhe këto shqetësime që ngre, janë reflektuar edhe në rezolutën që sot do të kalojë parlamenti, të cilën unë dua ta mbështes. Por kjo situatë, pengesë e konkurrencës, praktikisht oligarki në tregjet më të mëdha, situatë përcaktimi çmimesh, situatë e një stanjacioni, që në 10 vjetët e fundit nuk lëviz, ku është e pamundur që një biznes i ri të hapet, të hyjë në treg, të motivohet që të punojë, ku ndarja e tregut është e përcaktuar, është simboli dhe shembulli më i keq se si sot funksionon ekonomia shqiptare.

Nga ana tjetër, është reflektim i asaj çfarë ndodh në politikë, i asaj kënetës së jashtëzakonshme, që nuk lejon që të lëvizë

ekonominë shqiptare, e kapur prej fyti nga një grup biznesesh; i tregjeve që nuk lëvizin; i çmimeve që nuk lëvizin, dhe në fund i penguari dhe i dëmtuari më i madh është konsumatori.

Si në asnjë vend të botës, çmimi i karburantit dhe çmimi i ushqimit në Shqipëri përcaktohen nga bizneset, vendime të cilat, megjithëse Gjykata Kushtetuese i konsideroi të dëmshme për interesin publik, qeveria shqiptare me zor i përfundoi, por dëmi në ekonomi sigurisht që vazhdoi të ishte i madh dhe kolosal për qytetarët, ai llogaritet në vlerën e 500 milionë eurove.

Këto shqetësime duhet të kishin qenë subjekt dhe objekt i punës së AK-së, por, fatkeqësisht, nuk ka ndodhur kështu. Fatkeqësisht, nuk kemi pasur një analizë që të na ndihmonte, në dobi të interesit të qytetarëve, por edhe për ta parë se si mund ta bëjmë tregun më konkurrues në secilin prej këtyre sektorëve dhe më gjerë; se si mund ta çlirojmë ekonominë, se si mund ta hapim për bizneset e reja; se si konkurrenca mund të përdoret si motiv, qoftë dhe për këta të rinj, që nuk ia dalin dot, që largohen nga Shqipëria, sepse për shkak të konkurrencës largohen, për shkak të mungesës së konkurrencës në biznes, në ekonomi, në politikë, në sektorin publik dhe në çdo sektor.

Unë besoj se është shumë e vështirë që gjërat të ndryshojnë këtu dhe ne të ndikojmë këtu me ligje e rezoluta, por, duke folur për këto tema, duke folur për këto çështje, si dhe duke i denoncuar, mund të bëjmë një të mirë të madhe publike!

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjala për zotin Braçe.

Më pas të përgatitet zoti Berisha.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Dakord.

Zoti Berisha fjala për ju.

Do të flisni 10 minuta, sepse do të merrni edhe kohën e zotit Tritan Shehu.

Sali Berisha - Zonja deputete,

Zotërinj deputetë,

Zonja drejtuese e seancës,

Të dashur qytetarë dhe qytetare,

Drejtuesja e seancës, Kryetarja e Kuvendit, pak minuta më parë u shpreh se Kosova nuk duhet të bëhet çështje e problemeve tona të brendshme. Mendimi dhe qëndrimi im dhe i PD-së ka qenë dhe është se Kosova është një vend i pavarur, me qeveri legjitime dhe se në dialogun Kosovë-Serbi,

Shqipëria nuk mund dhe nuk duhet të implikohet, të përzihet në asnjë moment.

Kjo, së pari, sepse, në qoftë se përzihet, Shqipëria, për definicion, qëndron në anën e Kosovës, askush nuk mund ta besojë Shqipërinë si një broker të paanshëm, por në rastin e Edi Ramës, ai qëndron në anën e Vuçiçit dhe nuk ka shqiptar që beson në qëllime të tjera, përveçse për ta ndihmuar me çdo kusht, me çdo mënyrë padronin e tij, argat i të cilit është.

Deri në vitin 2013 Shqipëria, ndonëse u zhvilluan negociatat më intensive në Bruksel, bëri zero ndërhyrje në ato negociata dhe në një moment kritik të tyre, kur konkretisht m'u kërkua që të ndërhyj, refuzova në mënyrë të prerë, me bindjen se ai nuk ishte interesi i suksesit të negociatave.

Gjithçka ndryshoi pas vizitës së Edi Ramës në Beograd. Ky zotëri, për arsye të cilat i di ai vetë, pas asaj vizite u bë një zëdhënës i neveritshëm, avokat i turpshëm i të gjitha projekteve të Serbisë së Madhe, me të cilat e vërteta është se u zhbënë ato suksese që u arritën, përfshirë këtu edhe suksesin e marrëveshjes së përgjithshme, e cila jo *de juro*, por *de facto* ishte marrëveshje që normalizonte në zbatimin e saj marrëdhëniet dhe *de facto* realizonte njohjen e të dyja vendeve, them jo *de juro*.

Dolën skenarët, që Vuçiçi nuk i shiste dot më parë, e ndryshimit të kufijve dhe të ndarjes së Kosovës. Edi Rama e mori me pasion të madh këtë skenar. Unë ju them shqiptarëve se prapa hartave të ndryshimit të kufijve kishte vetëm një qëllim, zhvlerësimin total të pavarësisë së Kosovës dhe për rrjedhojë ndarjen e saj midis Shqipërisë dhe Serbisë. Vetëkuptohet një ndarje midis padronit dhe vasalit, argatit.

Fatmirësisht, ky projekt u hodh poshtë, së pari, falë kancelares Merkel, por më pas edhe komuniteti ndërkombëtar e realizoi se ky projekt ishte një projekt shumë problematik. Nuk humbën asnjë minutë kohë dhe nxorën nga Novi Sadi, mini-Shengenin, në të cilin, në hartën që vendosën në platformën e samitit, Kosova ishte zhdukur, ishte përfshirë e tëra në hartën e Serbisë.

Edi Rama vetë postoi, meqenëse jemi për ndërhyrjet, në Facebook-un e tij hartën e asgjësimit të Kosovës. Gjithçka ishte me qëllimin e vetëm që të ndahej Kosova. Ky projekt përfundoi në një aleancë trelaterale të turpshme, destabilizuese për Ballkanin, aleancë Beograd-

Tiranë-Shkup, viktimat më të mëdha të së cilës ishin fermerët shqiptarë.

Ata, me hapjen e kufijve për prodhimet e Shumadisë, Banatës dhe zonave të tjera, falimentuan në radhë njëri pas tjetrit. Pasi dështuan me Ballkanin e Hapur, Aleksandër Vuçiç dhe Edi Rama kërkuan të instalonin hegjemoninë serbe në rajon. Dua të them këtu se nga çereku i parë i shekullit të kaluar deri sot, deri para luftës në Kosovë dhe deri para luftërave të tjera, Ballkani u bazua mbi hegjemonizmin serb, kombe që sundoheshin nga kombi serb.

Kjo ide, kjo pikëpamje që lau në gjak, që i krijoi Ballkanit dramën më të mëdha, është përsëri e gjallë, përsëri mbahet, promovohet dhe reklamohet nga Aleksandër Vuçiç, Edi Rama dhe Dodik. Në këtë kontekst, paraqitja që ai i bëri projektit të asosacionit ishte ndërhyrja më brutale në çështjen më delikate në punët e brendshme të Kosovës, një akt antikombëtar, antishqiptar, duke e konsideruar Kosovën jo si një vend të pavarur, por një vend vasal.

Rama anuloi takimin me qeverinë e Kosovës sepse ajo nuk pranoi të diskutojë për draftin e tij të marrë në sirtarët e Vuçiçit. Ai bëri një provokacion të rëndë dhe përkeqësoi më tej gjendjen e dialogut të vështirë ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit.

Edi Rama e bëri këtë jo vetëm si shërbim ndaj Beogradit, por e bëri sepse korriku po vjen dhe është nën hetim të hapur penal në aferën "McGonigal".

Ai flet sot për komunitetin euroatlantik, por është i vetmi në atë komunitet që ka kompromentuar, ka korruptuar njërin nga personat më të rëndësishëm në fushën e sigurisë, udhëheqës të komunitetit euroatlantik të SHBA-ve, dhe tani është i gatshëm të kryejë çdo akt, të bëjë çdo gjë vetëm që të lehtësojë pozitën e tij të pashpresë.

Shqiptarët duhet ta dinë se një muaj më parë dosja shqiptare "McGonigal", e cila kishte në brendi vetëm ryshfetin dhe kontraktimin e McGonigal-it, në një kohë kur ishte në detyrë, për të shkatërruar opozitën shqiptare, tani është shkruar me dosjen ruse. Është shkruar me dosjen ruse se ky peshk i madh nuk binte kollaj në duart e Edi Ramës, por dikush e sollti atë, dhe ata që e sollën janë në dosjen "Deripaska". Koha do ta provojë.

Ndaj edhe Edi Rama tani ka humbur, nuk vjen dot këtu dhe kur del në medie, del sterrë i zi, del i sfazuar, nuk di çfarë flet. Kështu që në rast se flasim për Kosovën, në radhë të parë duhet të flasim për mosndërhyrjen në punët e brendshme të saj për interesa personale apo për interesa të Vuçiçit.

Së fundi, rrëmbimi i policëve të Kosovës përbën një akt terrorist, banditesk, një shkelje flagrante të rezolutës së OKB-së, të pavarësisë së Kosovës dhe të marrëveshjeve që Serbia ka me NATO-n.

Lindita Nikolla – Ju lutem, zoti Berisha, se keni kaluar kohën!

Sali Berisha – Në këtë kontekst, u bëj thirrje KFOR-it dhe komunitetit ndërkombëtar që të ndërhyjnë për lirimin e menjëhershëm të policëve të rrëmbyer, për rikthimin e menjëhershëm të tyre në Kosovë dhe dënimin e atij, i cili sillet si një fqinj zuzar, që nuk nje ligj të brendshëm dhe as ligj ndërkombëtar, Aleksandër Vuçiçit, që përbën dhe sot faktorin më kryesor, që kërcënon paqen dhe stabilitetin e rajonit të Ballkanit, i cili përbën Putinin e vogël dhe vendin e tij e ka shndërruar në një Rusi të vogël...

Lindita Nikolla – Zoti Berisha, ju ka mbaruar koha, ju lutem!

(Deputeti Sali Berisha i ndërpritet fjala, pasi i ka mbaruar koha në dispozicion.)

Lindita Nikolla – Ka kërkuar fjalën ministrja Spiropali, e cila merr 10 minuta nga koha e grupit.

Elisa Spiropali – “Sali Berisha në kërkim të shqiptarëve”, ky mund të ishte epilogu i karrierës së Sali Berishës. Ai i projekton fajet, gabimet, brejtjet e ndërgegjes së tij tek tjetri. Është e njohur kjo metodë e vjetër e paraardhësve të tij dhe ne si popull e kemi njohur mirë këtë projektim faji dhe nuk na lejohet të mos e shohim atë te përfaqësuesit tanë politikë, që, më së shumti, tradhtinë e kanë pasur në ballë të përpjekjeve të tyre. Unë e kam urreyer gjithmonë këtë term, sepse më është dukur si term i përdorur nga ata që politikën e ditës, që asgjësimin e kundërshtarit, që gjuhën më të egër politike, ato katet e nëndheshme të gjuhës, i kanë përdorur për të sulmuar kundërshtarët pa asnjë vetëdije politike, por mund ta përdor sot vetëm për të bërë një krahasim.

Sali Berisha foli...

(Deputeti Sali Berisha ndërhyr nga salla pa mikrofon.)

Minutat e tua kanë mbaruar, zoti Berisha! Tani është koha ime, vazhdo!

Sali Berisha, meqë foli këtu për hartën e Europës dhe për ndryshimet...

(Deputeti Sali Berisha ndërhyr nga salla pa mikrofon.)

Sali, vetëm ajo të ka mbetur që të përfundosh në kosh, siç, në fakt, koha ka ardhur për të përfunduar, por nuk ka rëndësi kjo, sepse ti damkën ia ke vënë vetes para se të ta vinin ata përtej detit. Po të jap një shembull.

Ti përmende këtu hartën e Europës, që, sipas teje, donin ta ndanin mes Shqipërisë dhe Serbisë, këtë nuk e ka thënë kurrë askush, por ti pate guxim ta thuash, dhe për këtë bëre fajtor dy njerëz, Miladinin shqipfolës dhe “Zografin bis”.

Miladini shqipfolës ishte drejtori politik i UÇK-së, Hashim Thaçi, shpallësi i pavarësisë së Kosovës dhe kryesuesi i grupit të Rambujesë, në kohën kur ti bëje thirrje që Marrëveshja e Rambujesë të mos firmosej; në kohën kur (sipas dëshmimeve të Remzi Hoxhës, që nuk dihet ku shkoi, me njohurinë tënde, thonë disa, por kjo duhet hetuar deri në fund dhe duhen gjetur fajtorët) marrëveshja dhe marrëdhënia me Milosheviçin ishin krejt ndryshe apo në të njëjtën kohë kur në dokumentet e deklasifikuara të CIA-s, të cilat kanë dalë sot, ti deklaroje se as Ibrahim Rugova dhe as këta enveristët me prirje për të vrarë të UÇK-së, nuk duhet të pretendojnë pavarësinë e Kosovës. Ai ishte Miladini shqipfolës.

“Zografi Bis” nuk ka bërë kurrë asnjë marrëveshje deti me Greqinë, që është rrëzuar nga Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë; “Zografi Bis” nuk ka furnizuar kurrë me naftë makinerinë vrasëse të regjimit të Millosheviçit, siç kanë dalë provat dhe e ke pranuar vetë pafuqinë apo bashkëpunimin; “Zografi Bis” ka krijuar traditën e mbledhjeve të përbashkëta mes dy qeverive, Shqipëri-Kosovë, dhe ka përfshirë në qeverinë e Kosovës dhe në institucionet e saj të larta personalitete të Kosovës, që ti nuk e bëje kurrë, se i rrije larg si djalli temjanit.

Nëse do të vazhdojmë të flasim për ato që ti ke bërë dhe për ato që ne kemi bërë, me në krye Kryeministrin, dhe ato që kjo qeveri ka bërë në çdo vend të botës, aty ku ka ndikim, duhet të dini se reputacioni i Shqipërisë dhe ndikimi i saj në këto vite është shtuar në mënyrë eksponenciale me largimin e zotërisë, që doli nga dera më shpejt

sesa unë pata mundësinë të ndizja mikrofonin, por jam e sigurt që do t'ia thonë. Edhe atë që ti paturpësisht bëre në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Europës kundër atij që e quaje Miladini shqipfolës, me miratimin e rezolutës së Dick Marty-t për hetimin e trafikut të organeve nga UÇK-ja, po tentojmë ta zhbëjmë ne, duke mbledhur firmat në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Europës dhe duke paraqitur aty një rezolutë të re anti-Dick Marty.

Këto janë faktet, por pasqyra dhemb, ajo tregon fytyrën që ke. Nuk ka në këtë vend mjeshër më të madh të projektimit të fajit diku tjetër se ai që sapo doli nga kjo sallë, i cili shumë shpejt do të dalë njëherë e mirë nga skena politike shqiptare për të shkruar aty ku e ka vendin.

Ne projektimet e fajit i kemi vuajtur edhe si popull, kur serbët vrisnin të pafajshëm në Kosovë dhe bërtisnin nëpër ekrane: “Po na vrasin shqiptarët”; kur përdhunonin gratë shqiptare, thoshin: “Po na përdhunohen gratë serbe”, dhe sa herë që angazhoheshin në veprime të dhunshme kundër shqiptarëve ngrinin duart lart duke thënë: “Ja shqiptarët e dhunshëm, ja kaçakët, ja luftëtarët”. Këtë e kanë bërë ata, por nuk e mendonim se do të vinte dita që këtë gjë ta dëgjonim edhe në këtë foltore.

Çdo herë që ky njeri hap gojën, mbjell përçarje, në Shqipëri e në Kosovë, dhe sa herë ka probleme serioze me drejtësinë, me politikën, me humbjet e tij të njëpasnjëshme, ky kapërcen kufirin në Morinë dhe shkon në Kosovë. Sa herë që këtij i mblidhet laku nga partnerët ndërkombëtarë, thërret për ndihmë patriotizmin e tij, që nuk e pati kurrë, atdhedashurinë që kurrë nuk e dëshmoi, sepse ta duash vendin tënd, ta duash Kosovën, do të thotë të mundohesh dhe të gësh zgjidhje që shkojnë përtej demagogjisë.

Edi Rama, “Zografi bis”, nuk e ka përdorur kurrë bashkimin kombëtar si çështje të demagogjisë, por ka punuar përditë që ne të afrohem realisht, konkretisht dhe të fitojmë peshë në rajon. Sot Shqipëria dhe shqiptarët janë faktorët kryesorë të stabilitetit në rajonin e Ballkanit dhe partnerët kryesorë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Bashkimit Europian dhe NATO-s. Shtetet e Bashkuara të Amerikës na dhanë lirinë dhe krijuan shtetin e dytë shqiptar në rajon, të cilat nuk ia kanë vënë më kot vulën në ballë “non grata” Sali Berishës, sepse e dinë çfarë bëjnë, kur e bëjnë dhe kur duhet ta bëjnë.

Ju mund ta mbani veten edhe për pak kohë me gajretin që ka një konspiracion kundër tij, që vjen nga ne, tradhtarët e kombit, nga ata në Veri në Kosovës, që vjen nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës apo kushdo tjetër, por fakti është që nuk ka dhe nuk ka pse të ketë konspiracion kundër atij që është i lexueshëm si drita e diellit; nuk ka! Ai i ka dhënë të gjitha provat se çfarë është i gatshëm të bëjë për pushtet dhe çfarë mund të bëjë sa herë ka pasur pushtet dhe sa herë ka qenë në opozitë. Këtë punë ka bërë, dhe fjalimet e tij i dimë përmendësh, nuk ka nevojë fare të vijë këtu e të flasë, sepse i njohim dhe mund t'i përsërisim për t'i shkruar në librin e turpit të politikës antikombëtare, që pretendon patriotizëm, atdhedashuri dhe strategji për Shqipërinë dhe për rajonin.

Dua të jap vetëm një fakt për marrëdhëniet e Shqipërisë, qoftë edhe në fushën tregtare (t'i lëmë rëndësinë e Shqipërisë, raportet diplomatike, peshën që ajo ka marrë, sigurinë që ofron Shqipëria për të gjithë rajonin si anëtare e NATO-s), meqë përmendi bujqësinë dhe Ballkanin e Hapur: vetëm në vitin 2013, kur qeveriste ky, ne importonim 10 lekë për çdo 1 lek eksport nga Serbia; sot importojmë 1,39 lek, duke e përmirësuar ndjeshëm bilancin tregtar me Serbinë. Edhe për këtë fakt të thjeshtë mjafton të reflektosh, për të kuptuar se peshë e Shqipërisë do të vijë duke u rritur, patjetër, në proporcion të drejtë me peshën e tij, që ka firmuar.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Faleminderit!

Fjala për zotin Erion Braçe.

Të përgatitet zoti Vasili dhe më pas zoti Bujar Leskaj.

Erion Braçe – E di që kolegët e mi do të reagojnë, por, të them të drejtën, meqenëse u bë kohë që jemi këtu, disa të vërteta duhet t'i themi siç janë.

Nëse ka një akt bashkëpunimi të pastër, nga fillimi deri në fund, të dëshmuar, të verifikuar, me impakt këtu, me impakt në rajon, me impakt në luftë, jo në paqe, në kurriz të shqiptarëve, në kurriz të boshnjakëve, në kurriz të kroatëve, në këtë vend, është thyerja e embargos së Kombeve të Bashkuara nga një qeveri, për turpin e saj, shqiptare, dhe nga një njeri, për turpin e tij, malësor: Sali Berisha. Po flas edhe një herë për një fakt të konfirmuar zyrtarisht, ndërkombëtarisht, me të cilin është damkosur

Shqipëria, ky vendi këtu, dhe në emër të të cilit janë bërë rrëfime të turpshme dhe të neveritshme, si rrëfimi që pasoi dëshminë e qartë, të kthjellët e të pastër të partnerit në thyerjen e embargos, ish-Kryeministrit të Malit të Zi, Bullatoviç, që vijoi në shqip me argumentin apo me alibinë se po i çonim karburant Kosovës, që të kalonte dimrin, dhe karburanti Kosovës, për të kaluar dimrin, po i shkonte përmes Millosheviçit. Ky është fakti.

Patjetër, fakt është që Shtetet e Bashkuara të Amerikës e kanë shpallur *non grata* Sali Berishën, për një mori arsyesh të ditura dhe të bëra publikisht kohë pas kohe, por nëse do të kishte një vend që duhet ta shpallte Sali Berishën *non grata*, duhet të ishte Kosova, dhe vetëm për këtë akt, për asnjë gjë tjetër, për thyerjen e embargos përkundrejt Serbisë së Millosheviçit. Kaq, dhe mbaron.

Për të ardhur te çështja për të cilën jemi mbledhur për të diskutuar, patjetër që unë e mbështes rezolutën e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, si për vlerësimin e punës së Autoritetit të Konkurrencës, të bërë gjatë vitit që shkoi, edhe për një mori detyrash që ajo lë në raport me vitin në vijim dhe për atë që i takon praktikisht të bëjë Autoritetit të Konkurrencës në këtë vend. Patjetër që roli i tij, i dhënë me ligj, është garantimi i konkurrencës efektive në treg. Pa diskutim, nga konkurrenca efektive, jo drejtpërdrejt nga Autoriteti i Konkurrencës, burojnë edhe çmimet e drejta për mallrat dhe shërbimet që duhet të marrin qytetarët shqiptarë brenda vendit. Rezoluta është e kthjellët, e qartë, e pastër dhe lehtësisht e verifikueshme vitin tjetër për punën e Autoritetit të Konkurrencës.

Ndërkohë, unë kam tre shqetësime.

Shqetësimi i parë lidhet me efektivitetin e vendimmarrjes së Autoritetit të Konkurrencës. E thashë edhe në Komisionin e Ekonomisë, që ndjekja e vendimmarrjes, si në rrugë gjyqësore, ashtu edhe në rrugë administrative, duhet të jetë prioritet absolut i Autoritetit të Konkurrencës. Kjo do të thotë se një vendim i marrë nga ky Autoritet, që ka në thelb të tij zbulimin e abuzimeve në treg, tregjet respektive të produktit apo edhe të shërbimeve, duhet të shkojë deri në fund.

Po ndalem edhe një herë për ta theksuar nga kjo sallë e parlamentit, që në vitin 2018 Autoriteti i Konkurrencës ka marrë një vendim për tregun më të rëndësishëm jo vetëm në qytetin e Tiranës, jo vetëm në qendër të Shqipërisë, por që ka një

ndikim themelor për çmimet në të gjithë territorin e vendit, pra tregu agrorshqimor i Tiranës, një element kyç për ndikimin në çmimet e produkteve bujqësore dhe blegtorale në çdo treg të vogël të lidhur apo të furnizuar prej tij. Për sa kohë që në vendimin respektiv është evidentuar shumë qartë abuzimi me pozitën dominuese në treg (pikërisht për këtë arsye është gjobitur, pikërisht për këtë arsye i janë lënë detyra të qarta); për sa kohë që nga viti 2018 e më tej abuzimi me pozitën dominuese vazhdon të jetë prezent atje (gjoha nuk është arkëtuar ende, për shkak të të gjitha lojërave që bëhen me sistemin e drejtësisë); për sa kohë që një pjesë e detyrave të lëna nuk janë zbatuar, patjetër që efektiviteti i kësaj vendimmarrjeje vihet në dyshim, aq më tepër kur produktin e kësaj vendimmarrjeje duhet ta provonte çdo qytetar në Tiranë, në Durrës dhe në të gjithë Shqipërinë për sa u takon çmimeve të produkteve bujqësore dhe blegtorale, që kanë si burim atë treg.

Në këtë vendim thuhet qartë që ju duhet të vazhdoni ta ndiqni dhe ta gjobisni derisa të kthehet në rrugën e drejtë, që keni përcaktuar ju, si Autoriteti i Konkurrencës, me këtë vendim. Ky është shqetësimi im i parë.

Shqetësimi im i dytë ka të bëjë me vendimet tuaja të datës 29.09.2021, i pasuar edhe nga vendimi tjetër i datës 16.12.2022, për sjelljen e 5 ndërmarrjeve që operojnë në tregun e grurit dhe të përpunimit të grurit për miell. Natyrisht, janë dy vendime me të cilat është e vështirë të biesh dakord, për më tepër kur e ke njohur çështjen, e ke ndjekur dhe në fund prisje një produkt të rëndësishëm prej saj. Megjithatë, këto janë vendime për t'u zbatuar. Mua me shqetëson se sa efektive janë këto vendime. Keni zbuluar qartësisht marrëveshje për çmimet e këtyre ndërmarrjeve në treg, i keni konstatuar ato si në shkelje të ligjit, i keni gjobitur, dhe me gjobitjen ka mbaruar edhe koha e monitorimit të tyre. Mund të më thoni se çfarë ndodh pas vendimeve që ju keni marrë? Çfarë ka ndodhur këta muaj? T'ju aktualizoj: sot që flasim, çmimi i himeve të grurit në treg është 37 mijë lekë për kuintal, ndërkohë që çmimi i një kilogrami miell është 72 mijë lekë për kuintal. A mund t'i verifikojmë edhe çmimet me të cilat po hyn gruri në territorin e Republikës së Shqipërisë, për këto ditë të qershorit? 28, 29, 36 lekë. Ka edhe që janë 43 dhe 46 lekë.

Po mirë, kur çmimi i grurit që po hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë po bie, si ka

mundësi që nuk reflektohet në çmimet e tjera të nënprodukteve që dalin drejtpërdrejt nga përpunimi i grurit?! Kjo do të thotë se sërish, ajo që ju keni lënë si detyrë, nuk po zbatohet nga këto ndërmarrje.

Në krahun tjetër, për të thënë se tregu nuk po funksionon, do të doja t'ju jepja 2 shifra të tjera. Kur çmimi i himeve është 37 mijë lekë për kuintal, si mundet që këta të mbledhin grurin me 29 lekë për kilogram, pra grurin e prodhuar drejtpërdrejt në vend?! Kjo do të thotë se sërish nuk po funksionon diçka. Këta, që janë prodhuesit kryesorë të miellit, janë në të njëjtën kohë edhe grumbulluesit kryesorë të grurit në të gjithë territorin e vendit. Kjo do të thotë që e kemi problemin me këtë treg. Natyrisht, për sa kohë që ju vjet keni marrë një vendim, e keni mbyllur hetimin dhe periudhën e monitorimit, duhet të riktheheni sërish për të parë sa efektiv ka qenë vendimi që ju keni marrë.

E treta, dhe kjo ka të bëjë me të gjithë ne këtu, por pa diskutim dua t'ju sugjeroj edhe juve, ka një politikë të tatimit mbi vlerën e shtuar në këtë vend, që, pa diskutim, ndikon drejtpërdrejt në konkurrencën e drejtë, të ndershme dhe efektive në treg. Gruri që vjen nga çdo vend tjetër, por jo nga Shqipëria, ka një skemë TVSH-je 20 me 20 dhe tregtarët janë të interesuar ta sjellin nga jashtë, sepse nuk humbin lekë. Ndërkohë, po ta grumbullojnë brenda vendit, për çfarëdolloj arsyeje, për ta bërë miell, apo historinë e elbit, që e kemi problem, na i thanë dje dhe e ngritën shqetësimin edhe në Komisionin e Ekonomisë, për ushqim për blegtorinë, do të humbin para, sepse skema është zero në hyrje dhe 20 në dalje. Ja një instrument fiskal, që ndikon drejtpërdrejt në prishjen e konkurrencës efektive në treg dhe e disfavorizon prodhimin vendas në raport me prodhimin e importit!

Pa diskutim që duhet edhe opinioni juaj, edhe mendimi juaj për këtë politikë fiskale, që, në gjykimin tim e të shumë kolegëve brenda sallës së Kuvendit, duhet të ndryshojë edhe për këtë arsye, sepse diskriminon dhe fyen konkurrencën e drejtë dhe efektive në treg. Ky është një problem shumë i madh, veçanërisht për prodhuesit vendas dhe për përpunuesit vendas, që falë punës dhe meritës së tyre po dalin edhe në eksport.

Shumë faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjala për zotin Petrit Vasili, 5 minuta në dispozicion.

Më pas do ta marrë fjalën zoti Bujar Leskaj, me 10 minuta kohë në dispozicion.

Petrit Vasili – E nderuar Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sikurse edhe më parë, në javët që kaluam në institucionet e tjera të pavarura, jemi sërish në të njëjtën situatë, ku raporti vjetor është kthyer në mënyrë të dukshme në një ditë kur legjitimohen ato para, të cilat paguhen nga taksat e shqiptarëve për të pasur edhe disa instrumente të tjera që ndodhen aty pikërisht për të mos qenë as protagonistë, as të pavarur, as për të qenë influencues dhe ndikues për më të mirën e qytetarëve. E njëjta gjë ndodh edhe sot, e njëjta rutinë, por asnjë nuk është në gjendje të thotë se kur këto institucione të pavarura, të cilat kanë një emër shumë të mirë, të madh dhe të bekuar “të pavarura”, do të veprojnë. Kushdo që e përdor mirë pavarësinë e tij, është në dobi të qytetarëve, kurse kush është “i pavarur”, por i varur 100 për qind nga qeveria, është një dëm i madh publik, sepse përveçse paguhen disa para për të mbajtur në këmbë një institucion fiktiv, i cili shpesh emërtohet edhe si “freskore e madhe e qeverisë”, nuk ka asnjë rol tjetër.

Natyrshtëm, Shqipëria është përballur në mënyrë të vazhdueshme me çmime të larta, kartele, monopole dhe oligopole të të gjitha llojeve dhe formave. Mëma e të gjitha këtyre çmimeve, që prodhojnë këtë gjëmë dhe mynxyrë, vijnë e prodhohen si të tilla, është pikërisht vrasja e konkurrencës. Duhet të bindemi njëherë e përgjithmonë se nuk po ndërtojmë socializmin që mbështetet mbi forcat tona, por po ndërtojmë kapitalizmin, dhe zemra e kapitalizmit është konkurrenca e ndershme. Kjo Shqipëria jonë nuk është e pafundme, e paanë, që është e pamundur të kontrollohet, por është lehtësisht e kontrollueshme, sepse të gjithë i njohin, i dinë dhe të gjithë i kanë parë në shfaqjen më të shëmtuar, pra se si monopolet bënin festë kur ishin bordet e famshme të transparencës, të cilat këtu në Kuvend u mbështetën, pavarësisht se u rrëzuan nga Gjykata Kushtetuese, por ama qytetarëve ua bënë dëmin.

A e ndjeu ndonjëri protagonizmin e këtij Autoriteti? Absolutisht jo, pati vetëm ndonjë të folur të vonuar me zë të mekur; ishte tamam si ata që thonë se nuk ka problem, sepse këta nuk bëjnë

dëm, sepse edhe këta, si të gjitha institucionet e tjera të pavarura, përshesh hanë.

A kishte vend për të pasur një protagonizëm shtetëror dhe ligjor të spikatur e të fortë? Po, patjetër që kishte. A ishte vendi për t'u përplasur, në kuptimin më të mirë të fjalës, me qeverinë? Sigurisht që ishte. A kishte vend për të ngritur zërin, për të mobilizuar opinionin publik, për t'i përdorur të gjitha mundësitë në medie dhe ç'dolloj mundësie për ta sensibilizuar për situatën, për të tundur dynjanë për këtë dhe masa të tjera që janë marrë, të cilat nuk zbatohen në shumë sektorë? Ndërkohë, rrinë të vakët duke thënë se janë të pafuqishëm, por janë të lumtur se janë të pafuqishëm, sepse kjo pafuqi nuk e mërzit dhe nuk e shqetëson qeverinë.

Realiteti është se vrasja e konkurrencës, zotërimi i tregut dhe qeverisja e tij në të gjitha segmentet e veta, duke qenë "klientë të rregullt dhe të ndershëm të qeverisë", nuk ishin shqetësim për Autoritetin e Konkurrencës.

Nuk është detyrë e një institucioni të pavarur të fshihet pas disa elementeve formale. Detyra e tij është të sakrifkohet, t'i gjejë të gjitha mundësitë dhe hapësirat për të mbajtur qëndrime shumë të forta publike, duke thënë edhe se qëndrimi i tyre është i pamundur në këto kushte dhe se nuk i ushtrojnë dot funksionet e tyre, për shkak se pengohen në këto pika. Asgjëkund nuk e kanë kërkuar këtë ndihmë.

Çfarë bëjmë sot? Vijnë një herë në vit, si në një përshpirtje të institucioneve të pavarura, që mpaken e vdesin, por që justifikojnë rrogat, paratë, udhëtimet dhe strategjitë me dokumente të shtypura bukura me *Excel*. Por çfarë mbetet në fund? Asgjë! Mbesin disa institucione që nuk kanë asnjë ndikim dhe influencë në veprimtarinë e qeverisë dhe në interesat e qytetarëve. Ndaj, kjo së bashku me rezolutën përkatëse nuk meritojnë as vëmendjen dhe as votën time.

Lindita Nikolla – Fjala për zotin Bujar Leskaj.

Keni 10 minuta në dispozicion.

Bujar Leskaj – Së pari, në këtë fjalë timen, dëshiroj që si deputet i Vlorës të shpreh ndjesën time të thellë ndaj qytetarëve të Republikës së Shqipërisë dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës, vëllezërve tanë, për pamundësinë që ne sot si deputetë të Kuvendit kemi për t'u shprehur për situatën në Kosovë. Njëherazi shpreh besimin tim se Kryetarja e Kuvendit do të dijë të

organizojë nesër ose në ditët në vijim një seancë të veçantë për situatën në Kosovë, ku ne deputetëve të Kuvendit të na jepet mundësia të shprehim pikëpamjet tona, solidaritetin tonë me Republikën e Kosovës, me Presidenten, me qeverinë, me partitë opozitare dhe, natyrisht, të dënojmë me forcë veprimet provokative të Serbisë. Unë besoj se Kryetarja e Kuvendit do ta realizojë shumë shpejt këtë seancë.

Të kthehemi te çështja në fjalë. Nga të gjithë qytetarët shqiptarë dihet se misioni i Autoritetit të Konkurrencës është mbrojtja e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, bazuar në kërkesat e ligjit të vitit 2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" dhe rregullat e sjelljes së veprimtarëve, duke mbikëqyruar veprimtarinë e institucioneve përgjegjëse ligjzbatuese shtetërore publike dhe jo vetëm. Megjithë përpjekjet e bëra, gjykoj se Autoriteti i Konkurrencës nuk ka mundur që ta përmbushë misionin e tij për arsyet e mëposhtme:

Autoriteti i Konkurrencës, për mendimin tim, nuk arriti të jetë efektiv në punën e tij. Sigurisht, Autoriteti i Konkurrencës e ka të vështirë ta realizojë misionin e tij te ne, ku funksionimi i shtetit ligjor është i dobët, ku shkalla e korrupsionit është e lartë dhe kapja e shtetit paraqitet në përmasa tejet shqetësuese. Megjithatë, institucioni duhej të kishte vepruar më fort që t'i luftonte rastet e shumta të situatave kartel në sektorë të ndryshëm të ekonomisë sonë të tipit monopol dhe oligopol, bazuar në denoncimet e shpeshta të firmave korrekte dhe të qytetarëve për abuzimet me çmimet, të përcjella nga mediat tradicionale dhe mediat sociale të vendit.

Hetimet e tij të thelluara në tregjet e prodhimit dhe tregtimit të miellit apo në tregun e tregtimit të karburanteve, duhej të kishin dalë me sanksione konkrete dhe të rënda ndaj shkelësve të ligjit "Për mbrojtjen e konkurrencës" dhe të parimeve dhe rregullave të konkurrencës së lirë. Për fat të keq, Autoriteti i Konkurrencës dështoi në këtë mision edhe si rrjedhojë e marrëveshjeve horizontale apo vertikale, e krijimit të pozitave dominuese në tregje të caktuara, sepse monopolet apo oligopolet vijuan me të njëjtin ritëm, në mos me një ritëm më të shtuar, për të dëmtuar funksionimin e tregjeve, zhvillimin e biznesit të papërkrahur nga qeveria dhe konsumatorët shqiptarë përmes çmimeve fundore abuzuese në treg, për shkak të situatës kartel.

Situata kartel formohet për shkak të pranisë së një tregu oligopol në një sektor të ekonomisë, ku ka disa kompani të mëdha, të cilat, për shkak të volumit dhe madhësisë së tyre, përcaktojnë çmimin e një produkti apo shërbimi në treg, në bazë të një marrëveshje të fshehtë mes tyre për të fiksuar një nivel çmimi jo mbi bazën e fitimit të dalë nga raporti kërkesë-ofertë, por duke i shtuar këtij fitimi edhe një pjesë abuzive të fitimit monopolist.

Autoriteti i Konkurrencës nuk ka arritur ta luftojë me efektivitet praninë dhe veprimin e karteleve në shumë sektorë të rëndësishëm të ekonomisë sonë. Ai nuk ka arritur të bëjë transparencë, t'ua bëjë të qartë shqiptarëve dhe të përipiqet t'i shmangë situatat ku një grusht kompanish, të quajtura rëndom nga populli "oligarkë", fitojnë, të suportuara nga qeveria, shumicën dërrmuese të tenderëve publikë, në veçanti në autoritete të tilla si, Autoriteti Rrugor Shqiptar apo Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Ju sjell situatën në qarkun e Vlorës, që e kam përsëritur edhe herë të tjera, ku kompani me reputacion 10-vjeçar apo më tepër në këtë qytet, në 7-8 vjetët e fundit nuk arrijnë të fitojnë asnjë tender nga ARRSH-ja apo FSHZH-ja, edhe pse konkurrojnë rregullisht dhe janë të afta për të punuar si nënkontraktorë.

Autoriteti i Konkurrencës nuk ka ndërmarrë asnjë hetim për situatën duopol në tregun e shërbimeve telefonike dhe celulare, me gjithë shqetësimet dhe ankesat e pareshtura të qytetarëve të përcjella nga mediat e vendit.

Autoriteti i Konkurrencës nuk ka arritur t'i plotësojë pritshmëritë e qytetarëve dhe të garantojë ndërveprimin e barabartë mes operatorëve të biznesit në tregjet e importit, shitjes me shumicë dhe pakicë të ushqimeve të shportës, karburanteve dhe të energjisë elektrike për biznesin e mesëm.

Autoriteti i Konkurrencës nuk doli qartësisht në asnjë rast kundër dublimit dhe praktikisht zerimit të kontrollit të tij në periudhën nga mesi i marsit të vitit 2022 deri në qershor të vitit 2023, për shkak të veprimtarisë së bordeve të caktimit të çmimit tavan për tregjet e karburanteve dhe të ushqimeve bazë të ngritura përmes akteve normative të qeverisë, pavarësisht se prania e tyre mund të përligjej vetëm në tre-katër javët e para të emergjencës së çmimeve, nën efektin

psikologjik të agresionit të diktatorit Putin në Ukrainë.

Autoriteti i Konkurrencës duhej ta kishte këshilluar qeverinë dhe të theksonte me forcë në publik se kontrolli i drejtpërdrejtë i çmimeve apo ndërhyrja në një masë drastike e qeverisë në tregje në formën që u aplikua përmes bordeve sjell pasoja të rënda në ekonomi, sikurse u vërtetua në praktikë nga menaxhimi 15-mujor me borde i dy tregjeve jetike për ekonominë tonë: si ai i ushqimeve bazë dhe ai i karburanteve. Për mendimin tim, këto pasoja do të ndihen shumë gjatë në ekonomi.

Autoriteti i Konkurrencës duhej të ishte treguar aktiv në luftën ndaj kostove të fshehta dhe të rritura të transaksioneve në industrinë financiare dhe bankare të vendit. Ai duhej të kishte marrë iniciativën të hetonte, bazuar në denoncimet e shumta të qytetarëve, ndaj nivelit, të perceptuar me të drejtë prej tyre si abuziv, të përqindjeve të interesit të ngarkuara nga institucionet dhe shoqatat e kursim-kreditit në mikrokreditë e dhëna.

Këto elemente të çojnë drejt dyshimeve të arsyeshme për praninë e një karteli në këtë sektor, denoncime që iu bënë me dije Autoritetit të Konkurrencës edhe në Komisionin e Ekonomisë, madje nga deputetë të mazhorancës. Një deputet me përvojë i Kuvendit në Komisionin e Ekonomisë përmendi me të drejtë inaktivitetin e Autoritetit të Konkurrencës kur denoncoi TPL-të e kompanive të sigurimit.

Autoriteti i Konkurrencës duhej të kishte në fokus dhe të mbikëqyrte me kujdes tregun e kreditit bankar dhe tregun e ndërmjetësve financiarë, të cilët mobilizojnë kursimet e shqiptarëve për një zhvillim më të qëndrueshëm të vendit, pasi kontratat midis kredidhënësve dhe kredimarrësve duhet të jenë më të thjeshta dhe më të qarta, jo të rënduara vetëm në një krah.

Autoriteti i Konkurrencës duhej të lobonte dhe të përipiqej që të reduktohet ngarkimi mbi kredimarrësin i çdo risku potencial dhe ngarkimi në kostot e kredisë i pjesës së kredive të këqija, të cilat nuk janë thjesht dhe vetëm dështim i bizneseve shqiptare, por edhe një cilësi dhe punë jo e ndershme e kredidhënësve. Në këto tregje shumë të rëndësishme për zhvillimin e ekonomisë Autoriteti i Konkurrencës ka një përgjegjësi dhe mision të qartë në mbrojtje të qytetarit konsumator dhe klient.

Autoriteti i Konkurrencës nuk zbatoi në asnjë rast praktikën e njohur, të ndjekur rëndom nga shumë struktura simotra të tij perëndimore, të njoftimeve dhe paralajmërimeve publike ndaj operatorëve abuzues në treg për të rritur presionin dhe për t'i frenuar ata në vijimin e abuzimit. Për njoftimet e veprimtarisë së tij Autoriteti i Konkurrencës është mjaftuar vetëm me vendosjen formale në uebin e tij.

Në tërësi, Autoriteti i Konkurrencës nuk ia doli të vërtetojë se përfitimet e një grushti kompanish të përkrahura nga qeveria nuk erdhën prej cilësisë apo çmimeve konkurruese të mallrave dhe shërbimeve të tyre, por nga deformimet e konkurrencës, duke dëshmuar kështu dobësinë e tij në kontrollin efektiv të tregjeve dhe në garantimin e konkurrencës së lirë.

Këto përbëjnë arsyet themelore pse ne kemi sot një imazh publik të dobësuar dhe një mungesë të theksuar besimi në aftësitë e institucionit të Autoritetit të Konkurrencës për të garantuar mbrojtjen efektive të interesave të konsumatorëve. Gati të gjitha shtresat e konsumatorëve shqiptarë dhe pjesa dërrmuese e kompanive të biznesit, të cilat nuk kanë fatin të përkrahen nga qeveria, ndihen të pambrojtur nga deformimet e mëdha të konkurrencës në Shqipëri.

Në diskutimin tim vitin e shkuar kam sjellë një pasazh nga një raport *preview* i konferencës së Kombeve të Bashkuara për tregtinë dhe zhvillimin, strukturë e OKB-së, që i është përcjellë Autoritetit të Konkurrencës. Në këtë drejtim nuk kemi ende reagime të konsiderueshme. Autoriteti i Konkurrencës nuk ka mundur të sigurojë një partneritet real me komunitetin e biznesit, konsumatorët dhe organizatat e shoqërisë civile për të zbuluar praktikant antikonkurruese në tregjet e hetuara, në ato që janë ende të pahetuara.

Duke mos e arritur këtë partneritet, Autoriteti nuk ka mundur të veprojë realisht si një institucion i pavarur në interes të publikut dhe të taksapaguesve, por ka vepruar si një shtojcë e qeverisë. Opinioni publik nëpërmjet raportimeve të shoqërisë civile dhe analizave në media ka dyshime në lidhje me pavarësinë e plotë të punës së institucionit të Autoritetit të Konkurrencës.

Autoriteti i Konkurrencës duhet ta zgjerojë sferën e kontroleve të tij, në mënyrë që të përfshijë natyrshëm kontrollin e përputhshmërisë me parimet e konkurrencës së lirë ndaj të gjitha

instrumenteve ligjore të përdorura për koncesionet dhe PPP-të, duke përfshirë marrëveshjet ndërqeveritare të lidhura me vendet e treta për zbatimin e projekteve të përbashkëta, si dhe analizën e thelluar të koncesioneve shtetërore që i kanë dhënë mundësi një kompanie të vetme private të realizojë pozicionin monopol për shfrytëzimin e një pasurie të vendit apo shërbim publik të kaluar me PPP dhe koncesione të tjera te privati. Këto janë sfidat e Autoritetit të Konkurrencës.

Megjithëse koha mbaroi, dua vetëm të përmend telegrafisht: ne kemi 2 vjet që presim të vijmë ndryshimet në ligjin “Për konkurrencën”, i cili daton nga viti 2003, kurse personalisht, për një ndryshim modest në ligjin aktual për të drejtën që duhet të kenë komisionet e Kuvendit të marrin çdo informacioni nga Autoriteti i Konkurrencës, kam një vit e gjysmë dhe ende ju, zonja Kryetare, si mazhorancë nuk po e fusni për diskutim. Mund ta votoni pro apo kundër. Ai është një ndryshim që e kam përcjellë me idenë e mirë që komisionet e Kuvendit, Kuvendi të rritë rolin kontrollues dhe bashkëpunues me Autoritetin e Konkurrencës, pasi suksesi i këtij institucioni, suksesi i Autoritetit të Konkurrencës në thelb është një hap para për garantimin e konkurrencës së lirë në Shqipëri.

Ju faleminderit!

Lindita Nikolla – Faleminderit!

Fjala për Ministren Xhaçka.

Olta Xhaçka – E nderuar Kryetare e Kuvendit,

Kolegë deputetë,

E mora fjalën për të ndarë me ju zhvillimet në Kosovë, të cilat jemi duke i ndjekur nga afër me shumë shqetësim, veçanërisht ngjarjet në Veri. Jemi të shqetësuar nga rritja e tensioneve dhe, sigurisht, jemi të angazhuar më të gjitha fuqitë dhe mundësitë tona me aleatët dhe partnerët, me SHBA-të, NATO-n, BE-në, që situata të mos përkeqësohet më tej. Jemi, po ashtu, të shqetësuar, por edhe të keqardhur që gjendemi në këtë situatë kaq delikate në një moment kur realisht besojmë se kishte një mundësi shumë të mirë, kishte një rast “të artë”, do të thosha, për të arritur një marrëveshje mes Kosovës dhe Serbisë, e cila do të çonte drejt një zgjidhjeje përfundimtare dhe drejt një njohjeje reciproke.

Ky është një shqetësim që, në fakt, nuk e kemi vetëm ne, por e kanë të gjithë aleatët dhe

partnerët, nga i pari tek i fundit. Ky kontekst ndërkombëtar ndihmon shumë për të kuptuar më mirë qëndrimin e Shqipërisë, por në rastin tonë shqetësimi bëhet vërtet i madh kur konsideron që aleatët dhe partnerët në mënyrë unanime e gjejnë pjesën më të madhe të përgjegjësisë për këtë që po ndodh te Kosova, çka ka krijuar mjaft tension dhe rrezikon të sjellë pasoja që deri dje as mund të imagjinoheshin, duke e çuar Kosovën drejt izolimit dhe duke i dobësuar në mënyrë shqetësuese pozitën e saj në sytë e SHBA-ve dhe të BE-së.

Situata më e fundit me 3 policët e kapur nga ushtria serbe, pa dyshim, e ndërlikon më tej situatën dhe rrezikon t'i hedhë benzinë zjarrit. Ne kemi qenë në kontakt të ngushtë me të gjithë aleatët dhe partnerët për këtë ngjarje. Kam komunikuar edhe me komandantin e KFOR-it, duke kërkuar vlerësimin e tij për çfarë ka ndodhur. Jemi në pritje të përfundimit të hetimit apo të raportimit që do t'i bëjë KFOR-i NATO-s, por ajo që mund të them në këtë pikë është se është e domosdoshme të ruhet qetësia. Po ashtu, është e domosdoshme që qeveria e Serbisë t'i lirojë pa humbur kohë të 3 policët. Lirimi i tyre do të ishte një kontribut i madh drejt uljes së tensioneve, ndërkohë që i lëmë kohë KFOR-it, i cili ka përgjegjësi për ruajtjen e kufirit të Kosovës në Veri, të zbardhë gjithë çfarë ka ndodhur. Ne kemi bërë dhe po bëjmë përpjekjet tona aktive që lirimi i 3 policëve të kufirit të ndodhë, ndërkohë kemi qëndrimin se ata nuk kanë bërë absolutisht asnjë vepër penale apo nuk e kanë kërcënuar sigurinë kombëtare të Serbisë. Në raste të tilla të kalimit të kufirit apo të hyrjes në një zonë, e cila do të konsiderohej e Serbisë, nëse e tillë ka qenë ngjarja, sigurisht që nuk parashikohet arrest, por do të parashikonte një kthim mbrapa dhe ky është qëndrimi ynë. Përpjekjet tona do të vazhdojnë për të bërë të mundur lirimin e tyre dhe kthimin e tyre pranë familjeve. Por në bisedën që pata me komandantin e KFOR-it, ai ma bëri të qartë se raporti që prodhohet, ndahet vetëm me NATO-n dhe, si vend anëtar i NATO-s, por jo vetëm, si vend që e ka Kosovën interes kombëtar, gjysmën e kombit të vet, Shqipëria duhet të mbajë një qëndrim konstruktiv, të vetmin qëndrim që, në fakt, e shtensionon situatën dhe e mbështet realisht Kosovën.

Po ashtu, i kemi ndjekur me shqetësim edhe deklaratat e qeverisë së Kosovës për ndalimin e

qarkullimit të automjeteve me targa serbe. Theksojmë se lëvizja e lirë është një pjesë shumë e rëndësishme e angazhimeve që kemi dhe që kanë marrë të gjitha vendet tona, përfshirë edhe Shqipërinë, edhe Kosovën, në kuadër të CEFTA-s dhe në kuadër të punës për krijimin e një tregu të përbashkët rajonal, por edhe në kuadër të Procesit të Berlinit, ku liria e lëvizjes dhe e qarkullimit të mallrave është një nga shtyllat kryesore të tij.

Sipas raportimeve që kam marrë sot, qeveria e Kosovës ka sqaruar se nuk bëhet fjalë për masa tregtare ekonomike, por për masa sigurie. Mbetet të shohim se çfarë do të thotë kjo në realitet, por ne shpresojmë që kjo të mos ndodhë, pasi jo vetëm se do ta përshkallëzonte më shumë situatën, por edhe do të dëmtonte ekonominë e rajonit, mbi të gjitha, vetë ekonominë e Kosovës dhe do ta dobësonte pozitën e saj edhe në sytë e aleatëve, të cilët kanë qenë dhe janë intensivisht të angazhuar për krijimin e tregut të përbashkët rajonal, që është edhe shtylla kurrizore e Procesit të Berlinit.

Ministria e Punëve të Jashtme e ka ndjekur me shumë vëmendje situatën e krijuar edhe pas mbajtjes së zgjedhjeve në 4 komunat me shumicë serbe dhe masat vijuese të panevojshme dhe të dëmshme politikisht.

Kryeministri Rama dhe Ministria e Jashtme kanë qenë të zëshme për këto zhvillime dhe, po ashtu, kemi qenë në kontakt me faktorin ndërkombëtar, veçanërisht me SHBA-të dhe BE-në. Jo vetëm kaq, por kemi punuar në mënyrë proaktive për të gjetur një zgjidhje. Siç e dini, Kryeministri Rama u ka përcjellë Berlinit, Parisit, Brukselit dhe Uashingtonit një draft për asociacionin. Ne e konsiderojmë hapin e ndërmarrë nga Kryeministri Rama me propozimin për asociacionin, si një hap shumë të rëndësishëm e të qenësishëm për shtensionimin dhe rikthimin në rrjedhë të dialogut.

Pas anulimit të mbledhjes së përbashkët të të dyja qeverive, kam dëgjuar shumë akuza dhe teori për mungesën e mbështetjes ndaj Kosovës. Dikush këtu e emërtoi edhe si "një akt të madh sabotazhi", si një sanksion ndaj Kosovës nga Shqipëria. Të gjithë ata që i kanë ndjekur marrëdhëniet e Shqipërisë me Kosovën që prej viteve 1990 e dinë shumë mirë se zakonisht ata që bërtasin më shumë se u digjet barku për Kosovën, janë ata që kanë bërë më pak ose i kanë bërë më shumë dëm Kosovës. Të gjithë e kanë të qartë se

kush e furnizonte Milosheviçin me naftë e sabotonte UÇK-në dhe kush e mbështeste UÇK-në e priste qindra e mijëra refugjatë kosovarë gjatë muajve më të zinj të luftës barbare të Milosheviçit. Ishte po kjo parti që qeveris sot Shqipërinë.

E pra, për ne Kosova është e shenjtë; për ne Kosova është një prioritet kombëtar, që udhëheq çdo veprim e çdo aksion në politikën tonë të jashtme. Ne ndajmë plotësisht objektivat e qeverisë së Kosovës, të çdo qeverie të Kosovës, në fakt, për një zgjidhje përfundimtare të negociuar me Serbinë, për anëtarësimin e Kosovës në OKB e të tjera. Por kjo nuk do të thotë që ne ta mbështesim 100% dhe në mënyrë të pakushtëzuar qeverinë e Kosovës në çdo hap që ajo bën, edhe kur jemi të bindur se ajo që po bën është një gabim me pasoja mjaft të rënda për Kosovën. Kjo nuk do të ishte mbështetje për Kosovën; do të ishte e papërgjegjshme dhe le të bërtasin sa të duan analistët dhe kinse patriotët e politikës dhe të rrjeteve sociale, kjo nuk ka për të ndodhur kurrë. Është e domosdoshme që situata të shtensionohet. Është e domosdoshme që qeveria e Kosovës të dëgjojë partnerët tanë ndërkombëtarë, aleatët tanë: SHBA-të dhe BE-në për shtensionimin e situatës; është e domosdoshme të ndalet thellimi i hendekut të qëndrimeve me SHBA-të dhe BE-në, sepse pasojat janë vërtet të rënda. Dialogu i lehtësuar nga BE-ja është rruga drejt normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Dialogu Kosovë-Serbi është rruga e vetme drejt paqes. Kjo sigurisht që kërkon guxim. Arritja e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse paqeje, të mbështetur nga BE-ja dhe SHBA-të, që mundëson njohjen e ndërsjellë mes dy vendeve, anëtarësimin e Kosovës në OKB dhe në BE, kërkon më shumë guxim sesa ajo që po ndodh sot në Veri, që, pa dyshim, ka rëndësinë e vet, por dytësore, krahasuar me përfitimet që Kosova do të kishte nga një qasje konstruktive krah miqve dhe aleatëve. Dhe në këtë proces, Shqipëria mbetet plotësisht e angazhuar për të kontribuar me çdo mjet dhe më të gjitha mundësitë e saj në mënyrë konstruktive, por jo duke vazhduar në rrugën e përplasjes me të gjithë miqtë dhe aleatët, sepse nga kjo Kosova nuk mund të dalë kurrë e fituar.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Faleminderit!

Këtu mbyllet kjo pikë e rendit të ditës.

Po, zoti Xhafa.

Më pas ju, zonja Doda.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Dakord.

Qani Xhafa – Faleminderit, zonja Kryetare!

Kolegë deputetë...

Lindita Nikolla – Për çfarë e ke kërkuar fjalën, të lutem?

Qani Xhafa – Lidhur me Autoritetin e Konkurrencës.

Lindita Nikolla – Nuk jeni regjistruar. Duhej të ishit regjistruar si diskutant. Megjithatë, po ju lë 3 minuta, si deputet i ri që jeni.

Qani Xhafa – Kisha më tepër një kompliment. Do të vlerësoja punën e Autoritetit të Konkurrencës në lidhje me vendimin e fundit, pavarësisht se është një vendim i vitit 2023, për anulimin e rritjes së çmimit të patentave të drejtuesve të automjeteve për të gjitha kategoritë, pasi ajo ishte një kërkesë ndoshta e gabuar e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe e Shoqatës së Autoshkollave.

Faleminderit, zoti Biba, që qetësuar mijëra shqiptarë, të cilët duan t'i pajisin fëmijët e tyre me leje drejtimi automjeti apo edhe për kategoritë e tjera të larta, për kamionë, autobusë e të tjera.

Jam dakord me parafolesit për mbajtjen e një seance për vëllezërit tanë kosovarë, por edhe për vërejtjet që iu bënë Autoritetit të Konkurrencës. Këtë mirësi që bëtë në vitin 2023 për patentat, uroj ta vazhdoni edhe për të tjerat.

Do t'ju sugjeroja që tek TPL-të të futet sistemi “*Bonus-Malus*”, pasi do të ndihmonte në uljen e çmimit të siguracioneve të detyrueshme ndaj mjeteve motorike, se është përfolur shumë, por asgjë nuk është bërë në këtë drejtim.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Zonja Doda.

Mesila Doda – Zonja Kryetare,

Më vjen shumë mirë që ministria e Jashtme, zonja Xhaçka, na dha një raport të parë për gjendjen dhe për marrëdhëniet midis nesh dhe Kosovës në këtë moment, por edhe për gjendjen se si ka shkuar situata në Veri të Kosovës. Megjithëse është një çështje jashtë rendit të ditës, është çështja më e rëndësishme për t'u diskutuar sot. Sigurisht, do të duhej të kishim bërë disa veprime që më parë. Sot komisionet e jashtme duhej të ishin bashkë të diskutonin, kryeministrit

duhej të ishin të konsultuar, sepse Kosova është një çështje që na përket nga afër. Askush nuk mund të thotë: “Jeni një vend fqinj”. Ne jemi absolutisht të gjithë në krah të Kosovës, ndaj një seancë e jashtëzakonshme do të ishte gjëja më natyrale dhe më normale për të cilën duhet të flisnim në këto momente. Asnjë nga institucionet nuk mund të jetë i përjashtuar. Kur flas për parlamentin, është absolutisht institucioni i parë, ndaj do të duhet të jemi të përfshirë dhe të flasim me një zë, duke hequr diferencat midis mazhorancës dhe opozitës, por duke menduar se cila është më e mira për Kosovën.

Besoj se është mendimi i të gjithë kolegëve që ky parlament nuk mund të jetë i anashkuar nga kjo situatë; do të duhet të themi fjalën tonë; do të duhet të jemi të gjithë njëzëri në krah të Kosovës. Sigurisht, është arritja më e madhe pas shpalljes së Pavarësisë dhe nuk mund ta dëmtojmë pozicionin e saj dhe të gjithë ecjen që ka bërë përgjatë këtyre viteve për shkak të situatave të tilla, të cilat ndërlikohen, apo duke mbajtur qëndrime të caktuara si mazhorancë apo si opozitë. Në këtë rast duhet të jemi të gjithë në krah të Kosovës dhe të flasim njëzëri.

Besoj se u kuptua që, me marrjen e fjalës nga ana ime, kërkoj të futet në rendin e ardhshëm të ditës një seancë e jashtëzakonshme për çështjen e Kosovës.

Ju faleminderit!

Lindita Nikolla – Kalojmë te projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (huamarrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për programin për menaxhim të qëndrueshëm dhe miqësor me klimën në sektorin e mbetjeve të ngurta”.

Fillojmë diskutimin në lidhje me paraqitjen e projektligjit. Do të shprehet relatorja, zonja Dhima.

(Ndërhyrje nga salla)

Në rregull.

Kalojmë te diskutimet.

Fjala për zotin Kreshnik Çollaku.

Kreshnik Çollaku – Faleminderit, zonja Kryetare!

Të dashur kolegë,

Sigurisht që çdo gjë në rendin e ditës është e rëndësishme, por mendoj se ngjarja më e rëndësishme dhe më e jashtëzakonshme që po

përjetojmë, është situata në Veriun e Kosovës dhe të gjitha problematikat lidhur me të.

Gjithashtu, më lejoni të shfrytëzoj sallën e Kuvendit për të folur në lidhje me një lajm shumë të mirë, lajmin që ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë, zonja Juri Kim, është emëruar zëvendësndihmëssekretare e Departamentit të Shtetit për Çështjet Europiane. Kësisoj, nga kjo sallë, besoj edhe në emrin tuaj, do t’i uroja sukses zonjës ambasadore, e cila është një garanci e mirë, sepse është një njohëse e mirë e Shqipërisë dhe e Ballkanit dhe do të jetë një ndihmë e fortë për proceset demokratike e për fuqizimin e marrëdhënieve tona!

Lidhur me historinë e Kosovës, me çështjen e Kosovës, në radhë të parë, më vjen mirë që më në fund, ministrja e Jashtme foli.

Ah, iku!

Në seancën e sotme dëgjova kolegun Dogjani, që nuk është këtu, i cili disa herë kërkoi që Komisioni i Jashtëm të mblidhej e të mbante një qëndrim. Doja t’i thosha mikut tim Dogjani, se këtë vit, të paktën pesë apo gjashtë herë, unë si anëtar i Komisionit të Jashtëm i kam kërkuar kryetares së Komisionit të Jashtëm dhe Komisionit të Jashtëm, që të thërrasë në dëgjesë ministren e Jashtme, për ta dëgjuar dhe, eventualisht, për të bashkëradikuar sjelljen e Shqipërisë në raport me Kosovën dhe me rajonin. I kam kërkuar jo vetëm për të bërë politikë, – zonja Kodheli nuk është këtu, por mund ta dëshmojë – një seancë dëgjimore edhe me dyer të mbyllura. Mbase qeveria ka informacione, të cilat mund të jenë sensitive dhe nuk duhet të dalin në publik, por Komisioni i Jashtëm duhet të dijë se çfarë po ndodh, të shohë e të eksplorojë mundësinë për të rënë dakord edhe në gjëra që na ndajnë. Nuk ka ndodhur, dhe kjo patjetër e bën me përgjegjësi, jo vullnetin e Komisionit të Politikës së Jashtme, por reagimin e qeverisë dhe të ministres së Jashtme.

Po çfarë po ndodh në Kosovë? Para se të them se si e vlerësoj sjelljen tuaj, dua të shprehem fare qartë e fare hapur se si e lexoj unë atë që po ndodh në Kosovë. Po të lexosh atë çfarë Albin Kurti po bën, po kërkon apo po pretendon, me dorë në zemër, siç thonë në Kosovë, nuk i gjej asgjë të padrejtë. Ai kërkon sovranitetin në një pjesë të territorit të republikës së tij. Por a mjafton e drejta? Edhe Ibrahim Rugova kishte të drejtë, kur kancelarë shumë të fuqishme, përfshirë edhe

atë amerikane, në ato kohë i kërkonin të qëndronte në statusin e autonomisë, ndërsa Ibrahim Rugova kërkonte pavarësi. Por sot, më shumë se kurrë, unë mendoj se ai model sjelljeje i Ibrahim Rugovës, që nuk u dorëzua kurrë, nuk e humbi kurrë nervin, nuk e humbi kurrë kontrollin, por investoi në mënyrë njerëzore dhe mbinjerëzore që të ruante aleanca jetike e strategjike me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Unë, mbase si mik i Albinit, si mik i Kosovës, do t'ia sugjeroja këtë sakrificë.

Albin Kurti ka të drejtë, por unë, nga kjo sallë, do t'i kërkoj të bëjë çdo gjë që është e mundur, njerëzore e mbinjerëzore, të investojë çdo resurs, që kjo marrëdhënie strategjike me Shtetet e Bashkuara të Amerikës të mbetet e paprekur, sepse është jetike për fatet e Kosovës dhe për fatet e tërë rajonit tonë. E thashë mendimin tim për Kosovën, për të mos pasur asnjë lloj spekulimi këtu, nga ana juaj. Problemi nuk qëndron te Kosova. Problemi është sjellja e qeverisë shqiptare.

Drafti që në mënyrë krejt të njëanshme dhe patjetër konspirativ, u propozua nga Kryeministri Rama për dialogun apo konfliktin Serbi-Kosovë, është një zhvendosje thelbësore e politikës sonë të jashtme. Unë nuk e kam idenë se çfarë është ai draft. Ai draft mund të jetë edhe mrekullia e botës, dhe nëse ndodh, le ta duartrokasim të gjithë, por ai draft e projekton Shqipërinë në konfliktin Serbi-Kosovë si një palë të tretë. Shqipëria nuk është palë e tretë në atë konflikt. Shqipëria është palë, po, por në krah të Kosovës, në çdo situatë e në çdo rrethanë. Projektimi i Ramës si një palë e tretë, me një draft që e njeh vetëm ai, është një zhvendosje e aksit të politikës së jashtme. Kjo edhe mund të ndodhë në situatë të jashtëzakonshme, por kush e ka autorizuar Kryeministrin që të jetë hartuesi dhe projektuesi i vetëm i politikës së jashtme të këtij vendi? A ka dijeni Presidenti i Republikës për këtë zhvendosje të qasjes së politikës së jashtme të Shqipërisë? Po parlamenti, a ka dijeni? Po deputetët, a kanë dijeni? Po Komisioni i Jashtëm, a ka dijeni? Po faktorët politikë e publikë në Shqipëri, a kanë dijeni? Zero. Askush s'ka dijeni. Po ashtu nuk ka dijeni as Kosova. Presidenca e Kosovës nuk ka dijeni. Qeveria e Kosovës nuk ka dijeni. Kryetari i Kuvendit të Kosovës nuk ka dijeni. Unë e kam shumë mik Enver Hoxhajn, një diplomat i shkëlqyer dhe një kontribuues i jashtëzakonshëm

në fatet e Kosovës, por është provokim që drafti t'i bëhet me dije nënkryetarit të Kuvendit të Kosovës, dhe të mbahet në injorim Kryetari i Kuvendit të Kosovës. Këto janë sjellje të padenjja.

Akoma më e rëndë është ajo që ndodhi me mbledhjen e Gjakovës. Unë ende nuk e besoj se është arritur deri në atë pikë në marrëdhëniet tona me Kosovën. Për çfarëdolloj motivi, për çfarëdolloj arsyeje, në çfarëdolloj situatë, Shqipëria nuk mund të anulohet në formë sanksionuese mbledhjen e qeverive të përbashkëta me Kosovën. Sidomos sot, kur ata kanë nevojë më shumë se kurrë për Shqipërinë, për mbështetjen e Shqipërisë, për përkrahjen e Shqipërisë, edhe për këshilla të ftohta e racionale nga Shqipëria, për t'u thënë: o njerëz, mos u nxitoni, se këtu e keni gabim. Por kjo nuk mund të bëhet duke pasur si synim kryesor provokimin e qeverisë së Kosovës dhe provokimin e Kryeministrit të Kosovës, për shkak se Albini dhe Edi Rama u ndjekan rivalë historikë në këto hapësirat shqiptare. E kujt i intereson fati i Albinit dhe i Edi Ramës, kur projektohet një marrëdhënie e tillë, e një niveli të tillë braktisjeje të Kosovës?

A e dini çfarë keni bërë? Më falni që po ju drejtohem juve, por jam i bindur, kolegë, se pavarësisht se nuk e thoni, e mendoni si unë. Çështja është e qeverisë. A e kuptoni çfarë dobësie ndërkombëtare i ka dhënë Kosovës braktisja e një mbledhjeje nga ana e qeverisë së Shqipërisë në këtë situatë? Kjo e lë vetëm Kosovën. Kjo e lë në baltë Kosovën. Unë e kuptoj argumentin se jemi pjesë e aleancave ndërkombëtare dhe e NATO-s. Po, po, jemi pjesë e NATO-s, por ju duhet të dini se në NATO ka pesë vende anëtare që nuk e njohin pavarësinë e Kosovës, dhe NATO po garanton kufijtë e Kosovës, sigurinë e Kosovës, por NATO si organizatë, si vendimmarrje e përbashkët përpiqet të mbajë një status neutral në raport me Kosovën. A mundet Shqipëria ta mbajë këtë? Gënjejmë veten, gënjejmë edhe miqtë tanë ndërkombëtarë. Në rast se Kryeministri Rama apo ministrja e Jashtme kanë vështirësi t'jua shpjegojnë këtë realitet juve dhe miqve tanë perëndimorë, të gjithë ne duhet t'i ndihmojmë, duhet të flasim me ta, për t'u treguar se është gënjeshtër që Shqipëria të pretendojë të mbajë një neutralitet, teksa Kosova mund të rrezikohet çdo çast nga djegia.

Rrëmbimi i tre oficerëve të policisë, në rast se nuk është akt lufte, është akt terrorizmi

shtetëror nga ana e Serbisë, gjë që paralajmëron edhe ngjarje të tjera. Unë s'dua të bëj asnjë paralele, por të tilla sjellje ka pasur Rusia në zonën e Donbasit të Ukrainës: rrëmbe policë, rrëmbe ushtarakë, e pastaj e dimë të gjithë se çfarë ndodhi. E në rast se ajo ndodh, në rast se Kosova sulmohet, nuk ka qeveri mbi dhë, nuk ka qeveri në tokë, nuk ka asnjë lloj qeverie, as e këtij e as e ndonjë tjetri, që mund t'i ndalojë shqiptarët që të reagojnë si një komb, si një popull, sepse, në rast se Kosova sulmohet, pavarësisht si sillen qeveritë apo parlamentet, të gjithë e dimë se kufiri Shqipëri-Kosovë bie, pasi askush nuk mund t'i ndalojë shqiptarët që të shkojnë në mbrojtje dhe në mbështetje të vëllezërve e motrave të tyre, siç e bënë në Kukës, siç bënë në UÇK luftëtarët vullnetarë që shkuan nga Shqipëria.

Prandaj, për të mos mbërritur në atë pikë, duhet që më së pari qeveria të flasë hapur me partnerët tanë. E nëse keni nevojë, edhe për ne të opozitës, për fjalën tonë, do t'ju mbështesim, pasi sot nuk ju konsideroj kundërshtarë, por ju konsideroj një organizëm që ka më shumë mundësi se ne të opozitës. Çfarë ju duhet nga ne? Ju duhet që të vijmë edhe ne te miqtë tanë ndërkombëtarë dhe të pohojmë se situata është e tensionuar në Kosovë, se ju nuk keni fuqi ta përballoni reagimin e shqiptarëve këtu apo atje, që kërkojnë mbështetje? Vijmë dhe ju ndihmojmë, por kjo është një e vërtetë që duhet thënë.

Meqë shoh se edhe koha po më mbaron, zonja Ministre e Jashtme, kur flasim për atë historinë se kush ka bërë më shumë apo më pak për Kosovën, e kam thënë edhe një herë në këtë sallë: unë e nderoj maksimalisht kontributin dhe angazhimin e Kryeministrit Majko në atë kohë, në lidhje me administrimin e asaj situatë jashtëzakonisht të vështirë. Por, zonja Ministre e Jashtme, nëse më dëgjon, besoj se kontributi i zotit Majko nuk i mbulon dot mungesat e mëdha që kjo qeveri dhe qeverisja juaj ka prodhuar në marrëdhëniet me Kosovën. E kur bie fjala për raste të tilla, këtu kam një kritikë shumë miqësore, por më besoni që e ndiej derisa po jua them. Sa herë që bie fjala për këto tema të rëndësishme, në mënyrë meskine debati dhe retorika juaj shkon në një pikë, po, te pika më e dobët e opozitës: filloni dhe bëni historikun e Sali Berishës: '90, '91, '92...2013, "non grata" e të gjitha me radhë. Nuk do ta kisha kollaj t'jua thosha, po të mos isha një

ndër ata deputetë, që edhe pse kam 30 vjet jetë politike me atë njeri, vlerësoj se prioriteti, që është diçka më e madhe se marrëdhënia, simpatitë apo simpatitë njerëzore, është marrëdhënia strategjike me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Por ju, jo çdo lloj debati mund ta mbulon duke etiketuar atë histori apo atë ngjarje. E para, sepse nuk u përgjigjeni të vërtetave. Dhe e vërteta është një, edhe kur e themi ne, edhe kur e thoni ju, edhe kur e thotë Sali Berisha. Ju nuk mund të mbuloheni pas sulmit kundër tij, për të mos iu përgjigjur atyre shqetësimeve prioritare, të cilat tejkalojnë çdo individ në këtë sallë.

E fundit, për sa i përket marrëdhënies që projektioni me *non grata*-t, meqë sapo jua dhashë shembullin e një pjese tonës, ju i kishit *non grata*-t në krye të fushatave. Duhej që SPAK-u t'i vinte prangat Vangjush Dakos, që ju të distancoheshit nga *non grata*-t.

Lindita Nikolla – Ju lutem, e keni kaluar kohën!

Kreshnik Çollaku – Dhe provën do ta keni shumë shpejt, e me raste të ngjashme, kur *non grata* të tjera t'ju trokasim në derë. Aty po, tregojeni nëse mbani anësitë dhe miqësitë politike dhe respektoni vendimet strategjike të një partneri të madh.

Ju faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjalën e ka zoti Fadil Nasufi.

Të përgatitet zoti Dashamir Shehi.

Fadil Nasufi – E nderuar zonja Kryetare e Kuvendit,

Kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Po futem direkt në temë, sepse seanca ka filluar që në orën 10:00, dhe pavarësisht se cili është rendi i ditës, folësit këtu po përqendrohen vetëm në çështjet e ditës, që pa dyshim janë të mprehta, siç është çështja e Kosovës. Megjithatë, kjo nuk bëhet as me patetizëm, as me patriotizëm historik, as jashtë agjendës së ndërkombëtarëve, të cilët janë ata që i dhanë lirinë Kosovës, e janë ata që monitorojnë gjithë këtë shqetësim imperativ, që kërkon vëmendjen e qeverisë e të shtetit shqiptar.

Programet e projektet e ujësjellës-kanalizimeve dhe të menaxhimit të integruar të mbetjeve në Berat, prej vitesh janë të lidhura me financimet e bankës gjermane KfW. Me një prezencë gati njëzetvjeçare dhe me një partneritet

të shëndetshëm me pushtetin vendor, financimet e KfW-së dhe të donatorëve të tjerë të përfshirë në programet e përbashkëta, kanë bërë të mundur që të kryhen investime në rrjetin e ujësjellës-kanalizimeve në Berat e Kuçovë, të rehabilitohet infrastruktura bashkiake, të mirëmenaxhohet administrimi i ujësjellësve, të unifikohen në nivel rajonal kostot e tarifat, të instalohen matës dhe teknologji bashkëkohore, të reduktohen humbjet në rrjet, dhe së shpejti të ndërtohet edhe impianti modern i përpunimit të ujërave të ndotura. Falë këtyre investimeve dhe financimeve të KfW-së, sot në Berat, në Kuçovë dhe në disa njësi vendore të këtyre bashkive, kemi 24 orë ujë të pijshëm.

Duke shprehur falënderimet dhe mirënjohjen për KfW-në dhe donatorët, që kanë realizuar shumë projekte madhore në Berat, ndihemi të privilegjuar që edhe në këtë marrëveshje që miratojmë sot, që ka të bëjë me programin e menaxhimit të qëndrueshëm dhe miqësor, në monitorimin e sektorit të mbetjeve të ngurta përfshihet edhe qarku i Beratit.

Megjithëse problemet mjedisore dhe çështjet e pastrimit, të sjelljes ndaj mbetjeve, me të cilat ne bashkëjetojmë, janë ende sfida dhe përditshmëri jona, si shoqëri dhe si institucione, ne duhet të vlerësojmë arritjet dhe kapërcimin e madh që kemi bërë në çështjet e trajtimit të mbetjeve dhe të ndryshimit rrënjësor për të pasur një Shqipëri të pastër.

Para vitit 2013 mjedisi dhe menaxhimi i mbetjeve paraqisnin një panoramë alarmante dhe shumë kërcënuese për shëndetin, për imazhin e vendit dhe nuk konsideroheshin nga askush as si çështje etike apo si ndjeshmëri publike, as si një urë lidhëse për zhvillimin ekonomik dhe promovimin e turizmit, as si prioritet dhe emergjencë për t'u ndarë nga kjo trashëgimi e turpshme dhe as me ndonjë strategji të qartë apo plan veprimi, për t'i dhënë fund kësaj situatë.

Në këta 10 vjet të qeverisë "Rama" është bërë një punë kolosale për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e territorit, për pastrimin e mjedisit, për administrimin e mbetjeve urbane, për mbrojtjen dhe sigurimin e shëndetit të banorëve, duke i dhënë fund situatës kaotike dhe duke krijuar një panoramë krejt tjetër, që evoluon çdo ditë nga fakti se po rritet ndërgjegjësimi i shoqërisë, po zbatohen objektivat specifikë, qëllimet strategjike dhe masat përkatëse të politikave strategjike të përfshira në dokumentin 15-vjeçar 2020-2035, të

shoqëruara me aksione kombëtare pastrimi, me financime të konsiderueshme për mbylljen dhe rehabilitimin e 10 venddepozitimeve ekzistuese, me investime për impiante grumbullimi, përpunimi dhe trajtimi të integruar të mbetjeve, me plane veprimi të qarta dhe me bashkëveprimin e qeverisë me pushtetin vendor, ndjekur çdo ditë nga qeveria jo thjesht si prioritet, por si një detyrë patriotike dhe si një kauzë kombëtare.

Në këtë rrugëtim pozitiv të përpjekjeve për përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve, me lejon të ndaj me ju modelin pozitiv në qarkun e Beratit.

Gjatë periudhës shtator 2018–dhjetor 2022 Bashkia e Beratit, Bashkia e Kuçovës, Bashkia e Dimalit, Bashkia e Poliçanit dhe Bashkia e Skraparit (të qarkut të Beratit) kanë zbatuar fazën e parë të projektit të menaxhimit të integruar të mbetjeve, financuar nga qeveria zvicerane me një fond prej 3 milionë e 484 mijë frangash zvicerane. Me zbatimin e këtij projekti iu dha zgjidhje problematikës 30-vjeçare të sheshdepozitimeve të menaxhimit të mbetjeve, ku para vitit 2018 mbetjet depozitoheshin në vende informale, në territoret pranë lumenjve, shpeshherë të rrezikuara nga përmbytjet apo nga zjarret e qëllimshme, të frekuentuara nga kafshët apo nga njerëzit që gërmonin për materiale të riciklueshme. Prej muajit prill të vitit 2021 sheshdepozitimet e Beratit, të Kuçovës dhe të Dimalit janë rehabilituar në përputhje me standardet bashkëkohore, ku përfshihen: sistemi i menaxhimit të gazit; sistemi i menaxhimit të ujërave kulluese, të ndotura; depozitimi i mbetjeve në mënyrë të kontrolluar, si dhe u kapsuluan në total 140 mijë tonë mbetje.

Sot bashkitë e qarkut të Beratit kanë ngritur strukturën e dedikuar për menaxhimin e sheshdepozitimeve, të shoqëruar edhe me planin e menaxhimit operacional. Qarku i Beratit e ka të miratuar planin rajonal të menaxhimit të integruar të mbetjeve, dhe pas miratimit të këtij plani në Këshillin e Ministrave është qarku i parë që ka një plan rajonal, i cili do të zbatohet edhe me mbështetjen e huamarrjes nga KfW-ja, të kësaj kredie që po miratojmë sot.

Qarku i Beratit, veçanërisht Bashkia e Beratit, si potencial gjithëvjetor turistik, është angazhuar me përpjekje maksimale për çështjet e pastrimit dhe të cilësisë së shërbimit e të menaxhimit të mbetjeve, pasi atraksionet turistike

dhe fluksi turistik, që po e kalon shifrën e mbi 400 mijë turistë në vit, po imponojnë vetëm një sjellje dhe vetëm një veprim: pastërti dhe vetëm pastërti!

Bashkia e Beratit, paralelisht me projektin e cituar më sipër, me mbështetjen e qeverisë suedeze, nëpërmjet agjencisë SIDA, po zbaton projektin për krijimin e të gjithë strukturës së grumbullimit dhe të diferencimit të mbetjeve, duke u dhënë prioritet mbetjeve të riciklueshme dhe ekonomisë qarkulluese. Pavarësisht se këtu po flasim për huamarrje dhe për financime nga KfW-ja, për menaxhimin e mbetjeve të ngurta është i pazëvendësueshëm kontributi i gjithsecilit, si qytetar, për të prodhuar sa më pak mbetje, për të ndarë në burim mbetjet në çdo familje, për të mbrojtur mjedisin duke mos e ndotur, jo duke bërë shpesh e shpesh aksione pastrimi.

Edukimi mjedisor dhe ndërgjegjësimi i komunitetit është një sfidë që nuk ndalet kurrë, dhe qytetarët e kulturuar, që kontribuojnë çdo ditë për pastërtinë dhe higjienën, janë një shembull që duhet kthyer në një shumicë absolute dhe në një model që duhet ndjekur nga çdo shqiptar.

Në qarkun e Beratit ne jemi të gatshëm ta zbatojmë këtë kredi, të cilën do ta miratojmë sot, pasi është dakordësuar territori prej 10 hektarësh, që do të shërbejë si qendër rajonale e menaxhimit të integruar të mbetjeve, e cila do të funksionojë si e tillë për 20 vjet, duke depozituar rreth 550 mijë tonë mbetje në total. Vetëm menaxhimi rajonal i mbetjeve, i dakordësuar tashmë në qarkun e Beratit, është zgjidhja optimale në aspektin financiar, ekonomik, mjedisor dhe shëndetësor, e shoqëruar edhe me zgjidhjen optimale të tarifës së menaxhimit rajonal të mbetjeve.

Nga kredia prej 50 milionë eurosh, që miratojmë sot, qarku i Beratit përfiton: financimin e projektit për ndërtimin e qendrave të menaxhimit të mbetjeve; ngritjen e impiantit të ndarjes së mbetjeve të ngurta nga ato të riciklueshme; *landfill* për mbetjet e ngurta; *landfill* për mbetjet inerte; stacione të transferimit të mbetjeve; makineri dhe pajisje për pastrimin e territorit, për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve.

Ju ftoj ta miratoni këtë marrëveshje.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Zoti Dashamir Shehi nuk është, konsiderohet se është tërhequr.

Fjala për zotin Xhelal Mziu.

Të përgatitet zonja Antoneta Dhima.

Xhelal Mziu – Të dashur qytetarë,

Të nderuar kolegë,

Marrëveshjen e huasë sot me KfW-në, për trajtimin e mbetjeve të ngurta, do ta konsideroja pozitive për sa i përket partneritetit që kemi me të, duke qenë një institucion financiar, i cili ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në këto vite, si në financimin e ujësjellës-kanalizimeve, në ndërtimin e rrugëve, ashtu dhe në trajtimin e mbetjeve urbane, por e konsideroj të papranueshme që gati në çdo seancë ne ndërmarrim iniciativën për të marrë një kredi, aq më tepër një kredi për një sektor abuziv si incenerimi ose trajtimi i mbetjeve urbane.

Shqipëria është bërë kryefjala e PPP-ve, e inceneratorëve, të cilët i kanë kushtuar jo pak buxhetit të shtetit, por më shumë se 430 milionë euro, madje PPP-të janë denoncuar jo vetëm nga opozita shqiptare, nga qytetarët shqiptarë apo nga institucionet audituese në Shqipëri, por dhe Banka Botërore dhe FMN-ja kanë qenë kundër tyre. Sa i përket marrjes së kësaj kredie, e shoh me mjaft skepticizëm, ka mjaft problematika shqetësuese për çdo qytetar shqiptar. Po ta shohësh, edhe në këtë kredi ne “ushqejmë” inceneratorët, sidomos njërin nga tre inceneratorët që kemi. Kjo është e papranueshme.

Në fakt, ne në Shqipëri nuk e kemi kapacitetin për të ndërtuar inceneratorë. Inceneratorët ndërtohen kryesisht në qytetet e mëdha europiane, jo në Shqipëri me 2 milionë banorë. Ndërtimi i tre inceneratorëve ka treguar se është vërtet një hap i gabuar dhe korruptiv. Kudo në Europën Perëndimore përdorimi i *landfill*-eve është një zgjidhje dhe ne nuk kemi pse të bëjmë shpikjen e rrotës, por mjafton të përdorim ndërtimin e *landfill*-eve, aq më tepër kur Shqipëria ka 61 bashki, ka territore mjaft të përshtatshme për ndërtimin e *landfill*-eve me një kosto shumë herë më të ulët se ndërtimi i inceneratorëve.

Edhe po të shohim në termat e ndërtimit të kësaj marrëveshjeje, ka mjaft probleme shqetësuese për qytetarët, si rifinancimi për Durrësin, që ka të bëjë me inceneratorin e Tiranës. Nuk është normale të mos kemi një listë analitike për financimin, pra se ku do të shkojë.

Tjetër problem shqetësues është dhe ndarja proporcionale e këtij investimi. Edhe në këtë rast shohim që kemi një shpërqendrim ose një

proporcion jo të drejtë të financimit, flas këtu për qarkun e Lezhës, të Shkodrës, të Kukësit, të cilat nuk janë përfituese si qarqet e tjera të Shqipërisë, duke pasur kështu një diskriminim territorial. Bashkitë, sipas detyrimit ligjor, marrin taksat e pastrimit të familjet, të bizneset, që janë taksa marramendëse. Është e pajustificueshme që të merret një kredi për t'i financuar, kur ato i kanë të gjitha kapacitetet e nevojshme për ta përballuar, kuptohet, duke përdorur *landfill*-et.

Është e papranueshme të jepet një kredi po për këtë sektor, ku shumë kollaj kjo kredi mund të përdorej në një destinacion tjetër. Kudo në botë përdoret mbledhja e mbetjeve urbane me ndarje në burim, vetëm në Shqipëri nuk ndodh kjo. A nuk do të ishte më normale që këto 50 milionë euro të shkonin në drejtim të familjeve, që ato të bënin ndarjen në burim, pra duke krijuar një kulturë dhe një kosto shumë herë më të ulët, madje duke i bërë bashkitë më efektive, që me ndarjen në burim ta shesin në treg produktin që marrin? Sot ndodh një absurditet me një incenerator të Tiranës, sepse, nëse ndërtohet një pallat në Kamëz, në Vorë, në Durrës apo në Kavajë, dheu që prodhohet duhet të shitet në inceneratorin e Tiranës, dhe nëse njëra nga këto bashki ka nevojë për ta përdorur këtë mbetje urbane për të mbushur një gropë brenda territorit të saj, duhet të shkojë ta blejë tek inceneratori i Tiranës. Është skandalozë dhe e papranueshme. Kështu që një zgjidhje e leverdishme do të ishte stimulimi për familjet, që të ndajnë produktin në burim, pra atje ku prodhohet kjo mbetje urbane.

Shqetësim për çdo qytetar mbetet borxhi publik, i cili ka arritur në shifra marramendëse. Është vërtet e frikshme shifra që marrim. Në dy seanca kemi të paktën një nënshkrim marrëveshjeje për marrjen e borxhit, madje borxh në euro, e cila e ka katandisur euron në atë pikë sa që çdo ditë humbim një lek. Është absurde, sepse qeveria vazhdon të marrë borxh dhe sapa mori eurobondin 500 milionë euro, me 6,125%, pra dy herë më shumë se dy vjet më parë. Marrim një borxh të madh për të paguar një kredi, që ishte me borxh të vogël ose, thënë ndryshe: bli këlysh për të shitur qen. Është absurde, aq më tepër kur thyhen rregullat e buxhetit të shtetit, kur tavani maksimal i marrjes së borxhit nga një qeveri është 300 milionë euro, por qeveria e ka kapërcyer këtë, duke mos u futur në tregun e brendshëm. Do të ishte më normale të bëhej nëpërmjet bonove të

thesarit apo blerjeve të euros në tregun e brendshëm, pasi do të ishte një zgjidhje më e leverdishme për buxhetin e shtetit dhe për qytetarët.

Është absurd edhe një fenomen tjetër në Shqipëri: jemi ndoshta i vetmi vend që Europë, por edhe më gjerë, që kemi një valutë vendase si leku, por ku, faktikisht, prioritare është euro. Kjo nuk ndodh në asnjë nga vendet e BE-së, as në Kroaci, e cila, edhe pse është anëtare e BE-së, përdor valutën vendase; po ashtu, dhe Bullgaria dhe disa shtete të tjera, të cilat ju i njihni më mirë, përdorin valutën vendase. Përse ne, në çdo lloj transaksioni që bëjmë, madje edhe në ato shtetërore, duhet të përdorim euron, ndërkohë që kemi valutën vendase?!

Bota po zihet për përdorimin e parave, si Rusia, e cila do të përdorë rublën në tregtinë e jashtme, kurse qeveria jonë, vullnetarisht, përdor euron dhe valuta vendase nuk funksionon. Pra, janë disa instrumente, të cilat e kanë përkeqësuar ndjeshëm ekonominë, ndaj shpresoj që qeveria të mos rendë pas huave që nuk sjellin një fizibilitet. Situata sot në Shqipëri dallon nga vendet e tjera të Europës. Në Europë ka filluar rënia progresive e inflacionit, vetëm në Shqipëri ndodh e kundërta.

Në muajin maj inflacioni u rrit më shumë se në katër muajt pararendës, madje kjo u certifikua fiks te grupi i ushqimeve, që pati një rritje prej 10%, duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në xhepat e qytetarëve. Ndaj unë jam kundër kësaj kredie, sepse destinacioni i saj është absolutisht i pajustificueshëm dhe do të rëndojë akoma më tej jo vetëm në ekonominë shqiptare, por edhe në xhepat e qytetarëve shqiptarë.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjalën e ka zonja Antoneta Dhima.

Të përgatitet zoti Sali Berisha.

Antoneta Dhima – E nderuara zonja Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Marrëveshja që po diskutojmë sot është një marrëveshje që do të mundësojë financimin dhe ndërtimin e infrastrukturës së domosdoshme në menaxhimin e integruar të mbetjeve sipas nevojave të identifikuar gjatë hartimit të studimit të fizibilitetit, sipas zonave të mbetjeve në Dibër, Tiranë, Durrës, Berat, në zonën veriore të rajonit të Vlorës dhe njëkohësisht në Korçë.

Objektivi kryesor, që do të arrihet me zbatimin e kësaj marrëveshjeje, është dhënia e kontributit për një menaxhim të qëndrueshëm të mbetjeve të ngurta nëpërmjet investimeve në infrastrukturën e tyre, si dhe mbështetja institucionale për dhënien e një shërbimi të përmirësuar të zonave të ndryshme.

Aktualisht, në të gjithë territorin ekzistojnë qendrat e menaxhimit të mbetjeve për zonat e mbetjeve, kryesisht Tiranë-Durrës, në Sharrë; Shkodër-Lezhë, në Bushat; Vlora në jug, Bajkaj në Sarandë; në Korçë, në Maliq, të cilat janë ndërtuar duke plotësuar kushtet teknike dhe ato mjedisore.

Gjithashtu, është ndërtuar dhe është në funksion impianti për trajtimin e mbetjeve dhe prodhimin të energjisë elektrike në Elbasan, po ashtu është në proces finalizimi ndërtimi i impiantit për trajtimin e mbetjeve dhe prodhimin e energjisë në Fier, si dhe është në proces finalizimi ndërtimi i qendrës së menaxhimit të mbetjeve për zonën e mbetjeve në Vlorë-Veri, në Sherishtë të Vlorës.

Ndërtimi dhe funksionimi i këtyre impianteve ishte jetik dhe i domosdoshëm, pasi ato i dhanë fund tymit dhe kancerit që vinte nga djegia e plehrave në Sharrë të Tiranës dhe në fushën mbi 60-vjeçare të mbetjeve në Fier, një imazh shumë i shëmtuar që në pamje dukej sikur ishte në vendet e Botës së Tretë: fusha dhe hapësira ku hynte dhe dilte kushdo për të rrëmuar plehra pa kontroll, duke rrezikuar shëndetin dhe jetën. Ai realitet dhe ajo situatë tejet e zymtë, që normalisht i ngjante një zone lufte me ato flakë të tmerrshme, ku retë e zeza dhe shishet e qelqit kërcisnin sikur piqnin kokoshka, sot nuk ekziston më, i takon së shkuarës.

Qytetarëve sot u intereson vetëm një gjë: a është qyteti i tyre më i pastër? A është lagjja e tyre më e pastër? A është rrugica e tyre më e pastër? Pra, ajo që ata nuk e kishin parë më përpara, në momentin kur ne kemi marrë pushtetin dhe kemi ardhur në qeverisje.

Personalisht mendoj se qytetet, lagjet, rrugicat sot janë më të pastra, janë më të gjelbëruara, janë më të bukura sesa dje, dhe kjo është meritë e kësaj qeverie dhe njëkohësisht e Kryeministrit Rama.

Ne që jemi në këtë sallë nuk duhet t'i përzijmë problematikat e proceseve, për të cilat

detyrimet janë të institucioneve të drejtësisë, me qëllimet e proceseve.

Ka pasur raste të mjekëve dhe infermierëve që abuzojnë me detyrën, por ne nuk mund t'i mbyllim spitalet, nuk mund të mbyllim qendrat shëndetësore.

Ka pasur raste kur një mësues, një edukator, abuzon me detyrën, por ne nuk mund t'i mbyllim shkollat, nuk mund t'i mbyllim çerdhët, nuk mund t'i mbyllim kopshtet.

Ka edhe raste aksidentesh në rrugë. Mos duhet që ne të mos vijojmë me rikonstruksionin dhe ndërtimin e këtyre rrugëve? Patjetër që ne do të vazhdojmë.

Ajo që duhet dhe është bërë deri tani është adresimi i njeriut, që është problem, apo referimi i procedurës, që është problem. Por nuk po ndodh që të mbyllet i gjithë procesi apo proceset vetëm nëse ka anomali dhe nëse ka problematika.

Njësitë e qeverisjes vendore kanë sot në dispozicion një pikë fundore për grumbullimin e mbetjeve, të cilat janë qoftë pikat teknologjike të trajtimit të mbetjeve, qoftë edhe fushat sanitare apo landfillet. Sipas ligjit, asnjë njësi e vetëqeverisjes vendore nuk lejohet të krijojë pika të paligjshme në territor, pasi ato kanë detyrimin që t'i çojnë mbetjet në pikat fundore, të cilat janë të miratuara.

Mosrespektimi i ligjit parashikon sanksione si për kryetarët e bashkive, ashtu edhe për administratën e bashkive.

Tri janë akset e zhvillimit të qëndrueshëm të menaxhimit të mbetjeve, si dhe ato të përmirësimit të mjedisit, të cilat do të arrihen me anë të kësaj marrëveshjeje: boshti social, që është përballja me kërkesën në rritje të vazhdueshme për shërbime cilësore, duke nxitur në këtë mënyrë vazhdueshmërinë, zhvillimin e aktivitetit social dhe ekonomik të rajoneve të përfshira; boshti mjedisor, që është mbrojtja e mjedisit, reduktimi i ndotjes së burimeve ujore dhe lumenjve në kushtet e rritjes së cenueshmërisë; dhe boshti ekonomik, që është rritja e performancës operative dhe financiare nëpërmjet ofrimit të shërbimit me tarifa të përballueshme, duke gjeneruar të ardhura nëpërmjet riciklimit të materialeve të riciklueshme që gjenerohen nga mbetjet.

Ajo që duhet theksuar, është fakti se realizimi me sukses i programit patjetër që do të sjellë në mënyrë të drejtpërdrejtë përmirësimin e

menaxhimit të integruar të mbetjeve në rajonet, të cilat janë bërë pjesë e kësaj marrëveshjeje dhe që janë pjesë e përfitimit të financimit e mbështetjes për ndërtimin e infrastrukturës së domosdoshme të menaxhimit të integruar të mbetjeve.

Duke iu referuar situatës aktuale, si dhe vizionit që qeveria shqiptare dhe Kryeministri ka për menaxhimin e mbetjeve të ngurta në të ardhmen, me anë të financimit të kësaj marrëveshjeje është parashikuar të financohet pjesërisht realizimi i dy komponentëve: së pari, furnizimi me makineritë dhe pajisje të domosdoshme për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve, si kosha dhe kontejnerë për depozitimin e mbetjeve, makineri për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve, makineri për pastrimin e rrugëve, makineri për pastrimin e plazheve dhe, së dyti, ndërtimi i qendrave të menaxhimit të mbetjeve, duke përfshirë impiantin e ndarjes së mbetjeve të ngurta nga ato të riciklueshme, landfill për mbetjet e ngurta urbane, landfill për mbetje inerte, stacione transferimi të mbetjeve, rehabilitimin dhe mbylljen e venddepozitimeve ekzistuese të mbetjeve.

Mbështetja financiare për zbatimin e këtij projekti do të sigurohet nga Banka Gjermane për Zhvillim (KfW), nëpërmjet marrëveshjes së huas, e cila ka një vlerë 50 milionë euro; marrëveshjes së grantit të investimit, e cila kap vlerën 6,9 milionë euro; marrëveshjes së grantit për masat shoqëruese në vlerën 5 milionë euro dhe marrëveshjes së grantit SECO në vlerën 4,75 milionë euro.

Në këtë marrëveshje qeveria shqiptare është bashkëfinancuese, pasi ajo do të mbulojë kostot totale që lidhen me shpronësimet, kryesisht pjesën e TVSH-së.

Ajo që të gjithë duam, dhe që dëshirojmë nga zbatimi i këtij programi, është realizimi me sukses i tij, pasi zbatimi me seriozitet dhe korrektësi në rajonet e përcaktuara do të sjellë në mënyrë të drejtpërdrejtë përmirësimin e menaxhimit të integruar të mbetjeve.

Vlen të theksojmë faktin se projekti është në përputhje me objektivin e zhvillimit të qëndrueshëm të “Agjendës 2030 për zhvillim të qëndrueshëm”, objektivi 12.6 dhe 12.4, si pjesë e një prej 17 objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, të cilët janë miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në vitin 2015.

Në përfundim të fjalës sime si relatores e këtij projektligji, duke vlerësuar rëndësinë që ai ka në menaxhimin e qëndrueshëm dhe miqësor me klimën në sektorin e mbetjeve të ngurta, të nderuar kolegë dhe kolege deputetë, ju ftoj ta miratojmë atë!

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjala për zotin Sali Berisha.

Të përgatitet zoti Eduard Shalsi.

Sali Berisha – Zotërinj deputetë,

Zonja deputete,

Zonja Kryetare e Kuvendit,

Më duhet të bëj një sqarim, sepse keqkuptimi malinj, i qëllimshëm ndaj kërkesës sime për zonjën Spiropali që t’i japë fustanin Edi Ramës, mori interpretime, të cilat absolutisht nuk ishin qëllimi im. Nuk kam ndërhyrë dhe nuk do të ndërhyj në mënyrë kategorike në orientimin seksual të asnjë njeriu dhe nuk kisha atë qëllim.

Por, do t’ju them diçka, juve, zonja Kryetare, që e drejtoni këtë parlament në kundërshtimin më flagrant me Rregulloren. Në qoftë se ti lejon të përgjigjet për Kryeministrin, të cilin unë e atakoj këtu me fakte dhe argumente, një person që nuk quhet Edi Rama, ti shkel me të dyja këmbët me një akt servilizmi total Rregulloren e Kuvendit. Mua personalisht nuk më lëndon fare ngritja e saj, përkundrazi, unë shoh mjerimin e Edi Ramës dhe se kush e mbron atë, por ti shkel Rregulloren, ti je bërë dhe do të bëhesh shkak për konflikte në këtë parlament, në qoftë se nuk zbaton Rregulloren. Asnjë njeri nuk ka të drejtë të flasë në emrin e një tjetri, kjo është një praktikë, prandaj më mirë t’i japë fustanin e vet Edi Ramës, sepse ai nuk është burrë të vijë të ballafaqohet këtu.

Atëherë, a nuk kam të drejtë unë për këtë? Çfarë është kjo? Flas unë, menjëherë ngrihet ajo si me qenë papagalli i Edi Ramës, por nuk e lejon Rregullorja. Mund të jesh papagall, por Rregullorja nuk e njeh papagallin. Më thoni ju tani: a e njeh Rregullorja papagallin apo nuk e njeh?! Prandaj, kjo praktikë duhet të marrë fund.

Problemi që diskutohet sot është pazgjydhshmërisht i lidhur me një nga aferat më të mëdha korruptive të Shqipërisë, të Ballkanit dhe të Europës, të djegësve të inceneratorëve. Shqiptarët duhet ta dinë se në vitin 2012-2013, u shpenzuan 4 milionë euro para të taksapaguesve europianë, për të ndërtuar strategjinë e Shqipërisë

ndaj mbetjeve urbane. U përcaktuan të gjitha pikat, ndërhyrjet dhe projekti për trajtimin e tyre në një akt megakorruptiv. Edi Rama në vend që të zbatonte këtë strategji, e cila në një mënyrë rikthehet tani me këtë ligj, e shkelmoi atë dhe me urgjencë solli dhe firmosi kontratat korruptive për inceneratorët. E filloi me Elbasanin, duke firmosur në 24 orë 17 akte administrative, rekord në historinë e këtij vendi apo të një vendi tjetër, sepse duhej krijuar ndërmarrja me të cilën Edi Rama, Erion Veliaj dhe Arben Ahmetaj duhej të bëheshin milionerë në mënyrë të rrufeshme.

Implikuan apo u implikua vetë këtu Lefter Koka, u përdor si hajduti i dobishëm. Po pse e them unë këtë? Sepse ai nuk kishte asnjë qindarkë në buxhetin e ministrisë së tij për ndërtimin e inceneratorit të Elbasanit. Atij pra, ai që vuan tani burgun atje (dhe mirë t'ia bëjnë, t'ia dyfishojnë, përderisa nuk i denoncon) i thanë: mbylle gojën sa të mundesh këtu, por ne kaq kemi atje!

Sa është kjo aferë? Nga 23 milionë, me çelësa në dorë kushtoi 11 milionë djegësi rrangallë i Elbasanit. Të tjerat u futën në xhep nga Edi Rama, Engjëll Agaçi, Arben Ahmetaj. Oreksi vjen duke ngrënë.

Vijmë te djegësi i Fierit. Çfarë thotë tani Farudin Arapi, njeriu juaj? Thotë se “Pas llogaritjeve që bëra, këtu depozitimi kushton 12 euro”. Në fakt, në kontratën e Tiranës është 11 euro. Dhe Arapi thotë: “Kurse djegia kushton 25 euro”, por mungojnë 2,8 milionë euro për të vënë në funksion rrangallën, që, sipas burimeve të medieve, e kanë çmontuar në Konstancë si një vjeturinë të pavlerë. Arapi thotë: “Djegia këtu, pra, kushton 25 euro”, ndërkohë që në kontratën Rama-Veliaj djegia kushton 29 euro.

Por më keq akoma, prej pesë vjetësh qytetarët e Tiranës tarifohen nga Edi Rama dhe Erion Veliaj, në kundërshtim flagrant me kontratën, 29 euro për ton. Kanë vjedhur, me llogari ditë për ditë, 100 milionë euro. Nuk kanë investuar asgjë në djegësin e Tiranës dhe, sipas dëshmimeve të atyre që kanë qenë pjesë e kësaj sipërmarrjeje, po lahen paratë e Pasdaranit nga Bruno Preseci, që është *de facto* sot pronari i 74% të të gjitha aksioneve të djegësit të Tiranës.

Por “SKAP-i” i partisë, sigurisht, nuk dëgjon dhe nuk shikon.

Prej pesë vjetësh Erion Veliaj u merr qytetarëve të Tiranës 29 euro për ton gjoja për

djegje, në një kohë kur të gjitha i depoziton dhe nuk djeg asnjë kilogram. *(Bie gongu.)*

Parlamentit i ka dalë tymi i djegësve. Tiranës i ka dalë tymi i djegësve. Regjimi i kalbësirës së plehrave vjedh shqiptarët në këtë mënyrë. Çfarë do të bëni ju me këtë? Unë e përshëndes rikthimin te strategjia europiane, por ju vazhdoni.

Secili prej jush është një Erion Veliaj, përderisa ju e mbroni atë.

Secili prej jush është një hajdut si Edi Rama, përderisa e mbroni atë këtu.

(Bie gongu.)

Edhe më keq se midis atij që bën dhe atij që hesht, më i keq është ai që hesht, se ka frikë, nuk ka guxim të mbrojë interesin publik.

Hajde pak e lexoje raportin e Farudinit, ti që proteston aty! Lexojeni!

Ndaj edhe ky ligj është i sabotuar në çdo gjë, derisa të vazhdojë vjedhja e tmerrshme me inceneratorët.

Edi Rama firmosi kontratën në kundërshtim...

Lindita Nikolla – Përfundoni, zoti Berisha.

Sali Berisha – Ja, një sekondë!

...me përcaktimin e Agjencisë Kombëtare të Prokurimeve, se kjo procedurë është antiligjore. Por Agaçi i tij dhe vetë Rama me Erion Veliajn, nuk njohin kufij në vjedhje.

Erion Veliaj firmosi në emër të këshillit, pa mbledhur këshillin; firmosi në emër të qarkut, pa mbledhur qarkun!

Lindita Nikolla – Kaloi 1 minutë, zoti Berisha, ju lutem!

Sali Berisha – Urdhëroni?

Lindita Nikolla – Kaloi 1 minutë nga koha.

Sali Berisha – Faleminderit atëherë! Nuk...

Lindita Nikolla – Më lejoni t'ju bëj një sqarim.

Neni 47 i Rregullores së Kuvendit thotë se ministri e merr fjalën sa herë e kërkon. Zonja Spiropali e kërkon fjalën si ministre e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin dhe vetëm në atë cilësi flet. Kjo ishte sa për sqarim.

(Deputeti Berisha flet pa mikrofon.)

Faleminderit, zoti Berisha! Ishte sa për t'ju sqaruar.

(Deputeti Berisha flet pa mikrofon.)

Zoti Shalsi, fjala për ju.

(Deputeti Spaho ndërhyr nga vendi pa mikrofon.)

Ia kam dhënë fjalën tani, zoti Spaho. I dhashë fjalën zotit Shalsi.

(Deputeti Spaho ndërhyr nga vendi pa mikrofon.)

Të mbarojë zoti Shalsi dhe, patjetër, do t'jua jap fjalën për procedurë.

(Diskutime pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Mundem, e nderuar zonja Kryetare?

Lindita Nikolla – Po, zoti Shalsi, jua kam dhënë fjalën.

Eduard Shalsi – E nderuar zonja Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sali Berisha, nuk të kam parë kurrë më të pafuqishëm në qëndrime sesa sot, nuk të kam parë më të mjeruar në të folur, nuk të kam parë më mizerabël në të sjellë, nuk të kam parë kurrë kaq të padenjë në të komunikuar dhe, për më tepër, më të padobishëm sesa sot, qoftë edhe për PD-në.

Një pjesë juaja e duartrokitët.

Nëse do të ishe i zgjuar, i urtë, i mençur, në vitin 2023 do të kishe hapur krahun dhe të lije historinë të të gjykonte, sepse unë besoj që edhe në opozitë do të kishte njerëz shumë më dinjitozë sesa ti. Por nuk është koha të merremi me ty.

Kurrë më parë Shqipëria nuk ka pasur dhe nuk ka qenë më dinjitoze në arenën ndërkombëtare dhe në raporte më të forta, më të shëndetshme, më të ngushta me partnerët ndërkombëtarë sesa tani, dhe kjo falë Edi Ramës.

Sot një koleg u mor me Kosovën, një tjetër u mor me kursin e këmbimit. Nuk dua të merrem me ta, por dua të them se sot kemi një marrëveshje, në fakt, dhe ndihem shumë i keqardhur që shumë prej jush pohuan se nuk do ta firmosin marrëveshjen me KfW-në, me një partner tradicional, i cili meriton mirënjohje dhe falënderime të veçanta për kontributet që ka luajtur vazhdimisht në Shqipëri.

Mbetjet kanë qenë një nga projektet e tyre. Ose e keni lexuar dhe nuk e keni kuptuar, ose nuk e keni lexuar. Por çfarë projekti po diskutoni? Çfarë nuk do të votoni sot, se nuk e kuptoj?

Projekti është i qartë: ka një marrëveshje huaje prej 50 milionë eurosh, ka një marrëveshje granti prej 6,9 milionë eurosh, ka një marrëveshje granti për masat shoqëruese në vlerën 5 milionë euro, ka edhe një marrëveshje granti SECO në vlerën 4,75 milionë euro. Këto marrëveshje kanë tri boshte: boshtin social, boshtin mjedisor dhe atë

ekonomik. Në Korçë ka një projekt *ongoing* që po zhvillohet, ku modeli është i suksesshëm, është ndërtuar një pikë ku trajtohen, ku ndahen mbetjet, ku depozitohen, gjithashtu. Ka edhe një strategji kombëtare për mbetjet, e cila shërbeu si premisë për të zhvilluar një studim fizibiliteti, i cili sot po materializohet me këto marrëveshje. Ka disa përfitues konkretë kjo marrëveshje, siç janë: zona Tiranë-Durrës, zona e Dibrës, zona e Korçës, ajo e Beratit dhe ajo e Vlorës.

Aktualisht, ekzistojnë zonat e menaxhimit të mbetjeve, siç jeni në dijeni, në Sharrë, në Bushat të Shkodrës, në Bajkaj të Sarandës, në Maliq, të cilat janë tashmë të ndërtuara. Gjithashtu, është në funksionim impianti i trajtimit të mbetjeve dhe i prodhimit të energjisë në Elbasan. Të mos harrojmë se çfarë përfaqësonte Elbasani shumë vjet më parë.

E kemi thënë dhe e themi: drejtësia të ushtrojë të drejtën e saj dhe të mbajë përgjegjësi përpara ligjit cilindo që e ka shkelur atë. Ama, Elbasani i djeshëm, në kohën tuaj...

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Në kohën tuaj, dhe ju sfidoj në tetë vjet qeverisje... Unë nuk e kuptoj përse disa nga zonjat e nderuara, që i kam parë në politikë vitet e fundit, e mbrojnë!

Nuk është çështje moshe, jo, është çështje mentaliteti, se mund të jesh i vjetër në moshë, por i ri në mendime, sikurse mund të jesh i ri në moshë dhe i vjetër në mendime.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Më tregoni nga vitet 2005-2013 një model tuajin se si mendoni t'i menaxhoni mbetjet, një në tetë vjet qeverisje!

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Doni të bëheni koracë mbrojtëse...

Lindita Nikolla – Ju lutem tani, se nuk do të bëni dialog nga vendi!

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, kolegë!

Eduard Shalsi – Jo, më vjen keq, se edhe të rinj në moshë, edhe keni këtë...

Ju dëgjova, nuk rashë dakord me ato që thatë ju, por nuk fola nga vendi. Pse e keni këtë? E bëni në komision, e bëni këtu. Ç'ë keni këtë pamundësi për të vetëkontrolluar emocionalisht veten tuaj? Kontrollonjeni dhe kini një gjë parasysh që, sa më emocionalë të jeni, aq më të palogjikshëm jeni.

Kontrollonjeni emocionet! Unë po jap opinionin tim, nuk po jap opinionin tuaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po ju pyes, pra, cili është opinionioni juaj? Cili ishte shembulli juaj në tetë vjet qeverisjeje për mbetjet? A keni një model? Një na thoni. Në të gjithë Shqipërinë, në tetë vjet thoni që keni një model.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju kemi sfiduar për qytetet. Ju kemi sfiduar për çdo gjë.

Cili është, pra, cili, se nuk e kuptoj? Nuk do ta firmosni këtë marrëveshje që e kemi ndërtuar me KfW-në? Fatmirësisht, kemi këta partnerë që na kanë mbështetur në ditë shumë të vështira, edhe kur nuk dinim, edhe kur nuk kishim ekspertizë. Pra, për çfarë jeni ju si opozitë? Nuk firmosni marrëveshje? U çudita, se dakord që mund të kundërshtoni, por a e keni kuptuar apo jo se për çfarë bëhet fjalë? Nëse nuk e keni kuptuar, unë them që deri në kohën e votimit të mund ta lexoni. Nëse keni pyetje, mund të pyesni, por nuk do t'i bënit një shërbim as asaj që ju përfaqësoni, as raporteve me partnerët tanë dhe as Shqipërisë duke mos miratuar një marrëveshje, që është ndërtuar mbi një strategji, mbi një studim fizibiliteti dhe ka masa konkrete. Nuk e kuptoj, ndaj edhe po jua them. Nuk arrij ta kuptoj logjikën pas këtij qëndrimi.

Nëse do ta shpjegoni, nëse do të jepni argumente, patjetër që edhe ne mund ta shohim. Por ka elemente konkrete kjo marrëveshje: flet mbi pikat e transferimit të mbetjeve; flet, gjithashtu, për trajtimin e mbetjeve; flet për vendndodhjet e pikave të transferimit të mbetjeve, pra flet për elemente që e bëjnë mjedisin më të pastër, për pasojë më të shëndetshëm.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ndaj, duke falënderuar të gjithë ata që kanë kontribuar për arritjen e kësaj marrëveshjeje dhe, sigurisht, partnerët e KfW-së, por edhe cilindo, do t'ju lutesha përulësisht që ta konsideroni edhe një herë qëndrimin tuaj për të mos votuar një marrëveshje. Nuk është në nderin tuaj.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Po, zoti Spaho.

Edmond Spaho – Zonja Kryetare, shikoni, për një projektligj kaq të rëndësishëm nuk ka asnjë përfaqësues nga qeveria për të dëgjuar diskutimet e Kuvendit të Shqipërisë. Kjo nuk është normale. Ka ndodhur dhe po ndodh vazhdimisht në këtë parlament. Për kë flasim

këtu? Ne flasim për qytetarët, por duhet të jenë edhe ministrat.

Së paku, duhet të jetë ministrja e linjës dhe zëvendëskryeministrja ose ministrja e Financave që merr borxhin në emër të qeverisë, ose ministrja e Marrëdhënieve me Parlamentin. Asnjëri prej tyre të mos jetë prezent?! Ky është serioziteti i debatit që bëjmë? Nëse është kështu, më mirë ta mbyllim debatin dhe të ikim në shtëpi.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjala për zotin Luan Baçi.

Të përgatiten zoti Arben Pëllumbi dhe më pas zonja Ina Zhupa.

Luan Baçi – Pse i keni kaq merak ministrat që i doni këtu? Ç'i doni? Si janë, si nuk janë, njëlloj janë, sepse ministër është vetë Kryeministri, të gjithë i ka ai në dorë. Megjithëse ka një lajm të fundit, që do t'i shkarkojë të gjithë ministrat dhe të bëhen gati disa deputetë.

Zonja Kryetare,

Kolegë deputetë,

Sot në një nga pikat e rendit të ditës na keni sjellë për miratim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, huamarrësi Ministria e Financave, (që s'është këtu) dhe KfW-së “Për programin për menaxhim të qëndrueshëm dhe miqësor me klimën në sektorin e mbetjeve të ngurta””.

Në fakt, një nga cilësitë më të dobëta të jetesës sonë është mungesa e gjelbërimit dhe e ajrit tepër të ndotur që gjendet gjithandej. Kjo që them, e dini që nuk është retorikë politike, por lidhet direkt me përditshmërinë tonë, si dhe me konkluzionet shkencore që japin ekspertët e mjedisit, shqiptarë dhe ata ndërkombëtarë. Të dhënat dëshmojnë për një realitet alarmant të ndotjes së ajrit, i cili ka pasoja të rënda në shëndetin tonë, sikurse edhe ushqimet e pasigurta, të cilat i konsumojmë të gjithë. Në çdo legjislaturë miratojmë apo ratifikojmë disa marrëveshje për çështjen e mjedisit dhe ajrit, dhe bëjmë shumë mirë, por çështja është se këto dokumente mbeten thjesht në sirtar apo në arkivat e institucioneve, ndërkohë që në jetën e përditshme nuk shohim asnjë rezultat pozitiv. Përkundrazi, në vitet e fundit, veçanërisht Tirana, por edhe qytete të tjera, si Fieri, Durrësi, Shkodra kanë probleme të mprehta me ndotjen e ajrit, shoqëruar edhe me mungesën e theksuar të hapësirave të gjelbra në komunitet.

Të nderuar,

Sot ju po merrni përsëri hua miliona euro dhe keni bërë një studim për disa nga qarqet dhe bashkitë e vendit, ku do t'i bëni këto investime, të cilat patjetër që e kanë domosdoshmëri sistemimin e mbetjeve të ngurta, dhe jo vetëm. Na thoni që këto investime do të jenë në formën e landiflleve dhe na i propagandoni si forma më e mirë, kur, në fakt, sipas ekspertëve, por edhe sipas mendimit të disa deputetëve tuaj të mazhorancës, të cilët e pranuan gjatë debatit në komision, landifillet nuk janë opsioni më i mirë për menaxhimin e mbetjeve. Kohë më parë ju na propaganduam me të madhe inceneratorët. Hodhët miliona euro në tre incineratorë: në Tiranë, në Fier dhe në Elbasan. Dhe me të drejtë këto bashki nuk i keni përfshirë në këtë studim, për arsye se e keni zgjidhur problemin me anë të inceneratorëve. Atëherë, më duhet t'ju pyes: ku janë inceneratorët tani? Në Fier inceneratori është kthyer në një bunker ndërtesë, ku nuk lejohet të futet brenda askush dhe nuk dihet se çfarë bëhet me 30 milionë euro të hedhura në atë incenerator. Rreth inceneratorit janë hapur gropa gjigande, ku depozitohen të gjitha mbetjet, urbane dhe të ngurta dhe kapsulohen me dhera për mos t'u hapur më kurrë. Tashmë vendi aty është kthyer në një landfill të dytë, si ai i Fushës së Mbrostarit, në të cilin ka mbi 30 vjet që kapsulohen të gjitha mbetjet, me mijëra e mijëra tonelata, të cilat përbejnë një rrezik shumë serioz për banorët e Fierit dhe të gjithë qarkut. U premtua nga qeveria dhe nga hajduti profesionist i bashkisë Fier, Subashi i "Rilindjes", se do të nxirreshin nga kapsulimi këto mbetje dhe do të digjeshin në incenerator, për të prodhuar energji dhe për të ulur kostot për qytetarët.

Ku jemi tani? SPAK-u ka kohë që po heton, ka arrestuar disa nga përgjegjësit e kësaj afere dhe, sipas tyre, ka nxjerrë rreth 600 milionë lekë të vjetër dëm ekonomik dhe për këtë do të përgjigjen të ndaluarit e deritanishëm. Mua më duhet t'ju pyes: a mund të na thoni, po me 32 milionë eurot e hedhura për inceneratorin e Fierit çfarë është bërë? Si mund të quhen "dëm ekonomik" vetëm 600 milionë lekë të vjetër të shkaktuar nga disa nëpunës? Natyrisht, ata nuk janë pa faj dhe duhet të përgjigjen për atë që kanë bërë. Por sipas tyre nuk quhet "dëm ekonomik" dhe "vjedhje" investimi me mbi 30 milionë euro; nuk quhet "dëm ekonomik" mosvënja në punë e

inceneratorit; nuk quhet "dëm ekonomik" mosfeksionimi i tij në asnjë drejtim; nuk quhet "dëm ekonomik" kalimi i të gjitha afateve të vënies së tij në punë; nuk quhet "dëm ekonomik" përdorimi i ambienteve të tokës rreth inceneratorit si hapësirë për kapsulim dhe depozitim të mbetjeve, për pasojë shkatërrimin total të tokës; nuk quhet "dëm ekonomik" kostoja e punonjësve që punojnë çdo ditë për t'i kapsuluar mbetjet dhe më pas duhet t'i nxjerrin sërish sipas marrëveshjes dhe të kalojnë për djegie. Pra, bëhet e njëjta punë dy herë. Nuk quhet "dëm ekonomik" tallja që u bëni punonjësve duke mos i paguar rregullisht, duke e hedhur topin sa nga Subashi, tek Arapi dhe sa nga Arapi te Subashi.

Po dëmi i shkaktuar në mjedis nga era e keqe dhe e padurueshme e mbetjeve që qëndrojnë me ditë të tëra në gropa të hapura derisa të mbushen dhe pastaj të kapsulohen? Po dëmi që u shkaktohet fermerëve të zonës së Mbrostarit, Kallmit, Vërrisë, Vajkanit dhe më gjerë në prodhimet e tyre bujqësore nga dekantimet e mbetjeve dhe përhapja e panikut në zonë se prodhimet e tyre tashmë janë të papërdorshme? Në Fier çështja e mbetjeve ka kohë që është kthyer në një emergjencë urbane, por askush në bashki nuk e vë ujën në zjarr, sepse fondet publike duhet t'i përthithë fantazma e inceneratorit që nuk bën asnjë punë. Nga 1 prilli bashkitë e qarkut të Fierit i kanë rritur kostot për depozitim të mbetjeve urbane në landfillin e inceneratorit të Fierit me 12 euro për ton; vendim ky i administratorit Farautin Arapi në bashkëpunim dhe në dakordësi të plotë me kryetarët e bashkive. Janë miliona para nga taksapaguesit që paguhen në llogarinë e të kërkuarve nga drejtësia dhe që nuk sjellin asnjë shërbim mbrapsht për qytetarët tanë. Inceneratori i Fierit, që u sekuestrua në mars të vitit 2022 nga SPAK-u, nuk ka të bëjë vetëm me një skandal korrupsioni, por edhe me një skandal të madh për nivelin e ndotjes në Fier. Edhe kjo, të nderuar, duhet të jetë objekt i hetimit nga SPAK-u. Inceneratori u ka kushtuar taksapaguesve shqiptarë rreth 32 milionë euro, por nuk është vënë asnjë ditë në punë. Ai nuk është funksional në incenerim, pra në djegie, sepse sipas administratorit Arapi duhen edhe 2,8 milionë euro të tjera për ta vënë në punë. Lind pyetja: përse paguhen 12 euro për ton nga bashkitë, kur inceneratori nuk punon dhe nuk i djeg

mbeturinat? A duhej të ishte në funksion inceneratori tani, pasi i ka marrë të gjitha pagesat, apo me këto pagesa nga bashkitë duhet të plotësohet 2,8-milionëshi i eurove që i duhen inceneratorit? Ja edhe një pistë tjetër që i takon SPAK-ut.

Depozitimi prej një viti e gjysmë i tonelatave të mbetjeve nga pesë bashkitë e qarkut të Fierit në landfillin e inceneratorit të Fierit, i cili nuk është vënë ende në funksion, ka krijuar një kontingjent të madh mbeturinash rreth inceneratorit në një gropë gjigande, siç e thashë. Duke qenë se ato nuk po trajtohen me teknologjinë e duhur, kjo bën që Fieri të ekspozohet ndaj një rreziku të madh mjedisor. Burime pranë inceneratorit më kanë bërë të ditur edhe këto ditë se hapësira e vendit të depozitimit është duke u zvogëluar, gjë që do të sjellë një krizë të re mjedisore. Askush nga deputetët apo nga zyrtarët e bashkisë nuk ka reaguar, nuk keni reaguar, sidomos pas zgjedhjeve të 14 majit, fitores së madhe që morët.

Kolegëve deputetë të mazhorancës, Avokatit të Popullit, drejtësisë së re dhe të gjithë deputetëve do t'i ftoj të bëjmë një vizitë së bashku në Fier. Ftoj sidomos deputetët e qarkut të Fierit, zotin Balla si drejtues politik, zotin Braçe, zonjën Dhima të shkojmë tek inceneratori i Fierit që të shikojmë gjendjen aktuale, siç është, që fjalët e miat këtu sot të mos merren si retorikë politike, të mos merren si propagandë, që të mos dilni e të thoni "gënjen", por të vini të shikoni që inceneratori i Fierit është në një gjendje vërtet alarmante. Rreth inceneratorit të Fierit ka me mijëra tonelata mbeturina që janë në gropa të hapura, të pahapura, të mbuluara dhe të kapsuluara. Inceneratori nuk punon dhe sipas të gjitha gjasave, sipas të gjithë informacionit me inxhinierët dhe teknikët që punojnë atje, ai incenerator nuk vihet punë, sepse është i një teknologjie të vjetër, të mbaruar fare, nuk është në gjendje t'i djegë ato mbetje, për më tepër, keni premtuar që do të merrnit edhe mbetjet e fushës së Mbrostarit, të cilat prej 30 vjetësh janë të kapsuluara, do t'i digjnit në incenerator, do të prodhoni energji, do të ulnit kostot dhe do të sillni të mira materiale për qytetarët e Fierit dhe të të gjithë qarkut.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjala për zotin Arben Pëllumbi.

Të përgatitet zonja Ina Zhupa.

Arben Pëllumbi – E nderuar zonja Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë,

Unë dëshiroj ta filloj fjalën time me një falënderim realisht të sinqertë për qeverinë gjermane si një nga donatorët dhe partnerët tanë të rëndësishëm nëpërmjet KfW-së për projekte të tilla, si sistemi elektroenergetik, sistemi i ujësjellës-kanalizimeve apo edhe trajtimi i mbetjeve të ngurta, pjesë e të cilit është edhe projektligji që po diskutojmë dhe do të votojmë sot.

Sigurisht, dua të them dy fjalë për qëndrimin që po mban opozita, jo se dua t'ju bëj moral se si do të votoni, kjo është e drejta juaj, por kam vënë re kohët e fundit se po prishet një traditë e mirë. Pavarësisht se kush ka qenë në opozitë, marrëveshjet ndërkombëtare, dhe në mënyrë të veçantë marrëveshjet me KfW-në, kanë qenë të votuara nga të gjithë. Kjo ndoshta falë edhe një botëkuptimi që ishte krijuar ndaj mosbesimit për njëri-tjetrin, por besimit ndaj institucioneve ndërkombëtare, duke qenë të tilla që shqyrtojnë, jo vetëm qëllimin për të cilin merren këto para, por edhe procedurat në bazë të të cilave akordohen këto para. Më vjen keq, pikërisht se ky besim që krijuam traditë në këtë parlament po prishet. Sipas meje po prishet, sepse po krijohet bindja që, po u votuan marrëveshje, qofshin edhe ndërkombëtare, sipas propozimeve të mazhorancës, konsiderohemi bashkëpunëtorë të saj. Mos qoftë kjo, por më vjen keq që kjo ndodh për projekte të tilla të rëndësishme, si ky që po flasim. Vërtet po marrim 50 milionë euro kredi, por kjo është një kredi krejtësisht e butë, një kredi me interesa pothuajse zero ose minimaliste, për shumë vjet pa pagesë principali. Kjo kredi është nga ato burime financimesh (më duhet t'ia them edhe një kolegu që tha "t'i gjejmë në tregun e brendshëm") që është e pamundur t'i gjejmë në tregun e brendshëm, për më tepër kur shkojnë për një sektor të tillë, siç është ai i trajtimit të mbetjeve.

Po, është e vërtetë që për mbetjet kemi diskutuar shumë, kemi debatuar shumë. Unë nuk jam specialist i kësaj fushe, por që nga prezenca ime në komisionin hetimor që u ngrit për mbetjet, por edhe për shkak të rolit që kam në Komisionin e Veprimtarive Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit, kam filluar të kuptoj diçka, se çfarë ndodh dhe më

vjen keq për një kakofoni, për një zhurmë që bëhet duke indoktrinuar mendjen e qytetarëve në elemente që kanë të bëjnë me korrupsionin. Aty mund të ketë pasur korrupsion, por këto janë çështje që po i heton drejtësia, ajo drejtësi e re të cilën ne e kemi ndërtuar, por unë nuk dua ta trajtoj çështjen në këtë aspekt.

Më lejoni të bëj disa sqarime për qytetarët, të paktën për atë që di unë në këtë fushë. Trajtimet e mbetjeve që ne prodhojmë të gjithë bashkë si qytetarë, kanë zgjidhje të ndryshme në varësi të zonave, në varësi të problematikave që kemi dhe nuk ka një recetë të mirëpërcaktuar nëse është më i mirë landfillimi i tyre, është më i mirë incenerimi apo është më e mirë një zgjedhje tjetër. Pikërisht, për këtë arsye bëhen studimet e fizibilitetit. Besoj se ky projekt që paraqesim sot, ka një studim fizibiliteti të mirëpërcaktuar dhe të qartë, sepse në disa zona mendon të bëjë landfillim, në disa zona mendon të bëjë trajtim paraprak të mbetjeve, kurse në disa zona të tjera duhet të shtojë disa impiante, të cilat kanë të bëjnë me ndarjen e mbetjeve. Pra, çfarëdo që të ndodhë, ka mbetje që riciklohen. Besoj se, edhe në përputhje me atë strategji që është aprovuar këtu në vitet 2012 - 2013, e cila u përmend, kjo gjë ka qenë pjesë dhe është duke bërë. Në të gjitha impiantet e trajtimit të mbetjeve bëhet ndarja e tyre, bëhet edhe riciklimi i tyre, por pikërisht këtu ne të gjithë bashkë, se nuk e dëgjova nga asnjë prej kolegëve, qoftë të mazhorancës, qoftë të opozitës, duhet të përmendim nevojën e transmetimit të një kulture të caktuar të qytetarët tanë, sepse ulja e kostove të këtyre mbetjeve që ne vetë krijojmë, fillon pikërisht nga ne, nga qytetarët e këtij vendi, nga ndarja që ne mund t'u bëjmë që në burim mbetjeve. Kemi provuar të bëjmë ndarje në burim, kemi provuar të bëjmë kazanë me ngjyra të ndryshme apo makina me ngjyra të ndryshme, por këto nuk kanë funksionuar. Megjithatë, ky projekt që ne sjellim sot, çon ujë pikërisht në filozofinë e edukimit tonë, të qytetarëve tanë, që të tentojmë të bëjmë ndarje, të paktën me dy lloj koshash, pra në një kosh të kemi mbetje të riciklueshme dhe në një kosh të kemi mbetje që nuk riciklohen.

Më lejoni të them se nga të gjitha mbetjet që nuk riciklohen, një pjesë e tyre do të shkojnë në landfill dhe një pjesë tjetër do të shkojë në incenerim. Incenerimi nuk është qëllim në vetvete. Incenerimi është për të ulur sasinë e tokës

që t'i vë në dispozicion për të depozituar këto mbetje. Landfilli ka problematikat e veta, sepse prodhon ujëra nëntokësore, të cilat duhen trajtuar, prodhon gazra, të cilat t'i i ke jashtë kontrollit, ndërsa incenerimi ka probleme të tjera, prodhon hir, prodhon ndotje, ka kosto të tjera. Pra, të gjitha zgjidhjet kanë problematikat e tyre. Një gjë ngelet e qartë dhe e panegociueshme: sa më të edukuar të jemi në raport me mbetjet që prodhojmë, sa më miqësorë të jemi me ambientin tonë, aty ku jetojmë, aty më të mira dhe më të lehta do t'i kemi zgjidhjet për këto probleme, të cilat nuk janë të sotmet dhe nuk kanë për të përfunduar ndonjëherë, për sa kohë ne do të vazhdojmë të prodhojmë mbetje.

Dikush nga kolegët tha se sot ndotja e ajrit është më e madhe apo pasiguria ushqimore është rritur. Nuk e di se ku jeton ky kolegj, por, meqenëse vjen nga një qark ku tashmë është ndërtuar një qendër e përpunimit e trajtimit të mbetjeve, edhe sepse inceneratori nuk funksionon atje, në atë qytet nuk është më ajo gropa e madhe ku digjeshin tonelata dhe tonelata të tëra mbetjesh, duke prodhuar jo thjesht re tymi, që shkonin në mushkëritë e të gjithë banorëve të atij qyteti dhe më gjerë, por nuk prodhon më as mbetje nëntokësore ujërash, të cilat ndotnin të gjitha tokat rreth e rrotull saj.

Sa për sigurinë ushqimore, besoj se (e kemi thënë, e kemi trajtuar, e kemi bërë) të gjithë ne duhet të jemi të vëmendshëm për të krijuar një besim më të madh te produktet "*Made in Albania*", te produktet tona. Por nëse ne të parët do të flasim keq dhe kundër prodhuesve tanë lokalë, duke filluar që nga prodhimet bujqësore, ata që punojnë gjithë ditën tokën për të arritur këto rezultate, sigurisht që nuk transmetojmë një mesazh të mirë.

Shqipëria ka përparuar, ka ecur, nuk ka më atë ajër të ndotur, nuk ka më atë territor të ndotur, nuk i ka më ato prodhime të pasigurta, siç i ka pasur ndër vite, por sigurisht që Shqipëria ka akoma problematika, me të cilat duhet të ndeshet, duhet të ballafaqohet, me të cilat po ndeshet dhe po ballafaqohet dhe pjesë e saj është edhe ky projekt, që na paraqitet sot, i KfW-së me qeverinë shqiptare për të adresuar një shumë të tillë parash me kredi të butë për të mbyllur disa hallka dhe zinxhirë të atij sektori, të cilët janë përkrahur edhe në strategjinë që ju përmendët pak më parë.

Kështu që, për të mos e zgjatur, unë besoj se është një marrëveshje që duhet votuar. Sigurisht, ne të mazhorancës do ta votojmë, sepse jemi në mazhorancë për të vazhduar të bëjmë punët tona, për të vazhduar të mendojmë për zgjidhjen e problematikave dhe halleve të qytetarëve, të cilat kanë të bëjnë edhe me mbetjet.

Në fund të fjalës sime dua të theksoj edhe një herë tjetër se edukimi dhe përcimi i një kulture të caktuar në raport me mbetjet që secili prej nesh prodhon në familjen e tij dhe mënyrën si i trajtojmë ato është fillesa dhe gjeneza e uljes së të gjitha kostove të këtij procesi.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjala për zonjën Zhupa.

Të përgatitet zoti Edmond Spaho.

Ina Zhupa – Faleminderit, e nderuar Kryetare!

Përpara se të flas për marrëveshjen që kemi në rendin e ditës, në fakt, edhe si ish-anëtare e komisionit hetimor për inceneratorët, dua të denoncoj publikisht nga foltorja e Kuvendit shkeljen e ligjit nga kjo mazhorancë, nga anëtarët e zgjedhur nga kjo mazhorancë në Këshillin Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar për kapjen e Radiotelevizionit Shqiptar duke emëruar në mënyrë të paligjshme dhe në shkelje flagrante të ligjit ish-deputetin e Partisë Socialiste, anëtarin e Partisë Socialiste, zotin Alfred Peza.

Ligji nr. 97/2013 ka disa kushte për atë që kërkon të bëhet drejtor, por edhe pse zoti Alfred Peza i shkel të katërta kërkesat e ligjit, ai zgjidhet në mënyrë të paligjshme. Ligji nr. 97/2013 në nenin 104, për papajtueshmëritë dhe konflikti i interesave në zgjedhjen e drejtorit të RTSH-së”, thotë që drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së nuk lejohet të jetë anëtar i partive politike, sekretar i partive politike, siç është Alfred Peza, i cili është edhe anëtar i Asamblesë Socialiste; nuk lejohet të jetë i zgjedhur kandidat për deputet apo i zgjedhur i tillë gjatë 2 legjislativave të fundit, siç ka qenë zoti Peza në legjislativën 2013-2017; nuk lejohet të jetë një person që ka në pronësi pjesë kapitali apo aksione të shoqërive tregtare apo të drejta të tjera në fushën e transmetimeve audiovizive, reklamës apo përmbajtjes së transmetimeve audiovizive, por zoti Peza është pronar i portalit “AlpeNews”; nuk lejohet të jenë persona të punësuar gjatë vitit të fundit në organe të tilla të transmetimit audioviziv apo këshillues të këtyre subjekteve, por deri para disa muajve Alfred Peza

ka qenë drejtor i medias “Panorama”. Pra, Alfred Peza i prek të gjitha shkeljet: drejtor i një media që nuk duhet të ishte gjatë vitit të fundit, pronar i një media tjetër, si “AlpeNews”, që nuk duhet të ishte anëtar i deklaruar i Partisë Socialiste, që nuk duhet të ishte ish-deputet i Partisë Socialiste, që nuk duhet të ishte...

Kjo është një zgjedhje në vazhden e zgjedhjeve për të kapur institucionet e këtij vendi, për të kapur medien, për të vendosur një ERTV 2, 3 dhe 4 për ta kthyer Radiotelevizionin Shqiptar në një mekanizëm të punësimeve politike dhe për ta forcuar atë në kapjen politike. Zoti Peza ka qenë zëdhënës i Partisë Socialiste, siç ka qenë edhe kryetarja e AMA-s.

Nëse ju i bëni ligjet për t’i shkelur dhe për të vendosur mashat tuaja atje, më mirë ta ndryshojmë ligjin nr. 97/2013 duke i hequr të gjitha kushtet për papajtueshmëri, në mënyrë që ju të mund të vendosni në ato poste ish-deputetët dhe ish-ministrat. Pra, ose ndryshoni ligjin ekzistues, meqenëse i keni votat, ose mos e shkelni. Ne jemi të detyruar që këtë çështje ta ndjekim edhe në gjykatë. Është e papranueshme që Radiotelevizioni Publik Shqiptar, i cili mbahet nga taksat e qytetarëve, të kapet në shkelje flagrante të ligjit.

Një javë më parë, kur Këshilli Drejtues ishte në Komisionin e Medies, unë u thashë se do të zgjidhin në mënyrë të paligjshme një Alfred, një njeri politik. Gjithashtu, u thashë të mos presin që këta njerëz, të cilët do t’i zgjedhin në mënyrë të paligjshme, ta qeverisin dhe ta menaxhojnë Radiotelevizionin në mënyrë të ligjshme, sepse siç janë zgjedhur, ashtu edhe do të sillen, me të njëjtën paligjshmëri, se atë kanë kutin e tyre.

Sigurisht, lidhjet e shumëfishta dhe mbyllja që ju i bëtë çështjes që ai kishte në SPAK si gazetar apo deputet miliarder, e kanë favorizuar në kapjen që i keni bërë personit në fjalë për t’i shërbyer verbërisht kësaj qeverie dhe këtij Kryeministri, por kjo nuk është arsye që e njeh ligji. Ligji ka kushtet cili duhet të jetë dhe cili nuk duhet të jetë drejtor, të cilat zotëria i shkel të gjitha. Ka edhe një moral kjo gjë. Ju keni shumë njerëz, të cilët mund t’i vendosnit atje për ta kapur politikisht institucionin, por nuk e kuptoj pse e kapni në mënyrë kaq flagrante dhe në shkelje të ligjit. Kjo është një metodë për të treguar që ju nuk pyesni për shtetin ligjor.

Të njëjtën gjë po bëni edhe me marrëveshjen që kemi sot për diskutim. Unë kam qenë anëtare e komisionit hetimor për inceneratorët. Si mund të flasim sot për sukses të inceneratorëve, ndërkohë që një ish-ministër dhe një ish-deputet janë në burg, kur të tjerë zyrtarë të lartë janë në burg, kur Partia Demokratike ka vërtetuar dhe ka çuar në SPAK të gjithë kupolën drejtuese të shtetit për veprime dhe mosveprime të qëllimshme për të çuar para tek inceneratorët që nuk ekzistojnë?

Në qoftë se në Fier do të shikoni një bunker, në Sharrë do të shikoni një fushë me lule, e cila paguhet për incenerator. Nga ana tjetër, e njëjta fushë merr fonde edhe nga Ministria e Bujqësisë si fermë, por më të njëjtin administrator, i cili diku shfaqet si administrator i inceneratorit të Tiranës, kurse te Frida shfaqet si administrator ferme. Unë jam shumë e sigurt që do t'ia dëgjojmë krismën kësaj çështjeje, se nuk mund të talleni në këtë mënyrë dhe të vidhni kaq hapur fondet e Bashkimit Europian. Ndërkohë që fermerët e ndershëm të këtij vendi nga qarku i Fierit, qarku i Vlorës dhe nga të gjitha qarqet e tjera nuk arrijnë të marrin dot asnjë subvencion të vetëm, fantazmat në mes të Tiranës marrin paratë që u takojnë fermerëve. E vetmja gjë e vërtetë është fusha me lule, ndërkohë që duhej të ishte një incenerator. Pra, taksapaguesit e Shqipërisë paguajnë për një incenerator që nuk ekziston. Çdo ditë nga taksapaguesit shqiptarë paguhet 86 mijë euro për menaxhimin e mbetjeve të Tiranës, për incenerimin e tyre, se është kosto akumulative, por, në fakt, inceneratori nuk ekziston dhe janë krijuar male me plehra.

Ju po sillni sot një marrëveshje për të na treguar se si do të menaxhohen mbetjet, ndërkohë që modeli i vetëm që kemi, është ai i administratorëve në arrati, i ministrave në hetim dhe i ish-ministrave në burg.

Çdo gjë tjetër që thuhet për modele është e kotë, sepse modeli i vetëm është shkelja në mënyrë flagrante e ligjit; vjedhja e taksave të shqiptarëve dhe mosndalimi i kësaj edhe kur ne dhe organet e kanë faktuar se po bëhet një vjedhje. Ju vazhdoni t'i paguani administratorët në kërkim. Mirel Mërtiri dhe Klodian Zoto janë në kërkim, kurse ju u kaloni paratë në konton bankare.

Çfarë logjike ka kjo në një shtet ligjor? Si nuk mund ndalohen pagesat çfarëdolloj gjëje që të ndodhë? Kjo është një kontratë antishqiptare,

sepse paratë, në fakt, shkojnë në *offshore*. Paratë kanë destinacion final këta që duhej të ishin këtu, të cilët nuk rrinë këtu sa herë diskutohen marrëveshje për paratë e shqiptarëve dhe afera se ku do të shkojnë taksat e radhës. Janë para të marra borxh, hua, quaje si të duash, të cilat mund të vireshin në shërbim të qytetarëve, jo duke i vjedhur qytetarët dhe duke mos u dhënë pas asnjë shërbim, sepse inceneratorët që ju propaganduat nuk ekzistojnë.

Çdo gjë që ju thoni sot dhe çdo votë pro që jepni, tregojnë se ju jeni pro vjedhjes dhe vazhdimit të grabitjes së taksave të qytetarëve shqiptarë. Sigurisht, ne jemi kundër dhe do të jemi gjithmonë kundër.

Shumë faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjala për zotin Edmond Spaho.

Të përgatiten zoti Tritan Shehu dhe më pas zoti Bujar Leskaj.

Edmond Spaho – Faleminderit, zonja Kryetare!

Kam ndjekur me vëmendje diskutimet e kolegëve të mazhorancës, midis tyre edhe të kryetarit të Komisionit për Ekonominë dhe Financat, i cili iu drejtua opozitës duke e pyetur: “A mund të më jepni qoftë edhe një shembull të vetëm të kontributit të opozitës në trajtimin e mbetjeve të ngurta?”. Madje, kjo lloj retorike sundoi edhe në debatin që bëmë për këtë çështje në Komisionin e Ekonomisë, duke u përpjekur ta cilësojë opozitën si simbolin e ndotjes së këtij vendi.

Po i them zotit Shalsi që t'ia lexojë mirë letrat për të cilat flet. Unë nuk besoj që ai nuk e njeh shkrimin dhe këndimin, por, po i lexove politikisht, do të arrish vetëm tek ato konkluzione të gënjeshtërtat, sikurse e tha ai.

Impianti i parë për trajtimin e mbetjeve të ngurta me metodën e riciklimit në Shqipëri është ndërtuar nga qeveria e Partisë Demokratike në Bushat dhe vazhdon të jetë ende sot e kësaj dite impianti më modern në Shqipëri.

E dyta, kjo strategji me të cilën po na vini sot, është hartuar në vitin 2010 dhe është financuar nga Bashkimi Europian, por ju e hodhët poshtë. Bile, edhe landfilli në Maliq fillimet i ka në strategjinë dhe projektin e Partisë Demokratike për ndërtimin e landfilleve në të gjithë Shqipërinë dhe për aplikimin e metodës së riciklimit.

Kam frikë se nuk do të jetë e vërtetë që do t'i riktheheni metodës së riciklimit dhe pretendimit për të ndërtuar 10 landfille në të gjithë Shqipërinë. Zoti Pëllumbi tha që, sipas vendit bëhet edhe kuvendi, pra, në varësi të specifikave, do të ndërtohet me riciklim, me incenerim ose me diçka tjetër, por kjo nuk është e vërtetë. Në fakt, projekti flet për 10 landfille me riciklim në të gjithë Shqipërinë, por nuk do të ndërtohen 10, sepse në Elbasan dhe Fier e keni bërë gjëmën: janë dy inceneratorë që nuk janë vënë në punë. Kjo është e vërteta, kurse çfarë duam t'i themi publikut është tjetër gjë. Pra, ky projekt parashikon ndërtimin e 8 landfilleve për një periudhë shumëvjeçare, nëse do të zbatohet, sepse dëgjova se këta 50 milionë euro do të jenë borxh për inceneratorët. Larg qoftë e nuk është kështu!

Pra, duhej të kalonin 10 vjet nga viti 2013, kur ju erdhët në pushtet, për të kuptuar se mbetjet e ngurta në Shqipëri duhet të riciklohen, sepse kjo është direktivë e Bashkimit Europian. Kur ne jua thoshim këtë gjë në vitin 2014, kur filluat ndërtimin e inceneratorit të Elbasanit, nuk na besuat dhe na etiketuat jashtëzakonisht keq. Madje, për të justifikuar ndërtimin e inceneratorëve dhe për të treguar se gjendja është katastrofike, nxorët ushtrinë rrugëve. Pra, ushtria e NATO-s mblidhte plehrat me shkop rrugë më rrugë të Shqipërisë.

Sot është koha t'u shpjegoni qytetarëve shqiptarë: pse po kaloni nga incenerimi në riciklim dhe a keni ndonjë përgjegjësi për të gjitha ato para që janë harxhuar gjatë këtyre 10 vjetëve? 470 milionë euro parashikohen për 3 inceneratorët. Disa kolegë të mazhorancës më kundërshtuan për këtë shifër duke thënë që e shtojmë ne. Po paguhen lekët dhe kështu do të vazhdojë, sepse Kryeministri thotë që nuk e prish dot kontratën për shkak se e çojnë në arbitrazh. Pra, ata po i marrin dhe do të vazhdojnë t'i marrin paratë, megjithëse kanë 2 vjet në arrati.

Kur është kjo logjikë, pse e prishi atë kontratën e Beketit, dhe na detyron sot të paguajmë 110 milionë euro?

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Beketi të çoi në arbitrazh dhe ti do të paguash për mbylljen e televizionit 110 milionë euro, dhe ka filluar të t'i marrë prej kohësh.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, çfarë tregon e gjithë kjo eksperiencë 10-vjeçare? Kjo tregon një fiasko totale të

projektit të Edi Ramës me inceneratorët, fiasko totale, nuk po them të projektit të qeverisë, as të projektit të mazhorancës, sepse është projekti i Edi Ramës. Ai vetë e ka iniciuar dhe ka insistuar që të realizohet. Fiasko është në konceptin e modelit që përdori inceneratorët, që nuk përdoren në Evropë.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Po, ka inceneratorë në Europë, por janë ndërtuar para 50 vjetësh, para 40 vjetësh, para 30 vjetësh, por nuk lejohet më të ndërtohen të rinj. Pse? Sepse modeli, që predikon direktiva e BE-së, është riciklimi; ka edhe dokumente që është kundërshtuar projekti i Edi Ramës nga BE-ja. Është edhe një fiasko e madhe korruptive; fiasko e madhe! Njerëzit sot i keni në burg dhe, pavarësisht hetimeve sipërfaqësore duke mos e vënë gishtin te përgjegjësi kryesor, ky ka rezultuar tashmë (dhe të gjithë e kanë të qartë dhe janë të ndërgjegjshëm) se është një nga projektet më korruptive që janë realizuar në Shqipëri. Kush përfitoi nga kjo histori 10-vjeçare, 470 milionë euro? Fitoi Mirel Mërtiri, Klodian Zoto, Stela Gugallja, por edhe Edi Rama. Mos na thoni pastaj se nuk ka përfituar, se do t'i ulnit inteligjencën, sepse Edi Rama nuk është as naiv, as budalla që t'ia rrëshqasësh ujin nën rrogos kaq keq me 470 milionë euro dhe të mos e marrë vesh, sepse ai të kupton për 470 lekë, jo për 470 milionë euro.

Edhe hetimet që po bën SPAK-u, e thashë edhe më sipër, janë hetime sipërfaqësore, sepse nuk ndodh që 17 vendime të Këshillit të Ministrave të miratohen në një ditë të vetme me urdhrin e Lefter Kokës, sepse nuk ka tagër, nuk ka fuqi të urdhërojë ministrat e tjerë të paraqesin projektvendime në qeveri. Madje, edhe sikur ta kishte këtë mundësi, dhe lidhje kaq të gjëra shoqërore, Kryeministri do ta pengonte. Çfarë është kjo, në një ditë 17 vendime të Këshillit të Ministrave?! Mos janë vendime si ato simitet në furrë që dalin paf-paf-paf? Kështu që, ju lutem, mjaft me lëvdata, rrahje gjoksi, se keni gjithë ditën që po i bëni, së paku duhej të vinit të turpëruar që pas 10 vjetësh hoqët dorë nga modeli që ju doli një aferë e plotë korruptive. Por këtu është një mazhorancë që as mëson, as reflekton, as ndryshon, vazhdon në atë që në këtë vend çdo gjë ka filluar në 2013, kur erdhi Edi Rama, se edhe dielli filloi të ndriçojë në vitin 2013 kur erdhi Edi Rama, dhe vazhdojnë e i marrin paratë zotërinjtë, pavarësisht se çdo gjë e keni ndryshuar. Nëse me

të vërtetë jeni për atë që duhen ricikluar mbetjet, së paku mos i jepni paratë, ndërpriteni paratë për Stelën, Mirelin për Klodianin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion, mos ia jepni paratë! Janë pothuaj 90 mijë euro në ditë që u jepni atyre; 90 mijë euro në ditë. Po të them, shiko të fundit se 40 milionë lekë Ministria e Kulturës apo e Turizmit i dha para 3 ditësh.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lindita Nikolla – Fjala për zotin Bujar Leskaj.

Po, zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – Zoti Spaho, faleminderit që ma përmende emrin, sepse më dhe mundësinë të them përpara të gjithëve që na ndjekin se as atë strategji, që e keni aprovuar vetë, nuk e ke lexuar, ose, të paktën, nuk e ke kuptuar fare.

A e di, zotëri, se çfarë është riciklimi? Ja, po ta them, nuk riciklohet lëvozhga e bananes, lëvozhga e bananes depozitohet në landfill, riciklohen ato materiale që janë të riciklueshme, ku hyjnë: plastika, letra, qelqi, hekuri dhe materialet e tjera që vijnë nga metalet. Këto riciklohen dhe janë në të gjitha projektet, për të cilat ne flasim, përfshirë edhe projektet, të cilave ju dhe drejtësia u dilni kundër. Edhe në Elbasan ka ndarje, sepse duhet të ketë fillimisht ndarje që të ketë riciklim, pra duhet që ato mbetje, të cilat shkojnë në një impiant të përpunimit dhe trajtimit të mbetjeve, të ndahen dhe në të gjitha impiantet që janë sot ka ndarje të mbetjeve. Në disa prej tyre ky projektligj që diskutojmë sot, do të shtojë pikërisht edhe procesin e ndarjes së mbetjeve, sepse, po nuk u ndanë, nuk ke mundësi t'i riciklosh.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ke mundësi t'i riciklosh. Përse i ndan ti atëherë mbetjet në impiante, nëse nuk i çon në riciklim? Do të thotë që qoftë në strategjinë tuaj, qoftë në këto kontrata, të cilat ju i keni goditur dhe që mund të kenë realisht elemente korruptive, për të cilat po heton drejtësia, ju nuk mund të thoni se nuk ka ndarje dhe ato materiale që ndahen, nuk shkojnë në riciklim, sepse është në interesin e atij që i ndan këto materiale t'i çojë në riciklim, se merr të ardhura.

Ajo që unë u përpoqa të thosha në fjalën time, është që pikërisht këtë kosto ne mund ta ulim, në rast se këtë ndarje e bëjmë ne qytetarët në shtëpitë tona dhe nuk paguajmë njerëz

apostafat në këto qendra për të bërë ndarjen. Po nuk u bë ndarja, nuk ka riciklim. Këtë ka pasur strategjia juaj dhe kjo është duke u bërë. Ky investim për të cilin ne flasim sot, bën pikërisht që atje ku nuk e kemi ndarjen, të mund të bëjmë edhe riciklimin në disa zona të caktuara. Kjo nuk ka të bëjë as me incenerimin, as me landfillimin, është procesi i parë që bëhet në çdo stacion të depozitimit të mbetjeve kur mbërrin mbetjet nga qytetet.

Lindita Nikolla – Ju mbaroi koha, zoti Pëllumbi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani replikë mbi replikë nuk ka. Ju e dini këtë gjë. Ia thoni veçmas zotit Pëllumbi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, ka ardhur zoti Tritan Shehu. A do ta merrni fjalën, zoti Tritan?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ishte para jush në listën e diskutantëve zoti Tritan, por nuk ishte këtu kur thashë emrin tuaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mirë, atëherë zoti Leskaj.

Bujar Leskaj – Unë kam respekt jo vetëm për moshën, por kam respekt edhe për kontributin politik dhe intelektual të zotit Shehu. Zonja Kryetare, mund ta marrë fjalën zoti Tritan Shehu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Normalisht, si vend në zhvillim e sipër, ne kemi nevojë për kredi të buta zhvillimi, të bazuara në një vullnet të qartë politik për ndryshim, në plane strategjike të koordinuara dhe të përcaktuara mirë, si edhe në plane konkrete pune për zbatimin e tyre.

Në kushte të tjera të ecurisë së Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve të ne, do ta kisha përshëndetur ratifikimin e marrëveshjes së huas së butë në vlerën 50 milionë euro ndërmjet Republikës së Shqipërisë (huamarrësi) dhe KFW-së, (huadhënësi), për programin për menaxhim të qëndrueshëm dhe miqësor me klimën në sektorin e mbetjeve të ngurta, por jam i detyruar të shprehem kundër këtij ratifikimi, për shumë e shumë arsye.

Së pari, ju, përfaqësues të mazhorancës, nuk keni bërë një analizë, një transparencë të plotë për veprimtarinë, për strategjinë, për implementimin që ju keni bërë në këtë 10-vjeçar, sa i përket trajtimit të këtij problemi. Ju, sapo morët pushtetin në shtator të 2013-s, e snobuat dhe sabotuat qëllimisht Strategjinë Kombëtare të

Menaxhimit të Qëndrueshëm të Mbetjeve 2007-2013, që patët trashëgim. Brenda një periudhë të shkurtër kohe, ju e zëvendësuat atë me planet famëkeqe të ndërtimit të inceneratorëve në Tiranë, në Fier dhe në Elbasan, gjoja në kushtet e emergjencës kombëtare të pastrimit, në kundërshtim të plotë dhe flagrant me qasjen miqësore me mjedisin të Bashkimit Europian dhe me Direktivën 2008/98/ të BE-së për menaxhimin e mbetjeve. Vetë, në atë kohë, specialistët e GIZ-it gjerman dhe të Bankës Shtetërore Gjermane për Zhvillim, KfW, janë shprehur se ndërtimi i tre inceneratorëve nuk ishte qasja e duhur në menaxhimin e qëndrueshëm dhe miqësor me mjedisin të mbetjeve.

Pasi u angazhuat ethshëm tek inceneratorët, me abuzime skandaloze dhe dëm ekonomik mbi buxhetin e shtetit dhe për buxhetet e tri bashkive Tiranë, Fier dhe Elbasan, sot dhe në të ardhmen, ju po angazhoheni të merrni një kredi për të mbuluar aktivitete që i ka për detyrë një kontratë tjetër koncesionare, 3 kontrata, të paktën për Bashkitë e Tiranës dhe Durrësit, që keni në programin që bazohet mbi kredinë e butë të KfW-së. Pra ju po merrni një kredi për të blerë pajisje furnizimi, makineri grumbullimi dhe transporti për mbetjet e ngurta të Tiranës dhe Durrësit, ndërkohë që Bashkia e Durrësit dhe Bashkia e Tiranës kanë kontratën koncesionare me inceneratorin e Tiranës, pikërisht për detyra të tilla. Ju pyes: përse këto dy bashki duhet të përfitojnë nga kredia dhe të realizojnë programe për menaxhimin e qëndrueshëm dhe miqësor me mjedisin të mbetjeve të tyre të ngurta, kur qytetarët e tyre tashmë paguajnë për përpunimin e mbetjeve të ngurta në inceneratorin e Tiranës tarifa mjaft të larta, madje janë të detyruar të paguajnë për to?! Pse dubloni detyrat dhe përgjegjësitë? Kush dhe cila strukturë do të mbajë përgjegjësi për këtë dublim? Se as ju, por asnjë përfaqësues i qeverisë, as ministrja përgjegjëse, nuk jepni informacion, të paktën, këtu në Kuvendin e Shqipërisë. Dhe i bie, sipas kësaj, që qytetarët e Tiranës dhe të Durrësit, më së paku, do të paguajnë në taksat e pastrimit dhe të mbrojtjes së mjedisit dy herë për të njëjtin shërbim. Kjo gjë nuk ndodh në asnjë qytet dhe në asnjë shtet të botës.

Në dhjetë vjetët e qeverisjes suaj, ju i keni përmbysur për keq ligjet për menaxhimin e mbetjeve, duke mos zbatuar strategjinë e BE-së

për mbetjet urbane. E pse ne sot duhet t'ju besojmë juve, se do të keni korrektësi në trajtimin e kësaj huaje, se do të ktheni rrugë dhe do të ndryshoni qasje?!

Në periudhën 2014-2023, ju arritët që: sistemet për grumbullimin dhe heqjen e mbetjeve të ngurta t'i kemi të pamjaftueshme dhe joefektive në rang republike; vendimet për mbledhjen dhe heqjen e tyre të merren në mungesë të një informacioni të besueshëm; të mos lini një traditë të mirëfilltë për trajtimin dhe heqjen e mbetjeve të ngurta; t'i lini bashkitë me burimet financiare dhe teknike të pamjaftueshme dhe qytetarët t'i lini me mungesë të theksuar informacioni sa i përket rrezikut që shkaktohet nga administrimi i dobët i mbetjeve të ngurta, praktikë të cilën ju po e vazhdoni edhe sot duke paraqitur këtë hua në kushte të mungesës së plotë të transparencës.

Shkurt, sipas mendimit tim, ju keni dështuar tërësisht, pasi:

1. Nëpërmjet kontraktimit të operatorëve ekonomikë privatë për menaxhimin e mbetjeve urbane për periudhën 2014-2023, deri tani nuk keni arritur të plotësoni asnjë objektiv të qenësishëm në drejtim të shërbimit të popullatës dhe ruajtjes së mjedisit në territoret përkatëse të bashkive.

2. Dhjetë vitet e qeverisjes suaj ju gjejnë me një kuadër rregullator të papërditësuar në zbatim të strategjisë kombëtare dhe akteve ligjore bashkëkohore të miratuara, dhe, për rrjedhojë, me objektiva të paqarta e të papërcaktuara mirë.

3. Gjithashtu, ju gjejnë me një edukim publik me mangësi të theksuara dhe të pamjaftueshëm në drejtim të rritjes së ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrjes së komunitetit në menaxhimin e mbetjeve të ngurta, nga ana e strukturave të bashkive dhe operatorëve ekonomikë. Për rrjedhojë, ky edukim i ndërmarrë nga ju, ka dështuar plotësisht të japë një impakt të ndjeshëm social për mbajtjen pastër të qyteteve tona dhe për ndarjen e mbetjeve në burim për riciklim.

4. Keni dështuar edhe në qasjen e "qeverisjes me pjesëmarrje" që duhej realizuar në përputhje me direktivat e BE-së, në procesin e vendimmarrjes për menaxhimin e mbetjeve urbane, duke miratuar nxitimthi në një mbledhje qeverie me dhjetëra vendime për menaxhimin e këtyre mbetjeve në nivel të bashkive.

5. Keni lejuar që pothuajse të gjitha venddepozitimet e mbetjeve në qytetet tona kryesore të mos plotësojnë kushtet e një landfilli bashkëkohor, me parametra të lartë mjedisore. Landfilllet, po ashtu, kanë tejkaluar afatin e përdorimit dhe kapacitetet e përpunimit.

6. Keni dështuar në koordinimin me pushtetin vendor për një veprimtari efektive mbikëqyrëse dhe kontrolluese të bashkive të qyteteve kryesore, në drejtim të realizimit të detyrimeve kontraktore nga operatorët ekonomikë, për shërbimin e grumbullimit dhe largimit të mbetjeve të ngurta. Për rrjedhojë, nuk keni arritur përmirësimin e cilësisë së shërbimit të pastrimit të qyteteve tona kryesore dhe realizimin e objektivave strategjikë dhe të pritshmërisë së qytetarëve.

7. Mungesa e një strategjie të unifikuar të menaxhimit të mbetjeve të ngurta në nivel kombëtar dhe kjo diskordancë që ju keni në këta 10 vjet, dhe në nivel të bashkive kryesore ka ndikuar në menaxhimin e mbetjeve me një infrastrukturë të dobët, të pambyllur, larg zbatimit të kuadrit ligjor për ndarjen në burim të mbetjeve e të tjera.

Sa i përket një debati që u zhvillua pak më parë këtu, më duhet të theksoj se me një politikë të gabuar në dhënien e lejeve mjedisore për pikat e grumbullimit të mbetjeve të riciklueshme, ju keni mbyllur shumë prej tyre duke gjeneruar edhe një problem të mprehtë social, pasi në këto pika, për hir të së vërtetës, vinin me qindra të vetëpunësuar nga shtresat më të varfra të shoqërisë, që i çonin mbetjet e grumbulluara në qytet, që i mblidhnin, ndërkohë që pikat e grumbullimit shërbenin si lëndë e parë për kompanitë e riciklimit. Me mbylljen e shumicës prej tyre, duke mos iu rinovuar lejet mjedisore, industria e riciklimit të Shqipëri mori një goditje dhe shumë nga sipërmarrësit e kësaj industrie, që kishin investuar te ne, i shpërngulën fabrikat e tyre në Maqedoninë e Veriut, e cila ka një legjislacion shumë më miqësor dhe përkrahës të industrisë së riciklimit.

Së fundi, në vend që të marrim kredi për të dubluar përgjegjësitë dhe detyrat e kontratave ekzistuese me koncesionarët privatë, ne duhet të përgatisim dhe të zbatojmë një strategji të vërtetë reale kombëtare dhe plan konkret veprimi në nivel të çdo bashkie, për menaxhimin e qëndrueshëm dhe miqësor me mjedisin të mbetjeve të ngurta.

Qeveria qendrore duhet të synojë, të kontribuojë dhe të ndihmojë në menaxhimin e bashkive, sidomos atyre kryesore të vendit, që kanë probleme të mprehta të trajtimit të mbetjeve të ngurta.

Faleminderit!

Lindita Nikolla - Fjala për zonjën Kryemadhi. Të përgatitet zoti Vasili.

Monika Kryemadhi – Faleminderit, zonja Kryetare!

Është parashikuar marrja e huas nga qeveria shqiptare, që do të mundësonte financimin e ndërtimit të infrastrukturës së menaxhimit të integruar të mbetjeve, sipas nevojave të identifikuar gjatë hartimit dhe studimit të fizibilitetit për zonat e mbetjeve në Dibër, në Tiranë, në Durrës dhe në Berat dhe në zonat veriore të rajoneve Vlorë dhe Korçë. Pra, konkretisht janë parashikuar 6 zona.

Në këtë marrëveshje, e vetmja gjë që më bën konfuze, sepse nuk kam çfarë të them për Dibër, për Beratin, as për Korçën apo për Vlorën, pavarësisht se nga mënyra se si është planifikuar menaxhimi i mbetjeve bëhet jo vetëm nga pushteti vendor, por edhe nga Ministria e Mjedisit, e cila mbikëqyr menaxhimin e mbetjeve të ngurta, por edhe të shumë problematikave të tjera që kanë, pra e vetmja gjë që më bën konfuze është pika 2, ku thuhet: “Tiranë-Durrës, ndërtimin e stacioneve të transferimit të mbetjeve dhe impiantit të ndarjes së mbetjeve të ngurta nga ato të riciklueshme; landfill për mbetje inerte; rehabilitim dhe mbyllje e venddepozitimeve ekzistuese të mbetjeve”. Pra, konkretisht janë zërat e ndarjes së mbetjeve të ngurta nga ato të riciklueshme dhe landfill për mbetje inertesh. Këto janë nga relacioni, i cili vjen nga ministritë përkatëse.

Faktikisht, kjo fjali më është bërë si lutje, të cilën e kemi mësuar përmendësh, sepse është lexuar dhe stërlexuar, është thënë dhe stërthënë dhe është pika që është përsëritur me shumë në kontratën me nr. prot. 6597, datë 31.08.2017 “Kontrata për ndërtimin e landfillit të inceneratorit dhe rehabilitimin e venddepozitimeve ekzistuese në Tiranë”. Parashikimi i projektit kërkon investim nga koncesionari në vlerën 128 milionë euro. Në këtë kontratë, për të cilën kjo hua, e cila është 50 milionë euro, por shtu edhe bishtat e tjerë, që shkojnë nja 17 milionë, shtu edhe shpronësimet, shtu edhe TVSH-në e të tjera, pra kalon mbi 80

milione euro, bazuar në aneksin 8, “Parashikimi i projektit teknik”, në pikën 1, “Parashikimi teknik i instalimeve të parashikuara”, nuk po jua lexoj lotin A, por po shkoj te loti B “Landfilli i mbetjeve të ngurta urbane”, po shkoj te loti D “Impianti i riciklimit dhe stabilizimit”, pra, të nderuar kolegë, nuk po merrem fare me zonat e tjera, nuk po merrem as me blerjen e makinerive, sepse 50 milionë euro për 2 apo 3 makina për Bashkinë e Dibrës apo për 10 makina për Bashkinë e Beratit, nuk mendoj se shkojnë 50 milionë euro, duke pasur parasysh që vetë pika 2 e relacionit parashikon “Blerje mjeteshe për Bashkinë e Tiranës” (Po ju kujtoj “ECO Tiranën”, e cila është një kompani që menaxhohet 51% nga Bashkia e Tiranës dhe 49% nga kompania italiane), më pas buxheti, i cili paguhet nga taksapaguesit, qytetarë të Tiranës, që është për pastrimin dhe grumbullimin e mbetjeve në Tiranë dhe për diferencimin apo ndarjen që bëjnë në burim qytetarët, për të mos dalë më pastaj te çmimi i famshëm 29 euro për ton, i cili është depozitimi apo djegia, sipas kontratës së lartpërmendur pak më parë.

Ajo që të bën përshtypje është (edhe pse ky proces vazhdon të jetë nën mbikëqyrje, nën kontroll, nën investigim, nën hetim, nën vëzhgim apo edhe si të doni ju), se guximi kalon çdo normë dhe se ne vazhdojmë akoma të paguajmë 29 euro për ton për depozitim, pra për kapsulim të mbetjeve në landfillin e Tiranës, kur, në fakt, në kontratë është ndarje, diferencim, riciklim, pastaj djegie dhe groposje. Përveç kësaj, paguajmë edhe shumë pagesa të tjera që vijnë nga kompanitë e ndërtimit, qoftë për inertet, për dherat apo edhe shumë kompani të tjera që i bashkëngjiten, si: bashkitë e Durrësit, Kavajës, Vorës, Rrogozhinës, Kamzë e kështu me radhë.

Ajo që të bën përshtypje është se për këtë projekt duket sikur është kapur për fyti Edi Rama dhe kompanitë e inceneratorëve, pra Mirel Mërtiri, Klodian Zoto apo edhe kolegët që janë sot në burg, e kërcënojnë Edi Ramën, duke i thënë: ose vazhdo, ose ne do të flasim. Për dy inceneratorët e sekuestruar, të Elbasanit dhe të Fierit, dua t’i korrigjoj pak kolegët, që nuk janë pronë e Klodian Zotos, por janë pronë e shtetit shqiptar, qoftë inceneratori i Elbasanit, qoftë inceneratori i Fierit, sepse Klodian Zoto, Mirel Mërtiri dhe Stela Gugallja kanë bërë ndërtimin dhe kanë marrë paratë. Mirel Mërtiri është pronar

i koncensionarit, sepse tashmë merret edhe me televizione. Koncesionari i Tiranës, është një institucion që merr minimumi 100 mijë euro në ditë nga xhepat e shqiptarëve, të cilat shkojnë në një kompani *offshore* pa ditur se ku përfundojnë. Inceneratorët e Elbasanit dhe të Fierit, janë institucione, të cilat janë ndërtuar dhe tashmë duhet të administrohen nga bashkitë përkatëse, por edhe pse nuk kanë punuar asnjë ditë, janë paguar. Pavarësisht nga kjo, bashkitë përkatëse janë përballur tashmë me administratorin (besoj se e keni marrë vesh që administratori i inceneratorit të Fierit ka dyfishuar çmimin e depozitimit të mbetjeve për Bashkinë e Fierit, ndërkohë që punëtorët atje kanë muaj të tërë që nuk marrin rrogat), sepse inceneratori nuk është vënë në punë për shkak se paketa e djegësve nuk është montuar, pasi nga kompania ndërtuese nuk është paguar kompania italiane, e cila ka instaluar djegësit. Pra, ka një kompleks të gjërave, të cilat, po të ketë një vullnet të mirë, mund të jenë vepra që mund të kthehen në funksion sa i përket administrimit të menaxhimit të mbetjeve, qofshin këto për ndarje-riciklim apo edhe për djegien e tyre.

Jam e bindur që llokma më e madhe do t’i shkojë inceneratorit të Tiranës, duke pasur parasysh që edhe “thembra e Akilit” qëndron në këtë incenerator. U përmend pak më parë që inceneratori i Tiranës fillon që me procesin ligjor të tij, me nënshkrimin e një kontrate në emër të marrjes së vendimit në Këshillin Bashkiak, pra rrëmbimin e kompetencave të Këshillit Bashkiak të qarkut të Tiranës e kështu me radhë, për të vazhduar më pas me nënshkrimin e një kontrate. Edhe pse Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka shkelur procedurat e miratimit dhe të nënshkrimit të kontratës, edhe pse është kërkuar në procesverbal firmosja ose vendimmarrja e kësaj e kontrate, miratimi i kësaj kontrate në Këshillin Bashkiak përsëri nuk është realizuar, nuk ka asnjë vendim të Këshillit Bashkiak të Tiranës sa i takon kontratës së 31 gushtit të vitit 2017, ndërsa sot na vjen një relacion nga qeveria për të marrë borxh në emër të qytetarëve të Tiranës, 50 milionë euro, për t’i çuar përsëri tek inceneratori i Tiranës.

Pra, nuk mjaftojnë 30 milionë euro nga Bashkia e Tiranës, 10 milionë euro nga Bashkia e Durrësit, presim të shohim sa janë faturat edhe nga bashkitë e tjera, të cilat kanë qenë në falimentim, sa paguhet për inceneratorin e

Tiranës, por ne sot kërkojmë që të paguajmë edhe 50 milionë euro të tjera, pa llogaritur përqindjet që do të paguajnë, interesat e shumë gjëra të tjera, për t'i çuar përsëri te inceneratori i Tiranës. Guxim idioti, mund t'ju them, sigurisht nëse do të kishim ministrat përkatës, të cilët kanë bërë propozimin për këtë aferë. Ky guxim idioti nuk më thotë gjë tjetër dhe faktikisht nuk mund të flasim më për shtet ligjor, sepse shtet ligjor kishte edhe Enver Hoxha, shteti i së drejtës këtu nuk ekziston. Po të kishte shtet të së drejtës, së pari, do të ishin ndërprerë pagesat e inceneratorit të Tiranës dhe do të ishte kthyer landfilli i Tiranës, pra Sharra e famshme, në një kompani që do të administrohej përsëri nga Bashkia e Tiranës, nga punonjës që janë qytetarë dhe taksapagues të Tiranës. Por këtu nuk ekziston as shteti i së drejtës dhe as shteti ligjor, por ekziston shteti i vjedhjes, shteti i hajdutit, ku kryehajduti është Edi Rama, i cili vjedh në mënyrën më ekselence. Tashmë nuk ka më nevojë të marrë firmat, siç e bëri me Erion Velinë për Tiranën, por i sjell në parlament, kukullat i ka që ta votojnë, ta miratojnë dhe vidhet në mënyrë ligjore një për një çdo qindarkë e qytetarëve të Tiranës.

Unë e deklaroj votën time kundër kësaj marrëveshjeje, edhe pse është me një institucion shumë të rëndësishëm, partner me vendin tonë. Të marrësh para borxh që t'ia japësh Klodian Zotos, Mirel Mërtirit dhe të gjithë enturazhit të mafies së plehrave, do të thotë që ke mbaruar çdo lloj komunikimi dhe limiti me qytetarët.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjalën e ka zoti Petrit Vasili.

Të përgatitet zoti Erion Braçe.

Petrit Vasili – E nderuar Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë,

Sigurisht që ardhja e një akti të tillë sot është, në radhë të parë e mbi të gjitha, thirrje nga ne të gjithë për një përgjegjshmëri të re lidhur me pafundësinë e parave që merren në këtë Kuvend dhe të gjitha *skuzat*, artificat dhe fshehja pas tyre është vetëm një alibi për grabitje të mëtejshme.

Këtu në këtë Kuvend kemi qenë vite më parë, kur në vitin e largët 2017 kemi denoncuar haptazi përmbysjen e piramidës së trajtimit të mbeturinave, sipas shqetësimeve jo të opozitës, por të GIZ-it, të Kooperacionit Gjerman, i cili është mbështetës edhe nga Banka Gjermane KfW,

por asnjë nuk u shqetësua, madje të gjithë duartrokitën fort e thanë që inceneratorët ishin një zgjidhje e mrekullueshme. Kjo ishte miopi, të gjithë europianët ishin gabim, e gjithë bota që mbron mjedisin, shëndetin, në radhë të parë, ndonëse nuk kam arritur ta kuptoj pse shëndeti është i fundit në radhën tuaj, se kjo ishte pikërisht një katastrofë, e cila po gatuhej me ndërjegje të plotë. U bë me kokëfortësi, u mbrojt, u financua, u vodh, këto janë realitetet, në të kundër nuk do të kishim ato procese që kemi në SPAK, ndonëse janë thjesht dhe vetëm një pickim që i është bërë problemit, pasi hajdutët e vërtetë, siç e shikoni, mungojnë edhe në Kuvend.

Normalisht, çdo qytetar do të mendonte se këtu bëhet fjalë për miliona euro, të gjithë kanë mbetur te 50 milionë eurot, por analiza e thjeshtë që bëhet, pikërisht nga relacioni i qeverisë, çfarë na tregon? Na tregon se do të financohen 50 milionë euro, që do të jenë kredi, 6,9 milionë euro të tjera janë grant për masat shoqëruuese, janë edhe 5 milionë të tjera që janë për marrëveshjen e grantit SEKO, si dhe 4,75 milionë euro të tjera. Pra, rreth 70 milionë janë vetëm në një dorë dhe askush nuk flet që janë marrë përsipër nga qeveria shqiptare kostot lokale, që kanë të bëjnë me TVSH-në dhe me shpronësimet, pra shkojmë në rendin e 85-90 milionë eurove investim.

Zonja Kryetare, a ka mundësi të mbahet qetësi?

Ndërkohë, çfarë na kërkohet? Po marr rastin e Tiranës, çfarë thotë relacioni i qeverisë.

Së pari, zona e mbetjeve Tiranë-Durrës do të ketë pikë, që do të trajtohet nga këto para, furnizimi të makinerive dhe pajisjeve për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave, si dhe pastrimin e territorit.

Së dyti, ndërtimi i stacionit të transferimit të mbetjeve, impianti i ndarjes së mbetjeve të ngurta nga ato të riciklueshme, landfill për mbetjet inerte, rehabilitim dhe mbylljen e venddepozitimeve ekzistuese të mbetjeve.

Unë e kuptoj që ju e ndani mendjen, ju jepet urdhri votoni dhe votoni, nuk e keni këtë siklet, as druajtjen dhe as turpin. Çfarë thotë kjo kontrata koncesionare, jo imja?! Në të thuhet: “Përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj kontrate, të Tiranës, asnjë entitet tjetër shtetëror, qendror apo vendor, nuk do t'i japë askujt të drejtën ta shfrytëzojë, ta përdorë dhe të përpunojë mbetjet urbane të qarkut të Tiranës apo ndërtimin e impianteve në këtë

zonë, që do të sillte si pasojë reduktimin e tyre”. E ka mbyllur, dhe të gjitha gjërat i janë dhënë koncesionarit.

Po çfarë ka pasur tjetër koncesionari të parashikuar, që i ka, për të cilat paguhet dhe merr edhe pagesa të rregullta?

Në pikën 2 të kontratës thuhet: “Me këtë kontratë nënkuptohet kapsulimi i venddepozitimit, impianti për përpunimin e ujërave të ndotura, impianti i diferencimit të mbetjeve, venddepozitimi i mbetjeve të ngurta urbane, nënstacioni elektrik e të tjera”, në fund: “venddepozitimi i mbetjeve inerte”. Sa herë do të paguajnë shqiptarët, dy herë? Ngrijeni dorën mos e kini siklet, mund të paguajnë edhe 24 herë, për ju nuk ka siklet. Po këtu janë, cila qëndron, qëndron njëra apo tjetra?

Në pikën e parë thuhet se do të blihen makineri për pastrimin e qytetit. A janë pajtuar kompanitë që e kanë për detyrë ta pastrojnë qytetin dhe kanë për detyrë pajisjen me makineri për shkak të atij detyrimi që kanë marrë edhe për inceneratorët, që plus ndërtimin paguhen afro 20 milionë euro në vit nga Bashkia e Tiranës? Kush do t’i bëjë? Do t’i bëjnë këta që morën kontratën, që marrin edhe lekët, kanë detyrim edhe t’i paguajnë, apo do të paguhen nga marrëveshja? Nuk ka mundësi të paguhen për të njëjtën gjë dy herë, apo kjo pagesa është për të mbyllur atë, që ata që morën koncesionin nuk e bëjnë dhe nuk e kanë bërë? Meqenëse nuk e kanë bërë, po u jepet një transfuzion me para të tjera. Hë se shqiptarët budallenj janë, edhe pse marrin borxh, i këpusin një votë në parlament, kjo vota është kolektive, përgjegjësia është kolektive, individuale nuk ka, jemi të mbrojtur juridikisht, është përpunuar shumë mirë ideja, kështu që hajdutllëku ndodh, por gjë nuk ka gjen! Është turp dhe mynxyrë e madhe të vidhet në këtë farë feje, sepse përcaktimet janë të shumë të qarta.

Si do t’u thoni qytetarëve të Tiranës, të cilët e dinë që edhe për sheshin “Skënderbej” është bërë tender më vete, i është dhënë një kompanie më vete që ta marrë, ta pastrojë, ta lajë e të tjera? I ka përsipër ajo, ka makinat, ka marrë edhe paratë për këtë punë. Do të blejnë makina t’ia japin asaj?! Kaq të thjeshta janë gjërat për t’ua shpjeguar qytetarëve.

Edhe teoria që ne e kemi pasur traditë të votojmë grantet e të tjera apo marrëveshjet, po, ka qenë se mbyllnin një problem, zgjidhnin një

çështje, por nuk është të legjitimojmë një vjedhje të dyfishtë, t’i themi aferim vjedhjes së dyfishtë. Pse t’i themi, është borxh, qytetarët paguajnë taksa, do të paguajnë edhe për larjen e kredisë, sepse duhet të vidhen dy herë, se ato nuk i bëjnë ata dhe të shkojmë t’i mbyllim ne.

Po mirë, në relacion thuhet, si premisë e kësaj: “Është ndërtuar dhe është në funksionim impianti për trajtimin e mbetjeve dhe prodhimin e energjisë në Elbasan dhe në proces finalizimi, ndërtimi për trajtimin e mbetjeve dhe prodhimin e energjisë në Fier”. E dinë të gjithë që Elbasani u prish pa u filluar të ndërtohej dhe u dhanë para të tjera për këtë gjë. Në Fier, e dinë që të gjithë që nuk funksionon asgjë dhe tarifa e depozitimit nga zero, që ka qenë, vajti në 12 euro. Të gjitha këto i dimë, janë sheshit, ndërsa ju thoni ne kemi kurajën dhe votojmë. Mirë, more, mirë, kjo kurajë është, por faktet janë aty, dhe këtë gjë s’e lëviz topi.

Arsyeja e mosmbështetjes së kësaj gjëje është se nuk mund të merren miliona euro të tjera borxh pa bërë transparencën e plotë për çdo lek të harxhuar e që harxhohet, ndërkohë që ne flasim me njëri-tjetrin. Si do të vazhdojë kjo çështje? Do të vazhdojmë të jemi borxh mbi borxh për të paguar me para hajdutllëkun që e mori përsipër, vajti në xhepat e të tjerëve, por nuk kreu punën? Këto janë faktet. Këtu nuk ka asgjë hamendje apo supozim. Se si trajtohen mbetjet në Tiranë, e keni parë me zë dhe me figurë! Kur kemi debatuar për këtë çështje se nuk po trajtohen, kompania koncesionare e Tiranës është hedhur përpjetë dhe ka thënë: “Ne i ndërtojmë të gjitha, bëjmë përpunimin, ndarjen e të gjitha me radhë. Deri në vitin 2030 do të jetë 100% standardi më i lartë evropian”. Ju ç’hyni në këtë mes me këtë lloj kredie?! Mirë, mund ta orientonit kredinë në një vend tjetër, që mund të ishte problematik, ndonëse këtu duhet të kishte një analizë të shkëlqyer e të detajuar se ku do të shkonte çdo lek, por kjo transparencë është dimension i ndaluar për ju. Por çfarë donte Tirana në këtë mes?! Tirana është lakuriq para të gjithëve, që nuk ekziston, që nuk bën asgjë. Ata thonë: “I kemi dalë ne për zot”. Ua kemi dhënë ne të gjitha, marrin dhe fitojnë para pa fund; i kanë marrë të gjitha ekskluzivitetet, i kanë me kontratë, të firmosura, e zeza mbi të bardhë. Ne jemi në borxh për 30 e kusur vjet. Çfarë do të themi prapë? Do të duartrokasim, që të mbajmë të pastër Shqipërinë? Po Shqipëria në vitin 2014

filloi me aksione të mëdha, doli ushtria nga të katërta anët, pastaj në vitin 2021 sërish doli ushtria. Pra, vitet shkonin dhe situata ishte në vendnumëro, se nuk të justifikon dot njeri që të dalësh në vitin 2014 dhe pas 7 vjetësh të dalësh sërish me ushtrinë! Menaxhimin e shtetit ti e ke. Je i pazoti? Je kusar? Njëra është më e keqe se tjetra. Realiteti është se e gjithë historia e mbeturinave është bërë vetëm një burim i pafund pasurimi mafioz dhe të paligjshëm.

Këto janë edhe arsyet themelore për të votuar kundër dhe për të mos i ngarkuar shqiptarët me këtë hajdutëri, që paguan dyfish: kusarët e qeverisë dhe kusarët që tashmë i quajmë “koncesionarë”.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjala për zotin Erion Braçe.

Të përgatitet zonja Flutura Açka.

Erion Braçe – Që një bankë zhvillimi si KfW-ja të nxirrte para për t'i dërguar në Shqipëri që të vidheshin, kjo është e vështirë për t'u menduar. Natyrisht, ka plot që e besojnë këtë gjë, sidomos nga ajo kategoria që vazhdimisht i thotë vetes se gomari fluturon, por që e gjitha sa dëgjuat është gënjeshtër, është e qartë dhe hapur fare. Asnjë lek nga kjo marrëveshje nuk shkon për inceneratorin e Tiranës, as për inceneratorin e Fierit dhe as për inceneratorin e Elbasanit. Kush nuk di të dallojë Tiranën nga Durrësi, natyrisht që e ka të vështirë të mendojë se paratë nuk vidhen. Është shumë e thjeshtë: sa kohë që flitet për një kontratë koncesioni për qarkun e Tiranës, dhe Durrësi është qark tjetër, pa diskutim që diferenca është shumë e qartë, aq e qartë sa, fjala bie, Gjiri i Lalëzit nuk bie në Tiranë, por në Durrës. Kjo është diferenca. Pikërisht, për këtë arsye, asnjë qindarkë e kësaj kredie nga Banka KfW nuk shkon për inceneratorin e Tiranës, përkundrazi do të shkojë për ato bashki që do të përqafojnë këtë model zhvillimi dhe trajtimi të mbetjeve urbane, përfshirë edhe mbetjet e ngurta.

A ka inceneratorë sot në vendet e BE-së dhe përtej, në vende jo të BE-së, në SHBA e të tjerë? Po, ka, madje janë në punë dhe, natyrisht, trajtojnë ato mbetje, të cilat i drejtohen incenerimit.

A bëhet incenerim sot në vendet e BE-së, përfshirë edhe fqinjët tanë, në vende përtej BE-së, pra jo të BE-së, apo edhe në SHBA? Po, bëhet incenerim, duke filluar nga Italia, që kemi në perëndimin tonë, duke vazhduar në Greqi e kështu

me radhë në çdo vend të BE-së. Incenerimi është një proces me anë të të cilit trajtohen mbetjet, siç është përcaktuar në ligjet respektive dhe në standardin e atyre vendeve.

A është incenerimi një nga alternativat në direktivën e BE-së për trajtimin e mbetjeve? Po, është një nga 7 alternativat, e shkruar e zeza mbi të bardhë, pikërisht në direktivën e BE-së, që citohet shpesh, por që asnjëherë nuk citohet korrektësisht, ashtu siç është e shkruar dhe ashtu siç përdoret në çdo vend të BE-së.

A ishin jetikë inceneratorët në momentin kur u vendos për t'i ndërtuar? Po, ishin. Praktikisht, çdo qeveri nga viti 1990 e deri te jona, kishte dështuar në trajtimin e mbetjeve, sa kohë që në periferi të çdo qyteti, që për shkak të zhvillimit, nuk ishte më periferi, por ishte thuajse në mes të zonës urbane, kishte male me mbetje, të cilave u vihej edhe zjarri, duke ndotur me një tym toksik pjesën më të madhe të qyteteve. A ishte emergjencë kjo? Po, ishte emergjencë. Nga se erdhi? Po, erdhi edhe nga kultura jonë e trajtimit të mbetjeve, por edhe nga dështimi i qeverive tona për t'i trajtuar mbetjet; shumë e qartë!

Çfarë të themi, që në Elbasan ishte lumturi e madhe të shikoje fushën e mbetjeve?!

Çfarë të themi, që në Lushnjë ishte lumturi e madhe të shikoje fushën e mbetjeve?!

Çfarë të themi ne që banonim në Kombinatin, që nga Sharra, e cila ishte atje matanë, tymi dhe aroma toksike që dilte prej andej ishte parfum për të gjithë banorët e Kombinatin e që shkonte deri te “21 dhjetori” i famshëm?!

Çfarë të themi, që *landfill*-i i Bushatit, vepra e paimagjinueshme e shokut Sali Berisha, në kohën e tij, ishte një sukses i paparë, që nuk përdorej pasi as komunat që ishin rreth e qark atij fshati, nuk binin dakord të dërgonin mbetjet atje, përfshirë Bashkinë e Shkodrës, Bashkinë e Malësisë së Madhe, Bashkinë e Pukës dhe Bashkinë e Fushë-Arrëzit?! Këto të themi?! Këtu në parlament kemi qenë kur vinin dhe ziheshin pse nuk vihej në punë *landfill*-i i Bushatit, modeli më i mirë i zhvillimit dhe i trajtimit të mbetjeve!

A ka korrupsion, në kuptimin e një akti, të një veprë të pastër penale në të gjithë procedurën ligjore dhe jo të tillë, administrative, gjithashtu, të ndërtimit të inceneratorëve? Po, ka dyshime shumë të qarta se ka korrupsion. Prokuroria e ka hetuar, ka ngritur një akuzë penale, që, sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, duhet të

aprovohej para një gjykate dhe, natyrisht, duhet t'i përfshijë të gjithë, pa përjashtim, nga i pari tek i fundit, edhe ata që janë marrë me procedurën, edhe ata që kanë qenë ngjitur, si miza pas këpucës, gjatë gjithë procesit të inceneratorëve, se, për të thënë të drejtën, kjo pjesë mungon në atë hetim; për të thënë të drejtën, çfarë nuk lexojmë e çfarë nuk dëgjojmë, se sa afër kanë qenë pikërisht ata që bërtasin më shumë se kushdo në sallën e parlamentit dhe jashtë saj, si denoncuesit e mëdhenj të aferës korruptive të inceneratorëve! Kur them "afër", nuk kam parasysh afërsi një metër, një metër e gjysmë apo dy metër, por të ngjitur fare, për të marrë atë që u takonte me demek nga lobimi për këtë histori.

Kështu që është shumë e rëndësishme që nga salla e Kuvendit të përcillet një mesazh shumë i qartë për ata që e kanë për detyrë të merren me aktet apo me veprat penale, me prokurorët apo me gjyqtarët, për të bërë drejtësi nga "A"-ja, te "Zh"-ja, sepse unë besoj fort se një politikë, sado e mirë që të jetë, po nuk pati përputhje me ligjin dhe ndershmërinë në zbatimin e saj, patjetër që do të dështojë. Në këtë sallë parlamenti jua kam vërtetuar disa herë rresht se politika shumë të mira dështojnë për shkak të veprimeve të pamjaftueshme, angazhimit të pamjaftueshëm të çdo lloj agjencie dhe organizmi, përfshi edhe agjencitë qeveritare për t'i zbatuar ato, natyrisht, edhe për shkak të korrupsionit.

Çfarë është kjo marrëveshje? Kjo marrëveshje është një model shumë i mirë, që na ofrohet e financuar për të gjitha ato bashki që do të bëhen pjesë e këtij modeli. Në gjykimin tim, është e paplotë, sepse unë mendoj se trajtimi i mbetjeve tashmë duhet të ikë nga tenderat e kontratave të tenderuara për të bërë pastrimin e qyteteve apo edhe fshatrave me sipërmarrje. Deri tani ky model, modeli i kontratave të tenderuara ka dështuar, nuk i ka bërë më të pastra qytetet tona, përkundrazi, ka shembuj shumë të qartë se në ato bashki, ku shërbimi i grumbullimit dhe i pastrimit të mbetjeve kryhet si shërbim publik nga vetë bashkitë, qytetet janë më të pastra. A duhet mbështetur ky model? Po, duhet mbështetur. A duhet unifikuar ky model nga Tropoja deri poshtë në Konispol, duke ua ofruar këtë shërbim edhe fshatrave, që janë një problem shumë i madh, ku nuk mbërrin koshi, ku nuk mbërrin makina e pastrimit? Po, duhet unifikuar. Ky model nuk duhet të fillojë nga mesi, por duhet të fillojë nga

fillimi, atje ku, patjetër, çdo bashki duhet të ketë ndërmarrjen e saj publike, që merret me grumbullimin e mbetjeve e pastaj vazhdon me stacionin e ndërmjetëm të trajtimit të mbetjeve atje, me atë fabrikën e riciklimit, që duhet të shpërndajë të ardhura në çdo bashki e jo thjesht të jetë vetëm një ndërmarrje fitimprurëse atje ku është krijuar e, në fund fare, edhe në *landfill*. Në qoftë se nuk bëhet nga "A"-ja te "Zh"-ja, përsëri do të dështojë dhe, në qoftë se nuk është publike nga "A"-ja te "Zh"-ja, duke eliminuar edhe tenderat për kontratat me sipërmarrje për grumbullimin e plehrave, natyrisht që nuk do të bëjë gjënë e duhur.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjala për zonjën Aça.

Flutura Aça – Faleminderit, zonja Kryetare!

M'i hëngrët, më duket, disa sekonda!

Kur dëgjon zotin Braçe, ç'është e vërteta, të merr malli të bëhesh socialist; më pas, kur dëgjon zotin Shalsi, të vjen turp edhe të jesh demokrat, sepse, në fakt, zotin Shalsi e dëgjova 7 minuta që u mor me ne të opozitës, ndërkohë që duhet të shikojë që malet me mbetje në Elbasan kanë shkuar deri në Shalës, ç'është e vërteta.

Zonja Kryetare, unë do të merrem me diçka tjetër, nëse është e mundur, meqenëse disa të tjerë u morën me tema të tjera. Kështu që do t'ia lejoj vetes të kapërcej pak nga tema, megjithëse ka shumë për të folur, por s'mund të flasim për gjithçka.

Unë dua të qëndroj te një ceremoni që ka ndodhur sot në Durrës për rivendosjen e bustit të kolonel Tomsonit, pikërisht në vendin ku është vrarë 109 vjet më parë.

Siç e dini, kolonel Tomsoni ka qenë pjesë e misionit holandez të parë të paqes, në vitet 1913-1914. Shqiptarët dinë vetëm për Tomsonin, por s'dinë asgjë tjetër përtej tij. Më vjen keq që sot, bashkë me Tomsonin, nuk janë përmendur edhe 17 oficerë të tjerë të lartë, të cilët meritonin nderim! Në nder të tyre, do t'ua shpjegoj historinë sot shqiptarëve nga kjo foltore. Në fakt, bashkë me patriotët shqiptarë ata nuk kanë bërë histori, por kanë qenë pjesë e historisë dhe, për këtë arsye, do të doja që historia të ishte më e vëmendshme me ta.

Gati 10 vjet më parë, ndërsa botoja disa fakte të reja historike me burime holandeze për ato 6 muaj të mbretërimit jetëshkurtër të Princ Vedit,

një luzmë dritëshkurtërish i lexuan këto të vërteta si cenime të miteve shqiptare, me gjykimin e rëndomtë bardhë e zi të kohës ku jetojmë dhe jo me larushinë e kohës në të cilën kanë ndodhur ngjarjet.

Brengosja e madhe e drejtuesve të baltatriçes shqiptare, që janë ende në pushtet, ishte cenimi që po i bëhej figurës së kolonel Tomsonit dhe heroizmit mitik të vrasjes së tij më 15 qershor të vitit 1914, pra sot e 109 vjet më parë.

Mua nuk më pengon aspak të them se kolonel Tomsoni e meriton atë bust, edhe pse, sipas këtij libri dhe shumë librave të tjerë që kam botuar vetë gjatë këtyre viteve të fundit, nga burime të mirëfillta historike holandeze, ai nuk u vra aspak në mënyrë heroike, siç ka gënjyer deri më sot historia me një shkujdesje të plotë.

Koloneli ynë i dashur e meriton pa dyshim bustin, por jo mitin heroik që ka mes shqiptarësh, të cilët kanë mbi njëqind vjet që mbajnë fajin e vrasjes së tij, të bindur që këtë e vërteton poezia e Asdrenit: “U vra Tomsoni” apo poema e famshme e Fan Nolit: “Tomsoni dhe kuçedra”, të botuara menjëherë pas vrasjes së kolonelit, madje në këtë të fundit dinjitari ynë i madh klith dhe na akuzon ne shqiptarët hapur si vrasës të kolonelit:

“Te ura, te ura, vraponi burra,

Tomsonin e ngratë, që ju vetë e vratë”

apo fjalimin tronditës të Faik Konicës në varrimin e kolonelit, tek i kërkonte ndjesë të thellë për prerjen në besë që i kishin bërë.

Ishte koha kur ethet e ruajtjes së shtetit dhe kombit tejkalonin çdo nevojë për saktësimin e të vërtetave dhe ruajtjen e tyre për brezat e mëvonshëm. Por ishte edhe naive të vishje këtë qyrk fajësie nga një dozë inferioriteti e politikanëve të pazotë për të bërë shtet, të gjendur mbase mes intrigave të të gjitha rrymave që donin ta ndanin Shqipërinë, të humbur në tisin e pasigurisë që po gatuante lufta e madhe ku bota po hynte me nxitim.

Në këto kushte, dinjitarët dhe shkollarët tanë nuk kishin asnjë mundësi ta dinin të vërtetën, nëse ishte apo jo heroike vrasja e kolonelit të famshëm dhe as se sa dorë kishin shqiptarët në të, qofshin këta edhe dumbabasë turkoshakë, që gjithaq nuk ka fe civilizimi që i amnistion për atë që i bënë Shqipërisë ato ditë që pasuan arratinë e Princ Vedit.

Ky libër që po sjell këtu i shteron të gjitha këto enigma, sepse, nëse do të duhej të vrisnin

dikë, shqiptarët më parë duhet ta kishin drejtuar tytën nga Princ Vidi, i cili, në fundin e fundeve, rezultoi se nuk ishte i zoti të menaxhonte as gjatësinë e vet, e lëre më Shqipërinë tonë.

Po jua sjell jo pa qëllim këtë qasje sot, pasi në këtë ceremoni përdëlyese që u zhvillua në Durrës, ku busti i kolonelit të famshëm u rivendos me nderime, me shtrëngime duarsh e duartrokitje protokolli, për fat të keq, u mbyll aty. Askush nuk po guxon ta thotë të vërtetën, sepse kolonel Tomsonin jo vetëm që nuk e vranë shqiptarët, por vrasja e tij jo vetëm që nuk pati asgjë heroike, madje as shpatën nuk e nxori nga milli e jo më të ishte mbi kalë duke imituar Napoleonin në urën Arole; hiperbolizim që mbushi ballinat e të gjitha të gazetave dhe revistave të botës.

Koloneli ynë i dashur u gjet i vrarë pa këmbale dhe siç ishte ngritur nga gjumi dhe me kokën e rënduar nga birrat e shumta të një nate më parë, por ajo që nuk do të thuhet kurrë është se, nëse ka një çështje vorio-epirote të hapur deri në ditët tona, ku hyjnë e dalin Belerë kryebashkiakë e bejlerë trafikesh politike, pa dyshim gisht ka edhe ai me negociatat e paautorizuara që bëri me krerët e pseudoqeverisë vorie-pirote në Korfuz, në mars të vitit 1914.

Nuk po kërkoj ta demistifikoj heroin e protokollit të sotëm qeveritar, as t’i bie ndesh faktit që ai u vra në Durrës më 15 qershor të vitit 1914, në një ditë trazirash të shkaktuara nga rebelët e Shijakut, as t’i bie mohut për rolin e tij në përbërje të misionit holandez në ngritje të xhandarmërisë shqiptare, as të cenoj sadopak kujtimet dhe veprat e letrarëve dhe të politikanëve shqiptarë të kohës, para të cilëve përkulem me nderim të thellë. Ajo që po kërkoj është që historia të merret seriozisht me këtë çështje, duke i shkuar më në fund të vërtetës deri në fund. Dhe këtë duhet ta bëjë kjo Akademi këtu ngjitur, e cila, me ç’duket, më shumë është e interesuar për mandatin e krerëve të saj sesa për mandatin e së vërtetës, e cila fle në fletët e zbardhura të arkivave të kohës. Kështu, mendoj se sot duhej të ishin nderuar edhe 17 oficerët e tjerë të lartë holandezë, të cilët kanë luftuar krahas luftëtarëve shqiptarë duke rrezikuar edhe jetën e tyre, fakte të cilat miti i kolonelit ose vetë vdekja e tij, mu si një vrimë e zezë, i ka përbirë të gjitha. Do të mjaftonte sot vetëm një pllakë e thjeshtë me emrat e tyre, të gjithë bashkë, modeste, nderuese. Ngaqë kjo nuk ndodhi sot, më lejoni të përmend emrat e tyre në

nderim, edhe duke ditur se mbase çdo shqiptar do të donte ta bënte.

I pari është drejtuesi i këtij misioni, gjenerali Vilem de Vir, i cili ia doli ta organizojë nga Vlora xhandarmërinë shqiptare në mbrojtje të territoreve të Shqipërisë në Jug, ku, falë tij, sot kemi të gjitha faktet e dokumentuara të masakrës së Hormovës që çoi në gjyotinë, jo më pak, por 217 burra dhe fëmijë, edhe pse historia nuk e përmend kurrë dhe ne nuk kemi bërë qoftë edhe një memorie të vogël këtu; kapiteni Karel de Jong me luftimet e tij në zonën e Beratit, krahas patriotit Nuredin bej Vlora; mjekët Tido Redingus dhe Frederik de Grot dhe serxhenti Jan van Vliit, që u morën me ngritjen e një shërbimi ambulator dhe përgatitën spitalet dhe dezinfektimin e zonave kënetore në të gjitha zonat bregdetare; kapiten Gerard Malinkrod, që e përshkoi nëpër luftime me çetat patriotike korridorin Tepelenë-Delvinë-Himarë; major Henri Kron dhe kapiteni Jan Fabius të vendosur në Shkodër, takimet e të cilëve me kryetarët e bajraqeve shqiptare krijuan një armatë luftëtarësh nga malësia shqiptare në mbrojtje të Durrësit; majori Hugo Verhulst dhe kapiteni Hendrik Reimers, që drejtuan luftimet me çetat shqiptare të Mustafa Maksutit e Kamber Sejdit në Elbasan dhe Çermenikë, duke mbetur edhe robër në duart e rebelëve; kapiteni Jan Sari, një organizator i shkëlqyer i kazermës së shtetit shqiptar, i cili luftoi krah Meleq beut dhe Luigj Gurakuqit; majori Snellen van Volhoven dhe kapiten Jetze Dorman, që luftuan në Përmet, Ersekë dhe veçmas në Korçë kundër kontrollit grek të ndihmuar nga mitropoliti grek, Germanosi; majori Vuter de Val dhe kapiteni Julius Sone, ky i fundit si komandant i Gjirokastrës ka marrë pjesë në luftime për mbrojtjen e popullsisë së djegur dhe të masakruar nga bandat greke në Tepelenë, Gjirokastër, Kurvelesh e Këlcyrë, në krah të çetës së Çerçiz Topullit; majori Lukas Rulfsema, i cili hodhi bazat e gardës dhe kavalerisë së parë shqiptare modeste, por edhe të protokollit shtetëror dhe në fund edhe major Johan Slyis, komandanti i Durrësit, i cili u ndëshkua me largim të parakohshëm nga misioni, pasi kishte arrestuar Esat Pashën, kanakarin e italianëve dhe jo vetëm.

Shkruajeni, të nderuar historianë, historinë ndryshe, pra drejt. Kurrë Shqipëria nuk ka qenë më europiane se ajo kohë; kurrë nuk ka pasur një denduri aq të madhe të klasit, të mendjes, të

entuziazmit dhe ethes për shtet, edhe pse në kufijtë e turizmit politik. Kurrë nuk janë mbledhur patriotë e nacionalistë nga diaspora njëherësh në një territor aq të vogël sa ç' ishte Durrësi i atyre ditëve e javëve e muajve, ku nuk kishte më shtëpi të lira dhe ku po ndryshonin me shpejtësi cilësia e bujtinave, e hoteleve; po ndryshonin menytë e restoranteve, veshjet e njerëzve në rrugë, ku festet e trashëguara zëvendësoheshin me një shpejtësi me kapelat europiane dhe shqiptarët po i bënin strehë me bujari Europës në shtëpinë e tyre, ose, më saktë akoma, shqiptarët po e materializonin atdheun e tyre europian, sepse ata kishin filluar ëndrrën e tyre të rrugëtimit të madh dhe, siç thotë Kolombi: “Për ëndrrat e rrugëtimeve të mëdha, vetëm duke ndjekur dritën e diellit, mund ta lësh pas botën e vjetër” dhe shqiptarët atë bënë, të ndihmuar në një fragment të vogël të historisë së tyre edhe nga 18 djem holandezë, që i ndoqën në ëndrrën e tyre europiane dhe që meritojnë të nderohen në mënyrën më fisnike të mundshme.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Këtu mbyllem diskutimet për këtë pikë.

Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës: projektligji “Për pranimin e protokollit për ndryshimin e marrëveshjes së Marrakeshit për themelimin e Organizatës Botërore të Tregtisë, marrëveshja për subvencionet e peshkimit”.

Fillojmë diskutimet me paraqitjen e projektligjit nga nismëtarja.

Zonja Krifca, keni fjalën me kohë të pakufizuar.

Frida Krifca – E nderuar zonja Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë,

Shqipëria është një vend anëtar i Organizatës Botërore të Tregtisë prej vitit 2000 dhe, si e tillë, përfitimet ndër vite kanë qenë të shumta, duke nisur nga reduktimi i tarifave të eksporteve tona, te rritja e besueshmërisë së investitorëve të huaj, te njësimi i politikave ekonomike dhe tregtare me politikën e partnerëve tanë, te nxitja e shkëmbimeve të mallrave dhe shërbimeve të tjera.

Në fushën e peshkimit posaçërisht, ashtu si edhe në shumë fusha të tjera, rregullat e OBT-së ofrojnë një kornizë të qartë rregulluese, të cilat, me thënë të drejtën, kanë dhënë një kontribut të madh eksponencial në rritjen e këtij sektori,

veçanërisht të eksporteve. Fakt është se peshkimi është shndërruar në një nga sektorët me rritjen më të shpejtë në ekonominë shqiptare, duke i rritur nga pak milionë eksporte në, përkatësisht 137 milionë në vitin 2022.

Për sa i përket projektligjit të prezantuar sot përpara jush, ndryshimet e propozuara në marrëveshjen themeltare të OBT-së synojnë që të përforcojnë zhvillimin e qëndrueshëm të përkrahimit, duke adresuar dy probleme kryesore: peshkimin e paligjshëm dhe rrezikimin e habitateve e specieve ujore nga peshkimi pa kriter.

Amendimet e këtij traktati vijnë pas negociatash të gjata ndërkombëtare të nxituara nga të dhënat thuajse alarmante të OKB-së dhe të Bankës Botërore. Në këto të dhëna thuhet (këtu dua të citoj raportin e gjendjes së biodiversitetit global nga OKB-ja), se 34% e stokut botëror të peshkut nëpër dete po ezaurohet nga peshkimi i paligjshëm apo përtej kufijve të qëndrueshëm të riprodhimit biologjik. Sipas Bankës Botërore, peshkimi përtej kapaciteteve të qëndrueshme i shkakton ekonomisë botërore 83 miliardë euro dëme. Problematike në këtë drejtim janë rreth 35 miliardë dollarë subvencione që qeveritë e ndryshme të globit japin së bashku mesatarisht për peshkimin në vit dhe që qëllimisht apo gabimisht kanë mbështetur rritjen e sasisë dhe të kuotave të peshkimit të specieve apo të habitateve të ndryshme që kanë rrezikuar apo e kanë përkeqësuar më tej situatën.

Në këto kushte, amendimi i propozuar në Konferencën Ministeriale të OBT-së në muajin qershor të vitit të kaluar në Gjenevë, po aprovohet hap pas hapi në parlamentet e vendeve anëtare të OBT-së, midis tyre edhe partnerët tanë të rëndësishëm.

Dua t'ju informoj se tri javë më parë, më 25 maj 2023, amendimet e propozuara u adoptuan unanimisht nga të gjitha vendet e Bashkimit Europian. Partnerët e tjerë të vendit tonë dhe vendet e rajonit, gjithashtu, kanë aprovuar ose janë në procesin e aprovimit të këtyre amendimeve. Një proces i tillë është i domosdoshëm, sepse ndryshimet mund të hyjnë në fuqi vetëm pasi të paktën 2/3-a e vendeve të OBT-së mund t'i harmonizojnë ato në legjislacionet e tyre përkatëse.

Në këto kushte, aprovimi i këtij projektligji është shumë i rëndësishëm për Shqipërinë; është

thelbësor për të vijuar harmonizimin e mëtejshëm ligjor të kapitujve të bujqësisë dhe të peshkimit, si dhe është një sinjal i fortë që ne japim në mbështetje të ligjshmërisë së bashkëpunimit në komunitetin tonë ndërkombëtar. Megjithatë, dua të theksoj dhe të nënvizoj për opozitën, por, sigurisht, edhe për të gjithë dëgjuesit se sugjerimi i Ministrisë së Bujqësisë për aprovimin e këtij ligji, pikë së pari, motivohet nga interesi ynë kombëtar dhe nga përfitimet konkrete që do të ketë në sektorin dhe fushën e peshkimit.

Në këtë drejtim, rikujtoj se para rekomandimit të ministrisë sonë, më herët projektligji është shqyrtuar nen për nen dhe është miratuar në parim në mënyrë unanime në Komisionin për Politikën e Jashtme, në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, në Komisionin e Ligjeve dhe në Komisionin e Ekonomisë.

Dua të theksoj, gjithashtu, se asnjë subvencion apo politikë subvencionuese e këtij sektori, pra e sektorit të peshkimit, e dhënë në Shqipëri, nuk është gjetur në shkelje. Ndaj, në këtë drejtim, projektligji nuk sjell ndonjë kufizim në politikën tona subvencionuese të këtij sektori apo ndonjë ndryshim thelbësor të skemave tona të mbështetjes së këtij sektori.

Së dyti, formalizimi i mëtejshëm i sektorit do të lejojë konsolidimin e industrisë së peshkimit, duke garantuar një rritje të vazhdueshme të eksporteve dhe punësimit, që janë në përputhje me objektivin tonë për të arritur 200 milionë euro eksporte nga peshkimi brenda vitit 2030.

Së treti, ndalimi i peshkimit ilegal dhe mbipeshkimi do të mbrojë rezervatet tona natyrore, duke bërë të mundur që të ardhurat e peshkimit të mos jenë sot për sot, por të shtrihen në kohë në mënyrë të qëndrueshme.

Së katërti, politika për mbrojtjen e specieve dhe ujërave tona detare është në përputhje me politikën tona për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Së pesti, aprovimi i këtyre ndryshimeve vjen me paketën për rritjen e asistencës teknike nga ana e OBT-së, që do ta lejojë Shqipërinë të mbështetet në ekspertizën më të avancuar botërore për nxitjen e mëtejshme të rritjes së sektorit të peshkimit, përpunimit dhe akuakulturës.

Të nderuara zonja dhe zotërinj,

Gjithnjë e më shumë peshkimi është shndërruar në një prej sektorëve me rritjen më të shpejtë të ekonomisë shqiptare. Në pak vjet eksportet janë shumëfishuar, punësimi është shumëfishuar dhe kartëvizita më e mirë e kësaj rritjeje është rezultati i arritur në fillim të qershorit, kur Shqipëria u shndërrua në vendin e parë në Mesdhe, që përmbushi sasinë vjetore të kuotës së peshkimit për peshkun ton, me plot 264 tonë. Kujtoj se nuk ishte shumë e largët dita kur Shqipëria i shiste kuotat e saj në ankand, sepse nuk kishte asnjë kapacitet për të peshkuar këtë lloj peshku për sasinë që i takonte në kuota. Pra, është një arritje e rëndësishme.

Kemi mbështetur industrinë e peshkimit për rinovimin e flotës, për instalimin e pajisjeve frigoriferike, për ndryshimin e motorëve, mbështetje me litër për naftë për të mitiguar kostot e rritura gjatë vitit të kaluar, duke e përfshirë edhe atë në skemën kombëtare të trajnimit. Qëllimi ynë është që të vijojmë ta mbështesim edhe më shumë.

Në këtë drejtim, aprovimi i këtij projektligji jo vetëm që nuk do të ketë asnjë pasojë frenuese, përkundrazi, do t'u japë një hov të ri eksporteve dhe punësimit në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare. Për këtë arsye, ju bëj thirrje, ashtu sikurse edhe në komisionet parlamentare, ta aprovojmë këtë projektligj unanimisht, duke dhënë kështu një sinjal të fortë të angazhimit dhe dedikimit të vendit tonë ndaj partnerëve ndërkombëtarë dhe kauzave globale, si dhe, mbi të gjitha, sinjalin e një mbështetjeje të fortë ndaj atyre mijëra shqiptarëve që punojnë në këtë sektor.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Faleminderit!

Hapim diskutimet.

Fjala për zotën Vullnet Sinaj.

Të përgatitet zoti Kreshnik Çollaku.

Vullnet Sinaj – E nderuar Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Duke qëndruar gjatë në Kuvend, është e pamundur të mos dalësh për një moment nga tema dhe projektligji që po diskutojmë, dhe të mos thuash dy fjalë për Kosovën, për të cilën dua të them se askush tjetër përveç partnerëve kryesorë që Kosova dhe Shqipëria kanë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Europian, nuk mund t'i gjendet afër me këshilla për paqen

në rajon. As Kosova, as ne nuk e ndërtojmë dot kapitalizmin duke u mbështetur në forcat tona. Pra, do të jetojmë të gjithë së bashku dhe historia ka treguar që jo vetëm ne, por edhe vende më të mëdha se ne kanë nevojë për një bashkëjetesë dhe politikë paqësore. Unë shpresoj të shprehja populllore: “Po nuk u turbulluan ujërat, ato nuk kthjellohen”. Shpresoj që kthjellimi i tyre do të jetë në interes të paqes në rajon.

Gjithashtu, dëgjova të gjitha diskutimet për projektligjin e mëparshëm për mbetjet, për financimin nga KfW-ja. Dua t'u them kolegëve të opozitës se, teksa i dëgjoja, më kujtohej se sa në vështirësi jemi vënë, kur në kohën që qeveriste Partia Demokratike në Shqipëri vinin miqtë tanë për vizitë, na vinte zor nga plehurat dhe nga koshat e mbushur me plehra. Unë them se është bërë shumë, pavarësisht, mund të ketë akoma më shumë për t'u bërë. Mendoj se kemi akoma më shumë për të bërë për pastrimin e qyteteve dhe fshatrave tona. Përditë e më shumë Shqipëria është duke u kthyer në një vend turistik dhe, duke qenë një vend i cili zhvillohet nëpërmjet turizmit, ne aq herë më tepër kemi detyrë për pastrimin e qyteteve dhe fshatrave tona.

Duke u kthyer te projektligji “Për pranimin e protokollit për ndryshimin e marrëveshjes së Marrakeshit për themelimin e Organizatës Botërore të Tregtisë, marrëveshja për subvencionet e peshkimit”, dua t'ju them se kemi një projektligj, i cili bën pranimin e ndryshimit të një protokollit dhe qëllimi i tij është që këtë ndryshim t'ia bashkëngjisë marrëveshjes themelore të Organizatës Botërore të Tregtisë.

Por vetë marrëveshja, çfarë ka në brendësi të saj?! Është një histori e gjatë e negociatave të Organizatës Botërore të Tregtisë për subvencionimin e peshkimit, duke filluar që nga viti 2001, duke vazhduar në vitin 2005 në konferencën ndërministrorë të Hong Kongut që vendosi ndalimin e formave të caktuara të subvencioneve të peshkimit, që ndikojnë në peshkimin e tepërt. Në vitin 2017 vazhdon me konferencën e 11-të dhe përsëri ngre theksin për mossubvencionimin e peshkimit që ndërton, krijon stoqe dhe dëmton oqeanet apo pasurinë e oqeanëve dhe të deteve. Vazhdon edhe në vitin 2022 dhe, duke qenë se vendi ynë është anëtar i Organizatës Botërore të Tregtisë, ne si parlament marrim në shqyrtim këtë marrëveshje për ta miratuar.

Po çfarë ka në brendësi të marrëveshjes?! Marrëveshja ndalon subvencionimin për anijet ose operatorët e përfshirë në aktivitete të paligjshme, të paraportuara dhe të parregulluara të peshkimit; ndalon subvencionimin e peshkimit mbi normat e lejuara të rezervave natyrore të peshkut në dete dhe në oqean; ndalon subvencionimin për rastet që kanë të bëjnë me peshkimin jashtë juridiksionit të një shteti anëtar.

Marrëveshja zbatohet për aktivitetet e peshkimit në ujërat e thella jashtë zonës ekonomike të një vendi dhe jo për aktivitetet e lidhura me akuakulturën ose peshkimin në ujërat e brendshme. Kjo marrëveshje është në përputhje të plotë me politikat e Bashkimit Europian për një zhvillim të qëndrueshëm. Ajo shënon një hap përpara për qëndrueshmërinë e rezervave të oqeanit, duke ndaluar subvencionin e dëmshëm të peshkimit, që janë faktori kryesor për varfërimin e rezervave të peshkut në botë. Ndalimi i subvencioneve për peshkimin e parregullt do të sjellë rritjen e rezervave natyrore, burimore dhe peshkore në nivel global në përgjithësi dhe në pellgun e Mesdheut në veçanti.

Marrëveshja kërkon transparencë nga vendet anëtare të Organizatës Botërore të Tregtisë. Kjo marrëveshje parashikon dhënien e asistencës teknike për ngritjen e kapaciteteve për të gjithë anëtarët e kësaj organizate, që janë vende në zhvillim apo më pak të zhvilluara, sepse vendi ynë në të gjithë sasinë globale të peshkimit zë një përqindje shumë të vogël, gati 0,01%. Por në këto raste, kur pranohet marrëveshja, atëherë ne kemi favore dhe vendet si vendi ynë, edhe pas miratimit të kësaj marrëveshjeje, kanë të drejtën që për 2 vjet pas miratimit të marrëveshjes të lejojnë subvencionimin e peshkimit. Projektligji nuk ka efekte financiare në buxhetin e shtetit.

Ligji që kemi aktualisht në Shqipëri, është një ligj i cili është përafuar me direktivat e Bashkimit Europian dhe që nuk lejon veprimtari të paligjshme të peshkimit apo tregtim të peshkut nga anije, të cilat nuk janë të ligjshme. Ligji ndalon eksportimin, importin dhe hedhjen në treg të këtyre produkteve.

Ligji parashikon: masa për mbrojtjen e llojeve të veçanta të peshkut dhe organizmave të tjerë nga mbipeshkimi; numrin dhe madhësinë e anijeve të peshkimit, fuqinë motorike të anijeve, llojin, sasinë, veglat dhe pajisjet me të cilat realizohet peshkimi në zona të caktuara; ndalimin

e peshkimit në këto zona të caktuara; sasinë e lejuar të peshkut për çdolloj leje dhe numrin e lejeve për llojet e caktuara të peshkimit. Pra, ligji ynë është në përputhje me marrëveshjen.

Dua t'i them të gjithë sektorit të peshkimit, pra të gjitha këtyre subjekteve që merren me peshkim, se miratimi i kësaj marrëveshjeje nuk cenon asnjë mbështetje që ka marrë ky sektor nga qeveria, siç janë çmimi i ulët i naftës pa taksa, që ata e marrin si të gjithë kolegët e tyre në Mesdhe dhe i ndihmon për të ulur kostot e peshkimit, mbështetja që ata kanë marrë nga qeveria për frigoriferë apo për ndërrimin e motorëve kur anijet kanë pasur probleme defektesh, sepse këto nuk ndikojnë në rritjen e fuqisë së peshkimit, por përmirësojnë peshkimin në vendin tonë. Pra, kemi të bëjmë me një marrëveshje, e cila në thelbin e saj ndalon subvencionimin për përpeshkim, për mbipeshkim dhe për mbishfrytëzim të tërësive të oqeanit dhe të deteve. Njëkohësisht, duke bërë ndalimin e atyre vendeve që subvencionojnë këtë lloj peshkimi, nga njëra anë ne kontribuojmë si vend për ruajtjen e faunës dhe florës së oqeaneve e të deteve, për ruajtjen e pasurive dhe të rezervave të oqeaneve e të deteve me sasinë e peshkut apo të specieve të tjera, njëkohësisht, duke u ndaluar ky subvencionim për këtë mbipeshkim, krijojmë raporte të drejta në tregun e peshkut dhe të eksporteve. Pra, në këtë mënyrë nuk ka favorizim të një vendi nga një tjetër. Kjo do të krijonte mundësinë që vendi ynë të rriste dhe të kishte mundësi për t'i rritur eksportet e tij në tregjet ndërkombëtare.

Të nderuar kolegë, nisur nga të gjitha këto që thashë, kam besimin e plotë që këtë marrëveshje do ta miratojmë të gjithë së bashku!

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Ilir Ndraxhi.

Të përgatitet zoti Etjen Xhafaj.

Ilir Ndraxhi – E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar deputetë,

Projektligji “Për pranimin e protokollit për ndryshimin e marrëveshjes së Marrakeshit për themelimin e Organizatës Botërore të Tregtisë, marrëveshja për subvencionet e peshkimit”, ka si qëllim miratimin e protokollit amendues për të përfshirë marrëveshjen për subvencionet e peshkimit në aneksin I të marrëveshjes së OBT-së që i ndalon shtetet anëtare të japin subvencione për anijet ose operatorët e përfshirë në aktivitete

të paligjshme, të paraportuara dhe të parregulluara; për peshkimin e stokut të peshkut të mbipeshkuar dhe për rastet që kanë të bëjnë me peshkimin jashtë juridiksionit të një anëtar.

Gjithashtu, synohet të adresohen shqetësimet e vendeve anëtare të OBT-së në lidhje me përfitimet e padrejta, që dëmtojnë konkurrencën e drejtë për ata anëtarë të OBT-së, të cilët mund të përballojnë të sigurojnë subvencione për industrinë e tyre të peshkimit. Ndalmimi i subvencioneve në lidhje me mbikapacitetin dhe mbipeshkimin apo për stoqet e peshkut/rezervat natyrore të burimeve peshkore, që konsiderohen të mbipeshkuara /mbishfrytëzuara ose subvencione për mjetet lundruese apo operatorë të përfshirë në peshkimin e paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar ose për aktivitete të lidhura me peshkimin është në përputhje me politikat që ndiqen nga Shqipëria në fushën e peshkimit brenda zonës ekonomike ekskluzive.

Nga kjo marrëveshje, bazuar në nenin 7 “Asistenca teknike dhe ndërtimi i kapaciteteve”, Shqipëria mund të përfitojë asistencë teknike nga OBT-ja për ngritjen e kapaciteteve me qëllim zbatimin e disiplinave, sipas kësaj marrëveshjeje.

Në mbështetje të kësaj ndihme do të krijohet një mekanizëm financimi vullnetar i OBT-së në bashkëpunim me organizatën ndërkombëtare përkatëse, Organizatën e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë (FAO) dhe Fondin Ndërkombëtar për Zhvillimin e Bujqësisë.

Kontributet e anëtarëve të OBT-së për mekanizmin do të jenë ekskluzivisht në bazë vullnetare dhe nuk do të përdorin burime të rregullta buxhetore.

Rregullat e marrëveshjes zbatohen për subvencione që janë specifike për peshkimin e egër detar dhe për aktivitetet e lidhura me peshkimin në det dhe nuk kanë të bëjnë me akuakulturën dhe peshkimin në ujërat e brendshme. Vendeve më pak të zhvilluara dhe atyre në zhvillim u akordohet një periudhë prej 2 vjetësh pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes, gjatë së cilës janë të përjashtuar nga zbatimi.

Gjithashtu, marrëveshja imponon transparencë nëpërmjet njoftimit të rasteve të peshkimit të paligjshëm dhe parashikon riciklimin periodik të funksionimit të marrëveshjes nga një komitet i përhershëm, që do të krijohet për mbikëqyrjen dhe për monitorimin e kësaj

marrëveshjeje, sipas përcaktimit të marrëveshjes. Marrëveshja parashikon dhënien e asistencës teknike për ngritjen e kapaciteteve të synuara për anëtarët e vendeve në zhvillim.

Projektligji “Për pranimin e protokollit për ndryshimin e marrëveshjes së Marrakeshit për themelimin e Organizatës Botërore të Tregtisë, marrëveshja për subvencioneve e peshkimit” është hartuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Marrëveshja për subvencioneve e peshkimit nuk ka efekte financiare të drejtpërdrejta në buxhetin e shtetit.

I ftoj kolegët që ta miratojmë këtë projektligji.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjalën e ka zoti Etjen Xhafaj.

Etjen Xhafaj – Faleminderit, e nderuar zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Si kolegu Ndraxhi dhe kolegu Sinaj, sigurisht, edhe ministrja e Bujqësisë mbajtën një nivel shumë teknik. Unë do të përpiqem të shpjegoj pjesën makro të kësaj marrëveshjeje, duke qenë se vitet e fundit ky ka qenë një nga diskutimet më të nxehta në Organizatën Botërore të Tregtisë, si pasojë e procesit që ka filluar në vitin 2001 në Doha, për diskutimin e atyre që ishin kuotat dhe mënyrat e paligjshme të peshkimit. Si pasojë e mbipopullimit që ka ndodhur kudo në glob, sigurisht që ka një kërkesë të rritur për ato që janë ushqimet dhe burimet e proteinave, të cilat janë më të diferencuara, rrjedhimisht kjo ka çuar që shumë nga vendet më të mëdha jo vetëm t'i kalojnë ujërat e tyre juridiksionale, pra ato 12 milje largësi nga bregu apo ato që janë ndarë si zona të peshkimit, por edhe të kalojnë në ujëra ndërkombëtare. Për pasojë është parë me vend, duke filluar nga viti 2005, që të kishte një diskutim të vazhdueshëm me të gjithë anëtarët e Organizatës Botërore të Tregtisë për format e subvencioneve, të cilat mbështesnin disa nga këto industri, të cilat për sa i përket peshkimit, veçanërisht peshkimit në det të hapur, ishin të dëmshme mbi përballueshmërinë e këtij sistemi dhe furnizimit me proteina të vendeve të mëdha dhe të zhvilluara, siç po tregohet jashtëzakonisht. Duke parë që totali i vëllimit botëror të peshkimit është në rritje, madje vitin e kaluar ka kaluar gati

185 milionë tonë metrik, pra një rritje me rreth 7 milionë tonë metrik në vit dhe mbi 51% e kësaj vjen nga burime të egra dhe jo nga akuakultura apo peshk i kultivuar, kjo është një nga ato çështje, e cila sot ka ndarë shumë nga vendet. Edhe marrëveshja që është arritur për rishikimin e aneksit IA të marrëveshjes së Organizatës Botërore të Tregtisë të nënshkruar në Marrakesh është një marrëveshje e pjesshme, e cila, duke rishikuar vetëm këtë nen, praktikisht prek dhe u shkakton shteteve anëtare që të mos japin subvencione për anije, të cilat janë të përfshira në aktivitetet e paligjshme të peshkimit; për peshkimin e stokut të peshkut të mbipeshkuar, sigurisht, për rastet që kanë të bëjnë me peshkimin jashtë juridiksionit, veçanërisht në ujëra ndërkombëtare dhe në efektet që këto sjellin më pas edhe në qëndrueshmërinë e këtyre burimeve të proteinave, si dhe në qëndrueshmërinë e këtij burimi që është vital, veçanërisht për shumë nga vendet e vogla të pazhvilluara. Kjo është arsyeja pse kjo marrëveshje është shumë e rëndësishme për Shqipërinë si një vend në zhvillim, i cili e ka të limituar aksesin në det, pra nuk ka akses në oqean. Sigurisht, të gjitha këto efekte, pra efekti zinxhir i mbipeshkimit, i peshkimit të specieve të rrezikuara dhe përdorimi i teknikave, që nuk janë adresuar nga kjo marrëveshje e peshkimit, të cilat dëmtojnë ekosistemet, kanë një impakt në të gjitha vendet e vogla dhe vendet në zhvillim. Prandaj mendoj se kjo marrëveshje duhet të nënshkruhet dhe të votohet nga të dyja anët, sepse ka një efekt afatgjatë edhe si një shkallë, e cila duhet shkelur medoemos për të ecur përpara për të pasur një marrëveshje tërësore për sa i përket sigurimit të burimeve të qëndrueshme dhe të përballueshme të ushqimit edhe në kohë, duke qenë se bota është duke u rritur në nivel demografik, si kurrë më parë. Besoj se, siç kemi rënë dakord në komisione, do të biem dakord edhe në parlament që ta votojmë të gjithë njerëzi këtë marrëveshje. Duke qenë se sot në këtë aulë janë prekur shumë gjëra, shumica e të cilave vazhdojnë ta thellojë këtë hendekun që i ndan të dyja krahët, dua të flas pak edhe për ato që janë çështjet më kryesore:

Së pari, është çështja e Kosovës dhe, pavarësisht krahëve dhe rreshtimeve tona politike, përpara këtij instinkti për të drejtuar gishtin nga njëra palë apo nga tjetra, thirrja jonë e parë duhet të jetë që 3 policët, të cilët janë rrëmbyer në

territorin e Kosovës, të kthehen, që ky të jetë një hap për depërshkallëzimin e kësaj situatë dhe për t'u kthyer në një term normal diskutimi dhe konsultimi të të dyja palëve, sepse në fund të ditës diplomacia është ajo zgjidhje që e gjithë bota ka gjetur për të mbajtur larg luftën, rrjedhimisht do të duhet që palët të ulen në tryezë dhe të diskutojnë. Më pas, se si e shikojmë këtë gjë, varet nga krahët e kësaj sallë. Sigurisht, ka dy shtete shqiptare në Ballkan dhe është e sigurt që ju njërin shtet e sulmoni gjithmonë dhe ai që sulmoni gjithmonë është shteti i Shqipërisë dhe fakti nëse ka të bëjë me një çështje të Kosovës apo edhe me çështje të tjera, që u ngritën këtu, nuk janë në thelbin e saj, sepse Shqipëria nuk ka synuar në asnjë moment të ndalojë dialogun dhe as të ndalojë mundësinë e veprimeve të Kosovës. Sot më shumë se kurrë, dhe kriza na e tregon edhe më tepër, është e domosdoshme që dialogu të vazhdojë, është e domosdoshme që palët të ulin tensionin dhe të gjejnë zgjidhje, të cilat të jenë afatgjata dhe jo vetëm për momentin. Në politikën e jashtme do të kishte shumë sens që uniteti që kërkojmë të ketë qeveria e Shqipërisë, shteti shqiptar me shtetin e Kosovës dhe me qeverinë kosovare të ishte një kërkesë edhe për unitet të brendshëm, sepse një shtet, i cili është i përçarë së brendshmi dhe vazhdon luftën mes vetes së tij, nuk mund të jetë i fortë në politikën e jashtme që të mund të kthejë përgjigje...

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Jo, jo siç dolët të gjithë, sepse këtu dëgjuam edhe për kolonelin Tomson. Sigurisht, duhet të fokusohemi edhe te disa çështje që janë pak më tepër të rëndësishme se marrëveshjet teknike, sepse këtu një nga parafolësit na tregoi dhe na akuzoi me gisht, i cili është ai që vjedh dhe është ai që hesht në këtë sallë. Tani nuk është këtu, por është ai që hesht, sepse ka vjedhur për 32 vjet me radhë dhe nuk flet asnjëherë. Problemi i madh i kësaj është se nuk mund të trajtohet gjithmonë sikur e keni gjetur fajtorin, është ulur këtu, tani duhet të gjeni fajin dhe gjithmonë kjo është çështja.

Prandaj, si pikë të fundit doja të adresoja për disa nga kolegët, duke qenë se këtu sot herët në mëngjes është rifolur, aplikacionin e komunikimit të Partisë Socialiste që quhet "Aktivisti", një aplikacion të cilit ju, përveçse i atribuoni disa numra që unë s'e di nga ju dalin, sepse një Zot e di që nuk janë fakte dhe nuk janë të vërteta, i

atribuoni edhe fuqi të mbinatyrshe kontrolli, të cilat nuk i ka.

Të nderuar kolegë, doja t'ju ftoja vërtet që, për sa kohë e kemi detyrë këtë që të gjejmë vetëm faje për t'ia hedhur njëri-tjetrit, të kemi mundësinë t'i kontrollojmë pak edhe faktet, jo vetëm fajin, që të shikojmë se çfarë bën një aplikim komunikimi, në të cilin mund të regjistrohesh me çfarëdo emri të duash dhe i cili nuk kontrollon asgjë nga gjërat që ju thoni dhe nuk ju detyron për asgjë nga gjërat që ju thoni, siç u duk edhe nga vetë përgjigjja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit, i cili i pa të dhënat që iu kërkuan dhe asnjë nga ato nuk ishte një e dhënë kritike që bënte individualizimin apo përcaktimin e individit, i cili ndërvepron me aplikacionin, që në fund të ditës është një aplikacion komunikimi i hapur për të gjithë, në daç mbështetësit tuaj, tanët, kritikët, kureshtarët, ata që janë kundër apo ata që janë pro, sepse në fund të ditës, e vetmja gjë që synon të bëjë është të informojë për aktivitetin e Partisë Socialiste. Prandaj, duke i lënë mënjanë të gjitha këto pretekste e justifikime me aktivistë apo patronazhistë, në fund të ditës, në qoftë se ju nuk filloni të shikoni që, kur drejtoni një gisht në një drejtim, tre nga gishtat e dorës tuaj janë drejtuar nga vetja, nuk besoj se do të arrini të fitoni ndonjëherë.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Këtu mbyllem diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës.

Kalojmë te projektligji “Për qeverisjen elektronike”.

Fillojmë me paraqitjen e projektligjit nga ministrja, zonja Ekonomi.

Koha në dispozicion pa kufizim.

Milva Ekonomi – E nderuar zonja Kryetare, Të nderuar kolegë deputetë,

Së pari, dua të bëj një falënderim të posaçëm për Drejtorinë Juridike në Këshillin e Ministrave, për pjesën juridike të AKSHI-t, që kanë punuar për një periudhë shumë të gjatë për ta sjellë projektligjin në këtë formë.

Nga ana tjetër, dua të falënderoj të gjithë anëtarët e Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, anëtarët e Komisionit të Ekonomisë, anëtarët e Komisionit të Ligjeve, të cilët kanë punuar dhe diskutuar për nene të posaçme të këtij projektligji për ta sjellë në formën që e kemi sot përpara!

Arsyeja pse vijmë me këtë projektligj nuk është një arsye jo e konsiderueshme, sepse në Shqipëri ne kemi rregulluar të gjitha shërbimet elektronike, por, në fakt, nuk kemi pasur një kornizë për e-qeverisjen. Vendimet, aktet ligjore, nënligjore, korniza ligjore që rregullonte këto e-shërbime ishte e shpërndarë në 8 ligje, 23 VKM, 24 urdhra, 5 udhëzime dhe 1 strategji digjitale, që ishte miratuar së fundi. Kështu, nevoja për këtë rregullim ligjor ishte shumë e domosdoshme. Për më tepër, projektligji është në funksion të përbushjes së programit politik të Këshillit të Ministrave lidhur me fushën e inovacionit, të teknologjisë së informacionit, i cili lidhet me shtimin dhe me promovimin e shërbimeve digjitale, e-shërbimeve, për qytetarët dhe për biznesin. Kështu konsolidohet infrastruktura digjitale në vendin tonë, duke respektuar me shumë rigorozitet parimet europiane të konkurrencës së lirë dhe të ndershme.

Edhe nëse u referohemi ndryshimeve dhe zhvillimeve që ka pësuar AKSHI, ato duhet t'i shohim me kohën. Në vitin 2007 AKSHI u krijua me një vendim të posaçëm të Këshillit të Ministrave dhe që nga prilli i vitit 2007, kur u krijua, e deri në fund të janarit të vitit 2008 u plotësua me staf. Ndërkohë që AKSHI zhvillohej, me një vendim të vitit 2011 në çdo ministrie apo institucioni të rëndësishëm shtetëror u krijuan njësitë TIK, të cilat merrshin me dizejnimin, projektimin, zbatimin dhe monitorimin e shërbimeve që i jepnin popullatës.

Ju e kuptoni që, në gjithë këtë histori krijimesh, natyrisht, dëshira për të pasur shërbime sa më pranë qytetarëve dhe sa më pranë bizneseve i bëri institucionet që të ishin të pavarura për mënyrën sesi i formuluan këto në një suport informatik. Për këtë arsye në vitin 2014 AKSHI-t iu bashkërenduan të gjitha këto njësi të vogla të teknologjisë së informacionit që ndodheshin pranë ministrive dhe institucioneve. Përveç kësaj, AKSHI-t iu dha detyra e rëndësishme që për çdo mall apo shërbim të prokuruar, që lidhej me fushën e e-shërbimeve të teknologjisë së informacionit, ai do ta kishte të përqendruar mënyrën e prokurimit, sidomos atë të hartimit të termave të referencës për nevoja të këtyre shërbimeve. Në këto kushte fusha e veprimtarisë së AKSHI-t duhej të shihej e pazgjdhur edhe me shërbimet që ofroheshin nga agjenci të tjera, si: AKCSEK-u, AKEP-i, ILDKPKI-ja, këto ishin

institucione që merreshin me shërbime informatike dhe ishin të gjitha nën varësinë e Këshillit të Ministrave.

Në këto kushte që jemi sot misioni kryesor i AKSHI-t është përfaqësimi i shtetit shqiptar në administrimin dhe mirëmbajtjen e çdo sistemi dhe infrastrukture *software* dhe *hardware* të shërbimeve të qeverisjes elektronike në fushën TIK, si dhe përgjigjet për ngritjen, mirëmbajtjen dhe administrimin e sistemeve dhe aplikacioneve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Kjo është një infrastrukturë e qendëruar për të gjitha organet dhe institucionet e administratës shtetërore, buxhetore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, por edhe për institucionet jobuxhetore, për të cilat përdoren tarifa shërbimi.

AKSHI, për të siguruar vazhdimësinë e politikave ekzistuese në fushën TIK dhe për të përcaktuar prioritetet e qeverisë në fushën TIK, bashkërendon strategjinë ndër-institucionale për ofrimin e shërbimeve elektronike me organe dhe institucione të administratës publike, për qytetarët dhe subjektet private; ofron politika të zhvillimit të shoqërisë së informacionit dhe në veçanti të shoqërisë së komunikimit. Në zbatim të fushës së veprimtarisë AKSHI harton strategji dhe plane veprimi për zbatimin e teknologjive të informacionit dhe të komunikimit elektronik në e-gov, ndërsa në cilësinë e autoritetit rregullator është përgjegjës i bazës së të dhënave shtetërore. Për këtë arsye AKSHI garanton një nivel të latë të sigurisë kibernetike, jep zgjidhje për incidente të sigurisë kompjuterike të bashkërenduar, si dhe është pjesë e ekipit përgjegjës ndaj incidenteve të sigurisë kompjuterike në institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave. Ndër objektivat më të rëndësishëm, gjithashtu, është edhe bashkërendimi i programeve në fushën e shoqërisë së informacionit dhe dhënia e kontributit në edukimin dhe nxitjen e përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit nga publiku i gjerë.

Aktualisht AKSHI është ofruesi i më shumë se 85% të shërbimeve të përqendruara nëpërmjet teknologjisë së informacionit dhe komunikimit të qeverisjes elektronike, të cilat i ka të rregulluara me një VKM dhe me një listë të bashkëngjitur. Ndër shërbimet më thelbësore që mund të përmendim janë: shërbimi i nënshkrimit elektronik, vula elektronike, certifikata

elektronike për organet dhe institucionet e administratës publike dhe subjektet private.

AKSHI kontribuon në përcaktimin e standardeve shqiptare të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, përcakton standardet shqiptare të shërbimeve publike elektronike, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe europiane, të cilat duhet të adaptohen dhe të udhëheqin veprimtarinë e administratës publike dhe subjekteve private.

Revolucioni digjital, i cili filloi në Shqipëri, bëri të mundur që nga 14 shërbime *online*, sot të kemi 1227 shërbime *online*, pra 95% të shërbimeve publike. Nën presionin e vazhdueshëm, që vijnë rrisitë teknologjike në botë, sidomos pas kohës së pandemisë, mund të themi që edhe AKSHI është përgjigjur menjëherë për të bërë një revolucion në Shqipëri. Ajo që ndodh sot është që ne kemi arritur të informatizojmë edhe regjistrat, ku depozitohen të dhëna për shërbime që përdorin qytetarët dhe bizneset. Nëse në vitin 2013 ne kishim vetëm 5 regjistra, që komunikonin me njëri-tjetrin, sot kemi 58 regjistra, që komunikojnë me njëri-tjetrin; nëse në vitin 2013 në portal ishin regjistruar vetëm 50 mijë përdorues, sot janë më shumë se 1,9 milionë përdorues; nëse në vitin 2013 në platformën qeveritare të ndërveprueshmërisë ishin realizuar 680 mijë transaksione, sot janë realizuar më shumë se 215 milionë transaksione. Për gjithë këtë përmirësim të AKSHI-t, raportet e organizatave prestigjioze në botë, si: OKB-ja, OECD-ja, Departamenti Amerikan i Shtetit apo progresraporti i BE-së, i japin Shqipërisë një meritë të veçantë në të gjithë revolucionin digjital që ka pësuar.

Ndërkohë, ne kemi kaluar edhe në përdorimin e vulës digjitale, e cila lehtëson shumë edhe marrjen e shërbimeve në një adresë *email-i online* si për bizneset, ashtu edhe për qytetarët, por që ta ndjekin këtë, shumë profesione, që më parë ishin profesione në *front office*, kanë kaluar si profesione në *back office* për të bërë të mundur ndërveprimin e të gjithë regjistrave dhe marrjen e shërbimeve.

Në fakt, çfarë është ky ligj që vjen sot? A është një domosdoshmëri? Miratimi i strategjisë digjitale për periudhën 2022-2026 kërkoi që të përdorej edhe një instrument i tillë, siç ishte instrumenti i vendosjes së një akti rregullator legjislativ, që do të mundësonte edhe më shumë

avancimin e shërbimeve që ofron AKSHI. Nga ana tjetër, ky instrument kërkon të harmonizojë të gjithë kuadrin rregullator të qeverisjes elektronike; të përcaktojë edhe standarde për subjektet private që komunikojnë me shtetin për dhënien e shërbimeve ndaj individëve; të ndjekë edhe disa nga ato rekomandime që kalon Kontrolli i Lartë i Shtetit në përmirësimin e bazës ligjore që përdor sot AKSHI.

Përveç kësaj, në momentin që ne sjellim një akt rregullator të këtij lloji, pa dyshim që aty vendosen edhe sanksione shtrënguese për autoritetet publike dhe private në momentin kur ato përdorin databazat dhe japin shërbim.

Pa dyshim, një aspekt të veçantë në këtë projektligj merr edhe mbrojtja e të dhënave personale, që jo vetëm e ka të rregulluar nëpërmjet instrumenteve digjitale që përdor, por e ka edhe të koordinuar me Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Ky projektligj sjell risi edhe për mbrojtjen kibernetike. Për këtë e gjithë infrastruktura kritike e informacionit është nën menaxhimin e AKSHI-t, sepse këto janë infrastruktura shumë të rëndësishme dhe kërkojnë vëmendje të posaçme.

Nga ana tjetër, është shumë e rëndësishme të kuptojmë se në momentin që shtohen shërbimet, në momentin që shtohet edhe ndërveprimtaria e të gjitha databazave shtetërore apo shtohet numri i regjistrave digjitalë, ka shumë nevojë që edhe kapacitetet njerëzore që punojnë me këto burime informacioni të trajtohen më shumë. Kështu, edhe aftësia e personelit tek AKSHI është një nga gjërat që është menduar të vijë si risi me futjen në zbatim të këtij projektligji.

Gjithashtu, kërkohet që edhe infrastruktura jonë digjitale të pësojë rritje në investime publike, prandaj, për këtë arsye, te disa komisione tuajat ju keni parë që po trajtohet një marrëveshje e re, ratifikimi i të cilës kërkon diskutim për përdorimin e tyre.

Unë mendoj se në këto kushte, ku të gjithë kemi qenë përdorues të shërbimeve të AKSHI-t, ai na ka lehtësuar jetën, na ka bërë të mundur që ta marrim në formë digjitale, në *email*-in tonë, qoftë edhe në aplikacionin që përdor AKSHI, ku ka rreth 340 mijë përdorues, rregullimi legjislativ i kësaj Agjencie është i domosdoshëm jo vetëm për të, por edhe për mënyrën se si i ofron shërbimet.

Ndaj, unë as nuk e diskutoj që për të gjithë kolegët kjo është një risi pozitive dhe çon e shumë më pranë qytetarëve dhe bizneseve, shërbimin digjital.

Ju falënderoj të gjithëve për kontributin që keni dhënë në diskutimet tuaja!

Lindita Nikolla - Faleminderit!

Blerina Gjylameti? Nuk është. Konsiderohet që është tërhequr.

Xhelal Mziu? Nuk është. Konsiderohet që është tërhequr.

Toni Gogu e ka fjalën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk bëhet kjo, ju e dini.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po filluam kështu, nuk mbaron kurrë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, zoti Bardhi!

Toni Gogu – E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë që po na ndiqni sot,

Pavarësisht faktit që kjo është një seancë e gjatë, unë besoj se ky është një moment kyç për historinë e vendit tonë. Prezantimi i ligjit “Për qeverisjen elektronike” nuk është një gjë e zakonshme, por besoj se është hapja e siparit të revolucionarizimit të shërbimeve publike në vendin tonë dhe Shqipëria i bashkohet avangardës, pararojës së vendeve, të cilat sot po e vendosin teknologjinë dhe revolucionin teknologjik në shërbim të qytetarit.

Ndaj, ai diskutim i gjatë publik, që është bërë nëpër kohë, nëse duhet të ulim shërbimet, kostot, duke hequr shërbimet për qytetarin, apo duhet të rritim taksat, në mënyrë që t’u ofrojmë më shumë shërbime qytetarëve, besoj që nuk i shërben zhvillimit të vendit, besoj që nuk i shërben as diskutimit tonë të sotëm, për shkak se teknologjia na ka ofruar një opsion të tretë.

Sot që flasim, epoka teknologjike ka treguar, përmes biznesit, se si kompani, të cilat nuk kanë qenë aty më përpara, e kanë kthyer botën e biznesit përmbys. E kemi parë në transport, përmes *uber*-it; e kemi parë në argëtim, përmes *Netflix*-it; e kemi parë në tregtinë elektronike, përmes *Amazon*-it, po e shohim edhe në shumë e shumë shërbime të tjera, që sot janë bërë një pjesë jashtëzakonisht e rëndësishme e çdo qytetari global.

Ndaj, unë besoj te forca e shumicës qeverisëse, e cila, përmes këtij ligji, imagjnon që

shërbimet publike, që janë fytyra publike e një qeverisjeje, duhet të modernizohen, duhet të jenë më të shpejta, duhet të jenë më të mira, duhet të jenë dhe më të lira për qytetarin, për shkak se konkurrenca është aty. Çdonjëri nga ne do të donte t'i merrte shërbimet nga shërbimet publike, ashtu siç i merr nga shërbimet private. Ndaj, ky ligj, që ne miratojmë sot, besoj se vendos gurin e themelit në kornizën e revolucionarizimit digjital të shërbimeve publike.

Po të krahasosh, në fakt, imagjinatën e kësaj shumice qeverisëse me imagjinatën që shkonte deri te: "Do t'i ofrojmë çdo shqiptari në mos pentium 4, por pentium 3 dhe pentium 2, 100%, pa diskutim", besoj që diskutimi politik ka mbaruar, për shkak se ajo çfarë i ofrohet sot çdo qytetari është që nga shtëpia e tij, nga karrigia, kolltuku apo minderi i vet, ai mund t'i kryejë shërbimet e tij në hipotekë, në noteri apo kudo.

Pra, bëhet fjalë për 1227 shërbime, tha zonja ministre, këto i thonë edhe auditorët e pavarur, të cilat ti mund t'i kryesh pa u ballafaquar me asnjë burokrat, as dorëgjatë, as veshëshurdhët, por i kryen në qetësinë tënde dhe merr shërbimin tënd. Sot që ne flasim janë 25 milionë dokumente të vulosura elektronikisht, sipas standardit europian, në sistemet tona.

Ndaj, unë besoj që qeveritë kanë shumë për të mësuar nga gjigantët digjitalë dhe ky projekt që ne kemi sot përpara është një ogur shumë i mirë për çdo qytetar shqiptar, pasi në mënyrë të ngjashme ne kemi nxjerrë të njëjtat mësim të vlefshme:

- thjeshtojmë proceset administrative;
- eliminojmë dyfishimin e kostove dhe të vonesave;
- rritim efikasitetin, eficiencën.

Prandaj 55 sisteme, që janë sot në *e-Albania*, ne i centralizojmë dhe i standardizojmë.

Në komision, zonja ministre prezantoi se si tashmë shërbimet do të organizohen sipas *life events*, pra ngjarjeve të jetës që i ndodhin çdo qytetari. Pra, nëse ti shkon të regjistrosësh një qytetar të sapolindur në Republikën e Shqipërisë, të gjitha shërbimet që kanë të bëjnë me një bebe, që i bashkohet bashkësisë sonë, vijnë menjëherë tek ai seksion. E njëjta gjë ndodh me një qytetar, i cili hap biznesin e tij, apo me një qytetar, i cili sapo krijon lidhjen martesore. Pra, të gjitha shërbimet ty të vijnë paketë në atë stacion jete ku ti ndodhesh në atë moment.

Prandaj, nëpërmjet këtij ligji ne u mundësojmë qytetarëve aksesin elektronik të një game të gjerë shërbimesh, ne u kursejmë qytetarëve përmes qeverisjes elektronike 990 vjet radha; 120 milionë euro, nëse nuk gaboj, është kursimi që bëhet në buxhetin e shtetit, ndërkohë që vetëm nga heqja e tarifave janë 9 milionë e ca euro.

Pra, këto janë risitë dhe të mirat e qeverisjes elektronike, por jam i sigurt se ka edhe sfida, ka sfida qoftë në diskutimet tona që ne bëjmë, qoftë nga vetë nëpunësit e administratës publike.

Sfida e parë është infrastruktura e nevojshme, por edhe trajnimet gjithëpërfshirëse, pasi vetë punonjësit, ndonjëherë, janë ata, të cilët duan të pengojnë zhvillimin teknologjik, duke thënë se e bëjnë më mirë punën, ndoshta edhe më mirë se makineria. Ndërkohë, së bashku kemi diskutuar edhe në Komisionin e Sigurisë për masat që duhet të marrim për sa i përket sigurisë kibernetike, të cilat vazhdojnë dhe janë në rritje e sipër.

Kolegë, pa ju marrë më shumë kohë, dua të them se standardet e larta që janë vendosur në jetën e qytetarit sot, qoftë të Republikës së Shqipërisë, qoftë edhe të qytetarit global, për shkak se bota është e hapur, janë standarde, të cilat qeveritë duhet t'i ofrojnë me të njëjtin komoditet, me të njëjtin reagim, duke bërë që qytetarët të kenë të njëjtën pritje nga qeveritë në ofrimin e shërbimeve të tyre.

Në përfundim, në tejkalim të të gjitha pengesave dhe sfidave që i përmendëm, qoftë të rezistencës që mund të bëhet nga administrata publike, për shkak se nënkupton një revolucion në administrimin publik, gjithashtu, qoftë të prezantimit dhe vendosjes së teknologjisë në shërbim të qytetarit, patjetër sfidë do të ishte që debati ynë të orientohej pro qeverisjes elektronike, duke shmangur thënie të tilla, si: "Ne të ulim taksat" apo "Ju do të ngrini taksat", sepse kjo bisedë tashmë ka mbaruar.

Në fund dua të them se përmes këtij projektligji ne forcojmë transparencën dhe llogaridhënien.

Unë kam dëgjuar se jeni të shqetësuar për aktivistin digjital. Pikërisht këto sisteme bëjnë të mundur gjurmimin se çfarë bën çdo punonjës i administratës, por ju trembeni se keni tjetër hall.

Sapo ka përfunduar gjyqi ku ju shkuat, në mos gaboj, në KAS për Rrogzhinën, dhe ku në

mënyrë të përsëritur nuk kërkuat atë që kërkon këtu nga mëngjesi deri në darkë, zhvlerësimin e rezultatit zgjedhor. Pse? Sepse keni ndërtuar një fabul të një gjyshi (po lexoja edhe një pjesë të një gazetari të njohur, Fabion Hasani, që tregonte historinë e një gjyshi të kohës së tij), i cili vjen këtu dhe ditën e parë thotë: “Kemi humbur se na tradhatoi Luli”, pastaj ditën e dytë thotë: “Kemi humbur se na i vodhi votat Edi Rama”, dhe ditën e tretë thotë: “Kemi humbur se këta i ndihmoi Ilir Rusmali i KAS-it”. Pra, janë tri përralla.

Ditën e parë demokratët e shkretë besojnë përrallën e parë të Lulit, ditën e dytë duhet ta harrojnë përrallën e parë dhe të besojnë të dytën, pra çdo ditë nga një përrallë të re. Ndërkohë, ndajeni mendjen, se me ritmin që ai ka nisur të shpallë armiq të partisë të gjithë bashkëpunëtorët e ngushtë, do t’ju vijë radha shumë shpejt edhe juve, sepse koha është e gjatë në opozitë. Çfarë ndodh? Ndodh që do të rehabilitohen vetëm të vdekurit. Domethënë, kur ndonjëri nga ju, larg qoftë, mund të ndërrojë jetë, vetëm atëherë do të rehabilitohet, përndryshe sa është gjallë do të jetë armik. Kështu që filloni dhe riorganizohuni siç duhet, ndani mendjen se si të vendosni teknologjinë, në fillim në shërbim të partisë suaj dhe anëtarëve të partisë, pastaj të qytetarëve, ndërsa ne i kryejmë këto punë.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Zoti Vangjel Dule nuk është, zonja Albana Vokshi nuk është, ndaj këtu mbyllen diskutimet për këtë pikë.

Kalojmë te pika tjetër e rendit me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Hapim diskutimet.

Zoti Petro Koçi, keni fjalën.

Petro Koçi – Faleminderit, zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë,

Më lejoni ta filloj me një koment lidhur me atë çka është diskutuar për situatën në Kosovë. Këtu ndodh shpesh që vjen kryedhëndri i sllavisë dhe mban kaq fjalime patetike për kombin, sa që edhe dëshmorëve të UÇK-së nën dhë u duket vetja një hiç përpara bëmave të mëdha që ka bërë ky burri, i cili vjen këtu çdo të enjte për të folur për kombin. Ndërkohë, dua të kujtoj se është i njëjti person që i ka bërë thirrje delegacionit kosovar në Rambuje që të mbante të njëjtin qëndrim si

Milloseviçi, pra të mos e firmoste Marrëveshjen e Rambujesë, të njëjtën gjë po bën edhe tani. Kështu, është e udhës që kur të tjerët të flasin për situatën, të shikojnë pak edhe nga vetja.

Çfarë ndodhi kur Kryeministri anonçoi se ka bërë një draft, natyrisht, të përgatitur nga ekspertë ndërkombëtarë, lidhur me çështjen e asosacionit në Kosovë? Ia bëri autostradë euroatlantike Albin Kurtit për të dalë nga rruga e vetëfundosjes që kishte filluar. I përgatiti justifikimin moral të jashtëzakonshëm Albin Kurtit përballë opinionit vendas për të marrë kthesën e duhur. Këtë bëri Edi Rama. Ju do të thoni: po këtë asosacionin a e do njeri? Asnjë nuk e do asosacionin, por asosacioni është një detyrim, nuk e do as Albin Kurti, as Edi Rama, as Petro Koçi, as ata dëshmorët që janë atje ku janë, por është një detyrim. A do Serbia që Kosova të vazhdojë të jetë e pavarur? Sigurisht që nuk do, por është detyrim, nuk ka çfarë bën.

Kështu që ne duhet të jemi të kujdesshëm, sidomos kur flasim në emër të një politike të konsoliduar euroatlantike, si në Shqipëri, kur komentojmë për zhvillime dhe situata për të cilat komuniteti ndërkombëtar, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Europian janë përcaktuar qartazi, nuk kanë lënë ekuivokë për t’i interpretuar ndonjëri prej nesh. Kështu që gjithë këshillimi ynë, gjithë investimi ynë duhet të jetë në favor të një qëndrimi edhe në Kosovë të njehsuar me komunitetin euroatlantik. Ky ishte komenti im paraprak për atë që u diskutua në fillim.

Për sa i përket projektligjit “Për arsimin parauniversitar”, sigurisht, më vjen keq që sot nuk është ministrja, por ne e kishim prezente në Komisionin e Edukimit dhe Mjeteve të Informimit Publik. Ndërkohë, për arsye se unë jam zëvendësueskryetar në Komisionin e Ligjeve, siç e quajmë ne rëndom, mora pjesë edhe atje. Ky është një ligj shumë i mirëpritur, sjell një sërë ndryshimesh shumë pozitive për sistemin arsimor parauniversitar.

Unë do ta përcaktoja me tre drejtime: liberalizon, rregullon dhe legalizon.

Çfarë liberalizon? Liberalizon disa norma të deritanishme, siç është ajo e moshës së hyrjes në klasë të parë, ku lejon fëmijët, të cilët janë të zhvilluar në raport me vlerësimin që bëjnë prindërit apo dhe ekspertët psikologë e të tjerë, që mund të futen në shkollë edhe pse moshën 6 vjeç mund ta mbushin brenda 31 dhjetorit të vitit

shkollor, që sapo ka filluar. Për shembull, liberalizon edhe faktin që në shkollat me natyrë të përgjithshme të hapen klasa të orientuara. Kjo do të thotë që edhe në disa vende, të cilat shpeshherë ne i quajmë gabimisht si provinca, në gjimnaze apo në shkollat 9-vjeçare, të hapen klasa me natyrë artistike, sportive apo me një natyrë profesionale tejet të veçantë, ku të kultivohen talente të spikatura edhe në moshë të vogël.

Aspekti i dytë është rregullator, ai rregullon veprimtarinë pas mësimit. Ju e dini që pas mësimit shumë fëmijë shkojnë në kurse të ndryshme, në trajnime e të tjera, të cilat, në fakt, me legjislacionin e sotëm nuk janë të rregulluara. Me këto ndryshime ky proces rregullohet, që do të thotë se është më i kontrollueshëm, krijon më pak hapësira për abuzime e të tjera. Gjëja më e rëndësishme është se ndalon rreptësisht dhënien e mësimit nga arsimtarë, të cilët kanë qenë subjekte të ndëshkuara nga ligji për krime seksuale, krime ndaj të miturve e të tjera. Ky diskutim ka qenë shumë i gjerë te Komisioni i Ligjeve dhe ka pasur propozime se si kjo gjë mund të rregullohej, në mënyrë që të mos lihej hapësirë për abuzim.

Në Komisionin e Edukimit dhe të Mjeteve të Informimit Publik ne përcaktuam se është ministri përkatës ai që nxjerr udhëzimin, i detyruar nga ligji, për të përcaktuar veprat penale, të cilat janë me natyrë të pahijshme dhe rrezikojnë integritetin e mësimdhënies dhe raportin e mësuesit me nxënësit. Ky është një akt, i cili, natyrisht, është legal dhe nëse ndonjë ministër në të ardhmen do të tejkalonte rregullat dhe do të nxirrte ndonjë aspekt që do të prekte të drejtat e njeriut, sigurisht, që do të jetë i atakueshëm pastaj nga strukturat tona të drejtësisë, deri tek ajo kushtetuese. Gjithashtu, rregullon edhe shkollat speciale, duke i kthyer ato në qendra burimore, ku prindërit dhe komuniteti mund të jetë më të lidhur me kategorinë e fëmijëve me nevojë të veçanta, pra me fëmijët që nuk dëgjojnë ose nuk shikojnë.

Çfarë legalizon ligji? Për shembull, shkolla e bashkuar është thënë gjithë jetën “shkollë e bashkuar”. Unë, kur kam qenë në Kalanë e Dodës nga viti 1984 deri në vitin 1988, isha në një shkollë të bashkuar, por legjislacioni ynë nuk e ka. Ky ndryshim në ligj e legalizon edhe këtë gjë dhe e përcakton se çfarë do të thotë “shkollë e bashkuar” dhe shumë aspekte të tjera.

Sigurisht, ne e kaluam në komision me shumicë votash, por vumë re se edhe deputetët e

opozitës në shumë gjëra ishin dakord, sidomos për moslejimin e atyre subjekteve që janë ndëshkuar nga ligji për ato lloje krimesh, të cilat unë i përmenda, pra që këto subjekte të mos kenë më mundësi të hyjnë në dyert e shkollave dhe të kenë raporte me nxënësit. Ne e dimë shumë mirë që kanë ndodhur gjëra tejet të rënda dhe është tronditur opinioni publik, por mendoj se këto ndërhyrje në ligj janë efikase dhe besoj se do të ndërpresin çdo lloj arsyeje apo kriteri, deri tani të lejueshëm, dhe të bëjë të mundur pikërisht që këto lloj subjektesh të mos hyjnë më në shkollat tona.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Faleminderit!

Fjala për zonjën Merita Bakiu.

Të përgatitet zoti Florenc Spaho.

Merita Bakiu – E nderuara, zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë,

Sot po diskutohet për disa ndryshime në ligjin nr.69/2012 “Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”.

Arsimi është baza e zhvillimi të një kombi. Sa më i arsimuar të jetë një komb, aq më shumë shanse ka që ekonomia e një vendi të rritet, të përparojë në drejtim të teknologjisë dhe të inovacioneve, duke përmirësuar mirëqenien e qytetarëve të saj dhe duke garantuar një zhvillim të qëndrueshëm për gjeneratat.

Ky ndryshim vjen në një moment kur problematikat për arsimin parauniversitar janë të shumanshme, të mprehta, ku mungon vizioni, vullneti dhe politikat për ta përmirësuar këtë situatë. Kujtoj këtu se jemi të renditur në treshen e fundit në rajon në testin ndërkombëtar të Pisa-s, gjë që tregon se diçka çalon si në mësimdhënie apo në kurrikula.

Kurrikulat janë unike në rajon e më gjerë për sa i përket përshtatshmërisë së tyre. Përmbajtja e kurrikulave, e planeve, e programeve dhe teksteve mësimore do të vijojnë të jenë po ato, të cilat shquhen për moskonsiderimin e nevojave dhe të mundësive të nxënësve dhe për kundërtitë e konfliktit që ato kanë me principet filozofike e psikopedagogjike të hartimit të tyre. Unë mendoj se nuk jemi vonë për të bërë një analizë të plotë të kurrikulës apo edhe të teksteve që kanë 10 apo edhe 16 vjet, që janë marrë nga Britania e Madhe, ku shumë gjëra kanë ndryshuar, sidomos në teknologjitë e informacionit, dhe ne duhet të bëjmë përshtatjen tonë sa më shpejt.

Në gjykimin tonë ky projektligj do të donte më shumë kohë për shqyrtim edhe për faktin se ndryshimet e sjella janë në kundërshtim me pretendimin e rritjes së cilësisë në arsim, ato nuk sjellin asgjë të re. Është më mirë që disa situata të rregullohen me udhëzime, me rregullore dhe me akte nënligjore, pa ndërhyrë në mënyrë frekvente në ligj, ashtu siç po ndodh në këtë rast. Kjo pasi edhe në amendimet e sjella së fundi bëhet fjalë për disa institucione që ekzistojnë dhe që janë legjitimuar edhe me udhëzim të ministrit të Arsimit.

Në nenin 1, ku flitet për termin “Shkollë e bashkuar”, ky institucion shkollor është i përcaktuar njëloj siç po vjen sot. Ju kujtoj se kjo rregullore ka dalë me urdhër të ministrit të Arsimit nr.31, datë 28.01.2020 dhe është ende në fuqi.

Neni 1, pika 5/2, thuhet: “Qendër burimore dhe aftësi të kufizuara”. Edhe ky amendim më duket i panevojshëm për sa kohë që në ligjin nr.69/2012 kemi nene që flasin në mënyrë të posaçme për këtë kategori nxënësish.

Amendimi i nenit 55 duket thjesht burokraci për të legjitimuar drejtuesit më frymë tërësisht politike në drejtimet e shkollave tona.

Ju vetë keni sjellë me këmbëngulje një ndryshim ligjor, ku drejtuesit e institucionit të arsimit parauniversitar duhet të kishin patjetër shkollën e drejtorëve, por mjafton që një kandidat të jetë regjistruar në shkollën e drejtorëve dhe emërohet përkohësisht drejtor.

Në amendamentin e nenit 55, që përkon me nenin 8, të projektligjit, thuhet se drejtuesi i shkollës shkarkohet në rast se konstatohet se pas emërimit si drejtor i IPAP-ve bën pjesë në forumet drejtuese të partive politike. Këtu kemi të bëjmë me dy standarde, pasi drejtori i institucionit vendor përgjegjës është vetë në forumet më të larta politike, jo anëtar, si drejtuesi i lartë forumesh vendore dhe qendrore, por edhe në asamblenë e PS-së.

Në nenin 6, pika 4, thuhet se drejtuesi i IPAP-it shkarkohet nëse ka kryer shkelje procedurale të zhvillimi të provimeve kombëtare të arsimit bazë dhe të Maturës Shtetërore. Drejtuesi i IPAP-it nuk ka asnjë mundësi të ndikojë apo të jetë pjesë e Maturës Shtetërore, pasi është i përjashtuar nga ky proces.

Neni 12, pika 2, me të cilin mund të jemi dakord në parim, duhet të rishikohet mirë edhe

nga juristët, pasi nuk e dimë se si mund të klasifikohen veprat e pahijshme.

Neni 13 mund të ezaurohej fare mirë me urdhra dhe udhëzime, për sa kohë ligji lejon hapësira për shkollimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Në përfundim, ardhja e këtij projektligji me shumë ngut nuk justifikohet as nga përmbajtja e tij dhe as nga risitë që sjell. Ndryshimet do të ishin shumë të pranueshme nëse në to do të përfshiheshin amendime për shkollat, si: zgjatja e orarit të qëndrimit të nxënësve, duke u dhënë mundësi të shprehin pasionet e tyre; ndihma me programe të veçanta për fëmijët me vështirësi në të nxënë, për t'i kapërcyer këto vështirësi; programe të veçanta për nxënësit elitare në fusha të ndryshme; programe për trashëgiminë kulturore, historike dhe për albanologjinë, të cilat zënë pak vend në kurrikulën tonë të arsimit parauniversitar; shtimi i kabineteve të informatikës, të historisë, arteve dhe zejeve që në moshë të herët; programe trajnimi falas për mësuesit dhe jo marrje kreditesh me lekë, siç ndodh sot me mësuesit shqiptarë; masa të thella për depolitizimin e plotë të shkollave dhe për rritjen e cilësisë përmes dijeve bashkëkohore, me infrastrukturë bashkëkohore; bonuse për mësuesit që pranojnë të punojnë në zona të thella, siç ndodh edhe me shumë praktika të mira jashtë vendit.

Për të gjitha këto arsye, sikurse e përmenda, ndryshimet nuk sjellin asgjë të re në drejtim të rritjes së cilësisë, të procesit të mësimdhënies dhe të mësimnxënies.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjala për zotin Florenc Spaho.

Florenc Spaho – E nderuar Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Seanca e sotme, edhe pse me një rend tjetër dite, është tejet e gjatë, e ngarkuar dhe me hipersensibilitet për të gjithë kolegët, si të mazhorancës, edhe të opozitës, për shkak të ndodhive në Kosovë, por ne jemi besimplotë që çdo gjë do të shkojë më së miri, pasi nuk na duhet asnjë provokim, por na duhet një diplomaci për të dhënë zgjidhje, siç e meriton Kosova, krah dy aleatëve tanë më strategjikë, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Europian.

Për sa i përket diskutimit të sotëm të projektligjit për sistemin parauniversitar, edhe pse ministrja e Arsimit nuk është prezente, dua ta falënderoj për kontributin që ka dhënë sa herë është kërkuar nga anëtarët e nderuar të komisionit për të zhvilluar seanca maratonë, prej më shumë se 5-6 orësh, për të dhënë më të mirën për këtë projektligj të shumëpritur, për hir të së vërtetës, edhe nga komuniteti i prindërve!

Projektligji për të cilin diskutohet sot sjell risi, absolutisht, për të bërë më të mirën për të gjithë fëmijët tanë në sistemin parauniversitar, por jo vetëm.

Të gjithë jemi koshientë që ka pasur kërkesa nga prindërit për t'i futur fëmijët në klasën e parë pa mbushur 6 vjeç. Ky ligj nuk detyron, absolutisht, por u mundëson të gjithë prindërve, që mendojnë se fëmijët e tyre e kanë të gjithë mundësinë dhe kapacitetin për t'u futur 5 vjeç në klasën e parë dhe të mbushin 6 vjeç në vitin kur fillojnë shkollën, pra deri më 31 dhjetor të atij viti, ta bëjnë këtë. Kjo është një risi.

Një risi tjetër e këtij ligji janë klasat speciale. Ne kemi shumë të rinj të talentuar, të cilët duhen promovuar, si në fushën e artit, edhe të sportit. Ne kemi bërë punë shumë të mirë edhe për sportin, për klasat sportive. Deri para vitit 2013, klasat sportive në shkolla ishin inekzistente dhe orët e edukimit fizik ishin pothuajse drejt tkurrjes totale, ndërsa tani janë shtuar klasat sportive dhe orët e edukimit fizik, që të rinjtë të jenë sa më afër sportit. Duke qenë sa më afër sportit, ata do të jenë më larg veseve. Një ndër këto vese, ku shpeshherë edhe ne prindërit (flas edhe si prind sot) mund ta humbim betejën, por nuk duhet të humbim luftën, është qëndrimi i të rinjve për shumë orë në telefon. Sporti është një ndër mekanizmat kyç që ne duhet të fusim në këto shkolla, dhe e kemi futur, që fëmijët të jenë sa më pranë sportit dhe larg veseve, jo vetëm larg telefonave, por edhe larg veseve të tjera. Sporti, përveçse i bën mirë shëndetit, është edhe një garë, që, duke e futur ndërmjet fëmijëve, i bën ata të konkurrojnë denjësisht për atë çfarë dinë të bëjnë më mirë, qoftë edhe në art.

Çfarë risie tjetër sjell ky ligj? Këshillimi për karrierën nuk ka qenë në shkollat e sistemit parauniversitar. Ne sot po promovojmë këshilluesit për karrierën. Jo të gjithë mund të shkojnë në universitet, por mund të bëhen profesionistë shumë të mirë, me zanate që mund

t'i përfitojnë nga shkollat profesionale apo nga qendrat e formimit profesional.

Ky ligj i shumëkërkuar, siç e thashë më sipër, nga komuniteti i prindërve dhe nga grupe të ndryshme interesi, sjell risi edhe për personat me aftësi të kufizuara. Absolutisht, ka njerëz të cilët mund të jenë të aftë dhe mund të bëhen të pavarur pas moshës kur kanë nevojë për kujdes prindëror. Çfarë bëhet pas moshës së kujdesit prindëror? Në sistemin parauniversitar u jepet rëndësi e veçantë edhe fëmijëve me aftësi të kufizuara, me shkolla të posaçme, me orë të posaçme, që t'i bëjmë të ndihën njësoj dhe të integrohen në shoqërinë tonë.

Unë njoh shumë fëmijë me aftësi të kufizuara, kam pasur fatin e madh të punoj me ta, dhe ata dhurojnë dashuri pa kushte, për hir të së vërtetës, të mësojnë se sa e bukur është jeta. Ata dinë të zhvillojnë një zanat apo një profesion më mirë se një person tjetër. Ne jemi pikërisht ata që duhet t'i stimulojmë dhe të krijojmë iniciativa për këta fëmijë, ndaj edhe ky ligj është kaq shumë i kërkuar, duke pasur edhe një fokus shumë të veçantë në arsimin parauniversitar.

Shpeshherë gjendemi përballë disa realiteteve që duhen thënë. A kemi pasur vite më parë oficerë sigurie të licencuar? Jo, nuk kemi pasur, por sot kemi. Për më shumë se 2-3 vjet kemi diskutuar për krijimin e një regjistri për të gjithë personat e akuzuar për krime seksuale, që këta individë të mos jenë pjesë e shkollave si mësues apo si staf mbështetës. Sot ky regjistër është realitet, për t'u dhënë më shumë siguri prindërve, fëmijëve dhe familjeve, të cilët nuk mund ta dinin cili ishte mësuesi apo punonjësi i asaj shkolle. Ne krijuam regjistrin për të gjithë personat që janë akuzuar për krime seksuale.

A kemi pasur më parë kaq shumë stafe psikosociale dhe stafe mbështetëse? Jo. Kjo do të thotë se fëmijët kanë qenë dhe janë gjithmonë prioriteti ynë. E gjithë bota rrotullohet ndaj sigurisë së engjëjve tanë, duke u dhënë një mbështetje të duhur, duke mos lejuar që në këto shkolla të japin mësim të sipërpërmendurit, duke i mbështetur të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara, por edhe fëmijët që ndihën të bullizuar apo të ndrojtur. Duke pasur stafe psikosociale, sot nëpër shkolla këta fëmijë janë më të lirshëm dhe integrohen më lehtë në shoqëri. Pse? Sepse pikërisht këto stafe psikosociale, të cilat ne nuk i kemi pasur shumë vite më parë, sot janë prezente në çdo shkollë.

Ky projektligj vjen sot pikërisht për të bërë ndryshime.

Përse themi që nuk mund të ndërhyjmë dot në ligj? Nëse ne nuk e kemi bërë aq mirë sa duhet një ligj dhe sot lind nevoja imediate për regjistrin e personave të akuzuar për krime seksuale, të cilët edhe kanë punuar në shkolla, si mësues apo si staf mbështetës, duhet ndërhyrë në ligj, duhet krijuar ky regjistër, apo ligje të tjera.

Unë jam besimplotë që ky projektligj do të kalojë, sepse të gjithë e duam sigurinë e fëmijëve.

Dua t'i falënderoj të gjithë anëtarët e komisionit, edhe të opozitës, që në këtë seancë diskutimi morën kohën e duhur për të bërë më të mirën për këtë projektligj, por nuk e pranoj të thuhet se ky projektligj nuk ka risi! Ky projektligj vjen pikërisht për ata fëmijë dhe për familjet e tyre, që kanë pasur frikë dhe kanë dëgjuar shumë në medie për mësues të akuzuar për krime apo për ngacmime seksuale, të cilët pas disa vitesh janë futur sërish në mësimdhënie.

Jam besimplotë dhe i ftoj të gjithë kolegët ta miratojnë projektligjin!

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjala për ministren Kushi.
Koha është e pakufizuar.

Evis Kushi – E nderuar Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë,

Projektligji për arsimin parauniversitar, të cilin do ta miratojmë sot, është një lajm shumë i mirë për të gjithë mësuesit, nxënësit dhe prindërit, sepse zgjidh shumë problematika, plotëson vakuume ligjore, por edhe e për afron atë më shumë me Bashkimin Europian.

Në fillim të fjalës sime, dua të falënderoj të gjithë ata që kanë dhënë kontribut, jo vetëm ekspertët e Ministrisë së Arsimit dhe punonjësit e institucioneve të ndryshme në varësi të saj, por edhe Këshillin Kombëtar të Arsimit Parauniversitar, sindikatat, parlamentin e nxënësve, shoqërinë civile, organizatat partnere, sepse përgjatë 1 viti të tërë ne kemi zhvilluar shumë tryeza, shumë konsultime, pikërisht për të arritur në draftin përfundimtar, në projektligjin që paraqitet sot dhe që do të marrë miratimin tuaj, të nderuar kolegë!

Arsyeja kryesore pse vendosëm të ndryshojmë ligjin e arsimit parauniversitar është pikërisht kthimi i shkollave speciale për nxënësit me aftësi ndryshe në qendra burimore, sipas

modeleve më të mira që ekzistojnë sot jo vetëm në vendet e rajonit, por edhe në vendet e Bashkimit Europian, për të ofruar jo vetëm arsim për nxënësit me aftësi ndryshe, por edhe më shumë shërbime për ta dhe për familjet e tyre, më shumë trajnime për mësuesit ndihmës apo për punonjësit psikosocialë, që janë të angazhuar, dhe shumë aktivitete të tjera.

Paralelisht me projektligjin, ne kemi punuar për të hartuar strukturën dhe mënyrën e funksionimit të këtyre qendrave burimore, pikërisht për të bërë më të mirën për nxënësit me aftësi ndryshe.

Ne kemi 7 shkolla speciale në të gjithë vendin dhe dy institute: Instituti i Nxënësve që nuk Dëgjojnë dhe Instituti i Nxënësve që nuk Shikojnë. Pikërisht këto dy institute do të jenë të parat që do të kthehen në qendra burimore, e më pas modelet e tyre do të shtrihen në të gjithë vendin.

Kemi bërë deri tani hapa të mirë, pozitivë, edhe për sa i përket kurrikulës së këtyre shkollave, edhe për sa i takon shkollës së mesme për nxënësit që nuk dëgjojnë, që deri më sot nuk ka pasur, por, për fat të mirë, ne punuam shumë, dhe këtë vit është hera e parë që nxënësit që nuk dëgjojnë, kur mbarojnë klasën e 9-të, nuk do të jenë të detyruar të qëndrojnë në shtëpi se nuk ka më arsimim për ta, por do të vazhdojnë arsimin profesional, do të marrin një profesion dhe nesër do të jenë të aftë për veten e tyre, së pari, dhe pse jo, të japin kontribut për shoqërinë.

Së dyti, projektligji i ndalon personat që kanë kryer vepra penale ndaj të miturve apo ndaj institucioneve arsimore, ose vepra penale që cenojnë figurën e mësuesit, apo të gjithë ata që do të jenë pjesë e Regjistrat Kombëtar të të Dënuarve për Krime Seksuale, të punojnë në institucionet tona arsimore si mësues dhe në asnjë pozicion tjetër, edhe pas rehabilitimit të tyre. Natyrisht, ne duhet të jemi shumë të kujdesshëm, sepse kjo nuk duhet të jetë një mënyrë abuzimi. Në nen do të përcaktohen qartë se cilat krime do të përfshihen, patjetër, me një udhëzim, siç u rekomandua edhe në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, sepse ka edhe shumë dënime të tjera, për të cilat njerëzit, mësuesit apo punonjësit e institucioneve arsimore, pasi rehabilitohen, mund të kenë të drejtën si të gjithë të tjerët.

Pra, lista e krimeve që prek ky nen i ligjit do të jetë e përcaktuar qartë, në mënyrë që të mos ketë asnjë abuzim dhe asnjë diskutim, por të garantojmë për nxënësit në institucionet tona arsimore, pse jo, edhe për mësuesit, më shumë garanci, më shumë mbrojtje dhe të mos cenohen nga asnjë rrezik, nga përsëritja e krimit (për ata që e kanë bërë më parë) apo nga një rrezik tjetër që mund të paraqitet nga persona të caktuar.

Një tjetër pikë e rëndësishme që vjen me këtë projektligj, është e drejta që u jepet prindërve për t'i regjistruar fëmijët e tyre në klasën e parë edhe në rastet kur ata nuk e kanë mbushur ende moshën 6 vjeç, por kanë një zhvillim psikomotor të spikatur. Regjistrimi i këtyre fëmijëve në klasën e parë do të bëhet me kërkesën e prindërve. Natyrisht, është vënë kriteri, afati deri më 31 dhjetor të vitit kur regjistrohet fëmija në klasën e parë, pra fëmija mund të mos e ketë mbushur moshën 6 vjeç, por edhe të mos jetë në moshë shumë të vogël. Të gjithë fëmijëve që do të mbushin moshën 6 vjeç deri më 31 dhjetor të atij viti, nëse prindi e kërkon dhe fëmija di të lexojë, di të numërojë, ka bërë klasat parashkollore, do t'u jepet kjo e drejtë, të cilën ligji aktual nuk ua jepte.

Së katërti, ne duam t'u japim më shumë zhvillim shollave të orientuara, siç janë shkollat artistike apo shkollat sportive. Aktualisht ne kemi 17 shkolla me arsim të orientuar, të cilave duam t'u japim një status të veçantë. Me këtë nënkuptojmë një strukturë organizimi dhe një mënyrë funksionimi të veçantë, që edhe punësimi i mësuesve, por edhe shumë vendimmarrje të tjera do të jenë ndryshe nga shkollat e tjera të zakonshme, pikërisht për t'u dhënë shkollave artistike më shumë zhvillim, autonomi dhe mundësi për t'u përshtatur me kërkesat që kanë sot nxënësit e talentuar dhe që ka në përgjithësi tregu artistik apo sportiv. Kemi punuar intensivisht; paralelisht me ligjin kemi punuar në grupe pune të veçanta me përfaqësues nga shkollat artistike apo shkollat sportive për të pasur mundësinë që shumë shpejt, pas miratimit të ligjit, të dalim me akte të tjera nënligjore për të filluar menjëherë zbatimin e këtij ligji.

Përveç statusit të veçantë për shkollat me arsim të orientuar, ne do të hapim edhe klasa të orientuara në shkollat e zakonshme, aty ku ka nevojë, ku ka nxënës të talentuar dhe ka kërkesë. Siç e thashë, ne kemi 17 shkolla artistike

në të gjithë vendin, por nuk i kemi dot në të gjitha qytetet. Ndërkohë, në të gjitha qytetet ne kemi nxënës të talentuar apo prindër të interesuar që fëmija i tyre të ndjekë studime edhe për disiplina të ndryshme artistike. Kështu me anë të këtij ligji do të hapim klasa të veçanta pikërisht për nxënësit që kërkojnë arsim të orientuar në një disiplinë të caktuar, duke u dhënë atyre mundësinë që ta kenë atje ku jetojnë dhe në shkollat që ata frekuentojnë.

Gjithashtu, me anë të këtij ligji ne do të shtojmë strukturën "Mësues në dispozicion" në çdo zyrë arsimore vendore në çdo bashki të vendit. Aktualisht ne e dimë që portali "Mësues për Shqipërinë" garanton meritokraci dhe transparencë, por shpeshherë, duke respektuar portalin, procedurat kërkojnë kohë, sepse, sapo lirohet një vend pune, ju e dini shumë mirë që ky vend i ofrohet atij që është renditur i pari në portal. Nëse ai nuk pranon, sigurisht, pasi merr kohën e tij për t'u menduar, i ofrohet atij që është renditur i dyti, i treti dhe shpesh kjo procedurë merr kohë dhe nxënësit mbeten pa mësim për disa ditë, shpeshherë, kur mësuesi i tyre mungon për arsye shëndetësore apo për arsye të tjera, merr më shumë kohë.

Kështu që kemi vendosur të kemi një strukturë mësuesish në dispozicion, të cilët punësohen me kontrata njëvjeçare pranë zyrave arsimore dhe janë të gatshëm në çdo moment, sa herë ka nevojë në një shkollë, kur mësuesi mungon, të shkojnë për ta zëvendësuar dhe kështu nxënësit nuk humbasin asnjë orë mësimi dhe nuk vonohen asnjë ditë e as një javë. Kjo ka qenë një kërkesë nga vetë institucionet arsimore, kanë qenë vetë drejtuesit e institucioneve arsimore, të cilët bien dakord me portalin, si mënyra më e mirë për të bërë punësimin e mësuesve me meritokraci dhe transparencë, ndërkohë ne duhet të reagojmë në situatat kur mësuesit mungojnë për arsye objektive.

Gjithashtu, kemi përfshirë në ligj institucionet arsimore private plotësuese, sepse për institucione, që janë zhvillime të fundit, si *afterschools*, ku prindërit mund t'i dërgojnë fëmijët e tyre pasdite ose edhe gjatë fundjavës për të bërë detyrat e shtëpisë apo edhe për aktivitete të ndryshme, kemi një vakuim ligjor. Ndërkohë, legjislacioni në fuqi nuk i ka të përcaktuara as kriteret dhe as procedurat se si hapet apo licencohet një institucion i tillë, ndërkohë atje janë fëmijët tanë, që shpesh marrin edhe mësim e u

rrezikohet t'u shtrembërohet arsimimi i tyre, për shkak se askush nuk mund t'i kontrollojë se çfarë arsimimi apo formimi kanë personat e punësuar në këto institucione. Me këtë ligj ne do t'i përcaktojmë qartë procedurat, rregullat, kriteret e institucioneve të tilla plotësuese private.

Për sa i takon monitorimit, inspektimit dhe vlerësimit të institucioneve arsimore, ligji i përcakton qartë përgjegjësitë dhe kompetencat që do të ketë çdo institucion, duke filluar nga Ministria e Arsimit, Agjencia për Sigurimin e Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, drejtoritë arsimore, drejtoritë rajonale, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar e kështu me radhë. Ndërkohë, bashkive, nëpërmjet këtij ligji do t'u kërkohet që, edhe kur duan të investojnë me të ardhurat e tyre në shkolla të reja, të marrin miratimin e Ministrisë së Arsimit, në mënyrë që të kemi një shpërndarje të investimeve sipas nevojave dhe politikave të arsimit parauniversitar.

E fundit, gjithashtu, kemi përfshirë në ligj konceptin e shkollës së bashkuar pikërisht në ato zona të largëta rurale, ku numri i nxënësve është më i ulët dhe ku është e pamundur të plotësohen kriteret për të pasur edhe një shkollë 9-vjeçare, edhe një shkollë të mesme. Prandaj, duke pasur një shkollë të bashkuar që ofron edhe arsimin fillor, edhe arsimin e mesëm të ulët, edhe arsimin e mesëm të lartë, u japim mundësinë nxënësve të arsimohen pranë vendbanimeve të tyre dhe u japim mundësinë prindërve që t'i kenë fëmijët e tyre afër, gjithashtu, ekonomizojmë burimet tona financiare dhe njerëzore, si dhe investimet tona në infrastrukturën arsimore.

Sfida jonë është zbatimi i ligjit, sepse ligji mund të jetë i shkruar bukur, mund të marrë në konsideratë edhe direktivat e BE-së, por, nëse ne nuk e zbatojmë siç duhet, të gjitha këto qëllime që kemi dhe të gjitha këto efekte që presim, nuk mund të kenë efikasitetin e duhur. Prandaj, jam e bindur dhe kam besim jo vetëm te Ministria e Arsimit dhe ekspertët, por tek të gjitha institucionet tona arsimore, në radhë të parë te mësuesit, që të gjitha këto ndryshime ligjore do t'i zbatojmë me përpikëri për ta rritur edhe më shumë cilësinë e arsimit tonë.

Faleminderit të gjithë atyre që kontribuan, natyrisht, edhe të gjithë anëtarëve të Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, të

cilët na ndihmuan që me sugjerimet e tyre ta bëjmë edhe më të mirë këtë ligj!

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjala për zonjën Eralda Bano.

Të përgatitet zonja Pranvera Resulaj.

Eralda Bano – E nderuar Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Nisur nga rëndësia e madhe që paraqet arsimit, si një e mirë publike dhe me impakt thellësisht kombëtar për zhvillimin e shoqërisë sonë, do të doja të ndaja disa mendime rreth amendimeve të ardhura në Kuvend për ndryshimet në ligjin 69/2012 “Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”.

Nisur nga detyrimi i dyfishtë, si pjesë e arsimit parauniversitar ndër vite dhe si përfaqësuese në këtë Kuvend e njëjës prej trevave më të njohura për traditën arsimore, siç është qarku i Fierit, po rendis disa nga problematikat që shfaqin amendimet e sjella së fundi në ligjin e arsimit parauniversitar.

Amendimet e ardhura nuk e vënë theksin mbi problematikat që ka sot arsimit në Shqipëri, ku përfshihen nxënës, mësues, drejtues shkollash, prindër, si dhe i gjithë komuniteti që është i lidhur drejtpërdrejt apo indirekt me sektorin e arsimit. Ne druhami se ndryshimet thellojnë politizimin e drejtimit të shkollës, si në rastin e komandimit të drejtorëve të shkollave apo mësuesve provizorë. Reformat e ardhura pak vjet më parë në këtë Kuvend me kaq bujë, si: Shkolla e Drejtorëve dhe portali “Mësues për Shqipërinë”, duket se nuk kanë dhënë rezultatet e mëdha që priteshin dhe tani, në vend që të shikonim përpara, bëjmë disa hapa mbrapa dhe kthehemi te komandimet e drejtorëve apo emërimet e mësuesve jashtë portalit, që do të mbeten ekskluzivitet sapo të fillojë fushata elektorale e radhës.

Ne prisim që të diskutonim shtimin e buxhetit të arsimit, i cili është më i ulëti në rajon dhe gati sa gjysma e vendeve të BE-së; rritjen e pagave në masën e premtuar me aq bujë me zë e figurë, por duhet të merremi me arnime, të cilat nuk e ndryshojnë fare cilësinë e dobët të copës fillestare. Nëse rritja 2400-3100 lekë e pagave të mësuesve quhet arritje, atëherë nuk ka nevojë ta diskutojmë fare.

Ne do të donim të votonim për shkollat me orar prej orës 07:30 e deri në orën 16:00, në mënyrë që prindërit të mos shkojnë poshtë e

përpjetë e të paguajnë shuma të majme nëpër *afterschool*-e, të cilat ju i legalizuar me ndryshimet e fundit që sollët.

Ishte rasti të votonim që shkollat të jenë jo vetëm për dhënien e dijës, por të ktheheshin në qendra të argëtimit, mësimit pasdite, të ofronin ushqim e shërbim shëndetësor falas dhe shumë aktivitete të tjera, për sa kohë, të paktën në letër, ne jemi vendi që e kemi arsimin dhe shëndetësinë falas. Mirëpo këto të fundit mbeten vetëm në letër, pasi prindi paguan ngrohjen e shkollës, transportin, madje edhe rojën, kur, në fakt, këtë detyrim e ka pushteti vendor.

Projektligji na vjen me masa e dënime për drejtuesit e shkollës në procesin e Maturës Shtetërore dhe provimet e lirim, kur dihet fare mirë se ata nuk kanë asnjë rol në këto proces, por projektligji nuk jep dënime për drejtuesit e Ministrisë së Arsimit, konkretisht për Komitetin e Maturës Shtetërore, që kanë përgjegjësinë ligjore për organizimin e provimeve të lirim dhe të Maturës Shtetërore. Projektligji nuk jep asnjë masë për përfaqësuesit e Ministrisë së Arsimit në këto provime, as për ata të institucioneve të varësisë. Dihet sa mirë është organizuar procesi i provimeve të lirim dhe i Maturës Shtetërore në vitet e fundit, por përgjegjësia institucionale dhe ligjore ka qenë zero për këdo që ka marrë pjesë në këtë proces, ose siç mund të thuhet në gjuhën popullore: “Nuk i ka hyrë askujt një gjemb në këmbë”.

Konkretisht, dua të hedh një pyetje për diskutim: a munden këto ndryshime të ligjit, që vijnë me kaq ngut, ta përmirësojnë dhe ta rritin cilësinë e arsimit? Mund të them pa asnjë mëdyshje që jo. Këto ndryshime nuk na garantojnë rritjen e renditjes në testimin PISA, sepse ne nuk kemi shtim, duke filluar nga kompjuterët, kabinetet për lëndët shkencore apo edhe për lëndë, si arte, muzikë, histori e të tjera.

Projektligji shumëmilionësh në euro i tabletave dhe i mësimit digjital është harruar. Po ashtu janë lënë në harresë të plotë mësimi përmes inteligjencës artificiale, zgjerimi i bibliotekave dhe rritja e numrit të titujve të librave në shkolla, jo më nismat si “Shqipëria lexon”, e cila, edhe pse u mor nga paraardhësit e ministrisë, u hodh në kosh brenda vitit.

Nxënësit elitare jo vetëm që nuk nxiten në prirjet që kanë, por atyre u tregohet vetëm dera e kurseve private, pasi Ministria e Arsimit nuk i

përmbush dot detyrimet e saj për hartimin e një kurrkule të veçantë dhe as për mjedise që nxitin dhe mbështesin këtë kategori nxënësish. Dijet e qëndrueshme dhe të duhura për jetën ua kanë lënë vendin kopjeve në provim, kurseve pas mësimit dhe rryshfetit për notën.

Neni, për të cilin votuam pro, ai i ndalimit të mësuesve me rekorde kriminale, nga mënyra si është formuluar, është kaotik dhe me shumë gjasa mund të bëhet i pazbatueshëm. Nuk e di se si Ministria e Arsimit ka tagrin dhe të drejtën ligjore të nxjerrë një udhëzim për veprat penale që ndalojnë mësuesin të japë mësım. A do të hyjnë në këto vepra penale dënime të parashkuara më herët? Për shembull, si do të trajtohet një mësues, i cili është kapur si student duke pirë një cigare marihuanë apo për kalim të paligjshëm të kufirit? A nuk do të ishte më mirë që veprat penale, të cilat ndalonin ushtrimin e profesionit të mësuesit, të përcaktoheshin në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë? A mundet që mësuesi të paraqesë një formular vetëdeklarimi në lidhje me gjendjen gjyqësore dhe më pas të verifikohet?

Unë besoj se nuk ka asnjë pengesë ligjore dhe është e mundur të bëhet, sikundër e kam përmendur edhe në Komisionin e Edukimit, por ne nuk mund të gjurmojmë me iniciativa individuale se kush ka kryer vepra penale jashtë vendit dhe vjen të punësohet si mësues në Shqipëri. Këtë ia përcolla ministres edhe në Komisionin e Medies, duke i referuar edhe raste specifike, sepse aktualisht ka mësues që janë të dënuar jashtë vendit dhe për ta nuk merret asnjë masë, por vijojnë të jenë ende në sistemin arsimor.

Së fundi, të nderuar kolegë, këto ditë po zhvillohen provimet e Maturës Shtetërore, por dalja e tezës në rjetet sociale, kopjimi dhe kushtet në të cilat u zhvilluan provimet, sollën zhgënjim në një pjesë të mirë të maturanëve dhe prindërve të tyre. E solla këtë argument për të kuptuar nevojën e madhe që kemi për të diskutuar thelbin e çështjeve të arsimit dhe jo të ndryshimeve ligjore që vetëm rritin e ndërlikojnë burokracinë dhe nuk sjellin ndryshime pozitive dhe efekte afatgjata në drejtim të përmirësimit të cilësisë së arsimit; reduktimit të braktisjes shkollë; uljes së numrit të analfabetëve funksionalë; rritjes së numrit të maturanëve dhe studentëve që vërtetë janë ekselentë.

Në vijimësi të logjikës së paraqitur më sipër, ne do të ishim gati të votonim ndryshime të tilla,

si: rritjen e buxhetit të arsimit; rritjen e pagave të edukatorëve, mësuesve, mësuesve ndihmës, psikologëve, sociologëve dhe punonjësve joarsimorë, rritjen e fondeve për kualifikimin e trupës mësime të ndërhënëse, dhe jo vetëm, zgjerimin e shërbimeve sociale në shkolla për nxënësit dhe prindërit e tyre; miratimin e statusit të mësuesit larg politikës, në shërbim të komunitetit, sipas një hierarchie që merr në konsideratë integritetin moral, atë profesional dhe arritjet e tij në studimet universitare, si dhe kualifikimin e vijueshëm gjatë ushtrimit të profesionit; rritjen e kapaciteteve të intelligjencës artificiale në shkolla; shtimin e numrit të kabineteve dhe laboratorëve, të mjeteve didaktike, të pajisjes me instrumente muzikore, të infrastrukturës sportive në shkolla, si fusha tenisi, basketbolli e futbollit; ngritjen e qendrave të ekselencës për arsimin parauniversitar në çdo qark të vendit; fuqizimin e arsimit dhe formimit profesional, i cili duket se është harruar nga kjo qeveri, e cila në vitin 2013 e quante një prioritet madhor.

Për të gjitha këto arsye dhe argumente që përmenda dhe për shumë halle e probleme që ka arsimit ynë prej çerdhes e deri në universitet, ne jemi gati të japim kontributin tonë, por nuk mund të votojmë ndryshime, të cilat ministria i shikon më shumë si një mundësi për të zgjidhur hallin e shpopullimit dhe të zbrazjes së shkollave që në fund ta fuqizojnë drejtuesit e shkollës politikisht dhe t'u lënë hapësirë për punësime preferenciale sesa si reforma të mirëfillta. Kjo nuk është rruga ku kërkon të shkojë arsimit ynë. Përkundër parullës suaj në zgjedhjet e fundit, duket se për arsimin keni vendosur të ecni vetëm mbrapa.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjala për zonjën Pranvera Resulaj.

Të përgatitet zonja Ina Zhupa.

Pranvera Resulaj – Faleminderit, Kryetare!

Së pari, shumë shkurt, pasi edhe kolegët e diskutuan, dua ta falënderoj ministren e Arsimit, sepse në fjalën e saj ishte shteruese për të gjitha risitë dhe pritshmëritë e këtij projektligji!

Nuk pretendoj të jem një njohëse shumë e mirë e arsimit parauniversitar. Projektligji u paraqit në Komisionin për Ekonominë dhe Financat për dhënie mendimi dhe, sigurisht, kur projektligjet vijnë në Komisionin për Ekonominë dhe Financat, supozohet të fokusohemi tek efekti

financiar në buxhetin e shtetit, por mendoj se, kur vjen fjala për një çështje me përparësi kombëtare, siç është arsimit, shifrat dhe vlerat duhet të dalin në plan të dytë. Ky projektligj ka shumë elemente në brendësi të tij. Ai përmirëson atë që është thelbësore: cilësinë e një arsimit eficient dhe të rëndësishëm dhe, mbi të gjitha, jo thjesht duhet të garantojë atë që është një e drejtë kushtetuese për t'u arsimuar, por, për të shkuar më tej, për ta garantuar këtë të drejtë gjithëpërfshirëse dhe të barabartë.

Ashtu sikurse u përmend edhe nga kolegët parafolës, janë disa elemente që përcaktojnë saktë dhe qartë pse ky është një projektligj, i cili sjell disa risi për gjithëpërfshirjen dhe barazinë. Këto elemente do t'i përmend në mënyrë të përmbledhur, duke tentuar shkurtimisht të shikoj se çfarë sjellin ato për rajonet nga vijmë, dhe janë pikërisht koncepti i qendrës burimore, ai i shkollës së bashkuar dhe ai i shkollës me status të veçantë. Qëllimi i krijimit të qendrave burimore, ashtu sikurse u sqarua edhe nga ministria e Arsimit, zonja Kushi, është garantimi i të drejtës për arsim cilësor dhe shërbime të specializuara, rehabilituese në qendrat burimore për nxënësit me aftësi të kufizuara, pavarësisht llojit të vështirësisë apo institucionit arsimor që kanë përzgjedhur për arsimimin e tyre. Pra, të ofrohen shërbime mbështetëse rehabilituese edhe në shkollat e zakonshme.

Duket si një fjali klishe dhe e përmbledhur në një tekst, ndoshta me fjalë të bukura, por do t'ju kërkoj që për një moment të kujtojmë rreth nesh njerëzit që kanë përgjegjësinë për t'u kujdesur për fëmijët me aftësi të kufizuara, për t'i bërë ata të gatshëm dhe të rehabilituar në shoqëri, ndonjëherë edhe më thjesht akoma për t'i bërë të aftë që minimalisht të kujdesen për veten. Kam në mendje shumë njerëz të tillë, të cilët nuk do t'i përmend për diskrecion, por jam shumë e sigurt se të gjithë ata, që përballen me këtë lloj vështirësie, e përkrahin gjerësisht përfshirjen në këtë projektligj të kësaj qendre burimore.

Në projektligj flitet edhe për garantimin, mirëfunksionim dhe eficiencën e shkollave të bashkuara, të cilat janë institucione arsimore parauniversitare publike, që përfshijnë nxënësit të disa niveleve arsimore. Është një koncept që ka ekzistuar edhe më parë, por, duke u përfshirë në ligj, bëhet më konsistent, më imponues dhe më detyrues.

Lëvizjet demografike kanë bërë që të kemi fshatra, zona periferike ose zona rurale, të cilat kanë shkolla të mira, por nuk kanë nxënës. E përmenda edhe në Komisionin e Ekonomisë rastin e fshatit Bestrovë në Vlorë, i cili ka një shkollë të investuar, por atje nuk ka fëmijë. Ndoshta nuk është momenti këtu, por edhe njësitë e qeverisjes vendore, sistemi arsimor, Ministria e Arsimit, zyrat e arsimit do të duhet të përdorin incentiva, në mënyrë të tillë që, të paktën në zonat ku shkollat ekzistuese janë me nivel dhe standard shumë të mirë, të gjendet një mënyrë për funksionimin e tyre në formatin e shkollave të bashkuara.

Në projektligj propozohen shkollat me status të veçantë si institucione arsimore publike parauniversitare, me strukturë organizimi, kurrikul dhe mënyrë financimi të ndryshme nga institucionet arsimore publike parauniversitare, me qëllim sigurimin e formimit artistik mbi baza të vërteta profesionale; të ruhet tradita dhe identiteti i shkollës në profilet muzikë, arte figurative dhe balet.

Në fakt, duke parë shkollat me status të veçantë dhe duke diskutuar në komision, më pëlqeu ideja që edhe shkolla e mesme e muzikës “Naim Frashëri” në Vlorë, me një traditë shumë të mirë, të jetë një përfituese potenciale e këtij statusi, por, ashtu sikurse të gjitha institucionet e tjera arsimore me status të veçantë, për ta përfituar këtë status do të duhet një VKM. Shpresoj shumë që edhe kjo shkollë ta përfitojë atë.

Nuk po ndalem te garantimi i të drejtës për arsim të orientuar me drejtim artistik dhe sportiv. Ashtu siç e përmendën edhe kolegët më parë, qëllimi i vetëm është që t’i bëjë sa më atraktive, sa më gjithëpërfshirëse dhe sa më edukative shkollat për fëmijët tanë.

Do të doja të vazhdoja edhe më tej, por më duket me shumë interes, dhe dua ta falënderoj grupin e punës dhe ministren e Arsimit (është një rast specifik, kur një mësues depërtoi në sistemin arsimor pasi ishte i dënuar), që në momentin më të parë, kur u hartua një projektligj i ri “Për arsimin”, futi një nen, i cili përjashtoi dhe i heq të drejtën një mësuesi që ka qenë i dënuar me vendim të formës së prerë për krime seksuale apo për krime të tjera. Detajet nuk kanë shumë rëndësi, por në thelb, në princip janë një element dhe një tregues shumë i mirë, që kanë si qëllim mbrojtjen e fëmijëve tanë nga të gjitha format dhe

nga i gjithë ambienti i rrezikuar nga elementë të tillë, të cilët janë persona që kanë kryer krime seksuale apo krime të tjera.

Do të shkoja përtej kësaj, që fëmijët tanë të mbrohen. Këtu është folur edhe për regjistrin e personave që kanë kryer krime seksuale. Ne e kemi kaluar këtë projektligj, i cili ka ardhur si nismë deputeti dhe si propozim nga zgjedhësit dhe është një tregues shumë i mirë dhe një hap para. Pavarësisht se do të duhet të bëhet funksional, përsëri është një instrument shumë i rëndësishëm për të garantuar atë që thashë pak më parë: mbrojtjen e fëmijëve tanë.

Do të doja që punonjësit socialë në shkolla të jenë shumë më aktivë dhe shumë më të përfshirë. Ideja ime është që njësitë e qeverisjes vendore do të duhet të kenë punonjëse sociale jo vetëm në nivel bashkie, por edhe në nivel rajonesh, sepse nevoja për t’i mbrojtur fëmijët është gjithmonë e rëndësishme, për këtë duhet bashkëpunimi i të gjitha institucioneve. Këtë kërkon të bëjë ky projektligj: të bashkojë dhe të strukturojë në një mënyrë shumë të saktë mirorganizimin e të gjitha institucioneve për të garantuar cilësinë e mësimdhënies gjithëpërfshirëse dhe të barabartë për të gjithë.

Ju ftoj të bashkohemi për ta miratuar këtë projektligj.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Zonja Ina Zhupa nuk është.

Fjala për zotin Bujar Leskaj.

Të përgatitet zonja Erisa Xhixho.

Bujar Leskaj – Në fakt, ashtu si deputetja parafolëse, edhe unë nuk jam ekspert i arsimit parauniversitar dhe nuk kisha ndër mend të flisja, por, duke menduar këto ditë në komision, hasa në një fakt drithërues si deputet i Vlorës, por besoj se dhe ju e keni në rrethet apo qarqet tuaja. Janë me dhjetëra fshatra në Bashkinë e Selenicës, kryesisht në Lumin e Vlorës, por edhe më gjerë në rrethin e Vlorës, që i kanë mbyllur shkollat e tyre. Konkretisht, këto shkolla janë mbyllur totalisht ose funksionojnë gjysmë: në Dukatin e Vjetër është mbyllur; në Tragjas, në Radhimë, në Sherishtë, në Mekat janë mbyllur; në Kërkovë ka mbetur vetëm një klasë e përbashkët; në Mifol është mbyllur; në Kaninë është me klasa të përbashkëta; në Kocul ka mbetur vetëm shkolla fillore; në Gërrec është mbyllur; në Mallkeq është mbyllur; në Gorisht është mbyllur; në Vranisht

është mbyllur; në Mesaplik është mbyllur; në Lapardha është mbyllur; në Treblövë është vetëm një klasë e përbashkët; në Velsh ka klasa të përbashkëta; në Ramicë, në Matogjin, në Bashaj janë mbyllur, por janë edhe dhjetëra shkolla në të gjithë Shqipërinë.

Vetvetiu, kur vjen një përmirësim ligjor, personalisht e suportoj ministren e Arsimit. Në vijim, ky është ndryshimi i tretë që bëni: keni bërë ndryshime në vitin 2015 dhe në vitin 2018. Pyetja është: çfarë mangësish plotëson dhe çfarë defektesh plotëson? Për këtë problem të mprehtë që ka qarku i Vlorës, por besoj edhe të gjitha qarqet e Shqipërisë, ju zgjidhni apo nuk zgjidhni 30% të problematikës. Në këtë kontekst, kur ju sillni ndryshime ligjore dhe pretendoni që keni sjellë ndryshime të mëdha, të cilat, për mendimin tim, nuk janë as të nivelit të vitit 2015, ju nuk keni zgjidhur asgjë, përveçse keni bërë një kozmetikë të punës suaj duke u përpjekur të argumentoni që arsimit nuk është në krizë. Ju bëni retushime, të cilat nuk e prekin thelbin dhe nuk janë politika afatgjata. Nuk ka mundësi që ju të bëni politika afatgjata në arsim, në rast se mezi i keni kaluar investimet në arsim në 3% të PBB-së, në një kohë kur në shtete normale e kanë arsimin prioritar, 5% të PBB-së.

Strategjia kombëtare e arsimit, sikundër deklarohet, ka vizion një sistem arsimor gjithëpërfshirës dhe të bazuar në parimet e barazisë dhe të mësimin gjatë gjithë jetës, që mundëson formimin cilësor të të gjithë individëve, duke kontribuar në mirëqenien personale të tyre, si dhe në forcimin e demokracisë dhe integrimin e vendit në BE, ku objektiv specifik është gjithëpërfshirja dhe barazia në arsim. Në këtë kontekst, kur kemi gjithë këtë zbrazëti, gjithëpërfshirja dhe arsimimi cilësor i nxënësve, pavarësisht se në cilën zonë të Shqipërisë gjenden, që është detyrim kushtetues, nuk mendoj se është realizuar. Po, ministrja ka dhënë një zgjidhje shumë të mirë që ka futur dhe do të implementojë konceptin e shkollave të bashkuara. Megjithatë ato kanë qenë në një formë, por janë quajtur shkolla të mesme të bashkuara. Tani ju e zgjeroni, dhe bëni shumë mirë që i kapni të tria nivelet, por përsëri, nisur nga numri i ulët i nxënësve në disa shkolla të zonave rurale, krijimi i këtyre shkollave është i domosdoshëm, sepse, për shkak të mosplotësimit të numrave, nxënësit dhe fëmijët ose mbeten të

paarsimuar, ose migrojnë brenda ose jashtë Shqipërisë, duke sjellë pasoja të tjera të rënda afatgjata ekonomiko-sociale. Por ju, zonja Ministre, do të pretendoni vërtet që keni bërë ndryshime thelbësore të qenësishme, në rast se me guxim do të vendosnit që dhe në ato fshatra sado të thella të jenë, në rast se ka qoftë edhe 5 fëmijë, atje të hapet shkolla fillore, shkolla 9-vjeçare, dhe shkollat e mesme le të jenë të bashkuara në rang njësie administrative, atje ku kanë qenë apo në varësi të zonave të tjera. Të gjithë ne e dimë dhe e kuptojmë që sistemi arsimor në Shqipëri është në krizë. Kjo nuk është përgjegjësi e ministres së Arsimit, por ne duhet të punojmë dhe çështja është si të dalim nga kjo krizë. Ju dhe deputetët e mazhorancës, pse jo edhe të opozitës, në asnjë rast nuk do të arrini t'i jepni zgjidhje këtij problemi nëse nuk loboni që arsimit, siç e thashë edhe më sipër, të jetë në nivelin 5% të PBB-së.

Nga ana tjetër, përveçse të rinjtë po largohen gjithnjë e më shumë nga Shqipëria, degët e mësuesisë nuk po preferohen më dhe në shumë universitete janë duke u mbyllur, për arsye se nuk po suportohen me incentiva të ndryshme. Mësuesit janë lënë vetëm në gjithçka dhe janë, në njëfarë mase, peng i politikës, pavarësisht se e maskoni ju me portale, pa portale, duke i ngarkuar me burokraci të panevojshme, e cila ndikon edhe në cilësinë e mësimdhënies.

E pra, sipas Bankës Botërore, ndryshimin e bën një mësues i mirë, dhe ke shkollë të mirë, ke arsim të mirë, kur ke një infrastrukturë të mirë shkollore. Me këto ndryshime në ligj, pavarësisht përpjekjeve për inkurajim, ju nuk e zgjidhni këtë problem.

Unë po ju jap disa shifra, që i kam marrë nga një studim i një eksperti parauniversitar, nga një pedagog në Vlorë, Ardi Stefa. Në maturën shtetërore 2013 morën pjesë rreth 46 000 maturantë, ndërsa në maturën 2015, afërsisht 40 000. 40 000 maturantë ishin para 8 vjetëve, minus 28 000 maturantë këtë vit, janë 12 000 maturantë më pak, më saktë 30% më pak. Po ta krahasojmë këtë me shifrën 46 000, që ishin në vitin 2013, i bie që sot, pas 10 vjetësh, ne kemi 18 000 maturantë më pak, afro 30% më pak se viti 2013. Mendoni në një moment: çfarë mund të ndodhë pas 5, 10 ose 20 vjetëve? Kjo është pyetja që duhet të shtrojë çdo deputet i përgjegjshëm i këtij parlamenti dhe çdo ministër që ndien

përgjegjësinë e punës, pavarësisht përpjekjeve të ministres, të cilat nuk dua t'i mohoj kurrsesi.

Sipas të dhënave të publikuara edhe në mediet kombëtare, në vitet 2022-2023 në shkollat shqiptare kishte 58 000 nxënës më pak, krahasuar me 5 vjet më parë. Sipas të dhënave të INSTAT-it, në vitet 2017-2018 kishim 153 nxënës për 1000 banorë, në vitet 2021-2022 kishim 136 nxënës për 1000 banorë. Nuk është vetëm rënia natyrore e popullsisë, por është edhe shpopullimi për arsye emigrimi, por edhe largimi i të rinjve, që po thellon një plagë 30-vjeçare për shoqërinë tonë, e cila, për fat të keq, u thellua në këta 10 vjet të sundimit të “sektit Rama” në vend.

Mijëra të rinj nën moshën 18 vjeç, një kontingjent për arsimin e mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë zgjedhin emigrimin, në shumicën e rasteve me familjet e tyre.

Politikat arsimore dhe politikat e tjera sociale të sektit “Rama” në pushtet kanë 10 vjet që vetëm nxisin emigrimin, analfabetizmin, analfabetizmin funksional, ndëshkojnë të arsimuarit dhe vrasin shpresën. Në këta 10 vjet mbi 300 000 të rinj janë larguar dhe mbi 500 000 shqiptarë janë larguar nga Shqipëria. Në këta 10 vjet afërsisht 150 000 nxënës braktisën shkollën. Vetëm këtë vit nga 31 000 maturantë, 11 000 kanë aplikuar për të studiuar jashtë shtetit. Këtu nuk bëhet fjalë vetëm për nxënësit ekselentë, por bëhet fjalë për shumë e shumë nxënës të tjerë. Kjo shifër rritet vit pas viti, duke bjerrë besimin në vend, në veçanti duke bjerrë besimin te rinia.

Po kthehem përsëri në fund të këtij diskutimi modest te Vlora. Në Vlorë në vitin shkollor 2022-2023 numri i nxënësve është 12 300. Vitin e kaluar shifra ishte 13 962, duke dëshmuar që këtë vit janë 1662 nxënës më pak. Në Vlorë dominon arsimi publik, ku vetëm 15% është arsimi privat dhe gjithsej janë 43 shkolla publike dhe 11 private. 800 janë klasa të para.

Zonja Ministre, besoj se më ndiqni me vëmendje.

617 janë klasa të dhjeta. Diferencën bëjeni vetë!

Më pak nxënës regjistrohen në gjimnaz, kjo si rrjedhojë e të gjithë politikës integrale që ndjek qeveria juaj. Sado të përpiqeni me këto plotësime pozitive që keni bërë, duhet të kaloni me guxim dhe të hapni shkolla në zonat e thella malore, atje ku ato janë mbyllur. Me shkollat e bashkuara krijohet mundësia për një zgjidhje në Vlorë, me

10% të atyre shkollave që përmenda në fillim. Nuk dua të keqkuptohet diskutimi im, por dua të them sa personalitete të shkencës, të kulturës, të artit vetëm në 30-50 vjetët e fundit e kanë zanafillën e karrierës së tyre intelektuale në bankat e këtyre shkollave, të cilat i citova në fillim dhe janë mbyllur në këta 10 vjet të qeverisjes suaj.

Ju faleminderit, zonja Ministre, dhe shpresoj të mos më keni keqkuptuar! Po të më keni keqkuptuar, jam gati për të replikuar!

Lindita Nikolla – Po, zonja Kushi, keni kërkuar fjalën.

Evis Kushi – Me disa nga shqetësimet që ngritët, zoti Leskaj, jam dakord, sigurisht, është dhe shqetësimi ynë, pavarësisht se shumë nga ato që thatë, nuk kanë lidhje me projektligjin, por nuk jam aspak dakord kur thoni: “Ndryshimet që keni sjellë, janë kozmetikë”. Nëse juve ju duket kozmetikë që shkollat speciale për nxënësit me aftësi ndryshe të kthehen në qendra burimore, sipas modeleve më të mira të Bashkimit Europian, nuk mund të jem dakord me ju. Madje në Vlorë ka një shkollë speciale për këta nxënës, e cila funksionon me ligjin në fuqi njësoj si shkollat e tjera. Por ajo shkollë nuk mund të japë maksimumin për këta nxënës, për familjet e tyre, për mësuesit që punojnë aty, ashtu siç është organizuar. Prandaj jemi të detyruar ta ndryshojmë ligjin, në mënyrë që kjo shkollë të shërbejë jo vetëm për nxënësit e saj, po edhe për nxënësit me aftësi ndryshe apo për mësuesit ndihmës, që janë të angazhuar në shkolla të tjera normale.

Juve ju duken kozmetikë institucionet arsimore plotësuese, ato *after school*, sepse bëtë një pyetje: çfarë vakumi ligjor ka? Ja pra, ky është vakumi ligjor. Gjatë këtyre viteve, pas miratimit për herë të fundit të ndryshimeve ligjore, janë ngritur qendra që quhen “pas mësimi” dhe ku fëmijët tanë shkojnë atje të bëjnë detyrat e shtëpisë, ndërkohë që askush nuk garanton që ata njerëz të angazhuar atje, të cilët mund të mos jenë fare mësues, pasi ligji nuk ka asnjë nen që të përcaktojë çfarë kriteresh a procedurash duhen për të hapur këto shkolla, nuk rrezikojnë formimin e fëmijëve tanë.

Ju duket kozmetikë nëse u japim mundësinë nxënësve të talentuar në qytetet e vogla, artistëve të vegjël, që të ndjekin arsimin e orientuar?

(Ndërrhyrje pa mikrofon nga salla)

A e dini ju se sot, në qytete të vogla nuk ka shkolla artistike?

Si kanë qenë? Më thoni nëse ka. Nuk ka shkolla artistike në qytetet e vogla. Prandaj ne do të hapim klasa artistike në shkollat normale, që edhe ata nxënës të talentuar atje të marrin mësim të orientuar. Janë vetë prindërit ata që na kërkojnë t'i regjistrojnë fëmijët në klasë të parë, edhe nëse fëmija i tyre i mbush gjashtë vjeç më 12 shtator, jo më 11 shtator kur hapet shkolla këtë vit.

Tani ju thoni që të mos ua plotësojmë këtë kërkesë prindërve, sepse ligji nuk e lejon, dhe se mësuesi e drejtori i shkollës penalizohet nëse e regjistron?

(Ndërrhyrje pa mikrofon nga salla)

Nuk është diskutim ky. Ju lutem!

Tjetër: personat e dënuar për vepra penale, ju mendoni të jenë nëpër shkollat tona? T'i lejojmë?

(Ndërrhyrje pa mikrofon nga salla)

Ligji aktual nuk ka asnjë nen, që t'i pengojë personat e dënuar për krime ndaj të miturve, që të punësohen si mësues. Është pikërisht ky ligj që do t'i ndalojë, dhe do t'i ndalojë sipas procedurave të përcaktuara qartë.

Lindita Nikolla – Faleminderit, ministre Kushi!

Evis Kushi – Ndërkohë, gjithsesi e kemi nxjerrë një udhëzim në dhjetor, po për ta bërë më të fortë zbatimin e kësaj pike, e kemi përfshirë në ligj. Natyrisht, ka edhe shumë çështje të tjera, të cilat s'janë aspak kozmetike, por edhe një gjë dua ta them: sikurse dhe ndryshime të vogla të ishin, nëse u shërbejnë 480 mijë nxënësve në të gjithë Shqipërinë, ia vlen ta ndryshojmë ligjin, sepse në arsim edhe një politikë modeste ndryshon jetën e shumë familjeve.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjala për zonjën...

(Ndërrhyrje pa mikrofon nga salla)

Nuk ka replikë mbi replikë, të lutem!

Fjalën e ka zonja Erisa Xhixho.

Të përgatitet zoti Asllan Dogjani.

(Debate në sallë)

Erisa Xhixho – E nderuar Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Arsimi parauniversitar, si baza e edukimit të brezit të ri, ka një rëndësi të jashtëzakonshme. Në mënyrë që të garantojmë një arsim parauniversitar cilësor, para së gjithash duhet të garantojmë një

sistem arsimor të depolitizuar dhe një garë të barabartë për maturantët që aspirojnë të bëhen studentë pak muaj më vonë.

Do të ndalem vetëm te këto dy elemente, duke lënë mënjanë qindra probleme të tjera që ka arsimit sot.

Së pari, është fatkeqësi që mësuesit tanë e kanë të pamundur të jenë të depolitizuar. Sikur të mos mjaftonte puna e lodhshme, shpeshherë me turne, e herë të tjera edhe me klasa të përbashkëta, ata duhet të punojnë edhe për partinë. Lodhja e tyre më e madhe nuk është procesi mësimor, përgatitja në shtëpi, kushtet shpeshherë të papërshtatshme në shkollë, apo në raste të tjera edhe rruga e gjatë për të shkuar atje ku japin mësim. Lodhja më e madhe është të kapin pikët në platformën “Aktivisti”. Performanca e tyre matet nga *like-t* dhe *share-t* e qeverisë në këtë aplikacion, një praktikë tërësisht antiligjore, e cila politizon me detyrim stafin pedagogjik.

Së dyti, nëse ndalemi te shpopullimi i vendit, fatkeqësisht, një “qytet” i tërë me të rinj largohet çdo vit nga Shqipëria. Ikin sepse janë të pakënaqur, ikin sepse nuk kanë shpresë; ikin sepse kërkojnë një të ardhme më të mirë. Ata ikin, Shqipëria plaket, ekonomia dobësohet, ndërsa e ardhmja e vendit bëhet gjithnjë e më e paqartë. Në fakt, këtë vit sezoni turistik nxjerr në pah përmasat dramatike të emigrimit të të rinjve. Sektori i hotelierisë dhe shërbimeve ka nevojë urgjente për punonjës, ndërsa bizneset janë detyruar prej kohësh të importojnë krahe pune.

Së treti, të rinjtë shqiptarë nuk e shohin Shqipërinë si një vend që ofron shanse e mundësi të barabarta. Maturantët janë shumë skeptikë dhe mosbesues te matura shtetërore. Fakti se para tri ditësh teza e provimit u publikua sërish në rrjetet sociale vetëm 20 minuta pasi ishte shpërndarë, kërkon hetim dhe përgjegjësi, jo thjesht propagandë. Është e disata herë që ndodh, por ende nuk ka përgjegjës konkretë në lidhje me këtë fenomen që po ndodh së fundi.

Për t'u kthyer sërish tek arsimit, më lejoni të përcjell shqetësimin e shumë prindërve me fëmijë në shkollat fillore e 9-vjeçare. Kjo qeveri dhe kjo ministri kanë pasur një premtim: “Bëjmë detyrat e shtëpisë”. Është premtuar, por ende nuk është zbatuar në shkollat e vendit. Ky program do t'u mundësonte fëmijëve qëndrim më të gjatë në shkollë, duke konsumuar dhe vaktin e drekës, e gjithashtu duke ulur kostot e prindërve. Shumica

e tyre, në mungesë të kohës dhe në pamundësi për t'i lënë vetëm, detyrohen t'i dërgojnë në “*after school*”, ku pagesa minimale është nga 100 euro në 200 euro. Pyetja është: pse ka lindur “*after school*”? Ka lindur sepse shkollat tona mbarojnë në orën 11:00-12:00. Kësisoj, ku do t'i çojnë fëmijët gratë që janë në punë, prindërit që janë në punë? Në pamundësi për t'i çuar te gjyshërit apo diku tjetër, i çojnë në “*after school*”. Kostoja financiare është rritur disafish për prindërit, nëse marrim parasysh edhe kurset private, ku shumë prindër janë të detyruar t'i dërgojnë fëmijët. Në fakt, shumë mirë që me këtë projektligj rregullohet ky vakum ligjor, shqetësim që unë e kam ngritur që prej shumë kohësh, por fakti pse këto biznese ekzistojnë, është se shkollat tona mbarojnë shumë shpejt dhe ua bëjnë të pamundur grave dhe vajzave që të kujdesen për ta, duke shtuar koston e tyre të jetesës.

Gjithashtu, unë mendoj se ne duhet të ndërhyjmë në sistemin parauniversitar, te kurrikulat e edukimit. Në fakt, ne kemi nevojë të edukojmë të rinj me mendim kritik, të rinj që janë të aftë të mendojnë dhe të dinë bazat e shoqërisë e të edukimit qytetar. Nuk kemi thjesht nevojë të edukojmë të rinj me tekste përmendësh apo që thjesht bëjnë riprodhim. Kësisoj, është e domosdoshme që në kurrikulat tona të futet edukimi qytetar, për të pasur bazat dhe konceptet e demokracisë, në mënyrë që ata të dinë të drejtat e detyrimet e tyre, dhe të mund t'i mbrojnë ato në të ardhmen.

Pa dyshim që shqetësim tjetër mbetet mësimi me dy turne, gjë që ndodh në qytetin e Tiranës, ku mund të përmend rastin e “Ismail Qemalit”, ku ende vazhdon mësimi me dy turne, por edhe në shumë shkolla të tjera. Kjo kërkon një zgjidhje emergjente. Prandaj kam kërkuar dhe vazhdoj të kërkoj rritjen e buxhetit për arsimin, kjo jo thjesht pse ne japim buxhet në një sektor, por sepse ky duhet të jetë prioritet kombëtar për të zgjidhur edukimin dhe punësimin e të rinjve, për t'u dhënë atyre shpresë e mundësi, që nëpërmjet edukimit të mund të kenë një punë dhe një të ardhme në Shqipëri.

Të gjitha ato që ne ngremë si shqetësime nuk mund të zgjidhen thjesht me fjalët “do të”. Është e rëndësishme të kuptojmë se buxheti i parë që duhet të plotësohet nga ky parlament dhe kjo qeveri, do të duhet të jetë buxheti për arsimin. Në fakt, në Komisionin e Ligjeve kam shtruar pyetjen

se cili është afati i mbajtjes së këtij premtimi për programin “Bëjmë detyrat e shtëpisë”, dhe çfarë e pengon ekzekutimin e këtij programi. Është fare e thjeshtë: buxheti. Pra, prindërit janë të detyruar t'i çojnë në “*after school*” për mungesë buxheti, ndonëse kjo qeveri ka patjetër buxhet me bollëk, por që thjesht duhet t'i çojë te nevojat e qytetarëve. Pra, nuk ekzekutohet një program, i cili do t'i jepte zgjidhje mijëra e mijëra familjeve anembanë vendit.

Pa dyshim, përshëndes faktin se në këtë projektligj është vënë një nen për veprat penale të krimeve seksuale, sikundër është referimi në regjistrin kombëtar të të dënuarve për krime seksuale, por, fatkeqësisht, zonja Ministre, ky regjistër është ende i pazbatueshëm. Prandaj, kam kërkuar në çdo mbledhje komisioni, qoftë në Komisionin e Integritimit, qoftë në Komisionin e Ligjeve, e po e kërkoj edhe sot këtu: të angazhohemi për të vënë në zbatim atë regjistër, ndryshe ky nen i këtij projektligji është i pazbatueshëm. Dhe do të jetë për turpin tonë të gjendemi në situata të tilla si në Berat apo në Lushnjë, dhe të themi: kemi ligj, por s'kemi zbatimin e tij.

Kësisoj, ju ftoj të ndërjegjësohemi të gjithë dhe të punojmë për ta vënë në ekzekutim atë regjistër. Mbetem absolutisht e angazhuar që të kemi prioritet kombëtar arsimin, edukimin dhe mbrojtjen e fëmijëve tanë.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Diskutanti i fundit për këtë çështje është zoti Dogjani.

Aslan Dogjani – Faleminderit, e nderuar zonja Kryetare!

Kur është fjala për arsimin, sigurisht që duhet të bëhemi të gjithë bashkë, pasi nga arsimi fillon gjithçka, ndaj çdo ligj që u shërben qytetarëve shqiptarë, fëmijëve nëpër shkolla, mësuesve, sigurisht që është i mirëpritur.

Por çfarë ndodh në të vërtetë? A është për shkak të mungesës së ligjit, që në datën 17 maj Fatjoni, nxënësi 15-vjeçar nga Gramshi, nuk mundi të punonte pasdite si shpërndarës picash, sepse u vra nga shokët e klasës? Fatjoni nuk mundi të realizonte ëndrrën e prindërve dhe ëndrrën e vet, siç kishin planifikuar, për t'u larguar nga Shqipëria dy muaj më vonë, për shkak të varfërisë, sepse u vra padrejtësisht nga shokët e tij. Secili nga ne këtu duhet ta drejtojmë gishtin te vetja. Secili nga ne, për një moment duhet të

mendojmë sikur ai fëmijë 15-vjeçar nga Gramshi, i vrarë nga shokët e klasës, të ishte fëmija jonë. Dhe duke menduar sikur ai fëmijë të ishte fëmija jonë, ne duhet të marrim masa që ngjarje të tilla të mos përsëriten më nëpër shkolla.

Nuk është vetëm rasti i Fatjonit. Në Kamzë, një djalë tjetër 15-16-vjeçar u plagos në shkollë. Në një shkollë në kryeqytet u kërcënua një fëmijë tjetër me thikë, me doreza boksi. Nxënësit bullizohen, rrihen nëpër shkolla, dhe shumë pak merren vesh. Fatkeqësisht, kjo është gjendja në sistemin tonë arsimor parauniversitar. Nëpër shkollat tona në Tiranë, Kamzë, Paskuqan, por jo vetëm, pihet drogë. Disa fëmijë, në vend të librave marrin thika e doreza boksi nëpër çanta. A e dini sa fëmijë vuajnë? A e dini sa prindër vuajnë për shkak se fëmijët e tyre përdorin lëndë narkotike nëpër shkolla? Kjo është një tjetër arsye shumë e madhe që Shqipëria po braktiset, që sot kemi më pak fëmijë nëpër shkolla.

E fillova me këto ngjarje fjalën time në lidhje me ligjin “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, sepse për prindërit shqiptarë më e rëndësishme është siguria e jetës së fëmijës sesa dija. Është e patolerueshme që në një vend ku shkohet për të marrë dije, fëmijët të mbajnë nëpër çanta thika e doreza boksi. Ku janë psikologët? Ku janë mësuesit? Çfarë edukate po u japim fëmijëve tanë? Çfarë brezi po rrisim? Ku është shteti? Ku është arsimi cilësor që u premtua? Ku po shkojmë kështu? Nëse nuk jemi në gjendje të rrisim një brez të shkolluar e të edukuar, jemi të destinuar të shpërbëhemi si komb.

Arsimi është katandisur si mos më keq. Pyetja ime është: çfarë risie sjell ky projektligj? A do të ndalohet dhuna nëpër shkolla, pas këtij projektligji? A do të përmirësohet cilësia e mësimdhënies? A do të kemi më shumë fëmijë nëpër shkolla? Fatkeqësisht, unë mendoj se jo. Dhe kjo është ajo çfarë u intereson qytetarëve shqiptarë: çfarë risie sjell projektligji?

Ky projektligj nuk sjell ndonjë risi, me përjashtim të ndalimit për të punuar në sistemin arsimor parauniversitar të një mësuesi që është i dënuar me vendim të formës së prere për kryerjen e një krimi, pra të një personi që diskrediton pozitën e mësuesit.

Ndryshimet e tjera, me emërime e shkarkime mësuesish e drejtorësh, do të japin mundësi më të mëdha për ta mbajtur nën kontroll

mësuesin e drejtorin nga politika. E keni katandisur sistemin arsimor si të ishte shkolla e partisë. Depolitizimi i arsimit nga ana e qeverisë ishte një gënjeshtër e madhe. Qindra mësues, duke besuar se konkurset për drejtues në zyrat arsimore, për drejtor shkollë e zëvendësdrejtor ishin të vërteta, harxhuan dhe vazhdojnë të harxhojnë parà pa fund nga rroga e tyre për të noterizuar dokumente, për të marrë pjesë nëpër konkurse, që ishin paracaktuar nga partia për patronazhistët, e tani aktivistët.

Në vitin 2014 nisi propaganda “zero kopje” për maturën shtetërore. Në të njëjtën kohë filloi presioni dhe maturantët u vendosën nëpër korridore, holle e palestra shkollash, për eliminimin e kopjimit, por testi dilte në media, siç doli edhe tani, 20 minuta pas provimit, kështu që notat dhe rezultatet ishin fiktive. Edhe në vitin 2023 u përsërit e njëjta gjë: vetë Kryeministri nisi fyerjet për mësuesit, si budallenj, të paafhtë dhe se duhet t’i nënshtroheshin provimit për mbajtjen e vendit të punës, dhe çdo mësues u detyrua t’i nënshtrohej provimit, pavarësisht se ishin diplomuar në universitetet e vendit. Asnjë mësuesi nuk iu ofrua nevoja e kualifikimit nga qeveria. Mësuesit i kërkohet të marrë tri kredite, që kushtojnë nga 15 deri në 20 mijë lekë secili dhe paguhen nga pagat e mësuesve. Shpërblimi i fundvitit u hoq; rroga e 13-të, e premtuar nga qeveria, ishte një mashtrim i madh; rritja e rrogës për 10 vjetët e fundit për mësuesit nuk mbulon as 50% të inflacionit; vlerësimi i nxënësve me nota nga viti 2014 deri në vitin 2022 ishte një eksperiment i shëmtuar i arsimit parauniversitar dhe një kosto ekstra për mësuesit. Ata duhej t’i bënin vetë fletoret dhe regjistrat për të vlerësuar nxënësit me shenja në vend të notave, duke i stresuar e munduar pa fund mësuesit, gjë që u detyruat ta ndryshonin në vitin 2021. Edhe vlerësimi i nxënësit me portofolin e të nxënësit ishte një lodhje fizike për prindërit dhe për mësuesit. Asnjë ndihmë nuk pati për nxënësit dhe mësuesit për mësimin *online*, vetëm miliona para të shpenzuara për *smartphone* dhe tableta, sa për propagandë boshe.

Reforma për krijimin e shkollave si qendra komunitare, si projekt që ka marrë nga buxheti i shtetit miliona për propagandë, në realitet ishte një dështim i plotë. Sot ato shkolla janë të mbyllura me çelës dhe hapen vetëm për të bërë propagandë.

Nuk dua ta zgjatem, se e shoh që jeni lodhur, por do të kërkoja që ne, si Kuvend i Shqipërisë, të bënim një strategji kombëtare, me qëllim që në shkollat tona të mos kemi më dhunë fizike e psikologjike, të mos na vriten më fëmijë, të kemi mësues dinjitozë, me paga dinjitoze, se në këtë mënyrë do t'i shërbejmë vendit dhe fëmijët tanë nuk do të largohen, siç janë larguar.

Faleminderit që më dëgjuat!

Lindita Nikolla – Këtu mbyllem debatet për çështjet e sotme.

Siç ju njoftova në fillim të seancës, janë dhe projektvendimet për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit, propozim nga grupet parlamentare të PS-së dhe PD-së. Këto projektvendime janë pa diskutime.

Ju lutem, bëhuni gati për votim!

Të nderuar kolegë, kalojmë në procesin e votimit.

Hapet votimi për prezencën.

Mbyllet votimi.

Janë të pranishëm 87 deputetë.

Vazhdojmë me votimin e akteve.

Projektrezoluta “Për vlerësimin e veprimtarisë së Departamentit të Administratës Publike për vitin 2022”. Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i hapur. Procedura e votimit: një votim me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 72 vota pro, 14 kundër dhe 1 abstenim.

Miratohet projektrezoluta.

Kalojmë në projektrezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2022”. Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i hapur.

Hedhim në votim projektrezolutën e dakordësuar mes komisionit përgjegjës, Komisionit të Ekonomisë dhe Financave dhe deputetes Jorida Tabaku.

Procedura e votimit: një votim me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 83 vota pro, 3 kundër dhe 1 abstenim.

Miratohet projektrezoluta.

Vazhdojmë me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes se huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (huamarrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për programin për

menaxhim të qëndrueshëm dhe miqësor me klimën në sektorin e mbetjeve të ngurta”. Ky akt kërkon shumicë absolute votash për miratim. Procedura e votimit: dy votime me elektronikë. Votimi është i hapur.

Hapet votimi në parim me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Janë 72 vota pro, 11 kundër dhe 3 abstenime.

Miratohet projektligji në parim.

Kalojmë në votimin nen për nen me karton, sipas variantit të propozuesit.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi me elektronikë.

Hapet votimi në tërësi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Janë 73 vota pro, 11 kundër dhe 2 abstenime.

Miratohet projektligji në tërësi.

Projektligji “Për pranimin e protokollit për ndryshimin e marrëveshjes së Marrakeshit për themelimin e Organizatës Botërore të Tregtisë, marrëveshja për subvencionet e peshkimit”. Ky akt kërkon shumicë absolute votash për miratim. Procedura e votimit: dy votime me elektronikë. Votimi është i hapur.

Hapet votimi në parim me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Janë 82 vota pro, 2 kundër dhe 3 abstenime.

Miratohet projektligji në parim.

Kalojmë në votimin nen për nen me karton, sipas variantit të propozuesit.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi në tërësi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Janë 81 vota pro, 1 kundër dhe 3 abstenime.

Miratohet projektligji në tërësi.

Projektligji “Për qeverisjen elektronike”. Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Procedura e votimit: dy votime me elektronikë. Votimi është i hapur.

Hapet votimi në parim me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Janë 72 vota pro, 15 kundër dhe asnjë abstenim.

Miratohet.
Kalojmë në votimin nen për nen me karton, sipas variantit të komisionit.
Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.
(Nenet nga 2 deri në 59 u miratuan me të njëjtën procedurë votimi.)
Kalojmë në votimin në tërësi.
Hapet votimi në tërësi me elektronikë.
Mbyllet votimi.
Janë 72 vota pro, 14 kundër dhe asnjë abstenim.
Miratohet projektligji.
Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”. Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Procedura e votimit: dy votime me elektronikë. Votimi është i hapur.
Hapet votimi në parim me elektronikë.
Mbyllet votimi.
Janë 74 vota pro, 10 kundër dhe 1 abstenim.
Miratohet.
Kalojmë në votimin nen për nen me karton, sipas variantit të komisionit.
Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.
(Nenet nga 2 deri në 18 u miratuan me të njëjtën procedurë votimi.)
Kalojmë në votimin në tërësi.
Hapet votimi në tërësi me elektronikë.
Mbyllet votimi.
Janë 75 vota pro, 10 kundër dhe asnjë abstenim.
Miratohet projektligji.
Projektvendimi “Për një ndryshim në vendimin nr.69/2021 “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, i ndryshuar”.
Deputetja Mirela Pitushi caktohet anëtare e Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.
Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i hapur.
Hapet votimi.
Mbyllet votimi.
Janë 82 vota pro, asnjë kundër dhe 1 abstenim.
Miratohet projektvendimi.
Projektvendimi “Për një ndryshim në vendimin nr.69/2021 “Për caktimin e anëtarësisë

së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, i ndryshuar”.

Deputetja Oriela Nebiaj caktohet anëtare e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i hapur. Procedura e votimit: një votim elektronik.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 83 vota pro, asnjë kundër dhe asnjë abstenim.

Miratohet projektvendimi.

Projektvendim “Për një ndryshim në vendimin nr.69/2021 “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit” , i ndryshuar”.

Deputeti Asllan Dogjani caktohet anëtar i Komisionit për Sigurinë Kombëtare.

Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i hapur.

Procedura e votimit: një votim me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 80 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet projektvendimi.

Projektvendimi “Për një ndryshim në vendimin nr.69/2021 “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, i ndryshuar.

Deputeti Lodovik Hasani caktohet anëtar i Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i hapur. Procedura e votimit: një votim me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 83 vota pro, asnjë kundër dhe asnjë abstenim.

Miratohet projektvendimi.

Projektvendimi “Për një ndryshim në vendimin nr.70/2021 “Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit”, i ndryshuar”.

Deputeti Asllan Dogjani caktohet anëtar zëvendësues në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash.
Votimi është i hapur. Procedura e votimit: një votim me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 82 vota pro, asnjë kundër dhe asnjë abstenim.

Miratohet projektvendimi.

Faleminderit!

Këtu mbyllet seanca për sot.

Seanca e radhës do t'ju njoftohet.

Ditën e mirë!

(Seanca u mbyll në orën 18:30)

Kryetarja e Kuvendit

Lindita Nikolla

**Sekretare e Sekretariatit për
Procedurat, Votimin dhe Etikën
Klotilda Bushka**

**Drejtoresha e Shërbimit të Redaktorëve
Suela Bala**